



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19, 20 DHE 26 DHJETOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19., 20. I 26. DECEMBRA 2013. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017,
5. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,
7. Debat parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013,
8. Debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Predlog Vlade Republike Kosova o usvajanju Strategije o kvalitetu vazduha za 2013-2022. godinu i Akcionog plana za 2013-2017. godinu,
5. Razmatranje Izveštaja performanse javnih preduzeća za 2012. godinu,
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kosovske agencije za privatizaciju za 2012. godinu,
7. Skupštinska rasprava o Izveštaju Evropske komisije o napretku Kosova u 2013.god.,
8. Skupštinska rasprava o procesu pregovara o Sporazumu stabilizacije i pridruživanja,
9. Formiranje Ad hoc komisije za izbor kandidata za članove Odbora RTK-a,
10. Razmatranje preporuke Komisije za obrazovanje, kulturu, omladinu, sport, javnu upravu i medije o razrešenju 2 članova Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarimet në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Pasi s'është lajmëruar askush në emër të grupeve, po jua jep fjalën sipas rendit të paraqitur. Pra, fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Roli dhe rëndësia e Shërbimit Inteligjent do të duhej të trajtohej ndryshe ngaqë është akceptuar nga personalitete me ndikim dhe me kompetencë të vendit tonë dhe nga qendrat më relevante ndërkombëtare në këtë fushë.

Në fillet e krijimit të institucioneve tona shumë nga të emëruarit apo edhe të zgjedhurit me procedura formale kanë qenë me më shumë fat se sa të përgatitur për pozitat e tyre. Ndryshe, nuk ka qenë e mundur të veprohet për shumë arsye.

Kështu ka ndodhur edhe me emërimet e para në AKI. Për të gjithë ata që kanë një pozitë në këtë institucion, duhet të lirohen nga edukimi me ngarkesa në ndërtimin e raporteve hierarkike. Duhet ta dinë se institucioni i tyre është aset shumë i rëndësishëm për Kosovën dhe Kosova me AKI-në paraqesin një rëndësi tepër të veçantë për shërbimet inteligjente ndërkombëtare.

AKI nuk duhet të perceptohet as nga vendorët e as nga ndërkombëtarët në sferën e inteligjencës si një institucion i shtetit të vogël prej 2 milionësh, por si kapacitet me mundësi të definuara në shumëshifror, si mundësi për akses në rreze komunikimi në mbi 10 milionë shqipfolës, si rreze komunikimi në 9 milionë serbishtfolës, në 6 milionë kroatfolës, në 4 milionë boshnjakfolës, në 90 milionë turqishtfolës, në gjysmë milioni malazezësh dhe në shifra relevante për romë, ashkali, egjiptian të cilët kanë mundësi akses në komunikimet e etnive të tyre.

Gjithashtu Kosova duhet parë edhe si mundësi për akses në ambientet - lutjet fetare me tempuj të tri konfesioneve fetare më të mëdha në gjithë globin, në të cilat tanimë nuk frekuentohen vetëm për parimësi obligative në komunikimet shpirtërore.

Dhe, derisa është kështu, Kosova dhe AKI janë burim potencialesh dhe oazë me kapacitete e mundësi shumëshifrore për të kontribuar për paqe, siguri, në strategjinë antiterroriste për regjionin tonë dhe për prosperitet global.

Andaj, tendencat kërcënuese për investime që janë bërë për regjionin tonë dhe prosperitetin global, kërkojnë mbështetje edhe më të madhe nga faktorët relevantë ndërkombëtarë për AKI-në dhe institucionet tjera të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të grupit?

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Procesi i privatizimit në Kosovë ka filluar me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, i cili ka pasur për detyrë që t'i administrojë të gjitha pronat shtetërore, publike dhe shoqërore.

Rundi i parë i privatizimit është mbajtur në korrik të vitit 2013, ndërsa deri më tani janë privatizuar shumë ndërmarrje, në ndërkohë AKM-ja është shndërruar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit që ka filluar të funksionojë në shtator të vitit 2003.

Mjetet e akumuluar nga shtija e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore arrin një shumë të madhe, megjithatë këto mjete janë të ngrira dhe nuk janë brenda procesit aktiv ekonomik vendor.

Të nderuar deputetë,

Edhe kësaj radhe do të flas për Industrinë e Gomës Kimike “Ballkan të Suharekës, por sot nuk do të flas as për mënyrën se si u privatizua as për çmimin përbuzës me të cilin u privatizua ky gjigant i madh ekonomik, por kësaj radhe do t'i paraqes kërkesat e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje të cilët përveç që humbën vendin e tyre të punës, ata që nga viti 2005 nuk kanë përfituruar edhe as 20%, ajo që u takon me ligj.

Punëtorët e kësaj ndërmarrjeje shumë herë i janë drejtuar AKP-së dhe kanë vizituar edhe Gjykatën për të kërkuar atë çfarë u takon. Edhe sot vazhdojnë grevën për realizimin e të drejtave të tyre, disa prej tyre kanë protestuar edhe në Prishtinë.

Prandaj, nga kjo foltore kërkoj trajtimin me seriozitet të kësaj çështjeje nga organet përgjegjëse, kërkesat e tyre duhet trajtuar, nuk është e drejtë ata të protestojnë që sa kohë dhe mos të përgjigjet askush. Prandaj, mos të harrojmë se këta janë punëtorë që me mundin e tyre ndërtuan Kosovën. Këta janë ata punëtorë që na mundësuan që të kemi bursa gjatë shkollimit, prandaj një respekt më shumë, një angazhim më tepër për realizimin e kërkesave të tyre, sepse edhe ashtu këto kërkesa janë ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

I thërras për një moment kujtesës suaj. Gjatë gjithë kohës për derisa vazhduan dhe po vazhdojnë bisedimet e Qeverisë së Kosovës me Serbinë, ne Lëvizja “Vetëvendosje” ju kemi paralajmëruar se në këto bisedime janë një proces që afrojnë Kosovën më afër Serbisë dhe Serbinë më afër Evropës. Madje këtë paralajmërim ua kemi bërë shpeshherë edhe nga kjo foltore që tani po flas.

Sot jemi në një gjendje ku fatkeqësisht koha na dha të drejtë. Si rezultat i negociatave dhe i marrëveshjeve Thaçi - Daçiq, Serbia mori ditën e fillimit të negociatave për anëtarësim me BE, ndërsa MUP dhe institucionet e Serbisë, po legalizohen në Kosovë.

Ju deputetët nga cilido grup parlamentar që i keni mbështetur këto negociata me votën tuaj, të vetëdijshëm apo jo, jeni ata që falë mbështetjes suaj kryeministri negocioi me Daçiğin dhe falë këtyre negociatave, Serbia mori ditën e anëtarësimit në BE.

Bashkimi Evropian ka mbivlerësuar përparimet që i ka bërë Serbia në dialog me Kosovën duke ofruar si shpërblim nisjen e negociatave për anëtarësim. Kështu, ju i dhatë amnistinë Serbisë, asaj që mbi kurrizin e saj mban barrën e krimeve më të rënda kundër njerëzimit e gjencidit dhe spastrimit etnik në Kosovë.

Në negociata u propagandua shumë se negociatorët e Kosovës do të bisedonin patjetër edhe për të pagjeturit shqiptarë që u vranë dhe u zhdukën nga forcat serbe në luftë, por siç jemi dëshmitarë askush s’i përmendi kurrë në asnjë tryezë bisedimesh në Bruksel.

Ditëve të fundit, zbulimin e varrezave të pretenduar në varrezat masive diku në Serbi, familjarët e të humburve e pritën me ankth dhe me shpresë se do të mund t’i gjejnë së paku eshtrat e më të dashurve të tyre. Por, ata nuk e dinin se edhe kësaj radhe trupat e të vrarëve nuk e gjetën rrugën e kthimit për në atdhe. Familjarët shpresuan, por nuk e ditën se me trupat e shqiptarëve Serbia po bënte pazar. Pesë trupa të shqiptarëve të vrarë, Serbia i dha si kapar për diçka që edhe të vërtetë e mori paraprakisht.

Rastësisht apo jo, asfalti dhe objekti mbi trupat e shqiptarëve në Serbi, i përkiste një ndërmarrjeje që quhej “Kosmet-Put”, e që në shqip do të thotë “Rruga Kosova”.

E pra, e di apo nuk e di Bashkimi Evropian se nëpër çfarë rruge po i afrohet Serbia asaj.

“Kosmet-Put” quhet rruga e Serbisë drejt Evropës, rrugë e cila kalon mbi eshtrat e shqiptarëve të vrarë e të fshehur.

Kryeministri i Kosovës bisedon me kryeministrin serb jo për kthimin e trupave të të vrarëve e të zhdukur, por për kthimin e atyre që vranë. Ai nuk flet me Daçiğin për t’i kthyer trupat dhe eshtrat e shqiptarëve, por për t’i kthyer serbët policë të MUP-it në Policinë e Kosovës.

Në vend që ta kërkonte nga Brukseli hapjen e Kosovës, e cila është kthyer në një vend të izoluar në mes të Evropës, ai me marrëveshjet me Daçiğin, ia hapi dyert Serbisë drejt integritetit.

Në vend që të kërkonte drejtësi për të gjitha krimet, vrasjet dhe spastrimet etnike ndaj shqiptarëve edhe pas luftës në pjesën veriore të Kosovës, pikërisht këtë drejtësi ia la në dorë atyre që i shkaktuan këto krime.

Si rezultat i këtyre bisedimeve MUP-i i Serbisë rikthehet në Kosovë, çetnikët udhëheqin me komuna, madje edhe ia kanë mësyre edhe këtij Kuvendi nëpërmjet kërkesave për vende të rezervuara.

Në të vërtetë, me luftën çlirimtare të UÇK-së e hoqëm Kosovën nga Serbia, por me negociata e mbajtëm Serbinë brenda Kosovës. Nëse UÇK-ja e shkëputi me luftë Kosovën nga Serbia, Qeveria e Kosovës e riktheu jo Kosovën në Serbi, por Serbinë në Kosovë. Madje Daçiqi e Thaçi kërkojnë edhe më shumë se sa kaq, kërkojnë diçka që përveç se është e papranueshme për ne është edhe e dhimbshme. E dhimbshme, por njëkohësisht e padurueshme, është tashmë kjo situatë.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Një kategori e dëmtuar keq nga lufta për 14 vjet me radhë po vazhdon të përballët me gjendje jashtëzakonisht të rëndë dhe kjo kategori janë të plagosurit civilë nga minat si pasojë e luftës në Kosovë.

Endrit Hyseni nga Carraleva e Shtimes në atë kohë ka qenë 7 vjeçar, sot është 21-vjeçar. 2/3 e jetës së vet të deritashme i kalon në një situatë jashtëzakonisht të rëndë pas humbjes së këmbës. Por ai me të gjithë tjerët që i takojnë kësaj kategorie definitivisht sot paraqesin një prej grupeve të njerëzve, një prej kategorive më të marginalizuara në shoqëri në Kosovë e cila nuk ka përkrahje institucionale dhe nuk ka madje as përkrahjen e nevojshme për jetë dhe nevojat bazike për jetë normale dhe të dinjitetshme.

Për ma keq, 14 vjet pas lufte edhe më tutje nuk dihet saktë numri i njerëzve në Kosovë që janë plagosur nga minat si pasojë e luftës që ka ndodhur në Kosovë. Në vitin 2011, me nismën e një grupi të invalidëve civilë nga lufta është themeluar Shoqata e cila po angazhohet për më shumë se 2 vjet tash që t'i kërkojë të drejtat e tyre të cilat u takojnë. Por, deri tash gjendja është dëshpëruese. Ata sillen andej e këndeje dhe nuk marrin përkrahje institucionale. Ndërkaq përkrahja për këtë kategori definitivisht nuk është dhe nuk duhet të shihet si ndonjë veprim vullnetmirë i Qeverisë as veprim vullnetmirë i Ministrisë së Shëndetësisë, as i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe as e Ministrisë së Arsimit. Përkrahja për të plagosurit civilë nga minat në Kosovë, është obligim institucional kombëtar edhe qytetar i Qeverisë së Kosovës.

Për më shumë, kërkesat e Shoqatës së të Plagosurve Civilë nga minat janë krejt themelore dhe krejt elementare.

Së pari kërkojnë asistencë ose përkrahje në avancim në edukim. Kjo nënkupton krijimin e lehtësimeve për mbijetuesit civilë nga minat në edukimin e atyre në institucionet edukative të Republikës së Kosovës.

Së dyti, kërkojnë kushte për integrim të plagosurve civilë në shoqëri. Kjo nënkupton aftësim profesional të tyre dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës, ndërkaq në këtë drejtim krijimi i kushteve më të favorshme për riintegrim dhe punësim është obligim i Qeverisë së Kosovës.

Dhe, së treti ata kërkojnë përfshirjen e kësaj kategorie në vetëm disa prej elementeve ligjore që kanë të bëjnë me kategoritë e dala nga lufta. Kjo nënkupton lehtësimin për rehabilitimin mjekësor, lehtësimin për rehabilitimin fizik, qasjen pa pagesë të shërbimeve shëndetësore në këtë aspekt, përparësinë në punësim në ndërmarrjet publike e kërkesa të ngjashme, krejt elementare ose bazike.

Mbi të gjitha këta njerëz që prapë nuk dihet numri i saktë, por llogariten që janë rreth 2000, nuk kanë asnjë lloj mbështetje financiare për pajisjet e tyre të nevojshme ortopedike, për protezat e tyre.

Kjo nënkupton se ka të plagosur civilë të cilët më shumë se 6 vjet, më shumë se 7 vjet nuk kanë arritur t'i ndërrojnë protezat e tyre, ndërsa nëse kthehemi te Endriti, ai këtë moshë e ka të rritjes së vet fizike. Prandaj, nuk është e mundur një situatë e tillë të tolerohet edhe më tutje, sepse është lënie anash, është diskriminim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Padyshim se sot do të flas për një temë që shpeshherë këtu e ka ngritur në Kuvendin e Kosovës që ndërlidhet me ngjarjet e fundit, konkretisht me arrestimet e fundit që kanë të bëjnë me Universitetin e Prishtinës në lidhje me aferat korruptive.

Padyshim që për ne si shoqëri është i papranueshëm korrupsioni në sistemin arsimor, ku dihet se sistemi arsimor është bërthama e shoqërisë sonë e cila rolin kryesor e ka në edukimin, arsimimin e brezave, gjeneratave të reja.

Në këtë rast jemi koshientë se ditëve të fundit kanë ndodhur pikërisht këto arrestime në Universitetin e Prishtinës në përgjithësi e konkretisht në Fakultetin e Mjekësisë në veçanti.

Dihet specifika e Fakultetit të Mjekësisë, dihet përgjegjësia e personelit akademikë dhe shëndetësorë që kanë të bëjnë që do të ballafaqohen drejtpërdrejt me shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Të mos harrojmë se ne kemi fatkeqësisht në vendin tonë, sistemi arsimor është mjaft i degraduar dhe fatkeqësisht po them këtu, është i korruptuar. Korrupsion nuk kemi vetëm në nivelin universitar, por kemi edhe në nivelin shkollor, atë fillor dhe të mesëm.

Por aty ku desha të ndalem në veçanti në Fakultetin e Mjekësisë, që është e papranueshme prapë për vendin tonë, nuk është lehtë dhe nuk është në parim, nuk është vështirë të zbulohet se si ndodhin këto të gjitha gjëra në atë fakultet, duke filluar që nga 14 vjetët e pasluftës do të shihni nëse shkojmë në renditje kronologjike duke filluar që

nga provimet pranuese se si janë pranuar studentët në Fakultetin e Mjekësisë, do të shihni shpeshherë ka ndodhur dyfishim i studentëve nga numri real.

Më pas vijmë te provimet e mirëfillta të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë, do të shihni se si është bërë trendi i provimeve të tyre ku shumëkush edhe flet haptas në atë Universitet për mënyrën e blerjes së notave, provimeve të tilla.

Më pas vijmë te punësimet. Kur jemi te punësimet shumë lehtë do të vëreni se me çfarë kritere punësohen në Fakultetin e Mjekësisë, po edhe në Universitetin e Prishtinës, në përgjithësi. Do të shihni një nepotizëm klasik të punësimit të stafit akademik dhe e gjithë kjo, në fund të këtij zinxhiri, po hakmerret me punë për faktin se del një mjek dhe nëse një mjek i tillë i ka kaluar nëpër këtë zinxhir jo të rregullt, atëherë çka pritet prej tij kur ballafaqohet drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarit të Kosovës.

Nuk është hera e parë që në Universitetin e Prishtinës apo në përgjithësi në sistemin arsimor kemi arrestime të tilla, kemi pasur vitin e kaluar edhe të fakulteteve të tjera në Pejë dhe konkretisht tash në Universitetin “Haxhi Zeka” dhe të gjitha këto të tjera afëra korruptive e rëndojnë gjendjen arsimore në Kosovë.

Unë u bëj thirrje këtu për faktin se i pranishëm është vetëm ministri i Arsimit, që së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ta vendosim ndër prioritetet e para sistemin arsimor në Kosovë, ngase nuk dyshoj në vullnetin dhe angazhimin e ministrit për ta luftuar këtë korrupsion i cili fatkeqësisht 14 viteve pas lufte ka zënë vend në vendin tonë, por që ta vendosë në prioritetet e para....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Gëzim, nuk je lajmëruar në emër të Grupit. Po mirë, edhe 2 minuta për Gëzimin, në emër të Grupit.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit kryetar!

... do të thotë betimi i ministrit të Arsimit që bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme dhe me Rektoratin, në veçanti ta vendosin në ndër prioritetet e para luftën kundër korrupsionit në Universitetin e Prishtinës, në të gjitha universitetet dhe në sistemin arsimor në përgjithësi, ngase fatkeqësisht kemi korrupsion në sistemin arsimor dhe fillet i ka shumë kaheër që nga paslufta dhe mos të harrojmë për fund, pa dashur të zgjas më shumë, për diagnozën të gjithë po e dimë se kemi korrupsion, por po flas për prognozën në sistemin arsimor në përgjithësi e në Fakultetin, në Universitetin e Prishtinës, në veçanti, prognoza është sikur kanceri i mushkërive dhe jam i bindur që shumica prej jush e dini prognozën e kancerit të mushkërive. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pasi jemi vetëm në fund të vitit, dëshiroj të shpreh shqetësimin tim për dy çështje që ndoshta mund të duken të kundërta mes vete, por në realitet që të dyja prekin dinjitetin dhe identitetin tonë.

Shkurt, dua të them se mbishkrimi në aeroportin “Adem Jashari”, ku Prishtinës i është hequr një shkronjë dhe nga “Prishtina” është shndërruar në “Pristina”, është i papranueshëm dhe i pajustificueshëm.

Me këtë rast dua t’i falënderoj të gjithë ata qytetarë që përmes rrjeteve sociale kanë shprehur indinjatën e tyre për shtrembërimin e gjuhës shqipe dhe kanë sensibilizuar opinionin e gjerë. Të them të drejtën, kur je në Aeroportin e Prishtinës, të krijohet bindja që je në Stamboll.

Kjo është dashur të bëhet me kohë nga institucionet përgjegjëse çka me këtë rast kërkoj të bëhet dhe të mënjanohet menjëherë ky skandal dhe të ketë mbishkrime në gjuhën shqipe drejt në Aeroportin e Prishtinës.

Gjuha duhet të mbrohet e aq më tepër kur kemi të bëjmë me emërtimet e institucioneve të rëndësishme siç është Aeroporti “Adem Jashari”.

Çështja tjetër që ka prekur shumë njerëz dhe plagë të hapura, është zbulimi i varrezës masive në Rashkë. Heshtja e pushtetit serb për gati dy dekada për njohuritë që i kishte për këtë varrezë dhe varrezat tjera, duhet të dënohet në radhë të parë nga vetë ne, që fatkeqësisht për një javë rresht heshtëm, por edhe nga Bashkimi Evropian i cili duhet të kërkojë nga vendi që mendoj t’i japë statusin e kandidatit, të zbardhë fatin e të gjithë të pagjeturve gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Jam e bindur që shteti serb i ka të gjitha informatat për të pagjeturit, prandaj t’i bëhet presion që të bindet dhe përfundimisht t’i sqarojë të gjitha rastet.

Si qytetare, por edhe si deputete, dua të jem pranë të gjithë atyre familjarëve që me ankth presin që 16 vjet për të marrë ndonjë lajm për më të dashurit e tyre, e ankthi u shtua edhe në masë më të madhe që nga identifikimi i varrezës në Rashkë.

Kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që çështjen e të pagjeturve ta ketë permanent në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Gjithashtu dua të inkurajoj dhe të shpreh përgëzimet e mia edhe për ekipin kosovar i cili qëndroi deri në fund në insistimin e tyre për zbulimin e varrezës në Rashkë përkundër problemeve teknike dhe gjithashtu presionit që iu bë gjatë atyre ditëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Javën e kaluar në Universitetin e Prishtinës për shkak të korrupsionit u arrestuan disa asistentë dhe bashkëpunëtorë të tyre. Bazuar në shkrimet e mediave, të arrestuarit kryesisht ishin të rinj, madje disa prej tyre janë ish liderë të organizatave studentore.

Avancimet e tyre tregojnë se ata aktivitetin e zhvilluar në këto organizata nuk e kanë bërë për interesat e studentëve dhe mirëqenien e tyre, por thjeshtë për interesa të ngushta personale dhe grupe. Pra kanë qenë të interesuar që angazhimin e tyre në organizatat studentore ta kapitalizojnë duke vënë në shërbim të menaxhmentit e që si shpërblim më vonë të pranohen në Universitet si asistentë apo personel tjetër mësimdhënës.

Por ja që doli që këta ish liderë dhe aktivistë të organizatave studentore të shpërblyer me pozitë e asistentëve për shërbimet e tyre për klane të ndryshme në Universitetin e Prishtinës, nuk po merren vetëm me punë të procesit mësimor, por edhe me ndërmjetësime të karakterit korruptiv, qoftë në formë të shitblerjes së notave, qoftë në formë të regjistrimit të kundërligjshëm të studentëve.

Kjo tregon që fatkeqësisht në korupsion janë të përfshirë grupmoshat e reja, pra asistentët dhe ish aktivistët e organizatave studentore. Por, realisht shikuar fuqia e tyre është e vogël për të kryer korupsion pa qenë të ndërlidhur edhe me profesorë me përvojë dhe stafin udhëheqës të fakulteteve dhe të Universitetit.

Prandaj është e pakontestueshme se personat e UP-së të arrestuar javën e kaluar kanë mund të shërbejnë vetëm si ndërmjetësues, sepse ata nuk kanë pasur kompetenca ligjore as ta regjistrojnë ndokënd në fakultet e as të japin nota në ndonjë lëndë.

Përfundimi logjik është se përfituesi dhe aktorët kryesorë të këtyre aferave korruptive është dikush tjetër, pra dikush që ka pozita më të larta, qoftë në procesin e mësimdhënies qoftë në menaxhmentin e fakulteteve apo të Universitetit.

Andaj, duke pasur parasysh gjendjen dhe rrjedhat e përgjithshme në Universitetin të Prishtinës, por edhe në arsimin e lartë në përgjithësi, kërkoj nga organet e drejtësisë në Kosovë, që lufta kundër korupsionit në arsimin e lartë të mos ndalojë vetëm me arrestimin dhe ndëshkimin e hallkës së parë të zinxhirit korruptiv, por të vazhdohet deri në fund, duke i sjell para organeve të drejtësisë të gjithë ata që me veprimet korruptive ia kanë dëmtuar dhe dita- ditës janë duke ia rrënuar imazhin institucionit më të çmuar të arsimit të lartë në Kosovë për themelimin dhe zhvillimin e të cilit gjenerata të tëra jo vetëm që kanë derdhur mund e djersë, por kanë derdhur lot dhe gjak. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjfuca.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Para dy ditësh në Bruksel Këshilli i Bashkimit Evropian mori qëndrime të rëndësishme lidhur me vendet të cilat aspirojnë integrimin evropian. Aty u konkludua se Serbia i ka plotësuar të gjitha kushtet për fillimin e negociatave të anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian. Kushtet e mëhershme të cilat i pat vendosur Gjermania nuk u përmendën fare dhe kërkesat plotësisht legjitime për tërheqjen e Serbisë nga veriu i Kosovës nuk i zuri askush në gojë.

Secili në këtë rajon, madje edhe më gjerë e ka të qartë se asgjë në thelb nuk ka ndryshuar nga politika hegjemoniste e Serbisë, sidomos karshi Kosovës. Dhe për të gjithë këtë përmbysje të pa paramenduar me ç'rast Serbia po i fillon negociatat e anëtarësimit, kurse

Shqipëria dhe Kosova ndodhen shumë larg, përgjegjëse padyshim që është edhe Qeveria jonë e cila e ndoqi gabimisht politikën e rehabilitimit të Serbisë duke e lozur rolin e fqinjit të mirë e të dëgjueshëm thuaja se nuk kemi asnjë problem me shtetin e Serbisë.

Në këto tri vjetët e fundit ne me vëmendje kemi përcjell negociatat e Serbisë me Kosovën dhe mund të themi që bilanci është ky. Ka barrikada që nga mesi i Mitrovicës e deri në kufijtë veriorë të Kosovës, ka kryetar komunash nga lista e Daçiqit, të cilët nuk e njohin shtetin e Kosovës, ka ish kriminelë të gatshëm të MUP-it për t'u futur në Policinë e Kosovës, ka kufij me Serbinë pa demarkacion, kemi fusnotën që na mbeti dhe e cila e dobëson njohjen e mëtutjeshme ndërkombëtare të Kosovës, sidomos nga këto 5 vendet e Bashkimit Evropian, e kemi një gjyqësi dhe një prokurori në veri të Kosovës, me gjyqtar i cili nuk mund të jetë shqiptar për ta gjykuar një qytetar të përkatësisë etnike serbe në veri.

Pra, përderisa me 21 janar Serbia i fillon negociatat për anëtarësimi në plotë në Bashkimin Evropian, neve na mbeten prej negociatave të gjitha këto probleme të cilat unë i përmenda.

Prandaj, është koha për t'i u kthyer vetvetes për t'i ndërprerë negociatat, për t'u orientuar kah projekti politik kombëtar, për të forcuar politikisht ekonomikisht dhe ushtarakisht në fund që të rezultojë e gjithë kjo me një politikë të jashtme e cila është në favor tonin dhe jo në kurriz të shtetit të Kosovës siç është tani.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Ky është inventari kombëtar i pyjeve i vitit 2012, i prezantuar si raport kohëve të fundit.

Ky raport vërteton saktësisht shqetësimin e deputetëve të këtij Kuvendi për gjendjen katastrofale në pyjet tona. Nga ky raport del se çdo vit në pyjet e Kosovës priten rreth 1 500 000 metra kub dru ilegalisht. Kjo do të thotë se 93% e prerjeve vjetore të pyjeve bëhen në mënyrë ilegale nga mafia e malit ndërsa vetëm 7% e tyre priten legalisht nga institucionet shtetërore të Kosovës.

Shteti i Kosovës e ka të organizuar sektorin e pylltarisë në 3 nivele. Megjithatë, nuk i arrin që as 7% të prerjeve vjetore t'i bëjë legalisht, as 7% e pylltarisë së Kosovës nuk është nën kontroll.

Dëmet nga këto prerje janë jashtëzakonisht të mëdha. Nuk e di edhe sot Ministria e Bujqësisë dhe Qeveria, a janë të njohura me këtë raport dhe a kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet reflektues për ta ndryshuar gjendjen në këtë sektor, a kanë organizuar njerëzit për ta parë komplet sistemin se ku është defekti i kësaj gjendje kaq të rëndë këtu?

Shteti pëson humbje edhe nga të hyrat për shkak se nga një përlllogaritje shumë e vogël rreth 30 milionë euro janë humbjet vjetore, pa e llogaritur rritjen e vlerës në zinxhir për

përpunimin e drunjve në vendin tonë. Për fat të keq edhe drunjtë që kanë vlerë teknike ato prehen për dru zjarri.

Ne kemi shprehur edhe herë tjetër këtë dyshim dhe kemi deklaruar se ndoshta zgjidhja më e mirë është që këto pyje t'u jepen popullsisë e cila është në nevojë, rreth 200 000 familje të Kosovës janë të privuara nga e drejta që t'i shfrytëzojnë këto pyje në mënyrë legale dhe njëkohësisht të arrijnë që t'i punësojnë anëtarët e familjeve të tyre.

Shtrohet edhe një pyetje tjetër, shumë e thjeshtë. Pse populli i Kosovës duhet të paguajë taksa për mbrojtjen e pyjeve të veta derisa ato nuk arrijnë që t'i mbrojnë?

Ftoj institucionet e Kosovës që të merren seriozisht me këtë problem për shkak se ky përveç që është një problem i vendit tonë, është problem i pasurisë tonë kombëtare. Ky është një problem edhe mjedisor shqetësues për situatën klimatike që e kemi ne edhe këtu, sepse edhe ne jemi kontribuues të një gjendjeje të tillë në nivel botëror. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu edhe është harxhuar koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Koha për pyetje parlamentare është 60 minuta. Për këtë pikë të rendit të ditës i kemi 17 pyetje parlamentare. Po e fillojmë me pyetjen e parë.

Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Ramë Buja. Nuk është këtu. Vazhdojmë. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Agim Çeku. Deputete e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Qe shumë kohë është formuar Komisioni qeveritar për verifikimin e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Procesi i aplikimit ka përfunduar. Deri ku ka shkuar puna e Komisionit dhe kur pritet të përfundojë?

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë, e nderuar deputete Kadrijaj,

Po, procesi i aplikimit ka përfunduar më 15 mars të këtij viti dhe siç e dini sepse jeni njoftuar, është një numër i madh i aplikuesve, 66 339 aplikacione janë, nga to 57 771 janë vetëm të veteranëve. Dhe, pas përfundimit të procesit aplikacionet janë mbledhur në Sekretarinë e Komisionit. Sekretaria e ka filluar sistemimin e çdo aplikacioni në bazë të njësiteve duke filluar nga skuadra, togu, kompania e deri te Shtabi i Përgjithshëm dhe gjatë këtij sistemimi është vërejtur që shumë aplikantë, shihet qartë, kanë qenë pjesëtarë

të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por nuk kanë qenë të sistemuar nëpër njësi konkrete, skuadër, tog apo kompani dhe thjeshtë shihet se ka pasur një kontribut, andaj janë ndarë në një kategori e veçantë si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe jo luftëtarë, jo të uniformuar, jo të armatosur, por thjesht pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne, duke u bazuar në Ligjin aktual për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, nuk e kemi një definicion të saktë apo definimi i veteranit është shumë sipërfaqësor, kështu që si Komision kemi vendosur që të kërkojmë që në procedurë të rregullt parlamentare të bëhet, të krijohet baza ligjore për kategorizimin e këtyre veteranëve.

Ne një gjë të tillë e kemi propozuar pasi veç në procedurë parlamentare është plotësimi dhe ndryshimi i ligjit që e përmenda. Si Komision e kemi dhënë kontributin tonë, kemi propozuar amendamente tona që e definojnë kategorizimin e çdo kategorie të dalë nga lufta dhe në bazë të kësaj baze ligjore ne do ta bëjmë verifikimin.

Por, duke besuar që do të kalojë në Parlament dhe duke i referuar rekomandimit tonë, ne kemi filluar verifikimin në dy zona, Zonën Operative të Karadakut dhe asaj të Shalës, pasi që e kanë një numër më të vogël në krahasim me zonat tjera të aplikantëve, që të shohim se gjatë këtij procesi të verifikimit cilat janë problemet, t'i nxjerrim disa mësimet dhe që mandej ta përcaktojmë modalitetin e verifikimit.

Është me rëndësi që Komisioni për Shëndetësi e Çështje Sociale sa më shpejt të procedojë këtë plotësim dhe ndryshim të këtij ligji dhe ne ta krijojmë bazën ligjore dhe të definohet çdo kategori e dalë nga lufta dhe atëherë ne si Komision shumë shpejt do të procedojmë dhe do t'i verifikojmë dhe do t'i kategorizojmë të gjithë këta veteranë, kështu që mbetet që të besojmë se shumë shpejt në këtë Kuvend do të vijë edhe plotësimi dhe ndryshimi apo amenamentimi i ligjit në fuqi për të drejtat dhe statusin e invalidëve, veteranëve, dëshmorëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër, propozimet e juaja që janë dhënë tash në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që të përfshihen kategorizimi i veteranëve të luftës janë përkrahur, Komisioni ka amendamentuar Ligjin aktual i cili pritet shumë shpejt të vijë në seancë dhe të miratohet. Mirëpo është kërkesë edhe e veteranëve dhe të gjitha kategorive të luftës që ky Komision t'i shpeshtojë takimet dhe në mënyrë sa më të shpejtë të kryhen këto kategorizime dhe të kryhen këto verifikime, sepse edhe në Ligjin aktual ne e dimë se nuk janë përfshirë veteranët. Gjendja e veteranëve është e vështirë dhe siç po shihet edhe nga deklaratimet mediatike ata nëse nuk rregullohet shumë shpejt çështja e tyre, do të përfshihen në një valë të protestave që po parashihen të organizojnë.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Unë i kuptoj shqetësimet e veteranëve, vërtet janë të bazuara, por i siguroj veteranët se këto vonesa nuk janë të natyrës subjektive, por të natyrës objektive. Ne si Komision qeveritar nuk mund të punojmë përmendësh, duhet të punojmë në bazë të një ligji, duhet të kemi bazë ligjore dhe mbetet vërtet që jemi në pritje të kësaj baze ligjore. Apeloj edhe te Kuvendi dhe te komisionet përkatëse që sa më shpejt t'i

sjellin në Kuvend këto plotësime e ndryshime dhe atëherë posa ta kemi këtë bazë ligjore ne do ta intensifikojmë shumë punën dhe shumë shpejt do ta kryejmë misionin dhe detyrën tonë.

KRYETARI: Deputetja Valbona Dibra pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për sigurimin shëndetësor është projektligji më i rëndësishëm që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës në këto vite të fundit sa i përket përfitimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Është një projektligj i cili do t'i ofrojë çdo qytetari të Kosovës një trajtim të dinjitetshëm shëndetësor.

Ne jemi të informuar se pas punës së madhe që ka bërë Ministria e Shëndetësisë, për të cilën e falënderojmë shumë, jemi të informuar se ligji ka kaluar në Ministrinë e Financave për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Zoti ministër, a mund të na informoni neve dhe gjithë publikun se në cilën fazë përgatitore është Projektligji për sigurimin shëndetësor, pasi që veç ka ardhur në Ministrinë tuaj? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Dibra,

Sigurisht se siç thatë edhe ju sponzoruesi i ligjit është Ministria e Shëndetësisë konform detyrave që i ka. Ne në fillim të këtij muaji kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë Ligjin për sigurimin shëndetësor, një ligj i një rëndësie të veçantë për ta vlerësuar koston e tij financiare dhe mund t'ju them që jemi në komunikim shumë intensiv me Ministrinë që ky ligj të kalojë sa më shpejt dhe që nga viti 2014, në pjesën e dytë të fundit apo diku në tremujorin e fundit të vitit 2014, të fillojë mbledhja e mjeteve financiare për fond dhe pastaj në vitin 2015, qytetarët të kenë mundësi.

Pra, është një ligj i cili është në procedurë dhe ne besojmë shumë shpejt pas sqarimit të disa përfituesve siç janë fëmijët, siç janë kategoritë e ndryshme dhe në sqarim të kësaj liste identifikimit të qartë të tyre, ne do ta lëshojmë deklaratën financiare dhe besoj që është një ndër ligjet shumë të rëndësishme siç e thatë edhe ju, ligj i cili do të na mundësojë që të kemi sigurime shëndetësore të dinjitetshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër a mund të na sqaroni më saktësisht çka përmban ky ligj dhe unë e dëgjova me vëmendje përgjigjen tuaj, sa është kostoja financiare e këtij ligji dhe kur do të hyjë në implementim? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëroni!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit! Për përmbajtjen e ligjit sigurisht që ministri i Shëndetësisë do të na jepte informata të shumta. Unë do të them që Ligji përmban sigurimet shëndetësore, krijimin e fondit i cili është një fond jashtëzakonisht i rëndësishëm, një fond që do të kërkojë edhe ndarjen nga mjetet e buxhetit të Republikës së Kosovës, për kontributet, për premiumet të cilat do të jepen nga qytetarët, realisht nga punonjësit të cilët punojnë nëpër institucionet publike dhe atë çka mund të them se kostoja financiare për vitin 2015 në buxhet, i cili nënkupton për pagesën për premiumin për të gjithë punëtorët që punojnë në pjesën e sektorit publik, pra atë kontributin që e jep shteti për ta, do të jetë diku rreth 17 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga premiumet që paguhen nga qytetarët, ndërsa në sektorin privat paguhen nga qytetarët dhe nga sektori privat.

Totali aktual është diku rreth mbi 80 milionë euro, të cilat do të krijohen në fond gjatë vitit dhe pjesa prej 17 milionë euro do të mbulohet nga buxheti, ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga kontribuuesit vetë dhe nga sektori privat. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Agani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Prej vitit 2010, Qendra Klinike Universitare po funksionon pa drejtorë të klinikave. Konkurse janë hapur kohë pas kohe, janë anuluar për shkak të shkeljeve ligjore që janë bërë në procedurën e përzgjedhjes së drejtorëve të klinikave.

Kjo po karakterizon se ushtruesit e detyrave, të cilët e kryejnë punën nuk kanë legjitimitet të madh dhe në fakt po ndodhin skandalet rend pas rendi në Qendrën Klinike Universitare.

Konkursi që është hapur tash, ministër, në përzgjedhjen e drejtorëve në Qendrën Klinike Universitare, a është në dakordim me ligjet në fuqi në mënyrë që më të mos ndodhë ajo që të shfuqizohet zgjedhja e drejtorëve për shkak të shkeljeve ligjore?

KRYESUESI: Zoti Agani, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Si përgjigje në pyetjen e juaj, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë, më ka informuar se konkursi i shpallur më 25 nëntor 2013, për drejtorë të klinikave në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, është në harmoni të plotë me Ligjin e punës, Ligjin për shëndetësi dhe Udhëzimin administrativ numër 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Dua të shtoj se ky konkurs është edhe në përputhshmëri të plotë me statutin e Shërbimit spitalor klinik-universitar të Kosovës, të miratuar në pajtim me Ligjin e shëndetësisë nga Qeveria e Kosovës, konkretisht me nenin 20 paragrafi 1 të këtij statuti i cili i jep të drejtë Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht sekretarit të përgjithshëm që deri në momentin e konstituimit të Bordit drejtues të këtij shërbimi dhe emërimit të drejtorit operativ, t'i kryejë detyrat e përcaktuara me ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja deputete? Fjalën e ka zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, për sqarime, ministër, mirëpo sipas Ligjit të shëndetësisë, konkursi nuk është dashur të shpallet pa përfunduar formimi i Shërbimit klinik-spitalor siç edhe parashihet në Ligjin e shëndetësisë. Do të duhej në fillim të formohej Shërbimi Klinik Spitalor me të gjitha organet e veta, e pastaj ky shërbim ta shpallë konkursin.

Ndërsa sa i përket statutit të Qendrës Klinike Universitare apo të Shërbimit Spitalor, me konkurs parashihet që drejtorët e klinikave të kenë titullin më të lartë, titullin akademik të profesorit dhe drejtori i zgjedhur duhet të punojë me orar të plotë të punës.

Në këtë rast të gjithë profesorët, punë sekondare e kanë punën në Qendrën Klinike, ndërsa punë primare e kanë punën universitare. Si do të mund një profesor në të njëjtën kohë të punojë me orar të plotë të punës si drejtor i një klinike dhe në të njëjtën kohë të jetë edhe profesor i Universitetit me orar të plotë?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Agani e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Pra, siç e thashë edhe në përgjigjen time, baza ligjore për hapjen e konkursit për drejtorë të klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka qenë Statuti i shërbimit, i miratuar në Qeverinë e Kosovës dhe neni 20, paragrafi 1 i këtij statuti që i jep të drejtë sekretarit të përgjithshëm të hapë konkurs derisa nuk emërohet Bordi drejtues dhe emërohet drejtori operativ i këtij shërbimi.

Arsyeja pse e kemi bërë këtë është mu ajo që e thatë ju në pyetjen e juaj se kemi pasur dëshirë që Bordit drejtues t'ia japim një situatë të konsoliduar me drejtorë të emëruar fuqiplotë në pozitat e tyre e jo me ushtrues të detyrës. Në kohën kur vetë Bordi drejtues duhet të konsolidohet dhe të fillojë një punë në një institucion plotësisht të ri shëndetësor në vend dhe me siguri se do të ketë sfida të veçanta për para vetes dhe ka nevojë për një aparat menaxherial operativ dhe të suksesshëm në punë.

Në pjesën e dytë të pyetjes, kjo çështje ndërmjet orarit të plotë të punës në Shërbimin Spitalor Kliniko-Universitar dhe në Universitetin e Prishtinës është çështje që do të

rregullohet me aktin nënligjor të paraparë me Ligjin për shëndetësi, pra me një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Universitetit të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në esencë, statuti nuk parasheh që drejtori duhet të jetë ekskluzivisht me thirrje të profesorit, por prej kandidatëve që janë në dispozicion do t'i zgjedhin ata të cilët kanë kualifikime më të larta, edhe profesionale, edhe shkencore.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht dua ta bëj një vërejtje për kryeministrin, i cili në mënyrë të vazhdueshme i injoron pyetjet parlamentare të përfaqësuesve të popullit, në të njëjtën mënyrë siç injoron pyetjet e gazetarëve, të cilat nuk i konvenojnë. Ai i frikësohet transparencës dhe kjo e ka vetëm një shpjegim: se ai po punon në kundërshtim me interesat e popullit.

Megjithatë, unë do ta bëj pyetjen: Më 6 qershor 2013, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Rezolutën për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në pikën e parë të kësaj Rezolute thuhet: “Qeveria e Republikës së Kosovës t’i kushtëzojë marrëdhëniet me Serbinë me kujdesin dhe interesimin shtetëror për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë lidhur me të drejtat e tyre civile, politike dhe etnike”.

Ndërsa në pikën 3: “Qeveria e Republikës së Kosovës ta hapë një zyrë në Prishtinë dhe një në Gjilan për këta qytetarë me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së atyre që janë shpërngulur sipas normave ndërkombëtare”.

Që prej miratimit të kësaj rezolute ka pasur bisedime të vazhdueshme me Serbinë nga kryeministri dhe nga zëvendëskryeministrja Tahiri dhe ka pasur disa marrëveshje të arritura me shtetin e Serbisë.

Prandaj pyetja ime është: “Çfarë kushtëzimesh ka bërë kryeministri deri tani ndaj Serbisë, në mënyrë që të përmirësohet gjendja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës? Pse nuk e keni hapur zyrën në Prishtinë dhe Gjilan deri tani? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Agim Kuleta, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Zoti Kuleta, e keni fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke i pasur parasysh dëmet shumë të mëdha në fushën ekonomike, politike dhe ato të sigurisë nga përdorimi i kodit telefonik të Serbisë, Sllovenisë dhe Monakos, Kuvendi i Kosovës, më 6 shtator 2012, e miratoi një rezolutë në të cilën parashihet zëvendësimi i këtyre tri kodeve me atë të Republikës së Shqipërisë.

Më pas, ndërmjet dy shteteve u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi, ku përfshihej edhe kjo çështje.

Ndërkohë, përkundër obligimeve që dalin nga kjo rezolutë për Qeverinë e Kosovës, ajo negocioi për çështjen e kodit telefonik me Serbinë dhe u tha që Kosova do ta ketë kodin e vet.

Si është e mundur që në kohën kur e kemi një rezolutë dhe një marrëveshje, pra dy dokumente të cilat hapin rrugë për ndërrim të kodit telefonik, Kosova vazhdon t'i përdorë kodet e huaja, ndërmjet të cilave, edhe atë të Serbisë.

Pra, çka po ndodh me këtë çështje? A është bërë ndonjë hap në këtë drejtim? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Ismajli, e keni fjalën.

FADIL ISMAJLI: I nderuari deputet,

I nderuari kryesues,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Faleminderit për pyetjen!

Zoti Agim, ka qenë edhe sponsorizues më duket edhe i marrëveshjes me Shqipërinë për kodin telefonik.

Është e vërtetë se është arritur marrëveshja në atë kohë ndërmjet dy ministrive Kosovë-Shqipëri dhe autoritetet e Shqipërisë me pas i janë drejtuar ITU-së dhe e kanë shprehur gatishmërinë që të jenë shtet sponsorizues për kodin telefonik të Kosovës. Mirëpo, përgjigja nga ITU ka qenë negative, ose nuk ka qenë pozitive.

Ndërkohë, që nga viti 2011 kanë vazhduar bisedimet në Bruksel për telekomin dhe më 8 shtator 2013 është arritur marrëveshja.

Çështja e parë dhe kryesore është që Kosova do ta ketë kodin e saj shtetëror telefonik, kodin ndërkombëtar, të cilin do t'ia japë ITU, kurse Bashkimi Evropian do ta ndihmojë Kosovën për ta marrë këtë kod.

Marrja e kodit shtetëror telefonik është edhe një forcim i shtetit të Kosovës. Kosova do ta ketë identitetin e saj shtetëror në fushën e telekomit, në fushën e telefonisë dhe me këtë kod, i cili pritet të realizohet sipas procedurave në janar të vitit 2015. Mund të them se kodi i Serbisë do të shkojë dhe me këtë shkojnë edhe të gjitha ato implikime që kemi pasur me faktin që një kohë e kemi pasur të imponuar këtë kod dhe presim që ITU ta akordojë kodin 383 ose 384, ashtu siç i ka takuar edhe në të kaluarën nga statusi i saj i mëparshëm.

Kështu që kjo vlen edhe për telefoninë fikse, edhe për të gjithë operatorët mobilë, në rastin tonë 'Vala', 'IPKO' e të tjerë, domethënë do të jetë kodi i njëjtë, i cili, përveç rëndësisë shtetërore, e ka edhe elementin komercial që do të thotë nuk do të ketë më tutje vjedhje të parasë në këtë drejtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kuleta?

AGIM KULETA: Sa i përket çështjes së kodit telefonik +355, konsideroj që është një neglizhencë nga Qeveria, sepse është dashur të raportohet lidhur me ecurinë e këtij procesi, përderisa Kuvendi e ka nxjerrë një rezolutë.

Unë megjithatë e marr me skepticizëm këtë informacion, sepse duhet të verifikohet.

Ndërsa sa i përket çështjes së kodit telefonik të Kosovës, më intereson të di a ka ndonjë plan dinamik Qeveria me afate, kur do të kryhen procedurat për realizimin e këtij kodi?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Plani dinamik parimisht është në bazë të marrëveshjes dhe thashë që data e fundit është viti 2015. Në ndërkohë që Bashkimi Evropian merr obligim që nëpërmjet procedurave të veta ta përkrahë Kosovën plotësisht për marrjen e njërës nga këto kode që thamë, dhe është çështje - përgatitja jonë në aspektin nëpërmjet Departamentit të Telekomunikimit është duke u bërë dhe aplikimi pothuajse është i gatshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për zëvendëskryeministrin Slobodan Petroviq. Ministri nuk është këtu. E ke konsumuar, në rregull. Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri nuk është këtu. Zonja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me Ligjin e të verbërve dhe mosfillimin e zbatimit të tij, për ç'gjë kjo kategori është mjaft e indinjuar dhe po ndihet shumë keq, por besoj që në mbledhjen e ardhshme do t'ia bëj pyetjen ministrit dhe do të na sqarojë, sepse është shumë me rëndësi për këtë kategori të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani. Zoti Mustafa, e keni fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Pyetja për ministrin e Shëndetësisë ka të bëjë me pakënaqësitë, të cilat i ka ai lidhur me buxhetin, gjë që është pasqyruar dhe me një votim në Qeveri.

Pyetja ime ka të bëjë me një informim, që kisha dashur të na japë ministri, meqenëse do të ballafaqohemi me votimin për buxhet, me çka kanë pasur të bëjë pakënaqësitë e ministrit me buxhetin për shëndetësi, sa janë adresuar ato pakënaqësi dhe nëse nuk janë adresuar çfarë pasojash mund të kenë në zhvillimin e projekteve dhe shërbimeve në këtë ministri?

Edhe, ju lutem, e kam pasur një pyetje herën e kaluar, nuk ka qenë ministri i Arsimit këtu...

KRYESUESI: Zoti ministër, Agani!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti deputet,

Pakënaqësitë, siç po i quani ju, ose qëndrimet e mia që i kam pasur në mbledhjen e Qeverisë, unë i kam shprehur në mënyrë publike qysh në atë mbledhje të Qeverisë dhe nuk ka pasur asgjë tjetër pos asaj që e kam thënë edhe aty, se është bërë fjalë për një mospërfshirje të një numri të mjekëve, të punëtorëve shëndetësorë, konkretisht 119 mjekëve në buxhetin e vitit 2014, si dhe për mospërfshirjen e projektit të Qendrës Klinike Emergjente Universitare si konstruksion financiar i financuar nga huat e buta, që do të merreshin nga tri institucione ndërkombëtare për vitin 2014.

Dhe, qysh gjatë mbledhjes së Qeverisë dhe menjëherë pas saj është gjetur zgjidhja për këto probleme, konkretisht për numrin e punëtorëve dhe është bërë pjesë e buxhetit të vitit 2014, dhe një pjesë do të adresohet në rishikimin e buxhetit në mes të vitit të ardhshëm.

Ndërsa sa i përket përfshirjes së projektit të Qendrës Klinike Emergjente Universitare, ka qenë i pamundur. Shpjegimi ka qenë nga Ministria e Financave, që ka qenë e pamundur të përfshihet në buxhetin e vitit 2014 për shkak të rregullës fiskale, e cila e kufizon huamarrjen dhe ngarkesën e buxhetit me hua, por ministri i Financave është zotuar se ne do t'i fillojmë në procesin e negociatave me këto institucione ndërkombëtare gjatë këtij viti dhe marrëveshjet përkatëse në rast të negociatave pozitive do t'i ratifikojmë në Kuvend për t'u bërë pastaj pjesë e buxhetit të vitit 2015.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Mustafa? Jo. Atëherë po i rikthehem pyetjes së zotit Mustafa, që e ka pasur për ministrin Ramë Buja. Mund ta lexoni pyetjen, meqenëse s'keni qenë në fillim në sallë. Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Pyetja ka të bëjë me nevojën që të kemi sqarime lidhur me buxhetin e paraparë për universitetet e reja publike që janë themeluar nga ky Kuvend. Më saktësisht për Universitetin e Pejës, të Mitrovicës, të Gjilanit dhe të Gjakovës.

Sa është buxheti për këto katër universitete, pasi rritja e buxhetit për arsim këtë vit nuk jep hapësirë për financimin e tyre minimal, ose nëse financimi i këtyre universiteteve të reformuara bazohet në ndonjë ristrukturim brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit, ku dhe cilat janë bërë shkurtimet dhe ristrukturimet eventuale brenda buxhetit të ministrisë?

KRESUESI: Zoti Buja, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra, zëvendëskryeministër,

Deputet Mustafa,

Faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Universiteti i Pejës është themeluar sipas vendimit të Qeverisë për vitin akademik 2013. Buxheti për vitin fiskal 2013 për këtë universitet ka qenë në total 1 982 230 euro.

Për vitin fiskal 2014, buxheti për këtë universitet në total është planifikuar të jetë 2 182 230 euro.

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01-118, 02-118 dhe 03-118, të datës 6.3.2013, për themelimin e universiteteve publike të Mitrovicës, Gjakovës dhe të Gjilanit si institucione të arsimit të lartë, fillimisht në rishikimin e buxhetit të vitit 2013 për tri universitete të reja janë ndarë nga 200 000 euro për secilin, që në total bëjnë 600 000 euro për vitin kalendarik.

Ministria e Financave gjatë hartimit dhe mundësisë së realizimit të kërkesave buxhetore për MASHT-in, për vitin fiskal 2014 ka ndarë buxhet për tri universitete të reja, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, gjithsej 4 500 000 euro, si dhe 30 000 euro mbështetje nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që domethënë për tri universitetet shuma e ndarë për secilin nga to është 1 510 000 euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Mustafa?

MUHAMET MUSTAFA: Po, tash e kam më të qartë situatën. E falënderoj ministrin për përgjigje. Por, më duhet të konstatoj se ajo frika jonë që e kemi shprehur që në fillim ekziston dhe me këto mjete, me këtë buxhet, është shumë vështirë të sigurohen standardet e cilësisë dhe puna normale e këtyre universiteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Ministri nuk është këtu.

GORAN MARINKOVIĆ: Ministar je bio tu, a neću postaviti pitanje bez njega. Tako da ostaviću za narednu sednicu.

KRYESUESI: Në rregull. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Çështja ka të bëjë më 7.11.2013, kur është arrestuar Azem Lajçi, pronari i kompanisë “Leka Med”, profesor, biznesmen, profesor universitar në Departamentin e Farmacisë në Universitetin e Prishtinës.

Azem Lajçi, në laboratorin e tij “Leka Med” po prodhonte barna pa licencë. Aty ai po falsifikonte barna. Sipas Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale në çdo aparaturë dhe hapësirë të laboratorit është hasur prani e baktereve të rrezikshme, ndër to edhe “Staphylococcus albus”

Në këtë ambient me baktere të rrezikshme, ndër të tjera, Azem Lajçi ka falsifikuar edhe pika AD, që u jepen fëmijëve pas lindjes për forcimin e eshtrave deri në moshën njëvjeçare.

Sipas të dhënave zyrtare, Azem Lajçi është profesor i Universitetit të Prishtinës, në Departamentin e Farmacisë. Pyetja është: I nderuar ministër, a jeni në dijeni për këtë shkelje të ligjit nga profesori biznesmen Azem Lajçi? A mendoni se për shkak të shkeljes së ligjit dhe shkeljes së etikës profesionale, të Statutit të UP, nenit 134 dhe të nenit 135, Azem Lajçi i është dashur t'i ndalohet paraqitja para studentëve dhe të suspendohet dhe të iniciohet marrja e titullit të profesorit?

A jeni në dijeni përse menaxhmenti i UP-së e ka bërë këtë tolerim ndaj Azem Lajçit, i cili bashkë me të arrestuarit e fundit e kanë dëmtuar rëndë reputacionin e Universitetit dhe profesorët e Universitetit "Hasan Prishtina"? Faleminderit

KRYESUESI: Zoti ministër Buja, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar kolegë ministra,
Zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Haxhiu,
Megjithatë shyqyr Zotit që filloi zbardhja dhe zbërthimi i ployës që është bërë në Universitetin e Prishtinës dhe në Fakultetin e Mjekësisë konkretisht, sepse në fakt është dashur një herë të nisë. Kanë qenë fjalë e fjalamani, por tashmë ka marrë rrugë besoj për t'u zgjidhur.

Për pyetjen konkrete tanimë, ne si ministri me ta marrë lajmin për arrestimin e zotit Lajçi, kemi kërkuar nga Universiteti "Hasan Prishtinës" t'i marrë masat e nevojshme karshi ligjeve dhe akteve tjera që i ka në fuqi. Por, Universiteti i Prishtinës deri më sot nuk ka marrë ndonjë njoftim zyrtar nga organet e rendit apo të drejtësisë lidhur me arrestimin e zotit Lajçi.

Arrestimi i zotit Lajçi nuk ndërlidhet me punët e tij si profesor dhe me veprime kundërligjore, siç thuhet në UP, të ushtruara në Fakultetin e Mjekësisë, të paktën deri më tani nuk ka informacion, por janë veprime kundërligjore të ushtruara në çështje të biznesit të tij privat.

Pas konsultimeve edhe me kryeinspektorin e punës së Republikës së Kosovës nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për suspendimin e të përmendurit, pasi ai është mbajtur vetëm për pesë ditë në paraburgim. Për këtë kohë, Rektorati ka urdhëruar që Shërbimi i Financave ta lërë me zero orë realizimi gjatë periudhës që është gjendur në paraburgim. Asgjë më shumë.

Por, pasi i përmenduri e ka një procedurë në gjyqësi, ose në gjyq, faktikisht, Universiteti i Prishtinës është duke i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, siç jam i informuar, që ta qartësojë vendimin e duhur konform ligjeve që janë në fuqi.

Pasi të qartësohet saktë nëpërmjet vijës zyrtare, UP-ja do të marrë vendim adekuat në lidhje me profesorin Lajçi. Universiteti çdo herë është në funksion të zbatimit dhe të respektimit të ligjit dhe besoj edhe kjo tanimë është bërë telashe dhe shqetësim i të gjithëve do të marrë fund. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, zoti Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Azem Lajçi nuk i ka zero orë, ai mban ligjërata dhe mësim para studentëve të Fakultetit të Mjekësisë. Besoj që atij që ta ka dhënë atë përgjigje i bën nder ajo.

Vendimi për suspendimin e asistentëve të arrestuar ishte i drejtë dhe mendoj që nuk do të duhej që Universiteti i Prishtinës ta toleronte Azem Lajçin dhe të ishte i përkëdhelur i tyre në këtë rast, edhe pse ndaj tij është ngritur aktakuzë për prodhimin ilegal dhe falsifikim të barnave.

Në media e kemi një lajm i cili qarkullon se Gëzim Dauti, një qytetar i Kosovës, për 850 euro vjedhje në kazino është dënuar me 4 vjet burgim, ndërsa profesor Azem Lajçi i merr mbi 1 000 euro nga Buxheti i Republikës së Kosovës për falsifikimin që ua ka bërë edhe ai tash mund t'u ligjërojë studentëve se si duhet të falsifikohen barnat në Departamentin e Farmacisë si profesor universitar. Le t'i bëjë nder atij i cili është duke ia bërë këto tolerime Azem Lajçit. Këtij Kuvendi dhe Universitetit të Prishtinës nuk besoj që i bën nder.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albana Gashi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Ministri nuk është këtu. Zonja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Raportin e Progresit për vitin 2012, si e gjetur është edhe mungesa e një marrëveshjeje formale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për t'i sqaruar dyshimet lidhur me mbetjet e personave të paidentifikuar në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Bëhet fjalë për trupat e pajetë, bëhet fjalë për shqiptarët e vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë, trupat e të cilëve janë hedhur në bregun e lumit "Lepenc dhe më pas gjatë reshjeve të mëdha gjatë vitit '99, këta trupa nëpërmjet këtij lumi janë bartur në Maqedoni. Pra, pengesë për hulumtimin e këtyre mbetjeve që dyshohen se ku janë varrosur këta persona është marrëveshja formale ndërmjet dy qeverive.

Pyetja për ministrin e Punëve të Jashtme është pse ende nuk është arritur kjo marrëveshje? Sepse problematika e kësaj marrëveshjeje nga viti në vit po përmendet edhe në Raporti i Progresit.

Mirëpo meqë ministri nuk është këtu, pres përgjigje në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me një publikim në njërin prej të përditshmeve ditë më parë, më saktësisht një shpallje për vende të reja të punës nga një operator i lojërave të fatit, që e ka emrin "Grand-Kazino".

Sipas informatave që ne posedojmë, kjo kazino pritet së shpejti të hapet në hapësirat e hotelit “Grand”.

Pyetja për ministrin është se a ka pranuar Administrata Tatimore e Kosovës aplikacion nga ky operator i lojërave të fatit dhe a është i licencuar ky operator?

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, urdhëroni!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Deputet Ymeri,

Bazuar në shënimet e ATK-së, nuk ndonjë kërkesë për licencim nga subjekti me emrin “Grand-Kazino”, të theksuar në pyetjen parlamentare.

Deri më tani, në Kosovë, nga ATK-ja është licencuar një subjekt për lojërat e fatit “Kazino”. Licenca e parë është marrë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financa më 1 qershor 2006, me emrin si “Kosovo - Star Bingo”, që më vonë është ndryshuar në “Global Entertainment Enterprises”, sh.p.k.

GEE, me numër fiskal 60058623, ka parashtruar kërkesë për vazhdim të licencës më 26 prill 2012, me numër reference 13-7/1008, dhe bazuar në Ligjin për lojërat e fatit është vazhduar licenca për periudhë kohore 31.5.2012 deri më 31.5.2014.

Administrata Tatimore e Kosovës ka pranuar njoftim nga subjekti nga data 30.3.2013, që e ka pasivizuar aktivitetin ekonomik për një kohë për shkak të problemeve në objektin ku e ushtron veprimtarinë dhe kontekstin gjyqësor me pronarin rreth qirasë së objektit.

Më 23.9.2013, ATK-ja e ka lëshuar një njoftim për subjektin në fjalë, duke rikujtuar se duhet ta fillojë veprimtarinë në përputhje me Ligjin për lojërat e fatit 04/L-080, në të kundërtën do t’i revokohet licenca.

Bazuar në informatën të sigurtë nga ATK-ja, biznesi ka filluar disa investime në hotelin “Grand”. Administrata Tatimore ia ka rikujtuar GEE-së nëpërmjet shkresës së datës 17.12.2013 se duhet t’i përmbahet Ligjit 04/L-080, nenit 60, paragrafi 1.7 për respektimin e largësisë nga objektet edukativo-arsimore, të institucioneve fetare, të pronës komunale, me rastin e caktimit të objektit për ta ushtruar veprimtarinë, si dhe nenin 58, paragrafi 1, për plotësimin e depozitës në Thesar me vlerë prej 168 mijë euro, të cilat i mungojnë nga shuma e siguruar prej 2 milionë eurosh në raportin e saj, 13 dhjetor 2013.

Bazuar në procedurat ligjore, asnjë subjekt i lojërave të fatit nuk mund ta zhvillojë veprimtarinë e vet pa e bërë kërkesën në objektet tjera me rastin e zhvendosjes, apo zgjerimit të lokalit, pa pranimin e lokalit, mbështetur në kriteret e përcaktuara me ligj, pavarësisht se është i licencuar.

Nga kjo konstatojmë se Administrata Tatimore nuk e ka aprovuar asnjë lokacion në objekt të ri për ushtrimin e veprimtarisë nga “Global Entertainment Enterprises”, sh.p.k., në Prishtinë.

Njëkohësisht, dua të ju informoj, sepse kjo temë ka qenë edhe më herët. Gjatë këtyre ditëve, në funksion edhe të zbatimit të planit të veprimtimit për intensifikimin e aktiviteteve për zbatimin e ligjit, ka aktivitete ditore ndërmjet ATK-së dhe Doganës dhe vetëm gjatë dhjetorit janë mbyllur 39 pika të lojërave të fatit. Janë dërguar njoftime, lajmërime, janë intensifikuar veprimtari me të gjitha palët e interesit, të cilat do të mund të ndihmojnë këtë proces, pra Doganat, Polica dhe komunat.

Dhe, bazuar në dinamikën e paraparë, ne presim që deri në fund të janarit të vitit 2014 të përfundojë me sukses plani i veprimtimit për mbylljen e të gjitha pikave, të cilat nuk janë në harmoni me ligjin, i cili është në fjalë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Ymeri, dëshironi pyetje shtesë? Jo. Deputeti Burim Ramadani, pyetje për ministrin Ramë Buja.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti ministër,

Më 2 maj të këtij viti, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar një mocion prej 5 rekomandimesh për çështjen e parandalimit dhe luftimit të drogave nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës.

Mocioni i Kuvendit të Kosovës është miratuar më 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Derisa viti shkollor 2013/2014 tash po shkon në pjesën e fundit të gjysmëvjetorit të parë, opinionin publik nuk është njoftuar që keni marrë ndonjë hap konkret për t'i zbatuar rekomandimet e mocionit të Kuvendit të Kosovës. Nuk është njoftuar nëse e keni ndërtuar një program të veçantë të trajnimit të mësimitdhënësve për çështjen e drogave, ashtu sikur është dashur të bëhet sipas mocionit të Kuvendit të Kosovës.

Pyetja është shumë e thjeshtë: Pse nuk po e zbatoni mocionin e Kuvendit të Kosovës, i miratuar më 2 maj 2013.

KRYESUESI: Zoti Buja, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet Ramadani,

Mocioni po zbatohet, përgjigjja shkurt, e më gjatë është kështu: Për opinionin faleminderit shumë që e keni bërë pyetjen, që të sqarohet për këtë çështje.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, në kuadër të politikave arsimore ka vendosur si prioritet trajnimin e mësimitdhënësve. Për parandalimin e dukurive negative

për vitin e ardhshëm 2014, rekomandim që është aprovuar edhe si mocion në Kuvendin e Kosovës në maj të vitit 2013, kemi vazhduar.

Në sajë të bashkëpunimit me partnerët e ndryshëm qeveritarë, si Ministrinë e Punëve të Brendshme, konkretisht Policinë e Komunitetit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shoqatën 'PEN', apo Rrjetin e Bashkëmoshatarëve, UNICEF-in dhe me organizatat tjera joqeveritare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e koordinon realizimin e projekteve të ndryshme vetëdijesuese si aktivitete ekstra-kurrikulare në shkollat e Kosovës, të cilat pretendojnë sensibilizimin e komunitetit shkollor për parandalimin e dukurive negative në shkolla, siç është çështja e drogës.

Për vitin 2014, prioritet është bashkëpunimi ndërministror, përfshirë edhe organizatat joqeveritare për ndërmarrjen iniciative të përbashkëta për vetëdijësim të mësimdhënësve dhe trajnim dhe prindërve për parandalimin e kësaj dukurie me përmasa kombëtare.

Po ashtu MASHT-i nëpërmjet plan-programeve shkollore, kryesisht në lëndët edukatë qytetare, biologji, kimi dhe aftësi për jetën, në shkollat tona ofron në vazhdimësi informacione të duhura për rreziqet dhe pasojat e përdorimit të drogave.

Prandaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mbetet e përkushtuar për t'i zbatuar rekomandimet që kanë dalë nga ky Kuvend dhe kanë të bëjnë me fushën e arsimit ekskluzivisht.

Ndërsa për pikën 5, është përgjegjëse një ministri tjetër, që është Ministria e Shëndetësisë, për ta realizuar çështjen e institutit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ramadani?

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit ministër!

Ju folët për vendosjen në prioritet të disa prej këtyre pikave kryesisht për vitin 2014, nëse ju kuptova saktë. Po e them pyetjen edhe një herë shumë më direkt: Sa prej rreth 20 mijë mësimdhënësve janë trajnuar në fillim të këtij viti shkollor për çështjen e drogave në shkolla fillore dhe të mesme? Sa është numri i tyre?

KRYESUESI: Zoti Buja, urdhëroni!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet Ramadani,

Numrin e saktë mund të ju sjell në seancën që vjen, por vazhdimisht të trajnimi i mësimdhënësve dhe të gjitha kategorive të mësimdhënësve tanë ka vazhduar për këtë çështje të përdorimit të drogës në shkollat tona dhe për dukuri tjera negative. Andaj, numrin e saktë mund t'ju sjell, sepse nuk e solla sot për arsye që mendova se nuk do të ishte i nevojshëm ta sjell. Por, trajnimi i tyre bëhet në mënyrë permanente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Burim Ramadani, pyetje për ministrin Bajram Raxhepi. Zoti Ramadani, ministri nuk është këtu, e dëshironi fjalën? Jo.

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministren Vlora Çitaku.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Gjatë muajit prill të vitit 2012, ministrja e Integrimeve, zonja Vlora Çitaku, e ka realizuar një vizitë mjaft të gjatë dyjavore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Duke qenë se puna e saj lidhet me vendet e Bashkimit Evropian, kjo vizitë ka tingëlluar paksa e çuditshme, përveçse shumë e kushtueshme për Buxhetin e Kosovës.

Mirëpo, ministri i Jashtëm i Kosovës, zoti Enver Hoxhaj, ka deklaruar gjatë një raportimi në Komisionin për Punë të Jashtme të Parlamentit se vizita e ministres Çitaku në SHBA kishte lidhje me një kërkesë për liberalizim vizash me SHBA-në, proces nga i cili do të përfitonin qytetarët e Kosovës.

Pyetja ime në lidhje me këtë është: Cili është rezultati i kësaj vizite? A është pranuar kërkesa nga ky shtet dhe në çfarë niveli ka arritur procesi i liberalizimit të vizave me SHBA-në?

KRYESUESI: Zonja Çitaku, e keni fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

E nderuara deputete Lama,

E mbaj mend që i jam përgjigjur një herë pyetjes suaj për vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kam qenë në SHBA edhe disa herë pas prillit të vitit 2012. Është një interpretim jashtëzakonisht rixhid i rolit të ministres së Integrimit Evropian nëse ndërlihet ekskluzivisht me vizita në shtetet e Bashkimit Evropian, sido që të jetë po përgjigjem konkretisht në pyetjen që ju e parashtruat.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e kanë një proces të ngjashëm çfarë e ka Komisioni Evropian për procesin e liberalizimit të vizave. Nuk është proces që bëhet me pranim, aplikim apo marrje të udhërrëfyesit. Kjo varet kryesisht dhe kryekëput nga shkalla e refuzimit të aplikacioneve për viza.

Një shtet duhet ta ketë nivelin nën 3% të refuzimit për të udhëtuar pa viza në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Niveli i refuzimit të vizave për shtetasit e Kosovës në ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ende ka numër dyshifror dhe ne ende nuk jemi shtet që mund të përfitojë nga udhëtimi pa viza në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Po ashtu, një kriter tjetër është edhe pajtueshmëria e politikave të migracionit. Në këtë pikë, Kosova dhe SHBA-të kanë pajtueshmëri në politikat e migracionit.

Ky Kuvend e ka miratuar Ligjin për riatdhesim dhe çdo shtetas i Republikës së Kosovës që qëndron pa leje apo e tejkalon qëndrimin që ofron viza riatdhesohet dhe kthehet në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama, pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Zonja Çitaku, pa dyshim që SHBA-të i kanë politikat e veta për mënyrën se si e japin vizat dhe për mënyrën se si i favorizojnë disa shtete në lidhje me liberalizimin e vizave, nëse mund ta përdorim këtë term.

Jam shumë e qartë në lidhje me atë. Po kështu jam shumë e qartë në lidhje me pozicionin e ministres për Integritet Evropian. Jo nuk është rixhid. Ju jeni për Integritet Evropian, të tjerat i ka Ministria e Jashtme.

Pyetja ime ishte kjo pra: A ka ndikuar vizita juaj në përmirësimin, sepse ju keni shkuar për këtë çështje. A ka ndikuar apo janë ato rregulla strikte, sepse unë nuk po shoh ku është rezultati i vizitës. Pyetja ime është - rezultati i vizitës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Çitaku, urdhëroni.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: E nderuar zonja Lama,
Nëse i referoheni vizitës së prillit, unë kam qenë pjesë e delegacionit të kryeministrit.

Agjenda evropiane ka qenë një ndër pikat themelore kryesore, e cila është diskutuar në Uashington gjatë vizitës së kryeministrit në prill të vitit të kaluar.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe gjatë vizitës në qershor të këtij viti, kur unë kam qenë pjesë e delegacionit të kryeministrit.

Po ashtu, kam pasur edhe vizita të ndara në SHBA, sikur që e kam të planifikuar një vizitë edhe në javën e tretë besoj të janarit të vitit të ardhshëm.

Nëse doni të insinuooni se unë po shkoj atje për t'i shpenzuar kot paratë e taksapaguesve, atëherë kjo është një insinuatë jashtëzakonisht e ulët.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Mahir Jagxhilar.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Para se ta parashtroj pyetjen, e shfrytëzoj rastin që t'ju lus t'u përmbaheni rregullave. Pra, kur është çështja te pika jashtë rendit të ditës, sepse unë kam ardhur në orën 9:30, e kam shtypur butonin, e nuk më jepet fjala, e ky është bërë një diskriminim, por gjithsesi le të jetë në ndërgjegjen tuaj.

I nderuar zoti ministër,

Duke marrë parasysh faktin se sistemi i ri i gradimit ka qenë i përcaktuar të hyjë në fuqi në janar të vitit 2013, e një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur, si dhe duke marrë parasysh faktin se ju në cilësinë e ministrit keni deklaruar që nga janari i vitit 2014 do të aplikohet sistemi i ri i pagave për nëpunësit civilë, kërkoj nga ju, zoti ministër, që të më njoftoni se a do të aplikohet sistemi i ri i pagave për nëpunësit civilë nga 1 janari i vitit të ardhshëm.

KRYESUESI: Zoti ministër Jagxhilar, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Qëndron konstatimi se kam deklaruar, në fakt ka qenë kërkesë edhe nga unë, por i kam sfiduar edhe institucionet e Kosovës që më 1 janar të fillojmë me sistemin e ri të pagave.

Por, duke u bazuar në kompleksitetin e procesit, sepse procesi duhet të përfundohet pas përfundimit të të gjitha organizimeve dhe sistematizimeve të brendshme të institucioneve, dhe pas dërgesës së kërkesave për aprovimin e rregulloreve për të gjitha institucionet e Kosovës në Qeveri sa i përket klasifikimit të vendeve të punës. Në anën tjetër, është edhe pjesa e projektit të Bankës Botërore sa i përket modernizimit të sektorit publik, ne ende nuk mund të fillojmë pa u zbatuar të gjitha çështjet, pa u testuar sistemi sesi do të funksionojë.

Pritet që në fund të muajit shkurt, nga Banka Botërore do të dërgohet komponenti, i cili është drejtpërdrejt i lidhur me sistemin informatik sa u përket pagave. Ndërsa, në anën tjetër, besojmë që të gjitha institucionet do të dërgojnë kërkesa, të gjitha rregulloret, edhe sa i përket organizimit, edhe sa u përket klasifikimeve, dhe do të aprovohen në Qeveri.

Pas aprovimit të të gjitha rregulloreve, atëherë nevojitet sigurisht një kohë edhe për testimin e sistemit. Kështu që më 1 janar nuk mund të fillojmë, por kjo çështje është biseduar, të ju informoj, edhe në grupin e veçantë për Administratën Publike, i cili bëhet në bashkëkruesimin në Bashkimin Evropian, dhe është pjesa e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që të gjitha këto çështje të përfundohen në fund të muajit maj, që me rishikimin e buxhetit të fillojmë. Dhe do të jetë edhe një sfidë sa i përket Raportit të Progresit evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Bytyçi?

KYMETE BYTYÇI: Zoti ministër,

Mua më intereson se deri ku keni arritur me nxjerrjen e të gjitha rregulloreve që e rregullojnë këtë fushë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Edhe një herë dëshiroj të ju theksoj se janë dy lloj të rregulloreve, rregulloret për institucionet qeveritare janë aprovimi i organizimeve dhe sistematizimeve të brendshme, sepse ka mbetur vetëm për dy ministri të aprovohen këso lloj të rregulloreve, ndërsa sa u përket rregulloreve për klasifikimin e vendeve të punës, mbi 70% për institucionet janë rishqyrtuar. Por, ende ka disa institucione të cilat hezitojnë, ose ende nuk e kanë dërguar aprovimin e rregulloreve sa u përket vendeve të punës. Edhe në rastin, në qoftë se dërgohen të gjitha rregulloret edhe të aprovohen, prapë do të nevojitet një kohë nga aspekti teknik të bëhen teste të nevojshme edhe nga aspekti i realizimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Agani e ka kërkuar fjalën për një sqarim ... Pra, zonjës Musliu i është përgjigjur me shkrim ministri dhe le të evidentohet për procesverbal.

Në rregull. E kryejmë edhe pyetjen tuaj, cila është ajo? Goran Marinković. S'është këtu Gorani.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Në sallë janë 83 deputetë, nëse keni vërejtje në procesverbalin e mbledhjeve plenare të mbajtura më 5 dhe 12 dhjetor 2013 dhe më 12 dhe 13 dhjetor 2013. A keni vërejtje? Jo.

Në sallë janë 83 veta dhe konstatoj që Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura, më 5 e 12 dhjetor 2013 dhe 12 e 13 dhjetor 2013.

Pika e katërt e rendit të ditës: Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017

Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar, për mocion të Lidhjes Demokratike është paraqitur zoti Arben Gashi

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkoj që pika 10 e rendit të ditës të hiqet prej rendit të ditës për dy arsye dhe të kthehet në Komisionin Funkcional, pastaj edhe në konsultim me Komisionin për Legjislacion.

Për dy arsye, arsyeja e parë rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, rekomandim për shkarkim të tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media. Arsyeja e parë është kjo. Objekti i rekomandimit ka ndryshuar, sepse personi i propozuar për shkarkim zoti Nevzat Hydaverdi, tashmë nuk është i gjallë dhe e dyta për të parë nëse kemi shkelje të ligjit dhe për të konstatuar këtë, duhet të kalojë nëpër Komisionin për Legjislacion për të konstatuar shkeljen ligjore.

Prandaj, rekomandoj që të kthehet në Komisionin funksional dhe pastaj në bashkëpunim Komisioni funksional dhe Komisioni për Legjislacion, me ndryshimin e objektit të rekomandimit të marrin vendim dhe t'i rekomandojmë pastaj seancës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Po ashtu, edhe unë për rend dite kam për pikën tetë më saktësisht të rendit të ditës që kemi debatin parlamentar për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Neve si deputetë nuk na është dorëzuar as çfarë materiali për këtë pikë. Mendoj që është goxha problematike që ta kemi një debat parlamentar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit pa e pasur Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Për çfarë do flasim aty përveç

një raporti që na e bën ministrja, kështu që rekomandoj që kjo ose kërkoj që kjo pikë të shtyhet derisa deputetët të pajisen me materialin e domosdoshëm për diskutim.

KRYESUESI: Faleminderit! Janë dy mocione të paraqitura, një që pika 10 e rendit të ditës, mocion i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që është Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media, për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, të rikthehet në Komision për shqyrtim dhe pika 8, mocion i Grupit Parlamentar të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” që është debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të shtyhet për një seancë tjetër, për shkak se materiali nuk ka ardhur me kohë.

Unë kam informatën nga Administrata që e keni nëpër ato kutitë postare, por megjithatë mocioni është mocion dhe ne jemi të detyruar ta zbatojmë sipas rregullave.

Lidhur me mocionin e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkoj deklarin e grupeve parlamentare. Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zonja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Konsideroj që është plotësisht e paarsyeshme kërkesa për ta larguar prej rendit të ditës, arsyetimi që nuk ka kaluar vendimi nëpër Komisionin e Legjislacionit, mendoj që po ashtu është jo e justifikueshme për arsye që me të vërtetë personi i vdekur sigurisht që nuk do të vihej në diskutim nëse do të duhej të jetë në listë, mirëpo ne e kemi një shkelje që nuk mund t’i ikim, një shkelje ligjore, janë kriteret ligjore të cilat përcaktojnë se kush mund të jetë dhe kush nuk mund të jetë anëtarë i KPM-së.

Me të vërtetë është një situatë që s’mund ta tejkalojmë më tutje dhe konsideroj që plotësisht është jo e arsyeshme për të kërkuar të hyjë në mocion dhe të largohet nga rendi i ditës. pra, ne do të jemi kundër kësaj.

KRYESUESI: Kërkoj deklarin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi dakord që kjo pikë t’i kthehet Komisionit, është e domosdoshme që Komisioni për Legjislacion ta shqyrtojë ligjshmërinë e një vendimi të tillë dhe kur kemi të bëjmë me ndryshimin e listës së emrave tash meqenëse i ndjeri më nuk është në mesin tonë dhe, në anën tjetër, edhe për shkak se është bërë një lloj barazimi mes potencialisht shkeljeve të ndryshme që kanë mund të ndodhin dhe këtë mendoj që duhet ta shqyrtojmë në dy vendime të ndara.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deklarimi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Me siguri ka deputetë këtu që janë të informuar se për një temë të tillë kemi diskutuar edhe në Kryesi të Kuvendit goxha gjatë, domethënë në Kryesi të Kuvendit me kryetarët e grupeve.

Mendoj se kur njerëzit janë parimor për temat tjera duhet të jenë parimor për gjithçka, t' i mbajnë parimet e veta dhe të vazhdojnë me parime e jo të kenë standarde të dyfishta për tema të ndryshme.

Unë mendoj se kurrfarë arsye nuk ka për t'u shtyrë. Në Kryesi të Kuvendit është diskutuar që një person i ndjerë të hiqet prej listës, nuk e di pse është hequr, mirëpo nuk mendoj që ka deputetë të Kuvendit të Kosovës që nuk e dinë që ka shkelje të ligjit rreth kësaj pike. Nëse dikush mund ta arsyetojë se nuk ka shkelje të ligjit, Grupi Parlamentar i Aleancës do të vepronte siç kërkojnë ata, por shkelje brutale të ligjit ka.

Një prej temave të cilat janë përmendur në Kryesi të Kuvendit është se një shkelje ka ndodhur shumë moti, edhe s'bën për t'u marr me të, ndërsa një shkelje ka ndodhur tash rishtas. Shikoni, nuk mund të vazhdojmë kështu. Nuk është kjo mënyrë të vazhdojmë e në tjetrën kohë të akuzohen të gjithë tjerët se po bëjnë shkelje të ligjit, se po bëjnë emërime politike etj., pra nuk është në rregull kështu.

Ne mendojmë se pika duhet të mbetet, është krejt parimore, nuk ka të bëjë me individë, por është turp Kuvendi i Kosovës të merret me njëri-tjetrin edhe të flasë për tema krejt anësore duke e ditur prej fillimit deri në fund që është shkelur ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!
Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrat,
Dhe të gjithë deputetët e seancës,

Duke marrë parasysh fjalimin e parafolësit mund të themi se edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, është diskutuar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht përzgjedhja e tyre vetë brenda Kuvendit ka qenë shkelje e ligjit, siç tha edhe parafolësi, mirëpo çështja e shkarkimit e kemi pasur edhe një emër të një personi të vdekur që është absurdi i këtij Kuvendi, që vjen një person i cili ka ndërruar jetë, të shkarkohet. Unë kisha dashur që mendimin që e kemi pasur brenda Kryesisë së Kuvendit, të vazhdojë ai mendim dhe të gjithë jemi në dijeni çka kemi biseduar brenda mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Dhe, në rast se dëshirojmë diçka tjetër, atëherë këtu janë votat e deputetëve të cilët mund të japin mendimin e fundit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS nuk ka të paraqitur për t'u deklaruar. Nga "Zajednička Budućnost", Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, presedavajući!
Poslanička grupa "Zajednička Budućnost" podržava mociju da se skide sa dnevnog reda ova tačka dnevnog reda, deseta.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë kemi mendime të ndryshme nga grupet parlamentare, unë jam i obliguar që ta hedh në votim mocionin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Nuk kalon mocioni i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Për janë 39 vota, abstenim janë 3 dhe 41 vota janë kundër.

Kalojmë në mocionin e dytë të paraqitur nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” që ka të bëjë me debatin parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Mocionin e keni dëgjuar, fjala është e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”.

Adem, merre fjalën!

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është që të mbetet pika e rendit të ditës dhe të vazhdojmë me debatin e kërkuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë të lus që pas kësaj që do të deklarohe mi edhe ne jemi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, por po të lus që t’ia mundësosh deputetit një të drejtë elementare që ta deklarojë votën nëse është shumë normale, nuk ka ndodhur hera e parë. T’ia mundësoni, po mirë zoti kryesues njeriu edhe mund të gabojë ky po e deklaroi votën, kjo është një fjalë që juve mendoj që ju obligon. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, kërkoj falje unë. Asnjëherë, s’na ka ndodhur pasi të kryhet rendi i ditës me u, unë kam gabuar zoti Armend Zemaj ka të drejtë ta deklarojë votën dhe për çka e ka fjalën. Kërkoj falje.

Jo, në votim edhe nuk e hedh një herë! Pse s’ka qenë, pse ka qenë, unë nuk e di. Urdhëro zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryesues, unë nuk kërkoja asgjë vetëm ashtu çka thotë Rregullorja. Vota ime është për mocionin që e ngriti Lidhja Demokratike e Kosovës. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” është deklaruar, Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e keni fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Për mocionin e dytë mendojmë se është kërkesë racionale që të shtyhet meqenëse nuk kemi material dhe e mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Duke e marrë parasysh se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit është marrë vendim që të jetë në pikë të rendit të ditës - debati parlamentar lidhur me ecurinë e progresit të negocimit të Marrëveshjes se Stabilizim-Asocimit dhe ministri është këtu, unë nuk e di pse po e shtyjme atëherë këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, zoti Sasha Gjokiq.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

I “Zajednička Budućnost” smatra da treba da tačka ostane u dnevnom redu s bozirom da Predsedništvo tako odlučilo.

KRYESUESI: Në rregull. E hedh në votim mocionin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” lidhur me shtyrjen e propozimit të debatit parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Regjia përgatitet për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj që me 54 vota për, 28 kundër, 2 abstenime, Kuvendi vendosi për shtyrjen e debatit parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes Stabilizim-Asociimit, që është pika 8 e rendit të ditës.

Vlorë, merre fjalën, por materiali është i Kuvendit, jo i Ministrisë.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Nuk është asnjë problem, unë do të jem sa herë që Kuvendi e ka në rend të ditës debatin për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, mirëpo dua ta bëj vetëm një sqarim. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është një dokument në negocim e sipër dhe unë nuk kam një marrëveshje si të tillë, të cilën mund ta sjell dhe ta deponoj në Kuvend.

Pra, ne po bëjmë fjalë këtu për një dokument pune. Për më tepër që nuk janë hapur ende të gjithë titujt e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, kështu që do të ishte më mirë që të ketë vetëm një raport nga ana jonë se ku jemi deri më tani, ndërkohë që debati i vërtetë të bëhet pasi të kemi hapur të gjithë titujt dhe pasi Komisioni Evropian t’i ketë prezantuar Kosovës të gjitha direktivat, sepse unë nuk mund t’ju sjell dokumente të cilat nuk janë ende dokumente zyrtare dhe janë dokumente pune.

Ajo çfarë unë kam menduar kur e kam sjell kërkesën është që të bëj një raportim ku jemi deri më tani, mirëpo sido që ta vlerësoni ju unë jam e gatshme që të diskutoj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në rregull, merre Visar fjalën, por e kemi materialin e Kuvendit e kemi nëpër ato, por mirë është në qoftë se ka diçka kërkon edhe me shkrim nga ministrja dhe nuk ka ndonjë problem, ajo është e drejtë jona.

Pika 4 e rendit të ditës:

4. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013 deri në vitin 2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013 deri më 2017

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Propozim strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planin e Veprimit për vitin 2013-2017 të propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Hasani për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje ministre,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis ka shqyrtuar raportin e Qeverisë për Strategjinë e ajrit dhe i ka ofruar rekomandimin që Strategjia për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për 2013-2017 me ndryshimet si në vijim.

Strategjia për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2017, zëvendësohet me strategjia e cilësisë së ajrit për periudhën 2013-2022. Në tërë tekstin e dokumentit të fshihen fjalët e veprimit.

Në bazë të nenit 29. 03L-160 për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga ndotja e strategjisë në periudhën 10 vjeçare propozohet nga Qeveria dhe miratohet nga Kuvendi. Qeveria ka proceduar në Kuvend strategjinë për cilësinë e ajrit, ndërsa Komisioni ka shqyrtuar në mbledhjen me 3.12.2013, pas shqyrtimit të projektit të strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planin e Veprimit për vitin 2013-2017.

Në bazë të nenit 29 dhe nenit 30 të Ligjit 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, vlerësoj se strategjia e cilësisë së ajrit dhe Plani i Veprimit për cilësinë e ajrit janë dy dokumente të veçanta që dalin nga obligimi nga neni 29 dhe 30 i Ligjit 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, të cilët i harton Ministria dhe i miraton Kuvendi i Kosovës.

Prandaj, Komisioni vendos që t'i rekomandohet Kuvendit për miratim të strategjisë së cilësisë së ajrit për periudhën 2013-2022, ndërsa Plani i Veprimit 2013- 2017 t'i kthehet Qeverisë për ripunim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua të sqaroj që vërtet zoti Zemaj ka votuar kundër, ndoshta ka gabuar kur e ka shtypur sustën, por edhe në qoftë se do të kishte votuar për nuk do ta kishte ndryshuar rezultatin.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Bujar Bukoshi.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Zonja dhe zotërinj,

Ky dokument që del si kërkesë e Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja e siguron një kornizë me të cilën do të arrihej zvogëlimi i ndotjes së ajrit në vendin tonë në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira.

Politikat në dhjetë vjetët e ardhshme 2013-2022 do të përqendroheshin në mbrojtjen e cilësisë së ajrit, shëndetit të popullatës dhe të mjedisit. Ky projekt drejtohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me pjesëmarrje aktive të gjitha institucioneve të nivelit qendror, lokal, institucionet shkencore publikut dhe ndihmohet nga ekspertë ndërkombëtarë, me këtë rast është edhe formuar një këshill, këshilli drejtues dhe grupet punuese për sektorë të veçantë.

Gjatë gjithë këtij procesi janë mbajtur takime të shumta dhe pesë punëtori ku kanë qenë të ftuara edhe grupet e cekura më lartë.

Kjo strategji përcakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit. Objektivat e përcaktuara janë të matshme dhe të arritshme në periudhën 2013-2022, që do të thotë të rriteshin mundësitë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në tërë Kosovën, implementimi i legjislacionit për ajër, sigurimi i kësaj kornize për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në bashkëpunim me të gjitha komunitetet dhe cilësia e ajrit do të merret në konsideratë nga institucionet qeveritare, komunale, banorët, bizneset, organizatat kur marrin vendime për veprimet e tyre.

Për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të caktuara përmes masave të dala nga kjo strategji, do të përgatitet edhe Plani i Veprimit për cilësinë e ajrit, ku do të identifikohen veprimet me realizimin e të cilave do të sigurohet mbrojtja e mjedisit, pra angazhimi i Qeverisë, industrive, individëve në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë dhe institucionet shkencore, si dhe shoqërinë civile. Faleminderit për mbështetje.

KRYESUESI: Faleminderit! radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritet Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete dhe,

Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Draft-strategjinë për cilësinë e ajrit 2013-2022. Strategjia për cilësinë e ajrit është një dokument i cili ka vizion arritjen dhe ruajtjen e cilësisë së ajrit që do t'i ngritë mirëqenien e popullatës, mbron shëndetin e popullatës dhe mjedisit, vizion i cili do të realizohet përmes implementimit të kësaj strategjie dhe legjislacioneve që ndërlidhen me çështjen ose problematikën e cilësisë së ajrit.

Për t'i identifikuar politikat shtetërore të cilat shkojnë drejt përfitimit në mbrojtjen e shëndetit, mjedisit, cilësisë së ajrit dhe zhvillimit të qëndrueshëm është e nevojshme që

Republika e Kosovës të posedojë një dokument të tillë strategjik i cili është edhe obligim nga Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Në këtë rast me aprovimin e këtij dokumenti strategjik Kosova plotëson edhe një kriter të kërkuar nga Bashkimi Evropian, domethënë për afrimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian.

Politikat e përcaktuara në strategjinë e cilësisë së ajrit kanë për qëllim të zhvillojnë dhe zbatojnë instrumente të caktuara për të ngritur cilësinë e jetës duke siguruar bazën për përmirësim të cilësisë së ajrit, kornizë me të cilën do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit në pajtim me standardet e përcaktuara dhe parimet e praktikave më të mira.

Vërehet se orientimet e politikave në strategjinë për cilësinë e ajrit janë të planifikuara për dhjetë vjetët e ardhshme, domethënë 2013-2022 dhe janë të orientuara në implementimin e legjislacionit për ajër, ulja e misionëve nga burime të veçanta, ulja e misionëve nga burimet mobile, ulja e misionëve të gazrave serrë dhe nga aktivitetet publike.

Objektivat e përcaktuara në këtë strategji janë specifike të matshme dhe realisht të arritshme brenda kësaj periudhe dhe kjo është edhe një arsye pse kjo strategji duhet të aprovohet.

Kjo strategji njëherësh nxjerr në pah edhe gjendjen e cilësisë së ajrit në Kosovë nga ku vërehet se gjendja e cilësisë së ajrit në Kosovë nuk është e kënaqshme, domethënë se kemi raste ku disa ndotës e veçanërisht pluhuri i suspenduar në ajër tejkalon vlerat limite që sipas standardeve të vendit dhe atyre të BE-së.

Meqenëse kontribuues kryesorë të ndotjes së ajrit janë sektorët të ndryshëm të cilët monitorohen nga ministritë dhe komunat, atëherë kjo strategji ka adresuar në mënyrë specifike masat e nevojshme të cilat do të zbatohen nga këto autoritete.

Përmes masave të dala nga kjo strategji janë identifikuar veprimet me realizimin e të cilave do të sigurohet zvogëlimi i ndotjes së ajrit, mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të popullatës, orientimi i prioritetëve të politikave të Qeverisë, industrisë dhe individëve në mbrojtjen e cilësisë së ajrit, sigurimi i kornizës strategjike për ndërmarrjen e iniciativave për një ajër të pastër, përpjekja e vazhdueshme për përmirësimin e mundësive duke i marrë parasysh performansën ekonomike dhe eficiencën, identifikimi i zonave dhe çështjeve me fokus special, nxitjen për eficiencën e energjisë përmes kujdesit gjatë dizajnit, shfrytëzimit dhe rishfrytëzimit të materialeve.

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Ky dokument përbën kornizën themelore për zvogëlimin dhe parandalimin e ndotjes së ajrit në bazë të cilës pas aprovimit sot në Kuvendin e Kosovës do të realizohen hapa të mëtejme në harmonizimin e legjislacionit me dispozitat e Bashkimit Evropian, implementimin e legjislacionit, implementimin e standardeve përmes politikave të caktuara në koordinim me strategjitë dhe planet tjera të veprimit.

Po ashtu, ky dokument hap rrugë edhe për përfitimin e donacioneve nga Komisioni Evropian dhe programet e IPA-së, për çka jemi të vetëdijshëm se ne brenda buxhetit të Kosovës nuk kemi mundësi ta trajtojmë as cilësinë e ajrit e as ambientin.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar edhe njëherë po e potencoj e mbështesim këtë strategji dhe ju ftoj që edhe ju të nderuar ta mbështesni me votën tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, ka shqyrtuar strategjinë me të vetmin qëllim që ka të bëjë kryesisht një strategji shumë e nevojshme për ngritjen e cilësisë së ajrit dhe njëkohësisht që ka të bëjë edhe me direktivat e BE-së që kërkohet do të thotë plotësimi i standardeve për BE-në, por njëkohësisht ne paraqesim shqetësimin lidhur sa i përket strategjisë edhe pse do të luajë një rol shumë pozitiv miratimi i kësaj strategjie. Pra, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike është pro miratimit të kësaj strategjie, por njëkohësisht strategjitë e tilla si grup parlamentar gjithmonë, do të thotë kemi i kemi i miratuar, por problemi qëndron tek Qeveria apo tek institucionet përkatëse, në këtë rast te Ministria e cila ka hartuar këtë strategji që strategjitë po marrin miratimin nga Kuvendi i Kosovës, por strategjitë nuk po implementohen nga institucionet dhe ministrinë përkatëse.

Ndoshta pak a shumë si pasojë e buxhetit dhe sidomos Ministria e Mjedisit është njëra prej ministrive e cila nga Qeveria e Kosovës nuk ka qenë në prioritet deri më tani dhe buxhetin më të vogël në krahasim me ministrinë tjera. Konsideroj që Qeveria e Kosovës ende nuk po e vë në prioritet Mjedisin i cili është njëri prej ministrive shumë të rëndësishme dhe njëkohësisht është njëri prej institucioneve me të cilat vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet përreth Kosovës do të thotë kanë ndarë buxhet të mjaftueshëm, njëkohësisht kanë vënë në prioritet fushën e mjedisit.

Konsideroj që në kuadër të kësaj strategjie me të cilën janë paraqitur disa objektive, vlen të theksohet se Kosova ende është vendi më i ndotur në rajon sa i përket ajrit dhe shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit në përgjithësi ende vazhdojnë të jenë termocentrali ‘Kosova A’ dhe ‘Kosova B’. Po ashtu mihet si përfaqësohet e linjitet, kompleksi industrial në Mitrovicë, Ferronikeli në Gllogoc, fabrika e çimentos “Sharr-Cem” në Han të Elezit, sistemet për ngrohje qendrore Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë.

Industria e rëndë bazike aktualisht nuk funksionon në Gjakovë, Pejë dhe Gjilan, prodhimi i bazës së asfaltit, pastaj transporti rrugor dhe shumë segmente tjera. Prandaj, ne konsiderojmë që një strategji e tillë është e nevojshme, por konsideroj që në mungesën e buxhetit të cilin e ka Ministria në këtë rast Ministria e Mjedisit, do të jetë problem që kjo strategji të implementohet.

Problemet mjedisore të shkaktuara nga ndotja e ajrit e konsideroj se mund të jenë mungesa e një politike zhvillimore mjedisore, më konkrete për ruajtjen e mjedisit, pastaj

mungesa e legjislacionit dhe mosharmonizimi i plotë i legjislacionit të aprovuar në mes të ministrive përkatëse, mosharmonizimi i akteve nënligjore që dalin nga niveli i pushtetit lokal me ligjet në fuqi, mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe mungesa e fondeve për përmirësimin e teknologjive dhe rehabilitimin e mjediseve të ndotura. Por problemi siç e thashë dhe në fillim numër një do të jetë do të jetë edhe mungesa e fondeve me të cilën Ministria përkatëse këtë rast e Mjedisit ende nuk po mund të gjejë fonde edhe nga donatorët e ndryshëm, por njëkohësisht kur Qeveria nuk e fut në prioritet këtë fushë e cila është shumë e rëndësishme që ka të bëjë në radhë të parë me shëndetin e popullatës në përgjithësi, ajo vetë nuk e fut në prioritet, atëherë shihet që ka edhe mungesa të donacioneve nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Prandaj, edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e miraton në parim këtë strategji dhe do të insistojë që fusha e mjedisit të jetë prioritet në të ardhmen nga Qeveria kjo aktuale, por edhe qeveria që do të vjen.

Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Sa i përket edhe strategjisë edhe Planit të Veprimit, Lëvizja “Vetëvendosje” ka trajtuar të dyja dhe konsiderojmë që është një nga strategjitë e radhës e cila në fakt është strategji për vetveten dhe nuk është strategji për të realizuar një qëllim.

Dhe, për pasojë edhe kjo strategji do të përfundojë në sirtarë, por realisht është vështirë të implementohet kështu meqenëse në hartimin e saj pas trajtimit që e kemi bërë nuk është askund në qendër të strategjisë qytetari.

Pra, nëse hartojmë strategji, nëse hartohen plane të veprimit për të gjitha këto do të duhej të ishte në qendër të vëmendjes qytetari dhe jo strategjia në vetvete. Pra, kur flasim për cilësinë e ajrit flasim për qytetarët dhe për cilësinë që do të duhej të ishte në shërbim të qytetarit.

Në fakt, në këtë strategji nuk ka ndodhur fare as konsultimi të themi si duhet i kësaj strategjie me qytetarët dhe kjo vërehet sidomos tek komentet që ne i shohim në këtë strategji ku i vetmi koment për këtë strategji është komenti i një kompanie industriale. Pra, nuk do të duhej të ishte qasja për të cilësia e ajrit përmes kompanive industriale, respektivisht nëpërmjet ndotësve, por duhet të ishte qasja nëpërmjet qytetarit dhe cilësisë për qytetarin.

Strategjia nuk ka pikë reference se prej kah do të fillojë dhe sa do të përmirësojë situatën e cilësisë së ajrit dhe kjo bëhet dhe shndërrohet në një ndër strategjitë e radhës dhe lë për të dyshuar që do të mund të implementohet edhe kështu siç është.

Pra, në këtë strategji askund nuk përmendet qytetari dhe përfitimi se cilin do ta ketë qytetari nga kjo strategji dhe ta zëmë në pikën 3 askund nuk përmendet gjendja aktuale e cilësisë së ajrit që do të duhej të ishte në formë të qartë me shifra, të dihet se është e keqe apo e mirë, apo shumë e keqe, apo shumë e mirë.

Pra, duhet ta kemi të qartë gjendjen aktuale në mënyrë që të përfundohet te synimi. Pra, kemi nevojë për referencën.

Rrjeti monitorues i cilësisë së ajrit në pikën 4.1 shihet qartë që nuk është në shërbim të qytetarit meqenëse të dhënat nga ky rrjet monitorues nuk janë të qasshme për qytetarin. Qytetarët duhet ta kenë të qartë cilësinë e ajrit kudo që janë pikat për kontrollimin e cilësisë në mënyrë që informatat nga këta monitorues të jenë të qasshme për qytetarët vetë, pra të jenë edhe këto në shërbim të qytetarit.

Në pikën 5, strategjia shtjellon dhe ofron informata ekskluzivisht profesionale të cilat pak ose aspak janë të rëndësishme për publikun e gjerë dhe institucionet të cilat do të bie barra e implementimit të kësaj strategjie.

Në pikën 6 të strategjisë flitet për objektivat e saj ku të gjitha në përgjithësi janë ose konfuze dhe nuk janë të matshme, pra kur një strategji të besohet se do të jetë e implementueshme do të duhej të ishte e qartë, të jenë edhe synimet e qarta dhe hapat drejt atyre synimeve të jenë të qarta.

Prandaj, në shumë raste lëvizja “Vetëvendosje” i ka votuar strategjitë e tilla, kemi pasur raste po mendojmë që nga përvoja që kemi do të duhej që kjo strategji t’i kthehej tash Ministrisë dhe të bëhet një plan më i qartë, të jenë hapat më të definuar, të kemi shifra më të qarta dhe të jetë një strategji që kur ta votojmë të mund të thirremi pastaj në të për sa i përket implementimit se kështu kështoj nuk do të mund të kemi as mundësi që ne të thirremi në këtë strategji kur bie fjala të kemi rast që Kuvendi ta zëmë ta bëjë monitorimin e implementimit të ligjit për cilësinë e ajrit apo kur nuk kemi strategji të qartë atëherë nuk kemi as ku të thirremi në monitorim të atij ligjit.

Prandaj, ne nuk do ta votojmë këtë strategji.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kosova është vendi më i ndotur në rajon dhe më gjerë. Shkaktarë të të cilët shkaktojnë ndotjen e ajrit janë edhe industria. Kemi rastin e Termokosit në Obiliq, kemi termocentralet, kemi Sharr-Cemin dhe shumë ekonomi të tjera biznesore, të cilat e ndotin ajrin. E kemi Obiliqin dhe shtrohet pyetja: Çka kemi bërë për qytetarët e Obiliqit, të cilët zgjohen dhe marrin një ajër shumë të ndotur dhe për shkak të cilësisë së dobët të ajrit është një numër i madh i personave, të cilët vuajnë nga sëmundjet kanceroze. Dhe, si Qeveri ende s’kemi bërë asgjë në këtë drejtim.

Ne si grup parlamentar për shkak të rëndësisë së veçantë dhe duke u bazuar në atë se është korniza themelore për mbrojtjen e popullsisë, e përkrahim raportin me rekomandime lidhur me strategjinë për cilësinë e ajrit, për vitin 2013 - 2022 dhe Planin e Veprimit për vitin 2013, me shpresë se edhe pse ka një kosto buxhetore, Qeveria do të gjejë fonde në mënyrë që kjo strategji të implementohet në tërësi, njëkohësisht duke bashkëpunuar edhe me komunat tjera, të cilat kanë elementet që duhet t’i zbatojnë në praktikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah strategjinë e cilësisë së ajrit dhe Planin e Veprimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući! Parlamentarna Grupa “6+” razmotrila je izveštaj sa preporukama u vezi strategije o kvalitetu vazduha, tako da čemo glasat za izveštaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Zajednička Budućnost”, zoti Gjokiq e ka fjalën.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Takođe i “Zajednička Budućnost” je razmatrala strategiju o zaštiti vazduha. I mi smatramo da treba da se usvoji i glasaćemo za. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e deputetëve. Zoti Hyseni e ka fjalën. Skënder Hyseni.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën, sepse kam përshtypjen se me lehtësi të padurueshme po kalojmë nëpër tema kaq të rëndësishme, siç është mbrojtja e ambientit. Është për t'u befasuar që sot mungon ministri i Mjedisit, kur flitet për një dokument kaq të rëndësishme dhe një temë kaq të rëndësishme.

Jemi të vetëdijshëm cilët janë ndotësit kryesorë të ambientit në Kosovë dhe mirë që evidentohen në mënyrë laksative, Por, përshtypja ime është që shumë pak fjalë bëhet dhe pak ide ka se si të mbrohet ambienti, si të arrihet ai kompatibilitet dhe harmoni e domosdoshme midis nevojës për të shfrytëzuar pasuritë natyrore, që Kosova i ka, domethënë domosdoshmërisë për zhvillim në njërën anë, dhe në anën tjetër mbrojtjes së ambientit, derisa i shfrytëzojmë pasuritë tona.

Përmenden si ndotës të mëdhenj termocentralet e Kosovës mbi bazën e linjitit. Kosova nuk e ka komoditetin e mosshfrytëzimit të linjitit për prodhim të energjisë, por në të njëjtën kohë nuk jepen ide dhe nuk investohet fare dhe më së miri për këtë flet buxheti që i është caktuar Ministrisë të Mjedisit, që është buxhet për keqardhje, për ta ruajtur popullatën nga ndotja e ambientit.

Kosova përpos strategjisë, të cilën u tha se Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë, unë kujtoj që Kuvendi duhet të jetë shumë më kërkues në raport me Qeverinë, që të aplikohen norma strikte, rigorozë dhe teknologji përkatëse bashkëkohore dhe për mbrojtjen e ambientit. Një pyetje, që do të mund ta shtroja është: Çfarë mendon Qeveria të bëjë me Kosovën A?

A ka plane të dekomisionimit të këtij termocentrali, i cili i ka plotësuar të gjitha kushtet që të mbyllet dhe me këtë unë nuk shkel mbi politikat e LDK-së, që është parti e qendrës së djathtë dhe absolutisht është e pajtimit, që Kosova të ndërtojë termocentrale të reja mbi bazën e linjitit, duke i respektuar në mënyrë rigoroze konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e ambientit. Mirëpo, është e papranueshme që të vazhdojë të helmohet popullata e Kosovës me termocentrale që nuk plotësojnë asnjë kriter elementar të funksionimit dhe të mbrojtjes së ambientit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza Balje e ka fjalën!

HAMZA BALJE: Hvala predsedavajući!

Kako se može zaključiti i iz ovog akcionog plana, za očuvanje kvaliteta vazduha, odnosno zdrave sredine, cilj je primena određenih instrumenata za očuvanje istog. Kvalitet vazduha kod nas ima velike nedostatke u upoređenju sa evropskim standardima.

Gledajući sa tog aspekta i u investicijama, koje se ulažu za sprovođenje ovog zakona, može se slobodno reći da smo još uvek na veoma niskom nivou. Procenjuje se da ja zagađenje vazduha u urbanim sredinama posebno u industrijskim zonama veoma visoka i trenutno najveća koncentracija zagađenja vazduha je u elektranama postrojenjima sa velikim sagorevanjima i u sektoru saobraćaja, posebno transporta. A takođe i u industrijalizaciji poljoprivrede, što se posebno odnosi na naše ruralne sredine u okolini Prizrena i Dragaša i prekomerne upotrebe ovakvih aktivnosti bi se trebalo urediti posebnim podzakonskim aktima.

Reč je o ruralnim sredinama, koje su pod zaštitom nacionalnog parka i reč je, znači o nacionalnom parku Šari. Ovaj akciona plan će navodno doprineti, pre svega kao upitnik našim građanima ili kao putokaz da se počnu edukovati da bi zaštitli zdravu sredinu i smanjili zagađenje vazduha u granicama normale, koje su po evropskim standardima. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne kemi një propozim të Komisionit FunkSIONAL, të dhënë më parë nga zoti Hasani dhe unë do të dëshiroja që ta precizoj edhe njëherë, sepse do të hyjmë në fazën e votimit. Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni ka kërkuar nga Kuvendi që strategjia dhe Plani i Veprimit të ndahen. Kjo ka qenë në bashkëpunim edhe me Ministrinë, për shkak se strategjia e ajrit 2013 - 2022 i plotëson kushtet dhe kriteret për të ecur më tutje, që me pas mundësi Ministria të krijojë një plan të veprimit për periudhën e ardhshme.

Prandaj, Komisioni ka kërkuar që këto dy të ndahen, të miratohet strategjia, ndërsa plani i veprimit t'i kthehet Qeverisë për ripunim. Dhe, kërkoj që deputetët ta votojnë këtë strategji, ndërsa planin e veprimit t'ia kthejmë Qeverisë për ripunim të më tutjeshëm.

KRYESUESI: Atëherë, në sallë kemi 68 deputetë. E hedh në votim propozimin e Komisionit FunkSIONAL, të arsyetuar nga zoti Hasani që Kuvendi të miratojë Strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013 - 2022, ndërsa Plani i Veprimit për vitin 2013 - 2017 t'i rikthehet Qeverisë për ripunim.

Po, zoti Liburn Aliu e kërkon fjalën shtesë.

LIBURN ALU: Deputetët e votojnë propozimin, që sipas jush siç e paraqitët, a votojmë dy herë ne? Një herë për Strategjinë, një herë për Planin e Veprimit, apo po e votojmë propozimin që Strategjia të kalojë, ndërsa Plani i Veprimit të kthehet? A është kjo? Se në këtë rast, ka dikush që është që të dyja të kthehen e dikush mund të jetë që të dyja të kalojnë. Më kuptoni?

Po jepni opsionin, që...

KRYESUESI: Tani, më mirë do të ishte që kjo të mos vinte në seancë, e propozuar kështu siç ka ardhur më herët, por, meqenëse komisioni e ka vendosur këtë, që ta ndryshojë propozimin e bërë më herët sipas rendit të ditës, Komisioni, respektivisht kryetari i Komisionit ka kërkuar në emër të komisionit, që të hiqet pjesa e dytë e propozimit, domethënë Plani i Veprimit për vitin 2013 - 2017 dhe ne po i votojmë pa këtë propozimin e komisionit.

Po votojmë edhe t'i ndajmë, në qoftë se ju mendoni që është më mirë. Unë nuk e kam problem ta hedh në votim dy herë. Tash, unë thashë që mirë do të ishte që të mos vinte kështu nga komisioni në seancë i papërgatitur. Megjithatë, sipas kërkesës suaj unë mund ta hedh në votim dy herë. Domethënë, miratimin e Strategjisë për ajrin për vitin 2013 - 2022 që të votohet, dhe pastaj pjesën tjetër ta votojmë edhe njëherë, që Plani i Veprimit për vitin 2013 - 2017... Po, Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që kryetari i Komisionit e sqaroi, por është decidivisht e shkruar edhe në rekomandimin e arsyetimit, kur thuhet që komisioni vendos që t'i rekomandojë Kuvendit për miratim Strategjinë e cilësisë së ajrit, për periudhën 2013 - 2022, ndërsa Plani i Veprimit 2013 - 2017 t'i kthehet Qeverisë në ripunim. Me sa i kam informatat, do të thotë është marrëveshja edhe me Ministrinë, me institucionin përkatës në këtë rast, do të thotë edhe Ministria është pajtuar që të shkojë kështu dhe nuk kemi tash nevojë t'i ndajmë.

Do të thotë, Plani i Veprimit për vitin 2013 - 2017 i kthehet në ripunim Qeverisë. Është marrëveshje dhe është pajtuar edhe Ministria në këtë rast.

KRYESUESI: Në rregull. Unë e kam këtë mundësi. Zoti Liburn, sqarona edhe ti pak.

LIBURN ALIU: Kështu: propozimi i Komisionit është pra, që njëra të kalojë, njëra të kthehet dhe po hedhet në votim. Nëse Kuvendi voton kundër, qysh është përfundimi? A më tregon mua dikush? Shumë logjikisht jam duke pyetur. Nëse votohet kundër, cili është përfundimi, se çfarë vendimi ka marrë Kuvendi?

KRYESUESI: Nuk kalon asnjëra Liburn, është praktikë... Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Shpresoj që në të ardhmen Komisioni përkatës parlamentar këto dilema t'i sqarojë në Komision dhe neve si deputet na është sjellë rekomandimi, por besoj shumë që do të

ishte korrekt që ne të votojmë për rekomandimin, sugjestionet e gjithsecilit pastaj mund të shihen pastaj, pas votimit të kësaj dhe ato sugjestionet mundën t' i qesim aty në komisionin përkatës aty parlamentar dhe të debatojmë, të mos të na marrin kohë shumë me një çështje, a ta ndajmë strategjinë a mos ta ndajmë, është rekomandimi dhe të votojmë për të.

KRYESUESI: Atëherë, e hedh në votim paketë, siç është Propozimi. Në sallë janë 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Me 57 vota për, 8 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi miratoi Strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013 - 2022, ndërsa Plani i Veprimit për vitin 2013 – 2017 i rikthehet Qeverisë për ripunim.

Pika 5 e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në pajtim me dispozitat e Rregullores kanë shqyrtuar raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me këtë raport ka vlerësuar se meqenëse ndërmarrjet publike në vitin 2012, nuk janë audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, atëherë ky komision ka nevojë ta shqyrtojë këtë raport.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është i mendimit që ky raport të renditet për shqyrtim në seancë plenare.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, zotin Pajaziti për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 22 nëntor e ka shqyrtuar raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012 dhe komisioni vlerëson se ky raport i prezantuar nga Qeveria është në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Ne, ditë më parë, po ashtu si komision, e kemi përfunduar edhe procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike. Vetëm ditë më parë, ne kemi nxjerr edhe disa rekomandime, të cilat u dedikohen funksionimit sa më të mirë dhe disa obligime shtesë, që duhet t'i marrë edhe Qeveria për funksionimin sa më të mirë të këtyre ndërmarrjeve publike.

Në raportin e radhës, më lejoni të ju them që njësia e caktuar e Ministrisë është për t'u lavdëruar për formatin, në të cilin e nxjerr këtë raport. Ka informata të bollshme për të gjitha ndërmarrjet dhe po ashtu, në fund si përmbledhje nxjerr edhe disa rekomandime, të cilat janë përafërsisht me ato të cilat edhe ne si Kuvend i kemi miratuar ditë më parë.

Prandaj, unë si kryetar i Komisionit po e nxjerr këtu edhe rekomandimin për miratim. Po ashtu, po i ftoj, meqenëse kemi pasur vetëm pak ditë ndërmjet, një temë të njëjtë të trajtuar si monitorim të zbatimit të këtij ligji, që të miratohet ky raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Deputetë të nderuar,

Meqë Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike nuk ka pasur materie të shqyrtimit, sepse këtij raporti nuk i është bërë auditimi i vitit 2012, ne nuk kemi paraqitur pengesë në procedurat e mëtutjeshme të trajtimit të tij, sepse edhe ne nuk e dimë se çka ka në të, pa e pasur raportin e Zyrës së Auditorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka analizuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike dhe si të tillë, përkundër vlerësimeve dhe vërejtjeve që i ka, bashkëngjitet me raportin e Ligjit për monitorimin që është paraparë edhe si udhëzim në të ardhmen, që të shihet një analizë më e mirë nga një grup i specializuar për performansës e këtyre ndërmarrjeve publike.

Prandaj, ftojme të gjithë deputetët që të miratohet ky si raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zharku e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin dhe përkundër disa të themi avancimeve apo përmirësimeve në performansës e tyre, shpreh rezerva në pika të caktuara.

E para ka të bëjë me atë, se të themi përkundër disa përmirësimeve operuese të disa ndërmarrjeve publike, kemi një përkeqësim në cilësinë e fitimeve.

Po e përmend rastin e KEK-ut, i cili ka zvogëlim në fitime, përkundër asaj themi përmirësimit operuese kur shpenzimet rriten më shumë se që rriten të hyrat.

Te PTK-ja kemi rënie të fitimeve, si pasojë e rënies më të madhe të të hyrave të ne se sa shpenzimeve. Në anën tjetër e shohim brengosëse që te INKOS-i nga fitimet e vitit paraprak, ka kaluar në humbje.

Natyrisht, efektet më pozitive janë në sektorin e ujërave, si në aspektin operues, edhe në atë financiar. Duhet përmendur posaçërisht në këtë sektor për dy kompanitë regjionale, ajo që është e Prishtinës dhe e Mitrovicës, me 71 kompani tjera publike në sektorin e ujit kanë vazhduar me humbje, megjithatë ka një zvogëlim të tyre. Megjithatë, të themi, edhe njëherë është rasti që të theksojmë rëndësinë e rekomandimeve në raportin e mbikëqyrjes së Ligjit për ndërmarrje publike, i cili ka kaluar javën e kaluar.

Në veçanti janë, të themi, dy rekomandime me rëndësi. E para ka të bëjë me krijimin e një mekanizmi të jashtëm për matjen e nivelit të kënaqshmërisë së shërbimeve të ndërmarrjeve publike, kurse e dyta natyrisht, me rritjen e përgjegjësisë së bordeve të kompanive ndërmarrjeve publike në rast se ato ndërmarrje themi nuk performojnë apo nuk tregojnë performansë të duhur.

Në fund, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk do ta votojë raportin krejt me qëllim të asaj themi që nuk jemi të kënaqur me nivelin e arritur në përmirësimin e performansës së ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Raporti për performansën e ndërmarrjeve publike për vitin 2012, siç u tha edhe nga parafolësi, është më i mirë them ashtu si paraqitje, se sa që ka qenë për vitet e kaluara, sepse e ka një dozë të shtuar të analizimit të dhënave, veçanërisht atyre financiare, po edhe arritjeve tjera të ndërmarrjeve publike, krahasuar me raportet tjera ku të dhënat janë paraqitur vetëm në formën e tyre të vrazhdë pa i shpjeguar pse.

Pra, kemi pasur problem me këto raporte për çdo vit, sepse në asnjërin prej tyre nuk ka pasur trajtim analitik të këtyre ecurive në ndërmarrjet publike pra, ngritjes apo rënies së përfitimeve, ngritjes apo rënies së prodhimit, lëvizshmërinë në treg, e kështu me radhë.

Ndërkohë, që ky raport e ka përmirësuar këtë aspekt të raportimit, jo kënaqshëm por megjithatë është një përparim, po në anën tjetër disa prej vërejtjeve, që kanë të bëjnë me këtë raport është tek aspektet tjera të raportimit. Për shembull, te disa ngjarje për sa i përket ndërmarrjeve publike të cilat këtu paraqiten vetëm si fakte pa e pasur prapë shpjegimin mbështetës për çështje të caktuara, ta zëmë për shembull, për vendimin e ZRRE-së mbi kthimin e 17,9 milionë eurove që i janë kthyer KEDS-it në momentin e privatizimit, që përmendet këtu në raport, edhe pse kjo është një ndodhi që ka ndodhur në vitin 2013 faktikisht, por është si një lloj obligimi financiar, ta quaj ashtu, i cili është i mbledhur gjatë vitit 2012.

Dhe, në këtë drejtim, edhe pse ka pasur shumë debat rreth kësaj çështjeje, raporti prapë e lë në nivel të një fakti të cilin e dimë të gjithë, por pa e interpretuar atë. Dhe, mendoj që në një raport që do të informojë deputetët edhe publikun në përgjithësi për performansën e ndërmarrjeve publike, domosdoshmërisht duhet ta kemi edhe aspektin analitik të cilitdo fakt, në mënyrë që interpretimi i faktit pastaj të jetë i mirinformuar, të them ashtu.

Aspekti tjetër i raportit ku dua të ndalem unë, natyrisht ka shumë gjëra të cilat mbase edhe nuk do të kem kohë që t'i përmend, po është edhe tek radhitja e sfidave të së ardhmes, siç quhen këtu në raport, për disa ndërmarrje.

Për shembull, po e nisim me PTK-në. Sfida e parë e radhitur në këtë raport për PTK-në është privatizimi, më saktësisht për Telekomin, më falni. Dhe, mendoj që kur Qeveria edhe kur ndërmarrjet raportojnë për performansën e tyre, nuk mund që të raportojnë ose t'i paraqesin si sfida një proces, të cilin do ta bëjë Qeveria, siç është privatizimi.

Pra, një proces për të cilin planifikon që ta kryejë Qeveria, sepse sfida duhet të jetë zhvillimi i ndërmarrjes e jo privatizimi i saj. Pra, privatizimi është një çështje tjetër që ka të bëjë me ndërmarrjen, mirëpo ne këtu duhet t'i shohim se cilat janë ato sfida me të cilat do të ballafaqohet ndërmarrja për t'u zhvilluar dhe përmirësuar. Ndërkohë, që privatizimi është një vendim i Qeverisë për të hequr dorë nga ndërmarrja, pra, janë dy çështje të ndryshme, të cilat nuk duhet të figurojnë në raport, veçanërisht jo si sfida.

Pastaj po këtu te Telekom, për shembull, kur kemi këso sfidash tjera, të cilat janë të radhitura këtu, që kanë të bëjnë edhe me Postën e Kosovës, pra që është procesi i prokurimit dhe planifikimit, pastaj angazhimi i ekspertëve, shitja e produkteve, që është një prej sfidave që na paraqitet këtu te PTK-ja, veçanërisht te Telekom, mendoj që raporti domosdoshmërisht duhet ta informojë Kuvendin dhe publikun në tërësi, duke qenë se është të paktën i definuar sipas këtij raporti, pronari i fundit i këtyre ndërmarrjeve publike, se cilat janë sfidat kryesore e PTK-së. Dhe, mendoj që këto sfida që janë paraqitur këtu, nuk i paraqesin realisht sfidat me të cilat ballafaqohet PTK. Edhe ato duhet të renditen këtu dhe duhet të tregohet se çfarë po bën Qeveria në mënyrë që t'i shmangë këto sfida, apo çfarë ka bërë ndërmarrja, në mënyrë që t'i shmangë këto sfida?

Sfida kryesore, me të cilën është ballafaquar PTK-ja prej vitit 2010 është ndalesa rigide që i është bërë në investim edhe në përmirësimin e rrjetit dhe të teknologjisë që ajo përdor. Pra, kjo është sfida kryesore e cila është bërë me direktivë të Qeverisë, me direktivë të ministrit të atëhershëm të Ekonomisë dhe Financave, pra Ahmet Shalës. Dhe, në këtë drejtim kjo duhet të radhitet dhe të shpjegohet pse po vazhdon të qëndrojë një ndalesë e tillë për PTK-në, duke ia humbur kështu diku afër katër vjet tash po bëhen, të investimeve të mundshme, që do ta kishin bërë telekomunikimin në Kosovë të një niveli shumë më të ndryshëm, shumë më të avancuar, se sa që e kemi sot.

Sfida tjetër është pastaj se si po ballafaqohet PTK-ja me konkurrencën në treg, e cila shpeshherë e merr formën e konkurrencës jolojale, pikërisht për shkak se eksponentët e kompanisë tjetër të telefonisë, pra të IPKO-s, kanë lidhje të drejtpërdrejta me Qeverinë e Kosovës dhe rrjedhimisht me anëtarët e Bordit të PTK-së, që në njëfarë mënyre po ia pamundësojnë apo po ia shkurtojnë mundësitë PTK-së për t'u zhvilluar dhe në këtë mënyrë për t'ia dhënë primatin operatorit tjetër që është IPKO.

Pra, edhe kjo është një çështje që duhet të radhitet në raport, në mënyrë që ta dinë, për shembull, edhe konsumatorët edhe publiku edhe ne si deputetë, si u bë që një kompani që ka pjesën dërmuese të tregut, pra "Vala-900" dhe që ka infrastrukturën shumë më mirë të vendosur në terren, të jetë prapa në aplikimin e teknologjisë 3G, krahasuar me një kompani e cila as nuk e ka infrastrukturën e PTK-së, as nuk e ka konsumatorin e PTK-së

dhe as nuk i ka të hyrat vjetore të PTK-së? Pra, kjo është një çështje të cilën duhet të na tregojë Qeveria neve, pse nisi IPKO-ja para “Valës” me 3G, kur “Vala” ka qenë shumë më herët e përgatitur që ta aplikojë këtë teknologji?

Ky është raport i performansës dhe kjo është një çështje që duhet të futet në raportin e performansës, sepse këtu e kemi një mungesë të pashpjeguar, pra që nuk është mungesë objektive, por që është sigurisht subjektive e performansës së duhur të PTK-së dhe duhet që Qeveria ta tregojë ku ka qenë ngecja për këtë çështje.

Pra, meqenëse ministri është këtu do të kisha pasur shumë dëshirë që ta dëgjoj nga ministri se çfarë ka ndodhur me këtë zhvillim në PTK, kur e kemi parasysh edhe nga raportimet në media edhe nga ekspertët e telekomunikacionit, që PTK-ja, “Vala-900”, madje kjo është thënë edhe nga menaxhmenti i PTK-së në përgjithësi, që PTK ka mundur shumë më herët të nisë me aplikimin e teknologjisë 3G dhe që këtu nuk flitet në raport fare?

Pra, këto janë disa prej atyre të metave, të them ashtu të këtij raporti që në njëfarë mënyre përmes mosinformimit bën keqinformim, të cilat e bëjnë këtë raport pastaj të vështirë për t’u pranuar nga Kuvendi, meqenëse nuk mendoj se kjo e paraqet pasqyrën reale të zhvillimeve në ndërmarrjet publike.

Prapë po e përsëris, të dhënat që janë këtu, sigurisht që janë të dhëna faktike, nuk po i kontestoj ato, mirëpo çka i mungon raportit është më shumë pjesë përbërëse e të vërtetës për ndërmarrjet publike, se sa ajo që është thënë në raportin për performansën e tyre.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë kundër këtij raporti.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Një pjesë kryesore të asaj që seriozisht e pata ndërmend ta them e tha kolegu Ymeri edhe e tha saktë.

Mirëpo po ia nis kështu, nëse një vrojtues i jashtëm kishte për ta parë performansën e ndërmarrjeve publike në Kosovë, do ta jepte një konstatim vetëm me një fjali: “6 vjet pas pavarësisë Qeveria e Kosovës nuk është në gjendje ta menaxhojë asnjë ndërmarrje publike normal”.

Edhe kur po them “ta menaxhojë Qeveria e Kosovës” e kam tepër të qartë unë, për të mos lënë vend për replika, unë e di që drejtpërdrejt Qeveria nuk i menaxhon, ama partitë në pushtet, është tepër e qartë dhe prapë kisha dashur dikush të më sfidojë në këtë që po e them, i kanë mbushur bordet e ndërmarrjeve publike me “aparatchikë” të partive politike, pa asnjë kriter profesional ose të integritetit individual.

Nuk jemi komunistë ne, e kemi të qartë që gjithkush ka lidhje politike, mirëpo është dashur ta bëjë minimumin e asaj që duhet bërë dikush në pushtet. Të paktën, ata njerëz

që janë politikë t' i zgjedhin ata që janë nominalisht, ose minimalisht edhe profesionistë, kjo nuk ka ndodhur.

6 vjet pas pavarësisë së Kosovës, kur ka nisur Qeveria e Kosovës ta marrë mbi vete menaxhimin e ndërmarrjeve publike, ka treguar se i ka konsideruar si mall të huaj, nuk është lodhur për to hiç, përpos dy ose tri ndërmarrjeve publike, nuk po i përmend cilat janë për të mos u dukur çuditshëm çka po them këtu, të gjitha pa përjashtim nuk kanë funksionuar ose operuar ashtu si duhet.

Ndërmarrjet publike zakonisht janë ndërmarrje të cilat sjellin shumë të hyra dhe vendet tjera kanë problem t' i menaxhojnë për shkak se sjellin të hyra, përderisa në Kosovë një numër të madh të ndërmarrjeve publike, e dini ju të gjithë, Qeveria edhe i subvencionon. Këtu nuk mund të ketë kurrfarë performanse, e cila do të sillte diçka në këtë vend.

Për 3G dhe “Valën” u fol më përpara, kolegu Ymeri foli, është me të vërtetë goxha e dhembshme, që një kompani, pavarësisht a është private a çka është, një kompani tjetër, e cila hyn në treg gati një dekadë më vonë se “Vala”, me të hyra shumë më të vogla e tjera, e tjera, siç u tha arrin të depërtojë në treg më mirë se sa ndërmarrja publike, e cila është jona, do të thotë e popullit dhe e cila befasisht ose paradoksalisht, me vendime të Qeverisë dëmtohet.

Zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Shumë ndërmarrjeve publike u është ulur vlera me veprime të Qeverisë së Kosovës, po them edhe njëherë, në gjashtë vjetët e fundit, jo vetëm në këto tre vjetët e fundit. Dhe, ndoshta është deri në një masë jo krejt fer për ta sulmuar sot ministrin këtu, për shkak se vonë e ka marrë këtë detyrë, sidoqoftë, ka qenë dashtë që në raport të jepen lakoret se çka është pritur prej ndërmarrjeve publike edhe aty ku ka ndoshta përmirësim të performansës.

Nuk mund të quhet përmirësim i performansës një rritje krejt e vogël pozitive për 6 vjet, domethënë, një ndërmarrje e cila krijon profit, një ndërmarrje e cila e ka tregun e sigurt. Gjithsesi se diçka pozitive ndodh aty, po a po ndodh pozitivisht mjaftueshëm, që ne të themi se po menaxhojmë diçka.

Vota jonë kundër ka për qëllim, të dërgojë një mesazh, të dërgojë një mesazh në Kosovë, të dërgojë një mesazh te ata njerëz që punojnë në ndërmarrje publike, për t' u treguar që e kuptojmë që shumica dërmuese e atyre njerëzve nuk kanë faj pse shteti ynë nuk po di të menaxhojë ndërmarrje publike ende. Dhe, është për të ardhur keq, është turp, është, domethënë, një ndër elementet kryesore të një shteti është që të dijë të menaxhojë me të mirat e veta.

Është një mesazh për t' u treguar bordeve, për t' i treguar Qeverisë së Kosovës dhe partive në pushtet, se kjo është mënyra më e keqe për të menaxhuar me shtetin, kjo është mënyra absolutisht e kundërt me çka do që kishte të bëjë një vend normal që e do vendin e vet, që e do shtetin dhe që do ta shohë shtetin duke ecur përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshendetje për ministrin!

Duke u bazuar në Ligjin e ndërmarrjeve publike Njësia për politikën dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike, e cila funksionon në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, raporti i performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2012, më vjen keq se ne tash jemi në fund të vitit 2013 dhe shqyrtojmë raporte të ndërmarrjeve publike të vitit 2012.

Unë kisha kërkuar në start nga ministri këtu, se në javën e kaluar kemi pasur raportin e monitorimit të Ligjit të ndërmarrjeve publike, ministër me një nen të posaçëm të caktohet, kur Njësia për monitorim duhet më së largu, ose më së afërmi, të vijë me raport edhe të auditimit dhe raportin e ndërmarrjeve publike, që të raportojë brenda Kuvendit të Kosovës.

Në rast se e shohim performancën operative, performancën financiare, qeverisjen korporatave, perspektivën në të ardhmen, i gjithë raporti mund të themi se nuk është aq i kënaqshëm në favor të qytetarëve të Republikës së Kosovës, ku ky raport shkon në Qeveri në korrik, në Komisionin e ministrave për ndërmarrje publike dhe aty i jepet drita e gjelbër, që të vijë në Kuvend të Kosovës.

Kur i shikojmë individualisht ndërmarrjet publike, shihet qartë se vetëm tri kompani kanë arritur ndjeshëm fitime financiare. Në këtë rast, në rast se marrim çështjen e KOST-it, më vjen ndoshta shumë keq që në atë kohë ministri ka qenë bash drejtor i KOST-it, aty mund të japim performancë të mirë, për arsye se akoma nga kalimi i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit, KOST-i ka kryer një punë shumë të mirë, jo për lëvdatë ministrit, por për punëtorët e KOST-it, të cilët e kanë larguar 110 KV-shin nga mënyra e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit dhe në këtë rast Kosova në çështjen e përfshirjes së tyre në transferin e aseteve të veta ka edhe 110 KV-shin.

Ministër, më vjen mirë që je këtu, në vitin 2012 është paraparë që, që në atë kohë Kosova dhe Shqipëria të kenë një linjë të 400 KV-shit dhe mbrëmë në media u tha, se Republika e Shqipërisë ka marrë vendim që të ketë një linjë 110 KV-ësh me Prizren, shumë e dhembshme.

Shumë e dhembshme, duke pasur parasysh se ne kemi miratuar këtu një marrëveshje, e cila ka pasur mundësinë e ndërtimit të linjës 400 KV-she Kosovë - Shqipëri, që do të thotë se prapëseprapë ata po i mbrojnë interesat e tyre. Por, nuk do të ishte interes as për shtetin shqiptar që të mos kishte një linjë 400 KV-she me Kosovën, që do të ishte një bashkëdyzim i tregut shumë të mirë mes Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Duhet të cek në këtë raport se në vitin 2012 në rast se shohim çështjen e ujërave është diçka shumë e habitshme që në këtë vit një shumë e madhe e qytetarëve të Kosovës, kur thuhet “sektori i ujërave”, “mbulueshmëria në shërbimet e ujit”, e ka ‘Radoniqi’ i Gjakovës me 96%, ndërsa shkallën më të ulët të mbulueshmërisë së shërbimeve të ujit gjatë vitit 2012, e ka shënuar Hidro-Morava e Gjilanit me 57%. Kjo është tmerr, në vitin

2012 të ketë akoma qytetarë të cilët nuk kanë mbulueshmëri të ujit, element kryesor për jetesë!

Duhet t'ju them, në tërësi si raport, mund t'ju japim dritën e gjelbër ose ta kthejmë, por esenca është që qytetarët e Kosovës në vitin 2012, pa dashje, se ministri në atë kohë s'ka qenë ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, mund të themi se ky ka qenë realiteti, që qytetarët e Kosovës janë përballë me shërbimet të cilat ua kanë ofruar ndërmarrjet publike qendrore të Republikës së Kosovës.

Ministër, e kemi cekur mjaft mirë në rekomandimet e monitorimit të Ligjit të ndërmarrjeve publike, që Qeveria nuk menaxhon direkt me ndërmarrjet publike, por menaxhon nëpërmes bordeve të ndërmarrjeve publike dhe të kemi dhënë një rekomandim, që këto borde të jenë borde profesionale, e jo si me rastin e KEK-ut, të ketë konflikt interesi në zgjedhjen e një anëtari të bordit në këtë ndërmarrje.

Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje këtij raporti, se kjo është çështje e kaluar, sikur të flasim për borën e parvjetme. Mirëpo, edhe njëherë kërkoj nga ju ministër, që në Ligjin për ndërmarrje publike të keni një nen apo një paragraf në të cilin saktë leni datën e saktë të raportimit të ndërmarrjeve publike dhe Zyrës së Auditorit, që të kemi raportet edhe financiare të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, zoti Sasha Gjokiq e ka fjalën.

SAŠA GJOKIĆ: Hvala, gospodine potpredsedniče!

I mi smo razmatrali ozbiljno ovaj izveštaj o javnim performancama javnih preduzećama za 2012.godinu.

Mi ne želimo da ulazimo sada u neku polemiku, s obzirom da želimo da istaknemo da se slažemo sa većinu kolega, koji su govorili i u ime poslaničkih grupa. Ne bih želio da diskutujemo kako su na stanju javna preduzeća.

Što se tiče finansijskih izveštaja, poznato je da cifre su čudo i da mogu da se šteluje kako kome odgovara. Ja imam jednu primedbu kao zamenik šefa poslaničke grupe, kad su ovakvi izveštaji zameram predstavnicima Vlade, što nisu prisutni, odnosno resornim ministrima, koji su dužni da budu ovde.

Ja neću komentarisati, samo ću se nadovezati na izveštaj Evropske Komisije u kakvom je stanju naša Vlada i naše Kosovo, tako ta u cilju poboljšanja za 2014. u naš rad, smatram i tražim od gospodina ministra da sve nepravilnosti, i kao što je moja koleginica rekla, o političkom imenovanju u bordovima i rodničkim vezama, da se to smanji, odnosno da se to više ne dozvoli. Tako da u načelo “Zajednička Budućnost” će podržati ovaj izveštaj da ne bi bilo posledice za građane Kosova.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, nga “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin me rekomandime për performansën e ndërmarrjeve publike për vitin 2012 dhe me gjithë ngecjet që janë evidente dhe sfidave me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike, duhet të kemi parasysh përparimin e avancimit dhe të përmirësimit në disa sektorë të caktuar dhe për dallim nga e kaluara, edhe Grupi Parlamentar “6+” do ta përkrahë raportin me rekomandime të performansës të ndërmarrjeve publike për vitin 2012.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala kalon te deputetët. Fjalën e ka zonja Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege deputete dhe deputetë,

U fol shumë për raportin vjetor të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012 dhe nuk do të ndalem shumë te raporti, sepse e thanë edhe komisionet, përkatësisht përfaqësuesit e Komisionit për Zhvillim Ekonomik fjalën e tyre. Unë kërkoj vetëm që të respektohet barazia gjinore në bordet e ndërmarrjeve publike.

Sipas rekomandimeve që ne i kemi votuar në këtë Parlament më 9 mars 2012, ka qenë një seancë që është mbajtur për nder të 8 Marsit dhe kur ne si deputetë i kemi votuar rekomandimet, e njëra prej rekomandimeve ka qenë që të ketë më shumë gra në bordet e ndërmarrjeve publike dhe të respektohet edhe Rezoluta e Parlamentit Evropian. Po e them se së fundi Parlamenti Evropian e ka marrë një vendim që në bordet e ndërmarrjeve publike të jenë 50% gra dhe 50% burra. Unë e di që kjo është vështirë e realizueshme të bëhet në Kosovë, por të paktën të kontribuojmë bashkërisht që të zbatohen ato vendime që ne i votojmë në këtë Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues!

Nuk mendoj se është folur sa duhet për raportin dhe besoj që duhet të flitet prapë. Unë mendoj që ka çështje të cilat Ministria e Zhvillimit Ekonomik është dashur t’i thotë në raport. E para e punës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si autore e këtij raporti, është dashur të tregojë se çfarë ka bërë ajo për ngritjen e performansës së ndërmarrjeve publike, ose cilat janë masat që Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka ndërmarrë që performansa të ngrihet edhe më tutje, sepse nga të dhënat që na vijnë nga raporti nuk e kemi një performansë të kënaqshme.

Unë po i përmend sektorin e energjisë dhe sektorin e ujit.

Prodhimi i energjisë është rritur në vitin 2012 për 147 gigavatë orë energji, humbjet teknike janë zvogëluar nga 16,78%, në 16,32%. Ky zvogëlim është 0,46%. Thënë ndryshe, me këtë trend duhen edhe 33 vjet që humbjet të kompensohen tërësisht, do të thotë të mos kemi humbje ekonomike.

Humbjet komerciale nga 21,37%, në vitin 2011, në vitin 2012 janë 20,37%. Do të thotë, me këtë trend neve na duhen edhe 20 vjet që të mos kemi fare humbje komerciale. Inkasimi është rritur nga 89,98% në 90%, që i bie 0,02%. Këto të dhëna janë në tabelën

numër 2 të raportit dhe me këtë trend i bie që edhe 50 vjet ne ta kemi një inkasim 100% të rrymës.

Tash nëse këta janë indikatorë të një performanse të mirë, atëherë edhe unë ju bëj thirrje që të votoni Por, me këso performanse, kur ne na duhen mesatarisht edhe 40 vjet për ta arritur 100% e efikasitetit të ndërmarrjeve publike, është e pamoralshme që të kërkohet një votë për raportin.

Në KOST, humbjet në transmision kanë rënë nga 2,2%, në 1,99%. Këtu me të vërtetë, kur i kam parë këto shifra, jam befasuar edhe me precizitetin e këtij raporti që e ka nxjerrë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, do të thotë kemi rënie prej 0,1%.

Kur jemi te sektori i ujit, para së gjithash duhet të përmendim se diku rreth 1/3 e popullsisë së Kosovës nuk ka qasje në ujë të pijshëm. E dimë shumë mirë nëpër zonat rurale se nga e marrin ata ujin e pijes, nëpër puse të cilat nuk janë aspak të pastra, të cilave asnjëherë nuk u janë bërë analizat se ai ujë mund të pihet. Prodhimi i ujit në vitin 2012 është rritur për 3%. Faturimi është rritur nga 39 në 40%, do të thotë me 1%, e me këtë trend na duhen edhe 60 vjet që ta kemi një faturim 100% të ujit që prodhohet dhe që del në shfrytëzim për qytetarët e Kosovës.

Inkasimi bie nga 61% në 60%, do të thotë na duhen edhe 40 vjet për ta pasur komplet inkasimin e ujit. Uji i pafaturuar zbret për 1%. Krejt për rrumbullakuar matematikat në sektorin e ujit, i bie që për çdo 100 litra ujë të prodhuar, vetëm 40 litra faturohen, dhe prej atyre 40 litrave, vetëm 26 litra inkasohen. Tash, nëse kjo është një performansë e mirë, atëherë unë i lutem ministrit që të na shpjegojë sesi kjo qenka e tillë.

Normalisht u tha më herët se jo të gjitha ndërmarrjet e kanë performansën e njëjtë, por kjo është mesatarja e atyre për të cilat po flasim.

Kur jemi te telekomunikimet, u fol gjithashtu që kanë rënë fitimet e Postë-Telekomit, kanë rënë fitimet e 'Valës' nga 46 milionë, sa kanë qenë në vitin paraprak, në 38 milionë në vitin 2012. Kemi një rënie prej 8 milionësh, e kjo është pikërisht të ndërhyrjes së Qeverisë. U përmend më herët vendimi i famshëm i vitit 2010, i cili i ka ndaluar të gjitha investimet dhe tash kemi një përparim teknik-teknologjik dhe të shtrirjes të rrjetit të konkurrentëve të 'Valës', që është në epërsi teknike në krahasim me 'Valën'.

Gjithashtu, komplet faji te humbja e Postës i adresohet Qeverisë për arsye se është bërë një ndarje jo e mirë dhe jo e menduar. Do të thotë kemi një humbje të Postës së Kosovës prej 1 169 000 euro, që vjen si rezultat i ndarjes së pamenduar mirë dhe tash e kemi një ndërmarrje, e cila afaron me humbje dhe nuk dihet se si do t'i mbulojë humbjet kjo ndërmarrje në të ardhmen.

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike e përmendi edhe më herët që na mungojnë do të thotë raportet e Auditorit të të gjitha këtyre ndërmarrjeve publike, mirëpo ne të gjithë kemi qasje në ueb-faqen e tij dhe mund t'i shohim të gjeturat e raporteve, të cilat pothuajse për të gjitha ndërmarrjet tregojnë se ka shkelje të mëdha.

Për ta parë se cili është efekti i Qeverisë, unë do ta përmend edhe një ndodhi të vitit 2013, e cila nuk është pjesë e këtij raporti. Ne e kemi parë që ndërmarrja publike Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, pjesa e kontrollit ajror ka afaruar me humbje, dhe këto humbje priten të thellohen edhe më tutje, për arsye se në vitin 2013 Qeveria e ka humbur kontrollin e hapësirës ajrore dhe i është dhënë Hungarisë. Edhe në biseda me nivelet e menaxhmentit të kësaj ndërmarrjeje është thënë që kjo ka ndodhur pikërisht për shkak të neglizhencës që është bërë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe komplet Qeveria, sepse për 2 kilometra autostradë, diku rreth 25 milionë euro, na e kemi humbur kontrollin ajror të paktën për 5 vjet dhe humbjet që i ka Kosova nga kjo janë 10 deri në 12 milionë, e mund të jenë edhe më të larta.

Unë propozoj që ne t’i themi ‘jo’ këtij raporti, do të thotë ju bëj ftesë deputetëve që t’i thonë ‘jo’ këtij raporti, sepse këtu ne nuk kemi asnjë aktivitet dhe nuk kemi asnjë vlerë të shtuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeveria, e cila ndihet si aksionare kryesore e këtyre ndërmarrjeve publike. Performansa është shumë e zbehtë. Nëse ne ecim me këta trendë, atëherë askush prej nesh nuk do të jetë në jetë edhe nuk do të arrijë ta shohë një performansë të dëshirueshme çfarë do të duhej ta kemi, sepse na duhet plot edhe 40 vjet për ta arritur një efikasitet 100% të ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe në vetë raportin shpjegohet shumë qartë që Qeveria nuk është pronare e ndërmarrjeve publike. Pra, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetenca në ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në ndërmarrjet qendrore, mirëpo nuk është pronar i këtyre ndërmarrjeve publike.

Ajo çfarë e kemi parë, jo vetëm në mandatin aktual të kësaj Qeverie, është se lufta që kjo Qeveri ua ka shpallur ndërmarrjeve publike dhe lufta që kjo Qeveri ia ka shpallur Kuvendit të Republikës, duke shpërfillur për çështjet më të rëndësishme, në fakt është e njëjta luftë. Shpronësimi i publikut dhe shpërfillja e përfaqësuesve të publikut janë i njëjti mohim. Kjo është vërejtur më së shumti dhe më së miri pikërisht te çështja e PTK-së, përkatësisht tek orvatjet për ta privatizuar atë.

Pra, lufta që Qeveria ia bën Kuvendit dhe ajo që ua bën ndërmarrjeve publike janë aspekti politik edhe ekonomik i së njëjtës luftë.

Këtu duhet theksuar që ky raport detyrohet ta pranojë që ndërmarrjet publike kanë sukses në performansën e tyre financiare, me gjithë faktin që nuk po ndihmohen, nuk po mbështeten e nuk po përkrahen. Në krahasim me vitin paraprak, pra i bie 2011, në krahasim me 2012, kur shikohen individualisht këto ndërmarrje publike pranohet që janë tri kompani: KOST-i, Kompania Rajonale e Ujësjellësit ‘Mitrovica’ dhe ajo ‘Radoniqi-Dukagjini’. I kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare, ndërkaq kompanitë e tjera rajonale të ujësjellësit, ose kanë punuar me humbje në vitin 2011, e më 2012 kanë nisur të punojnë me fitim, ose i kanë zvogëluar humbjet nga viti i tyre paraprak.

Pra, kjo tregon që ndërmarrjet publike po arrijnë të gjallojnë përkundër Qeverisë, jo për shkak të Qeverisë, dhe sigurisht që këtu duhet theksuar KEK-un, i cili në vitin 2011

kishte mbi 16 milionë profit, ndërkaq në vitin 2012 mbi 15 milionë, pastaj KOST-in, i cili e rriti profitin, nga mbi 1,2 milion, në mbi 2,7 milionë euro, dhe PTK-ja, e cila kishte profit mbi 46 milionë euro në vitin 2011, dhe mbi 38 milionë euro në vitin 2012, me ç'rast edhe vetë Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2013 thekson që PTK-ja i ka paguar 45 milionë euro dividendë Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ky është raport për potencialin e pamundësuar të ndërmarrjeve publike, sepse me gjithë shpërdorimin dhe me gjithë shpërfilljen qeveritare, kemi kaq shumë performansa financiare pozitive.

Për fund, dua të theksoj që ekonomia prodhuese e Kosovës i ka dy çështje jetike dhe të dy këto çështje kanë të bëjnë me rivitalizimin e domosdoshëm. I pari është rivitalizimi i 'Trepçës' dhe i dyti është rivitalizimi i sistemit "Ibër-Lepenc". Rivitalizimi i 'Trepçës' është jetik për rivitalizimin e industrisë, ndërkaq rivitalizimi i sistemit "Ibër-Lepenc" është jetik për rivitalizimin e bujqësisë. Ne nuk do të mund të kemi as industri, as bujqësi pa këto të dyja, por edhe në këtë raport këtu duket qartë se sistemi "Ibër-Lepenc" po punon me humbje për shkak se nuk po mbështetet, për shkak se pajisjet dhe i gjithë sistemi, në përgjithësi, me elementet e tij është vjetruar dhe jo për shkak se nuk funksionon si i tillë si ndërmarrje publike, pra për shkak të karakterit të ndërmarrjes.

Edhe një herë po them që këto ndërmarrje publike po funksionojnë jashtëzakonisht mirë, kur kemi parasysh shpërfilljen dhe shpërdorimin që u bëhet dhe defektet që ekzistojnë nuk janë për shkak të karakterit të ndërmarrjes, por për shkak të faktit se nuk u del zot Qeveria e Kosovës si ushtruese e të drejtave të aksionarit. Pra, ju e dini që edhe me projektligjin për buxhetin, mbi 100 milionë euro parashihen për asfaltin e autostradave, ndërkaq as 2 milionë euro për 'Trepçën', dhe është e qartë se ndërmarrjet publike në Kosovë edhe 14 vjet pas çlirimit, edhe gati 6 vjet pas shpalljes së pavarësisë, arrijnë që të gjallojnë dhe ky gjallim, edhe një herë po them, duhet të lexohet, jo si gjallim për shkak të Qeverisë e qeverisjes, por përkundër kësaj Qeverie dhe qeverisjes jo vetëm në këtë mandat, e cila i ka shpërfillur në rastin më të mirë dhe i ka shpërdoruar në rastet e zakonshme qysh prej planit famëkeq 'Banjsko' e deri te ky projektligji i fundit për buxhetin e vitit 2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmeti.

AMIR AHMETI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër,

Qytetarë të Kosovës,

Meqenëse kolegët deputetë përmenden shumë nga rekomandimet dhe nga ky raport i performansës së ndërmarrjeve publike, unë po ndalem vetëm në tri pika, shkurtimisht. Nuk ka në këtë raport rekomandime të drejtpërdrejta e konkrete për ta larguar ngërçin për ndërmarrjet publike, të cilat janë ndërmjet pushtetit qendror dhe pushtetit lokal.

Nëse ia shtojmë kësaj problematike dhe ndërmarrjet publike lokale, të cilat nganjëherë janë regjionale dhe udhëhiqen nga aksionarët të cilët zgjidhen - një aksionar nga një komuna, për shembull e Prishtinës, një aksionar nga komuna e Drenasit, tjetri nga komuna e Lipjanit, atëherë mund ta merrni me mend se si këta aksionarë mund ta

menaxhojnë një ndërmarrje publike regjionale. Për atë, edhe qytetarët pastaj nuk kanë shërbime nga këto ndërmarrje, por aksionarët janë të pafuqishëm për shkak të ligjit që e ka bërë këtë konfuzion.

Vërejtje tjetër imja është edhe se në raport përmendet si sukses i disa ndërmarrjeve publike zvogëlimi i humbjeve. Konsideroj se krahasimi i viteve paraprake do të duhej që këto ndërmarrje ta kishin një strategji për ngritjen e fitimeve, e në asnjë mënyrë strategji për zvogëlimin e humbjeve dhe të mbetet një gjendje ‘status quo’. Dhe e treta, e fundit, nuk mund të them se kemi performansë të kënaqshme të ndërmarrjeve publike, kur qytetarët e Kosovës sot vuajnë nga mungesa e ujit të pijshëm, vuajnë nga mungesa e energjisë elektrike dhe shërbimeve tjera që qytetarët i presin nga ne.

Konsideroj se pa ngritjen e efikasitetit të këtyre ndërmarrjeve publike nuk do të kemi performansë të mirë të këtyre ndërmarrjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit nënkryetar, zoti Haliti!

I nderuar ministër, meqenëse një e kemi këtu,

Të nderuar deputetë dhe deputete kolege,

Shqyrtimi i raportit për performansën e ndërmarrjeve publike mund të jetë vetëm një pretekst për të folur për situatën e mirë që vepron në këtë sektor, e jo ai që të shërbejë si bazë për një vlerësim real, apo për nxjerrjen e konkluzioneve dhe të sugjerimeve të nevojshme.

Së pari më duhet të them se është një distancë shumë e largët kohore, gati plot 12 muaj prej kohës që është përfshirë në këtë raport, e deri te momenti që po e shqyrtojmë. Për shkak të kësaj distance kohore, tash asnjë konkluzion yni nuk do të ishte i qëndrueshëm, meqenëse në dhjetorin e vitit 2013 kemi të bëjmë me një gjendje krejt tjetër fare.

Për ilustrim po e përmend rastin e Korporatës Energjetike të Kosovës, e cila, si nga aspekti organizativ, ashtu edhe ai funksional, sot nuk është çfarë është prezantuar në raport. Në këtë sektor kemi dy kompani të mëdha, një publike, tjetra private, që e ndryshon esencialisht funksionimin e këtij sektori. Neve tash na ofrohen të dhënat për vitin 2012, në vend se të kemi një raport për përfundimin e procesit të privatizimit të Distribucionit dhe të Furnizimit, apo për funksionimin e tregut dhe të raporteve ndërmjet operatorit të prodhimeve dhe të atij të Distribucionit, ose raporti nuk e bën shumë të qartë situatën e re të krijuar pas koncensionimit të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”.

Nuk theksohet aq shumë se tash kemi të bëjmë vetëm me një sektor, i cili mbetet në pronësi publike, e nuk është fjala për tërë aeroportin si një etnitet. Me këtë rasat unë do të insistoj që në Parlament ta kemi një raport për funksionimin dhe efektet e deritashme të partneritetit publiko-privat në këtë sektorë, posaçërisht pse këtu është kryer një investim i madh, por edhe për faktin se ka ankesa rreth trajtimit të disa operatorëve ekonomikë nga subjektet që e kanë marrë në koncesion atë. Unë nuk po them se janë të drejta apo jo këto ankesa, por gjithsesi se duhet analizuar zhvillimet në këtë sektor.

Problemi i përhershëm që e përcjell sektorin e ndërmarrjeve publike janë bordet e tyre. Disa prej tyre funksionojnë mbi bazën e paqëndrueshmërisë ligjore me mandatet e zgjeruara e të stërzgjatura, por edhe me konflikt interesi të qartë. Në këtë rast, vetëm dua të përkujtoj se në zgjedhjet lokale u pa se sa të politizuara janë këto borde, apo sa anëtarë të tyre janë kryetarë të degës apo kandidatë për postin e kryetarit të komunës. Rastet e këtilla, pa marrë parasysh se sa janë në numër, tregojnë qartë se Qeveria e Kosovës, përkatësisht partitë, koalicioni qeveritar, po e shkelin Ligjin për ndërmarrjet publike, apo se ato edhe më tej po i përdor si vend për punësim të familjarëve, apo të militantëve partiakë.

Unë nuk dua të ndalem shumë te treguesit e afarizmit të ndërmarrjeve, i vetëdijshëm që tash e kemi një situatë krejtësisht tjetër në këtë sektor, por se performansa e tyre, në përgjithësi, nuk është e mirë, duket nga grupi i ndërmarrjeve që afarojnë me humbje.

Në vitin 2012 kanë qenë 9 ndërmarrje, ndërsa në vitin 2012 janë 10. Është e qartë se numri i tyre mund të jetë rritur për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative që ka ndodhur, mirëpo humbjet në fund të vitit të kaluar kanë qenë mbi 9 milionë euro, ose 34% më të larta. Me këtë normë të rritjes së humbjeve nuk mund të themi se në këtë sektor gjendja është e mirë dhe se performansa është drejt përmirësimit. Duke pasur parasysh këtë situatë, atëherë Qeveria e Kosovës, si dhe mekanizmat e saj monitorues duhet të ofrojnë zgjidhje për disa kompani, si është Kontrolli Ajror në Aeroportin e Kosovës, pastaj për Postë-Telekomin e Kosovës dhe për ndërmarrjen e ujërave “Ibër-Lepenc”, ku duket qartë se humbjet janë në rritje e sipër.

Njëkohësisht shqetësuese paraqitet edhe gjendja në kompaninë më profitabile në vend, Posta dhe Telekom i Kosovës. Ndoshta sot këtu mund të jetë gjendja krejtësisht tjetër, qoftë më e mirë apo më e keqe, por sipas raportit të prezantuar të hyrat janë 10% më të ulëta, shpenzimet 6%, kurse fitimi ka rënë gati për 20%. Problemet këtu janë shumë më të thella se ato nuk e reflektojnë aq shumë mënyrën e menaxhimit dhe e efikasitetin e punës, sa joseriozitetin e Qeverisë që Kosova lidhur me këtë aset. Stërzgjatja e procesit të privatizimit dhe e bllokimi i investimeve kapitale kanë shkaktuar dobësimin e afarizmit, afarizmin në uljen e rentabilitetit, uljen e vlerës së përgjithshme të kësaj pasurie, si dhe dobësimin e saj përballë konkurrencës në treg. T’ju përkujtojmë se konkurrenti kryesor i PTK-së tash në treg ka hyrë me teknologjinë 3G, ndërsa kjo ndërmarrje publike tash është duke i bërë hapat e parë drejt aplikimit të saj. Nga kjo del se në treg do të dalë me këtë teknologji, në kohën kur konkurrenca ka depërtuar thellë në tregun tonë.

Dhe, për fund dua të theksoj se te disa ndërmarrje, posaçërisht te ato për furnizim me ujë, për ngrohje, si dhe për çështjen e mbeturinave, problem ende mbetet arkëtimi i të hyrave të faturuara. Kjo çështje zvarritet prej viti në vit, por ne nuk e kemi një vlerësim të saktë se ku qëndron esenca e problemit dhe cilat janë zgjidhjet. Identifikimin e tyre duhet ta bëjë Qeveria në nivel qendror, apo pushteti lokal, meqenëse në raport nuk duket se dikush është duke u brengosur për shkallën e ulët të arkëtimit, dhe për këtë edhe Grupi Parlamentar dhe unë si deputet kemi marrë vendim që të mos e votojmë, të mos e aprovojmë këtë raport për performansën për ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik është diskutuar raporti për ndërmarrjet publike dhe më 13 nëntor është mbajtur edhe një dëgjim publik në të cilën kanë qenë të ftuar shumë njerëz nga organizatat e ndryshme, nga ndërmarrjet e ndryshme, nga OJQ-të e ndryshme, me ç'rast është diskutuar për ndërmarrjet publike.

Ajo që gjatë tërë kohës është thënë është që ligjet apo raportet të cilat po vijnë në Kuvendin e Kosovës, si ky raporti i kaluar për të cilin, sikur edhe raportet tjera, po diskutojmë, tregojnë mungesën e pjesës së auditimit apo mungesën e raportit të auditimit, gjë që e bën raportin e këtyre ndërmarrjeve jo të plotë dhe me shënime jo të mjaftueshme për të diskutuar. Në anën tjetër, gjatë diskutimeve të shumta që i kemi pasur edhe në komision, por edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së, është cekur që për shembull te ndërmarrja e ujërave ekzistojnë edhe problemet, sikur problemi i 29 000 lëndëve, të cilat janë sot në gjykatë dhe për të cilat faturimi është bërë duke paguar TVSH-në, me ç'rast ndërmarrjet janë ato të cilat automatikisht janë në një minus të thellë, gjë që jo vetëm që kërkon ndihmë, por kërkon një ndryshim urgjent të ligjit për ta rregulluar këtë çështje.

Kur flitet për ndërmarrjet e ujërave do të cek se në raport thuhet që ekziston 96% e mbulueshmërisë, por, në anën tjetër, në komunën e Gjakovës, në të cilën edhe gjendet Liqeni i Radoniqit, më se gjysma e fshatrave janë ato të cilat nuk kanë ujë nga ujësjellësi dhe nuk kanë kanalizim. Janë diskutuar edhe ndryshimet, të cilat kërkohen me rritjen e numrit të komunave, e ndryshimet duhet të bëhen edhe në ligj, por edhe në bordet e ndërmarrjeve rajonale, pasi tani i kemi edhe komunat tjera, të cilat duhet të participojnë nëpër këto borde.

Nga dëgjimi publik të cilin e kemi pasur ka dalë edhe kërkesa, sidomos nga Asociacioni i Komunave, që të barten kompetencat nga AKP-ja në komuna me rastin e shfrytëzimit të stacioneve të autobusëve.

Çështje tjetër, e cila është diskutuar dhe pandërprerë po përmendet është çështja e bordeve. Në raport, por edhe në diskutime thuhet që bordet në fakt janë borde në shumicën e rasteve të skaduara dhe borde shumë joprofesionale. Në përgjithësi, është kërkuar në masë të madhe zbatimi i ligjit, gjë që tregon që ekziston një mungesë në performansën e bordeve dhe në zbatimin e Ligjit ekzistues për ndërmarrjet publike.

Dëshiroj gjithashtu të rikujtoj që më 9 mars 2012 kemi pasur rekomandime të Kuvendit të Kosovës, rekomandime të cilat janë votuar pa asnjë votë kundër dhe njëra prej atyre pikave ka qenë që të bëhet aplikimi i Ligjit të barazisë gjinore nëpër bordet e ndërmarrjeve publike. Nga raporti, të cilin e kemi parë, ky ligj gati që nuk gjen fare përdorim nëpër bordet e ndërmarrjeve publike, por kjo nuk është e vetmja gjë të cilën Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar. Gjithashtu, më 20 dhjetor 2012, në Kuvendin e Kosovës, pa asnjë votë kundër, është aprovuar edhe Rezoluta në të cilën gjithashtu ceket kjo çështje dhe kërkohen veprimet konkrete.

Pika e tretë në këtë aspekt është Rezoluta e Parlamentit Evropian, e cila shumë pak ditë më parë është aprovuar atje dhe ajo kërkon që në bordet e ndërmarrjeve publike të ketë 50% me 50% të të dyja gjinive. Duke i pasur parasysh të gjitha këto që u cekën prej anëtarëve Lidhjes Demokratike dhe prej anëtarëve të tjerë të Kuvendit, shihet se Ligji për

ndërmarrjet publike ka nevojë për një ndryshim-plotësim dhe është kërkuar edhe në komision, prandaj ne kërkojmë që të silltet në Kuvend ndryshim-plotësimi i Ligjit të ndërmarrjeve publike, në ndërkohë që të bëhet zbatimi i këtij ligji, pasi është parë që edhe zbatimi i tij është pikë e cila mungon.

Dhe, duke i pasur parasysh të gjitha këto, ne Grupi Parlamentar i LDK-së nuk do ta votojmë këtë raport të ndërmarrjeve publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit është zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe në emër të komisionit edhe u tha mjaft për përmbajtjen e raportit dhe unë do të provoj të flas shkurt, që më tepër të fokusohem në dy çështje, të cilat edhe u diskutuan, por nga qasja ime.

Vërtet një konstatim që qëndron nga të gjitha diskutimet se prona publike në Kosovë menaxhohet keq dhe lë për të dëshiruar. E para, ajo rrezikohet dhe zhvlerësohet dita-ditës dhe, e dyta, nuk kemi fare të bëjmë me menaxhim kreativ, që çon në zhvillim, por shumica e aseteve mbahen deri kur konstatohen se po zhvlerësohen.

Çështja e dytë është se ne duhet ta ndryshojmë qasjen në raport me ndërmarrjet publike. Dihet se përgjegjës dhe trup politikëbërës është bordi, ndërsa ne shumë pak diskutojmë për këtë dhe sa herë e kemi një problem nëpër ndërmarrjet publike, zakonisht flasin menaxhmenti, dhe e kemi pasur rastin e disa problemeve kur i kanë pasur ndërmarrjet publike dhe kemi parë se para mjeteve të informimit del menaxheri, i cili zakonisht provohet të bëhet ‘mish për top’, por unë nuk di rast që është marrë në përgjegjësi, e ka shkuar në përgjegjësi bordi i një ndërmarrjeje publike atëherë kur ka pasur probleme dhe dihet pse.

Konstatimi edhe i Raportit të Progresit dhe i të gjithëve është se sado që ne kemi dëshiruar ta krijojmë një autonomi për ndërmarrjet, por ‘de fakto’ sa më shumë që na ato i kemi larguar nga menaxhimi i Qeverisë, aq më shumë kanë qenë të politizuara dhe aq ma i madh ka qenë interferimi i qeverisjes në ndërmarrje, dhe ata njerëz që janë imunë dhe të zgjedhur, ‘de fakto’ janë ata që jetojnë më së miri. Janë shumë kompetentë për ndërmarrje, por ‘de fakto’ asnjëherë nuk marrin përgjegjësi.

Edhe sot kur po flasim, ne e dimë që kemi borde, qoftë anëtarë të bordeve, apo ndoshta diku edhe shumica e këtyre bordeve që u ka dalë mandati dhe të cilëve nuk ka të drejtë t’u vazhdohet mandati, por ata duhet t’i nënshtrohen një konkursi publik, që ne nuk e kemi, e kjo është një dëshmi se sa ne jemi të përkushtuar dhe sa na dhimbset prona dhe efektet që duhet t’i japë prona publike, përkatësisht ndërmarrjet.

Mirëpo, unë nuk besoj se ata njerëz nuk i nënshtrohen konkursit publik se konsiderojnë se janë të pazëvendësueshëm, veçse janë ata që janë të zgjedhur dhe mundësisht le t’u zgjatet mandati sa më shumë. Dhe, kjo e tregon krejt. Unë nuk di pse flasim për raportin, kur ne e kemi këtë gjendje.

Dhe, çështja e dytë, vetë fakti se na sot po votojmë në paketë për të gjitha ndërmarrjet tregon se sa ne e konsiderojmë të rëndësishëm monitorimin e këtyre ndërmarrjeve, sepse secila ndërmarrje e ka mënyrën e vet të menaxhimit, i ka sukseset, i ka përgjegjësitë dhe unë do të kisha pasur dëshirë sikur ne sot në raport të kishim ndërmarrje për ndërmarrje. Pa u lodhur, çdo ndërmarrje veç e veç të votohet, sepse nëse tash i kemi gjysmën e ndërmarrjeve të suksesshme dhe gjysmën të pasuksesshme, çka do të votojmë sot? Si do ta votojmë? Si ta bëjmë diferencimin e atyre që janë të përkushtuar, që punojnë dhe kanë rezultate dhe atyre që eventualisht nuk punojnë dhe nuk kanë rezultate? S'e kemi krijuar atë bazë.

Prandaj, kjo është ajo që unë po them: duhet komplet të ndërrohet qasja në raport me ndërmarrjet publike, të kihet një monitorim, pastaj të shihet se cila është performansa, të cilat janë mundësitë, cilat janë sukseset dhe mbi të gjitha, në secilin raport, cilët janë hapat tremujorë, gjashtëmujorë, njëvjeçar, ose disavjeçarë të të gjitha këtyre ndërmarrjeve. Asnjërin nuk e kemi. Prandaj, nuk di - po të më pyeste dikush, sinqerisht, meqenëse kjo është pronë juaja, është pronë e këtij vendi, është pronë e këtyre qytetarëve, ne sot flasim në emër të qytetarëve, çka duhet të veprojmë tash, më me dëshirë kishim thënë: sot po vendosim si të duash, por hajde pas tre muajve t'i kthehemi kësaj pune, se kështu nuk shkon. Kjo nuk është në rregull.

Prandaj, plotësisht e shohë të arsyeshme që kjo informatë, po e quaj informatë se nuk ka lidhje me raport, të mos votohet, jo për ta nënvlerësuar punën e atyre që kanë punuar mirë, por për të treguar se kjo nuk është qasje e menaxhimit të ndërmarrjeve publike të kësaj prone dhe zhvillimit që pritet nga kjo pronë.

Të mos flas edhe defekte veç e veç, se nga njëherë duke dashur ta mbajë primat Qeveria, i kanë ngatërruar punët në disa raste, siç janë ndërmarrjet e ujësjellësve dhe kanë krijuar probleme tejet të mëdha, por edhe nëpër disa ndërmarrje tjera, prandaj i bëjmë mirë këtij vendi në rast se tregohemi seriozë dhe duke mos e vlerësuar të keq raportin, por duke mos e votuar dhe duke dhënë mundësi që, më në fund, kur ky vend emëron njerëz përgjegjës, atëherë duhet të monitorojë se cila është përgjegjësia e këtyre bordeve, në radhë të parë, dhe të mos të gjejnë 'mish për top' te menaxherët sa herë që ngushtohen dhe, në anën tjetër, duhet saktësisht të dihet ku fillon dhe ku përfundon përgjegjësia e ministrive, në këtë rast e Ministrisë për Zhvillim, por edhe kur fillon dhe përfundon përgjegjësia e Kuvendit kur miraton.

Dhe, në fund, po e shtroj një pyetje: Kemi pasur raste edhe më parë, çka nëse nuk votohet një raport i një ndërmarrjeje? A e di dikush çka vepron ky Kuvend, ose një ministri, nëse nuk miratohet? Ne kemi pasur raste kur në këtë Kuvend nuk e kemi votuar raportin e një ndërmarrjeje dhe sikur kurrëgjë të mos kishte ndodhur. Pra, nëse ka nevojë të ndërrojmë rregullore, të ndërrojmë ligje dhe nëse një institucioni nuk i votohet raporti, nënkuptohet përgjegjësia dhe unë e di sot veç një rezultat: kurrëgjë nuk do të ndodhë nesër, si u votua, si nuk u votua raporti. Dhe, vend sikur Kosova që nuk zbatohet ligji dhe njerëzit ndihen të relaksuar, unë nuk po shoh.

Prandaj, edhe një herë po them - qasja në raport me ndërmarrjet publike duhet të ndryshojë urgjentisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri, zoti Ismajli.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do të flas shumë shkurt. Me vëmendje i dëgjova të gjitha komentet rreth raportit, me shumicën e të cilave edhe unë pajtohem. Sidoqoftë, ju falënderoj edhe po ndihem shumë i kënaqur, sepse po shoh që pjesa dërmuese e deputetëve, edhe jashtë atyre të cilët kanë qenë në komisionin konkret, me shumë kujdes dhe vëmendje e kanë lexuar dhe analizuar këtë raport.

Ju falënderoj gjithashtu që keni vërejtur së paku një ndryshim kualitativ në formën e prezantimit për të cilin jam angazhuar personalisht që të jetë më deskriptiv dhe me të dhëna më të sakta, me një kronologji dhe pasqyrim më modern, nëse mund ta quajmë ashtu, në raportimet e ngjashme që ndodhin në botë.

Sikur të isha edhe unë i thirrur për të raportuar për performansën si rezultat i ndërmarrjeve veç e veç, po ju them që edhe nëse ai votim do të thotë shpërblim qoftë i menaxhmentit apo i qeverisjes së ndërmarrjes së posaçme publike, edhe unë do të isha që të mos raportoj, qoftë të mos votoj as vetë. A jam i kënaqur? Nuk jam i kënaqur asnjëherë me punën dhe me rezultatet. Pse? Sepse sigurisht ka mundësi edhe më tepër dhe mu nga ky fakt edhe Ministria e ka iniciuar ndërrimin e legjislacionit, i cili e mbulon ndërmarrjen publike. Ka pasur mungesa në vazhdimësi, ka edhe më tutje, por kjo nuk dok të thotë se nuk do të angazhohemi. Ka edhe rezultate, të cilat i përmendën kolegët këtu në ndërmarrje të caktuara, edhe të ujërave e të tjera, por unë mendoj që duhet të votohet raporti mbi transparencën që e tregon se çfarë është ajo që po na ndodh mbi nxjerrjen e fakteve se ku çka do të bëhet.

Nuk qëndron se nuk kemi paraparë çka pritet në vitet në vijim të bëhet dhe unë shpresoj se në vitin e ardhshëm, me iniciativat që do të merren në legjislacion, me heqjen e disa barrierave, të cilat i kanë ndërmarrjet publike, qoftë në aspektin e infrastrukturës legale, e sidomos të asaj rregullative, të cilën edhe para komisionit e kam theksuar, elementet mbi të cilat as Qeveria, as komiteti qeveritar nuk i ka kompetencat për t'i ndërruar, ndërsa vërejtjet të cilat u dhanë për PTK-në, për kontestin që KEK-u ka pasur me KEDS-in për 17,9 milionë, nuk qëndrojnë në raport normalisht, sepse këto nuk janë ngjarje që i përkasin vitit 2012. Kjo ka të bëjë me vitin 2013 dhe sigurisht që ato do të reflektojnë në raportin vitin e ardhshëm, domethënë ky është raporti i vitit 2012.

Unë ju drejtohem që të votohet dhe të aprovohet raporti për transparencën të cilën e prezanton. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar zonja e zotërinj deputetë, konstatoj se në sallë janë 74 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për ta votuar raportin e performansës për ndërmarrjet të ndërmarrjeve publike për vitin 2012. Votojmë tash!

Konstatoj që me 38 vota kundër, 3 abstenime dhe 31 për, Kuvendi nuk e miratoi raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012. Faleminderit! Shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012

Raportin vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovar të Privatizimit për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Gjithashtu, edhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Zonja ministre,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar këtë raport. Është fjala për një raport që ka ardhur shumë më herët. Ne këtu e kemi zyrtarisht që figuron data 30 korrik që e kemi aprovuar si komision. Për sa kemi informata, është Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që e ka vonuar për shkak të trajtimit ose mungesës së raportit të Auditorit Gjeneral.

Sido që të jetë, ne këtë raport e kemi këtu. Komisioni konsideron që është në përputhje me ligjin dhe i kërkon Kuvendit që ta miratojë. Komisioni po ashtu e ka miratuar.

Ajo që duhet theksuar është një rekomandim që i bashkëngjitet këtu, meqë Komisioni konsideron që kjo agjenci është në pozitë të pavoritshme për shkak të mungesës së anëtarëve të bordit dhe ia kemi bërë edhe referencën e veçantë me shkrim në plotësimin sa më të shpejtë dhe duhet t'i përmbushin detyrat edhe Qeveria, edhe Kuvendi, që të plotësohet ky bord sa më shpejt.

Po ashtu, po e shfrytëzoj rastin të njoftoj dhe të kërkoj gjithashtu që edhe Qeveria të bëjë diçka më shumë në raport me ligjin. Agjencia e Privatizimit ka kërkuar me shkrim më herët nga ne që të fillojnë procedurat e plotësim-ndryshimit të këtij ligji.

Unë personalisht dhe si Komision kemi kërkuar edhe nga Qeveria, edhe nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, që në bashkëpunim edhe me agjencinë, edhe me faktorët tjerë ta

shqyrtojë këtë mundësi dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse kjo konsiderohet e nevojshme, të fillojë ky proces.

Në shtyp kemi pasur po ashtu informata se disa ngecje, sidomos që kanë të bëjnë me pagesat e punëtorëve nga kompanitë, fabrikat ose ndërmarrjet që janë shitur janë në mungesë të ligjit, dhe drejtpërdrejt fajësohen deputetët.

Dëshiroj të theksoj që ne vetëm para një viti e kemi ndryshuar këtë ligj. Meqenëse bëhet fjalë për një ligj dhe një proces që është i ndjeshëm dhe është konsideruar një proces i mbështetur edhe nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, plotësimi eventual i tij ose ndryshimi, qoftë brenda një viti të bëhet po ashtu në konsultime me krejt faktorët dhe sidomos me ata që para një viti e kanë sjellë iniciativën, draftin ose projektligjin për ndryshim.

Pra, ne jemi të gatshëm si Komision që t'i fillojmë procedurat e ndryshimit të ligjit, por kërkojmë edhe nga agjencia dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe partnerët që sa të jetë e mundur më shpejt ta sjellin iniciativën me shkrim, nëse jo ne si Komision së shpejti do ta kemi prapë në rend dite dhe të marrim një vendim ndoshta edhe në mënyrë të njëanshme për plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Edhe një herë përsëris, Komisioni e ka miratuar dhe i kërkojmë Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pasi është e obliguar t'ia paraqesë Kuvendit raportin vjetor dhe në kuadër të këtij raporti duhet t'i përfshijë edhe pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2013, e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012 dhe ka vlerësuar se në të janë paraqitur të gjitha shpenzimet në mënyrë të detajuar, ashtu siç ka kërkuar Komisionit për Buxhet dhe Financave, në bazë të formularëve të harmonizuar për të gjitha institucionet e pavarura.

Në raport janë paraqitur shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe po ashtu janë paraqitur të dhënat për buxhetin e planifikuar dhe për shpenzimet, të cilat kanë ndodhur në këtë institucion, si dhe është bërë krahasimi me vitet paraprake.

Buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën janar-dhjetor 2012 ka qenë 8 709 000 euro dhe janë shpenzuar diku 6 022 000 euro, çka do të thotë që buxheti është shpenzuar në masën 74,55%.

Për paga dhe mëditje është shpenzuar 96%, për mallra dhe shërbime 58%, për shpenzime komunale 91%, për investime kapitale 9,42%, çka do të thotë që ka pasur një ngecje në realizimin e investimeve kapitale.

Agjencia Kosovare e Privatizimit po ashtu i ka paraqitur edhe të dhënat për të hyrat, të cilat i ka transferuar në llogarinë bankare të Thesarit në emër të llogarisë së Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Gjatë shqyrtimit të këtij raporti në Komision kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe deputetët kanë ngrehur disa çështje për të cilat kanë kërkuar sqarime nga të pranishmit, domethënë nga përfaqësuesit e Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Dhe, një çështje që është ngritur aty ka qenë edhe çështja e fondit të 20-përqindëshit, i cili është vlerësuar se po ndodh shumë ngadalë shpërndarja e tij dhe është kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të ketë një angazhim më të madh sa i përket shpërndarjes së tij, si dhe janë diskutuar edhe çështje të tjera, të cilat kanë pasur të bëjnë me mosrealizimin e shpenzimeve ashtu siç janë planifikuar, sidomos të mallrat dhe shërbimet.

Pasi përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit i kanë dhënë sqarime të nevojshme për çështje të cilat janë ngrehur në Komision, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar njëzëri raportin financiar të këtij institucioni dhe ka rekomanduar që të miratohet edhe në Kuvend.

I nderuar zoti kryetar,

Unë nuk e shoh të arsyeshme që për shkak të mungesës së raportit të auditimit, raportet e institucioneve të pavarura, raportet e punës, ku duhet të përfshihen edhe raportet financiare të shqyrtohen me një vit vonesë, siç po na ndodhë kështu. Auditori e ka agjendën tjetër, kurse ligji thotë që raporti për punën dhe raporti financiar sillet sipas afateve të cilat janë paraparë me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e auditimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të Fondit të Privatizimit për vitin 2012.

Gjatë shqyrtimit të raportit, Komisioni ka konstatuar se vendet boshe të Bordit të Drejtorëve kanë penguar vendimmarrjen formale. Mungesa e Bordit të Drejtorëve të AKP-së ka shkaktuar vonesa në procesin e privatizimit dhe të nënshkrimit të kontratave që mund të ndikojnë në dëmtimit e operatorëve ekonomikë.

Ligji i AKP-së i përcakton qartë kriteret për emërimin dhe mandatin e Bordit të Drejtorëve. Mirëpo, nuk e përcakton përgjegjësinë dhe mënyrën e zbatimit të procedurave lidhur me shpalljen dhe dorëzimin e propozimit të caktuar që kandidatët të

emërohen nga Kuvendi. Për t'i evituar mangësitë në AKP, Komisioni ka rekomanduar që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për AKP-në. Më gëzon fakti që edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e po ashtu edhe ai Funksional e përkrahën për t'i saktësuar afatet kohore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Me ligj duhet të përcaktohen afatet e qarta kohore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, në mënyrë që të mos ketë zbrazëti në funksionimin e agjencisë, si dhe procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Duhet të parashihet qartë hapja e konkursit, zhvillimi i procesit të vlerësimit të kandidatëve dhe nxjerrja e kandidatëve të propozuar për emërim para Kuvendit.

Po ashtu, duhet të merret parasysh edhe ruajtja substanciale e mjeteve të deponuara në BQK, pasi aktualisht mjetet ruhen me zero interes, ndërsa inflacioni vetëm në vitin 2012 ka qenë jo më pak se 2,5, që nënkupton se në mjetet e deponuara ky ka humbur në substancë jo më pak se afërsisht 14 milionë. Shënimet financiare të fondit mbahen në një dokumentacion exell, i cili është mjaft i madh dhe kompleks dhe si i tillë nuk mund të kuptohet lehtë nga lexuesit e jashtëm.

Për vitin 2012, llogaritë AKP-së, e edhe të fondit, janë me opinion të kualifikuar, opinion të keq. Prandaj, unë e falënderoj Kuvendin që pati mirëkuptimin që nga seanca kur ishte e radhitur e priti raportin e Auditorit, sepse nëpërmjet tij e shohim sesi është performuar brenda procesi i kësaj agjencie.

Për këtë, AKP-ja mendon se ka pasur fond të pakualifikuar për shkak se 1,2 milion euro të përdorura për shërbimet e likuidimit ishin paguar pa pasur bazë ligjore të qartë në llogarinë e fondit, e jo nga ajo e agjencisë.

Për këtë, AKP-ja mendon se ka pasur një bazë juridike, pra është mendimi i AKP-së që ka pasur bazë në këtë mënyrë siç ka vendosur që shpenzimet për likuidimin e ndërmarrjeve t'i trajtojë prej fondit, e jo prej buxhetit të AKP-së, por që në rrethana të tilla nuk prezantohet si shpenzim.

Prandaj, pasqyrat nuk paraqesin pamje të drejtë dhe auditori e jep këtë konstatim dhe e konsideron këtë si veprim antiligjor. Shpenzimet nuk janë pasqyruar në tabela financiare, edhe pse të njëjtat ka ndodhur dhe pritet të ndodhin, sepse kontrata është rreth 20 milionë, dhe do jetë në funksion për katër vjet.

AKP-ja ka mungesë në politikat dhe politikë të aprovimit për kompensimin e të punësuarve. Kompensimi i tyre bëhet me një vendim për pagat e personelit të financuar nga menaxhmenti i AKP-së.

Mungesat e politikave për kompensimin e të punësuarve e rritin mundësinë që të bëhen pagesa jashtë rregullores në fuqi. Lidhur me këtë, Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të hartojë rregullore të brendshme për kompensim të stafit në përputhje me ligjin për pagat e shërbyesve civilë, e jo kjo të bëhet me vendime ad hoc.

Rregullorja e AKP-së për kompensimin e punëtorëve të Bordit të Drejtorëve përcakton që drejtorët individualisht janë përgjegjës t'i deklarojnë të hyrat e tyre në ATK dhe t'i

paguajnë obligimet e tyre tatimore. Kjo rregullore nuk është në linjë të plotë me Ligjin numër 03/L-161 mbi të ardhurat personale. Kompensimet për anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë paguar nga kategoria 'mallra dhe shërbime', ndërsa do të duhet të ishin paguar nga kategoria 'paga dhe mëditje'.

Për të njëjtat të ardhura duhet të konsiderohet tatimi i mbajtur në burim dhe Ligji për të ardhurat personale. Kompensimet e Bordit të Drejtorëve pa e konsideruar Ligjin për të ardhura personale e rrit rrezikun që tatimi të mos deklarohet dhe të paguhet me kohë.

Lidhur me këtë është një rekomandim.

Lidhur me këtë, Komisioni ka vlerësuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të bëjë harmonizimin e rregulloreve të brendshme për kompensim të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve sipas Ligjit numër 03/L-161 mbi të ardhurat personale, si dhe me raport me shkrim ta njoftojë Komisionin nëpërmjet Komisionit të Kuvendit lidhur me procesin e ndërmarrë sa i përket kësaj çështjeje.

Sipas të dhënave nga Auditori i Përgjithshëm, shpërndarja e 20-përqindëshit nuk ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara. KZAP-i ka hasur në parregullsi të ndryshme, si: ka mospërputhje të listave të ndërmarrjeve shoqërore me librezat amë të të punësuarve, mospërputhje të librezave së punës dhe fletëpranimit të punëtorëve, nuk kishte dëshmi, kopjet e certifikatave të lëshuara nga ndërmarrjet shoqërore, deklarata nga sindikata e punëtorëve, apo ndonjë dëshmi shtesë që e vërteton legjitimitetin e punëtorit.

Sipas KZAP-it, përvoja e punës nuk është kualifikuar si duhet për 20-përqindëshin që u takon punëtorëve. Këtu e kem një rekomandim. Bazuar në këtë, Komisioni ka rekomanduar që këtij procesi t'i bëhet një auditim i performansës, në mënyrë që Kuvendi të ketë informacion të saktë për këtë proces.

Rekomandimet nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike u janë shpërndarë deputetë dhe kërkojmë që të njëjtat t'i jenë bashkangjitur raportit në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012, pjesë e të cilit është edhe raporti i Auditimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të Fondit të Privatizimit.

Raporti vjetor paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet dhe sfidat e agjencisë gjatë vitit 2012. Gjatë vitit 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka mbajtur tri valët e privatizimit dhe ka realizuar tetë shitje të aseteve me likuidim.

Në përputhje me ligjin, AKP-ja ka lidhur kontratë për ofrim të shërbimeve profesionale për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore. Qëllimi i angazhimit të ofruesit të shërbimeve

profesionale është që ta përmbyllë procesin e likuidimit të të gjitha ndërmarrjeve shoqërore, të cilat janë nën përgjegjësinë, apo mandatin e AKP-së.

Me qëllim të implementimit të kësaj kontrate, mjetet janë marrë nga llogaritë e këtyre ndërmarrjeve shoqërore, e jo nga fondet e mirëbesimit, siç u cek nga parafolësit. Kjo është praktikë e të gjitha vendeve që kanë bërë likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, e me të cilën praktikë kanë rezultuar me sukses.

Gjatë vitit 2012 janë themeluar autoritetet e likuidimit për 173 ndërmarrje shoqërore në likuidim në pesë zyrat rajonale të AKP-së. Çështje shumë e rëndësishme është edhe shpërndarja e 20-përqindëshit, kur gjatë vitit 2012 janë publikuar 49 lista fillestare, 45 lista finale dhe janë shpërndarë mbi 21 milionë euro, shumë kjo nga e cila kanë përfituar 15 394 punëtorë.

Sfidë për procesin e shpërndarjes së 20-përqindëshit ka qenë edhe mungesa e vendimeve të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ankesat dhe kundërshtimet e parashtruara nga punëtorët në këtë gjykatë.

Pra, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ende mbetet pengesë në realizimin e shpërndarjes së 20-përqindëshit.

Siç dihet, AKP-ja e ushtron autoritetin administrativ në cilësinë e administratorit të “Trepçës” nëpërmjet njësisë për riorganizimin e saj. Sipas raportit, njësia për riorganizimin e “Trepçës” nuk ka kapacitete njerëzore për kryerjen e projekteve për planin e riorganizimit të saj. Për këtë arsye është vërejtur nevoja për angazhim të ofruesve të shërbimeve profesionale nga buxheti i agjencisë, apo edhe nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Për më shumë se gjashtë muaj, AKP-ja ka funksionuar pa bord të kompletuar. Kjo ka shkaktuar ngërç institucional dhe e ka pamundësuar AKP-në që ta zbatojë plotësisht mandatin e saj siç është paraparë me ligj. Si rezultat i moskompletimit të bordit kanë mbetur shumë çështje pa u miratuar. Si çështje të mbetura peng, deri te kompletimi i Bordit të AKP-së janë: informimi dhe miratimi i listave të punëtorëve; aprovimi për shitjen e koncentratit të “Trepçës”; miratimi i transaksioneve të valës 56 të shitjes, miratimi i transaksioneve të shitjes nëpërmjet likuidimit dhe disa çështje të tjera.

Në këtë rast, ne i bëjmë thirrje Qeverisë që sa më shpejt t’i iniciojë procedurat për plotësimin vendeve të lira të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Të nderuar deputetë,

Opinionimi për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe për Fondin e Privatizimit është opinion i kualifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, me përjashtim të mosprezantimit të vlerës prej 1,2 milion euro me pasqyrat e Fondit të Privatizimit dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duhet pasur parasysh se këto mjete janë pasqyruar vetëm në planin e rrjedhës së parasë, e jo në pasqyrat tjera financiare.

Për vite me radhë, opinionin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe për Fondin e Privatizimit ka qenë opinion i pakualifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Prandaj, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahë këtë raport dhe njëherësh i fton edhe deputetët e tjerë që ta miratojnë atë.

I nderuari kryetar,

Unë dua ta mbështes edhe fjalën e parafolëses time, zonjës Hadërgjonaj, që ne si Kuvend nuk duhet t'i zvarritim ose ta zgjatim afatin e shqyrtimit të raporteve vjetore me pritjen e raporteve të Zyrës së Auditorit Gjeneral, sepse ne jemi të obliguar me ligj t'i shqyrtojmë këto raporte dhe ne, nëse duam, si Komision i drejtojmë raportet e Auditorit në seancë apo jo. Dhe, nuk është e arsyeshme që të prolongohen komisionet tjera në shtyrjen e shqyrtimit të raporteve vjetore në mungesë të raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral, sepse ajo ka agjendë tjetër dhe Kuvendi tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Unë jam dakord me këtë dhe jam që të respektohen ligjet, por seanca ka vendosur për këtë çështje dhe vendimet kanë qenë të seancës. Prandaj, ju kërkoni me kohë respektimin e ligjit dhe ashtu siç e parasheh ligji për çdo agjenci për të raportuar. Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre,

Më 30 korrik 2013 e kishim raportimin e AKP-së në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, raportim ky i vonuar me kohë dhe i raportuar jo nga kryesuesi, sepse ai bashkë me dy anëtarë të tjerë kanë dhënë dorëheqje, me ç'rast ky trup është gjymtuar dhe nuk është në gjendje ta kryejë punën e vet në formë të plotë, ashtu çfarë parashikohet. Atë ditë, as zëvendëskryetari nuk erdhi për shkak të problemeve shëndetësore siç na thanë, ndërkombëtarët nuk erdhën, as përfaqësuesi nga minoriteti, dhe i vetmi nga Bordi ishte zoti Haxhi Arifi, i cili as ai nuk raportoi, por kërkoi që këtë ta bëjë drejtori menaxhues, zotëri Shkëlzen Lluka.

Kjo paraqitje, që në fillim, edhe ashtu e vonuar, nuk jepte një mesazh të fillimit të mirë të këtij bordi. Në fakt, edhe pse është kërkuar që Qeveria ta kryejë detyrën e saj dhe të bëjë plotësimin e Bordit të AKP-së, si nga unë personalisht në Komision dhe në seancë, por edhe si rekomandim i Komisionit, ky bord vazhdon të mbetet i gjymtë, me ç'rast një numër shumë i madh i punëtorëve nuk kanë mundësi ta marrin 20%-përqindëshin nga privatizimi i ndërmarrjeve të tyre, gjë që u takon me ligj dhe, në këtë pikë, e shohim një pakujdesi të madhe nga Qeveria, e cila po lejon që me muaj të tërë ky bord aq i rëndësishëm të mbetet pa u plotësuar dhe pa mundësi që ta kryejë detyrën e vet.

Raporti i AKP-së është kthyer nga seanca dhe është kërkuar që t'i bashkëngjitet raporti i Auditorit. Ky raport tashmë i është bashkangjitur raportit paraprak të AKP-së. Në fakt, raporti i Auditorit për AKP-në do të duhej të sillej në Kuvend si pikë e veçantë e rendit të ditës, pasi përmban shumë të gjetura, por edhe shumë rekomandime, të cilat do të duhej të votoheshin të veçanta dhe të ndara nga raporti vjetor i AKP-së, në mënyrë që të tentohet të bëhet përmirësimi i performansës së këtij bordi dhe AKP-së, në përgjithësi.

Nga raportimi i drejtorit Llluka kemi marrë informatën se privatizimi është në përfundim e sipër dhe tani është faza e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe shqyrtimi i kërkesave të kreditorëve. Si problem është paraqitur mosefikasiteti i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, e cila nga 130 milionë të mbledhura për shpërndarjen e punëtorëve ka lejuar shpërndarjen e vetëm 74 milionëve dhe pjesa tjetër e mjeteve, si dhe 225 lista të punëtorëve mbeten peng i këtij institucioni. Me rastin e amendamentimit të tri ligjeve për AKP-në, lidhur me AKP-në nga deputetët e LDK-së në Komisionin për Zhvillim Ekonomik është kërkuar që Fondi i Privatizimit i Kosovës të përdoret në funksion të zhvillimit ekonomik. Kjo gjë ende nuk ka ndodhur dhe ky fond deri më tani shpenzohet për funksionimin e vetë AKP-së, por në fakt edhe zvogëlohet dita-ditës, ashtu siç shihet edhe nga raporti i Auditorit.

Fondi i Privatizimit, i cili është formuar nga pasuria e Kosovës për sa vite qëndron larg ekonomisë dhe nuk e ndihmon rritjen e ekonomisë së Kosovës në asnjë mënyrë. Një pjesë substanciale e fondit ruhet në BQK me interes zero, e në ndërkohë inflacioni në vitin e kaluar ishte 2,5%, gjë e cila tregon, jo ruajtjen e këtij fondi, por zvogëlimin e vazhdueshëm të tij. Shënimet e financave të fondit ruhen në një dokument të exell-it, e jo në një bazë të mirëfilltë të shënimeve, e cila në asnjë mënyrë nuk mund të perceptohet si ndonjë tendencë e kursimit të mjeteve të fondit, duke pasur parasysh shpenzimet shumëmilionëshe për këshilltarë të ndryshëm në fazat e ndryshme të privatizimit. Kjo vlen edhe për një 1,2-milionëshin që është shpenzuar për shërbimet e likuidimit.

Kompensimet e anëtarëve dhe të stafit ende nuk janë bazuar në ndonjë rregullore, pasi mungojnë politikat e duhura që e përcaktojnë mënyrën e ndarjes së kompensimeve. “Trepça” është një çështje shumë e rëndësishme për të cilën është kërkuar ligji i veçantë dhe kjo ka dalë edhe si obligim nga debati të cilin e ka kërkuar Grupi Parlamentar i LDK-së, dhe ende mbetet i parealizuar. Bile, nga raportimi kemi kuptuar se deri më tani kërkesat e kreditorëve për “Trepçën” shkojnë diku afro 1 miliard euro. Në raportin e auditimit, performansa e AKP-së është cilësuar si raport i kualifikuar, gjë që nuk paraqet raport të mirë dhe tregon qartë se ka keqpërdorime të evidentuara dhe se ka atë gjetura, të cilat nuk na lejojnë që këtij raport të AKP-së t’i japim një notë kaluese në Kuvend.

Pra, edhe një herë në fund kërkoj urgjentisht, kërkojmë urgjentisht si grup parlamentar veprimin e Qeverisë për plotësimin e Bordit dhe të anëtarëve, funksionalizimin e këtij bordi aq të nevojshëm për t’i vazhduar procedurat. Gjithashtu, edhe pajtohem me kërkesën për ndryshim-plotësimin e ligjit.

Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë kundër raportit të AKP-së, ndërsa kërkojmë që raporti i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike të silltet në Kuvend dhe të votohet, pasi ka rekomandime të vlefshme që mund të ndikojnë në përmirësimin e performansës së AKP-së.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Natyrisht që edhe në këtë raport, sikur edhe shumë raporte që na vijnë në Kuvend për t’u diskutuar dhe miratuar nga agjencitë e pavarura, që i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit, e

kemi një mangësi që po e përcjell vazhdimisht secilin raport, e që po e bën atë që më herët e vlerësova si fshehje të një pjese të vërtetës, pra një të vërtetë gjysmake, dhe me këto të vërteta gjysmake vërtet ne nuk mund të operojmë, sepse e vërteta gjysmake, pavarësisht saktësisë të saj, prapë nuk është e tërë e vërteta dhe rrjedhimisht e kemi të vështirë që qatë vlerësojmë punën e një agjencie, duke mos i pasur parasysh të gjitha çështjet e raportuara në raportet që na vijnë këtu.

Puna e AKP-së nuk lidhet vetëm me atë që e ka bërë AKP-ja, por edhe atë që të tjerët pretendojnë që e ka bërë keq AKP-ja, dhe rrjedhimisht në raportin e punës për një vit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit duhet domosdoshmërisht të figurojnë edhe të gjitha kërkesat ligjore që i bëhen nga ndërmarrjet e ndryshme, nga sindikatat e ndryshme asaj për shkeljen e procedurave, ose për shkelje të supozuara të procedurave që i ka bërë AKP-ja gjatë trajtimit të privatizimit, likuidimit të ndonjë ndërmarrjeje të caktuar dhe në këtë raport, sikur edhe në raportet tjera, asnjëherë nuk kemi pasur një trajtim ose të paktën një listim të rasteve gjyqësore, në të cilat AKP-ja është njëfarë forme palë e paditur.

Veçanërisht këtu po e përmend një rast që e kemi diskutuar disa herë edhe në Kuvend, pra Fabrikën e Tubave, ku nuk shihet fare në raport se çka do të bëjë AKP-ja me këtë borxh, të cilin e ka vlerësuar si borxh edhe Gjykata Kushtetuese, ndaj punëtorëve të Fabrikës së Tubave, pastaj nuk kemi asnjë fjalë të vetme për Fabrikën e Amortizatorëve, një proces ky i kontestuar po ashtu i privatizimit, dhe nuk kemi asnjë fjalë të vetme as për “SharrCem”-in, po ashtu proces i kontestuar i privatizimit, për “Ballkanin” e Suharekës e kështu me radhë.

Pra, të gjitha këto proceset e kontestuar të privatizimit, në të cilat akuzohet AKP-ja, më herët AKP-ja si shkelëse e drejtpërdrejtë e procedurave, rregullave dhe ligjeve, nuk figurojnë fare në raportin e AKP-së. Pra, këtu flitet për punën e një AKP-je të cilën ne nuk e njohim, sepse atë që e njohim nuk është ajo që figuron në këtë raport të dorëzuar.

Çështja tjetër që duhet të përmendet, edhe pse përmendet në letërën e njërit prej anëtarëve të Bordit, po flasim për vitin kur AKP-ja e ka humbur kryesuesin e vet, pra kryesuesin e Bordit, i cili është vrarë në vitin 2012, e që zyrtarisht është vlerësuar si vetëvrasje, e që shumë çuditërisht, por këtu në raport të vlerësohet vetëm si vdekje tragjike, pra nuk quhet vetëvrasje, dhe pastaj komplikimet dhe vështirësitë që i ka paraqitur ky akt ndaj punës së AKP-së edhe moskompletimit të Bordit.

Çështja tjetër që lidhet me vitin për AKP-në, e që vazhdon edhe në momentin kur këta kanë raportuar, edhe në momentin kur ne po flasim, është moskompletimi i Bordit, gjë që e ka bërë Agjencinë Kosovare të Privatizimit një agjenci impotente karshi detyrave ligjore që i ka, sepse pa Bord, pa kuorum të Bordit, pa shumicë të Bordit, këta nuk mund ta marrin asnjë vendim dhe rrjedhimisht të gjitha ato punë do të duhej t'i kryente AKP-ja. Ka mbetur pezull për shkak të moskompletimit të Bordit, pra herën e parë me vonesën pas vrasjes të Dino Hasanit, dhe pastaj herën e dytë me vonesën e njëjtë që po e bën Qeveria karshi dorëheqjeve që kanë ndodhur në AKP, në vitin 2013.

Por, prej punëve që AKP-ja, siç ka raportuar në raportin që po e diskutojmë, që nuk po mund t'i kryejë për shkak të mungesës së Bordit, disa prej tyre u përmendën dhe nuk dua

t'i përsëris. Është i rëndësishëm të përmendet një fakt, që AKP-ja njëkohësisht njihet si administrator ligjor i kombinatit "Trepça" dhe, në anën tjetër, vetë AKP-ja është e pakompletuar, pra që nënkupton që nuk mund t'i marrë disa vendime për "Trepçën", që do të kishin qenë vendime që do ta mundësonin funksionalizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Pra, në njëfarë mënyre, me ligjet që i kemi miratuar në këtu në Kuvend, të sponsorizuara nga Qeveria, e kemi vendosur gjigantin më të madh dhe më të rëndësishëm ekonomik të Kosovës nën administrim të një agjencie, e cila, jo vetëm që ka qenë agjencia më jo llogaridhënëse në Kosovë, prej se ekzistojnë institucionet e Kosovës së pasluftës, por edhe njëkohësisht tash së fundi është bërë edhe një prej institucioneve më jofunksionale të Kosovës. Pra, në njëfarë mënyre, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë e ka vendosur "Trepçën" nën një bord, nën një agjenci, e cila më së paku e ka mundësinë që ta menaxhojë si duhet "Trepçën" dhe rrjedhimisht e kemi një Trepçë, e cila prej një gjiganti ekonomik bosht të zhvillimit ekonomik të një hapësire shumë më të madhe se sa Kosova, tash është shndërruar në një ndërmarrje, e cila as veten nuk po mund ta mbajë.

Pra, në këtë drejtim, konsideroj që këtu përgjegjësia është drejtpërdrejt e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak se i dimë kompetencat që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës, veçanërisht karshi kësaj agjencie.

Në raportin e agjencisë thuhet që ajo i ka në monitorim 9 ndërmarrje, të cilat janë privatizuar me kushte, por këto thuhet vetëm në pikat e përgjithësuara. Pra, prapë e kemi këtë problemin e përgjithësimit të një çështjeje dhe të tejkalimit të shpejtë të një çështjeje, e cila është shumë e rëndësishme, sepse kjo është një çështje që po përsëritet vazhdimisht vit pas viti. Pra, edhe në raportin për vitin 2011, nëse lexohet me vëmendje, e shoh që e njëjta gjë thuhet për të njëjtat ndërmarrje, dhe pastaj e njëjta gjë për vitin 2010 thuhet e njëjta gjë për të njëjtën ndërmarrje. Pra, Agjencia Kosovare e Privatizimit asnjëherë nuk po tregon se çfarë është duke ndërmarrë në këto raste dhe çka po prodhon kjo mbikëqyrje që po e bën ajo, por vetëm po na tregon se i ka nën mbikëqyrje. E këto ndërmarrje janë ndërmarrje, të cilat janë privatizuar me spin off special, dhe të cilat as për së afërmi nuk kanë arritur t'i plotësojnë kushtet e kontratës, e këtu përfshihet edhe Ballkani i Suharekës, punëtorët e të cilit janë në grevë janë tash e dy muaj.

Pra, është e pamundur që ne ta vlerësojmë punën e AKP-së karshi kësaj çështjeje shumë të rëndësishme, sepse nuk na tregohet se çfarë ka bërë AKP-ja, përveçse pranohet që janë nën monitorim. Pastaj, këtu përmendet vetëm 9 ndërmarrje, ndërkohë që nuk tregohet edhe për ndërmarrjet tjera të mundshme që do të duhej të ishin në monitorim, apo për nivelin e plotësimit të kushteve të kontratës nga privatizuesit e ndërmarrjeve tjera me spin off special. Pra, as këtë nuk e kemi si të dhënë nga AKP-ja, që do të duhej t'i dorëzohej këtij Kuvendi, në mënyrë që Kuvendi ta ketë mundësinë pastaj ta vlerësojë edhe punën e AKP-së, por edhe zhvillimet e gjithëmbarshme në sektorin e industrisë prodhuese në Kosovë.

Pra, në njëfarë mënyre, raporti i AKP-së, në vend se të ishte raport i punës së AKP-së, këtu është shndërruar në një raport ose të dëshirave të AKP-së, por më shumë i disa sukseseve të vogla të AKP-së, për të cilët ata duhet që ta informojnë Kuvendin.

Sa i përket raportit financiar, u përmend këtu raporti i Auditorit të Përgjithshëm. E kritikon në shumë aspekte performansën financiare të AKP-së. Unë konsideroj që është e domosdoshme, është shumë mirë që po e diskutojmë raportin e punës së AKP-së, së bashku me raportin e audituar të financave të AKP-së për shkak se këto dy çështje janë shumë të ndërlidhura. Natyrisht, pra, puna e AKP-së vërehet edhe në mënyrën se si AKP-ja po i menaxhon fondet e privatizimit të Kosovës, edhe vetë buxhetin e vet.

Në raport të Auditorit thuhet se shpërndarja e 20%-përqindëshit, lista e punëtorëve në disa raste nuk është bërë në harmoni me rregullat e përcaktuara ligjore. Pra, këtu ka pasur shkelje të drejtpërdrejta të kryera nga AKP-ja, për të cilat këta duhet të përgjigjen gjithsesi, dhe AKP-ja nuk ka arritur t'u përmbahet shumicës së rekomandimeve të Zyrës së Auditorit, gjë që tregon se agjencia nuk ka bërë një adresim të plotë të rekomandimeve. Pra, në njëfarë mënyre tregon një lloj joserioziteti dhe shpërfillje absolute që kjo agjenci u bën rekomandimeve që dalin nga auditori.

Po ashtu, në raport thuhet që AKP-ja nuk ka mundur të krijojë marrëdhënie të duhura për bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës, që e ka një prej detyrave primare si agjenci, meqenëse edhe fondet e mirëbesimit lidhen me deponimin e tyre në Bankën Qendrore.

Dhe, për ta përfunduar, Lëvizja “Vetëvendosje” për këto arsye dhe për shumë arsye tjera për të cilat nuk kam kohë t'i publikoj këtu, jemi kundër këtij raporti, por arsyeja kryesore pse e kundërshtojmë raportin është ajo që e thashë në fillim. Pra, që raporti dështon ta tregojë vërtet punën e AKP-së dhe në çfarë mënyre AKP-ja i ka plotësuar, madje edhe formalisht dhe minimalisht kushtet ligjore që i paraqiten asaj, e lëre më që të bëjë diçka më të mirë për vendin dhe ekonominë e vendit. Faleminderit!

KRYTARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Ministre,

Nëse e shohim mandatin e AKP-së, në fillim mund të konkludojmë që ajo është gjithçka, përveç se një agjenci e pavarur në funksion të publikut. Prandaj, edhe raporti i cili është sjellë këtu mund të jetë, siç u tha edhe nga kolegët, një raport i dëshirave, por ajo çfarë është realiteti i punës së AKP-së në fakt është komplet e kundërta. Nëse i shohim bordet, shohim që vazhdojmë të jenë, jo veçse të politizuara, por edhe të pakompletuara dhe me probleme të shumta, madje deri në skenat të cilat i kemi parë në të kaluarën, e që janë lidhur edhe me rastet tragjike.

Nëse e shohim gjendjen e ndërmarrjeve të privatizuara, kjo flet për një dështim të kësaj agjencie në ushtrimin e funksionit të saj. Janë ende të freskëta të gjitha ato skandale, të cilat e kanë skandalizuar opinionin e të cilat janë ndërlidhur me zyrtarët më të lartë të kësaj Qeverie, duke filluar nga zëvendëskryeministri i parë, e deri në këtë Kuvend, kur është vërejtur që nëpërmjet kësaj agjencie realisht ka pasur përfshirje dhe favorizim të grupeve të caktuara të lidhura me politikën dhe absolutisht nuk ka pasur përpjekje që kjo agjenci ta kryejë rolin e saj për ta zhvilluar ekonominë e këtij vendi.

Si grup parlamentar, ne dëshirojmë t'i shtrojmë edhe si pyetje lidhur me punën e agjencisë dhe po presim që të marrim përgjigje në të ardhmen, sepse përgjigjet për 20-përqindëshin e punëtorëve vazhdojnë të hedhen si faj te një ose tjetër institucion, mirëpo këta njerëz vazhdojnë të mbeten pa këto të ardhura, të cilat u takojnë dhe për të cilët kanë punuar vite me radhë.

Nëse e shohim si proces, procesi i privatizimit ka pasur afate kohore dhe asnjëherë nuk po jepet një përgjigje pse është vonuar privatizimi në tërësi. Pse këto afate kohore nuk janë respektuar dhe pse pothuajse të gjitha ndërmarrjet e privatizuara paraprakisht janë degraduar deri në atë shkallë sa janë shitur për një çmim sa për të thënë? Sidomos kur flasim për ndërmarrjet e spin off-it special, edhe pse si koncept privatizimi duhet të ndodhë në një vend për qëllime të zhvillimit, përmes futjes së kapitalit të huaj, rrjedhimisht rritjes së punësimit, në Kosovë ka ndodhur e kundërta.

Në shumicën e rasteve është ndërruar destinacioni i këtyre ndërmarrjeve, janë shitur për hekur, punëtorët kanë mbetur në rrugë dhe kanë mbetur pa punë, ndërkaq asnjëherë Agjencia nuk ka dhënë arsyetime ose shpjegime se çka po e pengon në kryerjen e punës së vetë.

Po dua të ndalem te toka bujqësore. Nëse e shohim në disa raste, ku ka qenë më atraktive dhe ku është shitur, i është ndërruar destinacioni, ndërkaq, një pjesë shumë e madhe e tokës bujqësore ka mbetur djerrë dhe pa përkujdesje nga askush.

Dua ta përfundoj, dje me ministrin Ismajli, që shkoi e i cili deklaroi që kërkon ndërprerjen e ristrukturimit të “Trepçës”. Dhe, unë po dua edhe njëherë ta thërras që t'i mbajë duart larg nga “Trepça”, për faktin se kjo agjenci është e pavarur dhe Qeveria nuk ka të drejtë ta urdhërojë se çka të bëjë. Kjo është e para.

E dyta, në “Trepçë” po edhe në Kosovë, e sidomos në “Trepçë” dhe Mitrovicë, kemi nevojë për një kapital të pastër, përmes të cilit do të zhvillohet kjo ndërmarrje dhe jo për para të dyshimta, të cilat mund të vijnë nga njerëz të cilët si duket politikën po e shohin si mjet për të shfrytëzuar atë çka ka mbetur e pashfrytëzuar në Kosovë.

Prandaj, dua ta lus Qeverinë Thaçi, që ta ndajë në këtë rrethanë dhe në këtë moment biznesin nga politika, sepse në mënyrën siç po shihet, sidomos me rastin e “Trepçës”, Kosova për ta po shihet si një ishull mafioz dhe jo si një vend i cili duhet të zhvillohet përmes agjencive të pavarura, të cilat janë të thirrura që ta kryejnë punën e tyre dhe që t'i raportojnë Kuvendit.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk e voton këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara ministre,

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe në një seancë të kahershme pat marrë vendim që ky raport i AKP-së të mos

shqyrtohet pa raportin financiar të saj, gjë që kemi votuar. Dhe, sot është pritur që të votohet edhe raporti dhe rekomandimet nga Komisioni për Mbikëqyrje Financiare.

Në rast se e shohim raportin e AKP-së si raport i një Agjencie shumë të rëndësishme, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mund të themi se në AKP që nga vdekja e kryesuesit apo kryetarit të Bordit të AKP-së, mund të themi se AKP-ja ka ngelur çdo herë pa bord të kompletuar. Fatkeqësia që ka ndodhur në këtë bord pas vdekjes së të ndjerit Dino Hasanaj, prapëseprapë u paraqit edhe me anëtarë të tjerë, të cilët dhanë dorëheqje.

Në rast se e shohim çështjen e funksionimit të AKP-së mund të themi se AKP-ja nuk mund të funksionojë pa bord dhe kjo u pa edhe pas vdekjes së të ndjerit dhe tash pas largimit të tyre, ndërsa në këtë raport të cilin sot po e shqyrtojmë, mund të themi se vetë anëtarët të cilët kanë raportuar brenda Komisionit Parlamentar, kanë shprehur mendimin se AKP-ja nuk po mund të funksionojë sepse po ballafaqohet me shumë probleme, duke marrë parasysh se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme, është duke u paraqitur si problem në procesin e likuidimit.

Në rast se e marrim çështjen e funksionimit të AKP-së dhe çështjen e ndarjes së 20%-shit të punëtorëve, atëherë duhet t'i bëjmë apel Qeverisë së Kosovës, në këtë rast që shumë shpejt ta kompletojë Bordin e AKP-së. Ligjin për AKP-në ne e kemi ndryshuar pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, mirëpo prapëseprapë në bazë të rekomandimeve që po shihen këtu, mund të themi lirisht se duhet sa më shpejt që të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji i AKP-së.

Ndërsa, tek çështja e "Trepçës" ne e kemi biseduar edhe me përfaqësues të AKP-së dhe më vjen shumë keq që njerëzit duhet t'i lexojnë raportet dhe rekomandimet, të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës, ku vetë Kuvendi i Kosovës i ka dhënë të drejtën ekskluzive ministrit Ismajli, që të sjellë në Kuvend Ligjin për "Trepçën".

"Trepça" nuk është pronë e askujt, është pronë e Kosovës, mirëpo nën menaxhimin e AKP-së dhe ne kemi biseduar brenda Komisionit Parlamentar si do të bëhet çështja e funksionalizimit të "Trepçës". Dhe, presim shumë shpejt brenda këtij Kuvendi që ministri i Zhvillimit Ekonomik të sjellë Ligjin për "Trepçën".

Ndërsa për çështjet mafioze, atje është Gjykata dhe Prokuroria, ku dihet mjaft mirë se po u bëhet apel, por po u bëhet apel në mënyrën e kundërt, gjë që është e dhembshme, kur deputetët merren me çështjet e prokurorit dhe hetuesisë.

Në rast se e shohim raportin e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare, mund të themi se në këtë raport është potencuar mjaft mirë çështja se Auditori nuk e ka nxjerrë çështjen e auditimit brenda kësaj agjencie të mirë, mirëpo prapëseprapë Komisioni për Mbikëqyrje Financiare ka dhënë rekomandimet e veta dhe ne si grup parlamentar kërkojmë nga Qeveria:

1. Ta kompletojë bordin e agjencisë më të rëndësishme brenda Kuvendit të Kosovës, që raporton për arsye se brenda kësaj agjencie mund të vijnë edhe investitorë të rinj për të investuar në Kosovë,

2. Të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit dhe

3. Çështja e përdorimit apo çështja e bllokimit të fondeve të punëtorëve apo të 20%-shit të punëtorëve të apeloher shumë shpejt te Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme, që të zgjidhet në bazë të miratimit të Bordit të AKP-së.

Këto dy raporte duhet të shkojnë së bashku, se ne kemi pritur që raportin e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare, që të kompletohet raporti i AKP-së dhe arsyeja që tash i kemi të dy raportet, edhe të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Koalicioni për Kosovë të Re u jep përkrahje dy raporteve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Fondit të privatizimit dhe duke u bazuar në raportin e Auditorit Gjeneral kemi arritur t’i identifikojmë mangësitë, siç janë në vijim dhe të cilat për ne janë jashtëzakonisht shqetësuese. Ndër to janë, pa dashur t’i përsëris ato që i thanë kolegët e mi të nderuar:

- Mungesa dhe vonesa e propozimit për emërimin e kryesuesit të bordit të drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me anëtarë të tjerë të bordit të drejtorëve, të cilat emërimet do të mund të ndikonin në përfundimin me kohë të mandatit të AKP-së dhe kjo ka shkaktuar që AKP-ja të mos mund t’i mbulojë të gjitha objektivat e parapara me planin strategjik.
- Mospagesa për kontratën e shërbimeve profesionale sipas Ligjit të AKP-së, për kompensimin e ofruesve.
- Mosnxjerrja e një rregulloreje të qartë lidhur me shpërndarjen, regjistrimin dhe dokumentimin e plotë të përfituesve të 20%-shit.
- Ristrukturimi i brendshëm i vendeve të punës pa pëlqim të Ministrisë së Administratës Publike, me çka rritet mundësia e pagesave të pabazuara.

Dhe, krejt në fund, Grupi Parlamentar “6+” i përkrah dy raportet në fjalë me rekomandimet, të cilat janë dhënë, sidomos nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, Sasha Gjokiq e ka fjalën.

SAŠA ĐOKIĆ: Zahvaljujem se gospodine potpredsedniče!

Poštovane ministarke,

Kolege poslanici,

Želim da govorim u ime “Zajedničke Budućnosti” i pažljivo smo razmatrali izveštaj KPA-a. S obzirom da je izveštaj dostavljen u 2012.godinu a obuhvaća i period o 2010 – 2012-e.

Koliko sam ja mogao da vidim odnose na analizu firmi koje su u privatizaciji i koje su privatizovane. Isto tako u tabelama je prikazana i privatizacija zemljišta.

Ja želim da naglasim da odluke koje su donošene u tom periodu, nisu zakonske odnosno nisu validne. Zašto to naglašavam? Zato što u toku perioda član borda KP je bio gospodan Slobodan Petrović. Želim da podsetim da po Zakonu o visokim ličnostima, on je gospodin Petrović nije mogao da bude u nezavisnom telu borda, jer je on bio u međuvremenu imenovan za zamenika premijera i ministra Lokalne samouprave.

Po Zakonu Rerpublike Kosova on nije mogao da obavlja funkciju u Bordu KP-a. Međutim, gospodin Petrović je od 2010 - 2012 obavljao tu funkciju gde su donete mnoge sumnjive privatizacije i s obzirom da je zakon prekršen, “Zajednička Budućnost” konstatuje da svaka odluka gde je gospodin Petrović učestvovao smatra se pravno ništavna i mi ne želimo da glasamo za ovaj izveštaj.

O radu nezavisnih institucija ne želimo da se mešamo, ali želim da naglasim da ćemo pokrenuti sve zakonske mehanizme, kako u institucijama Kosova tako i u ovlašćenim predstavnicima međunarodne zajednice.

Gospodo, vi znate da je formirano posebno veće pri Ustavnom sudu i ono ima mandat da rešava predmete, odnosno zahteve i tužbe građana o zaštiti privatne imovine i povraćaj iste. Međutim, iako u zakonu stoji da do okončanja spora u Posebnom veću, niko ne može da raspolaže ili privatizuje imovinu koja je u sudskom sporu.

Agencija KP-a to čini iako na to nema pravo, odnosno zakonsku osnovu. Meni je žao što gospodin Kući ministar pravde nije prisutan i “Zajednička Budućnost” zahteva od gospodina ministra pravde da ispita zašto se krši zakon, Ustav Republike Kosova.

Drugo, “Zajednička Budućnost” je u više navrata pozivala gospodu Maju Milanović, sada članicu Borda KP-a, da nam objasni privatizaciju 29 hektara ua Čaglavici i isto tako 130 hektara zemljišta u Čaglavici. Na osnovu čega i kako je i kome prodato to zemljište, kada odgovorno tvrdim da su sve parcele u procesu povraćaja u Posebnom Veću, a većina je i vraćena vlasnicima i uknjižena na ime vlasnika u Katastarstvu Republike Kosova.

KP je na nezakoniti način doneo ove odluke. Želim da naglasim da mi iz “Zajedničke Budućnosti” iskoristićemo sve pravne mogućnosti da se ovakav način privatizacije spreči i da učesnici ako su učestvovali u nezakonitim radnjama, privedu pravdi i za to odgovatraju.

Zajednička Budućnost zahteva ostavku člana borda Maje Milanović, jer ona nije stručna, sposobna da obavlja ovakvu visoku funkciju i da snosi odgovornost. Isto tako s obzirom da je bliska rođaka visokog funkcionera u Vladi Kosova.

I da zaključim, svu dokumentaciju koju poseduju poslanici “Zajedničke Budućnosti” predaćemo predstavnicima nadležnim organima Republike Kosova, međunarodnim predstavnicima, jer smatramo da ima indicija i postojanje elementa organizovanog kriminala.

Isto tako želim da istaknem da nas u narednom periodu čeka donošenje Zakona o denacionalizaciji a ako pogledamo zemlju u ukruženju videćemo koje oni imaju probleme, pa postavljam pitanje, šta nas čeka s obzirom na ovakvu privatizaciju u budućem periodu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç u tha edhe nga parafolesit e tjerë, ne sot po e shqyrtojmë raportin vjetor të Fondit të Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Fondit të Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka evidentuar një varg dobësish në formë të gjetjeve për vitin 2012.

Dobësitë janë vërejtur në menaxhimin financiar dhe kontrollin, përfshirë këtu edhe masat parandaluese. Arsyet për këtë janë se shumë nga dobësitë e vitit të kaluar janë paraqitur edhe këtë vit.

Fakti se një pjesë e madhe nga rekomandimet e dhëna vitin e kaluar nuk janë implementuar në plotësi është një tregues i kësaj gjendjeje.

Në këtë kudër, ashtu siç e kemi gjykuar në kuadër të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, si devijim dhe shkelje më flagrante është ajo që lidhet me kontratën e lidhur me një kompani të huaj prej 20 milionë euro, ofertë kjo e hapur dhe e vlerësuar jashtëligjshëm nga drejtorët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Në këtë kuadër dua t’ju rikujtoj se një opinion i kualifikuar jepet kur Auditori nuk është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale me pasqyrat financiare.

Aty ku Auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose më tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare, e që janë materiale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar.

Opinion i kualifikuar i auditimit mbi Fondin e Privatizimit është se: “Pasqyrat e rrjedhës së parasë prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të pagesës së paaprovuar për shpenzimet profesionale të likuidimit të NSH-ve të privatizuara, në vlerë prej 1 228 009€, e cila është bërë pa bazë ligjore”.

Fjala është për pagesën që i është bërë një kompanie të jashtme, si konsulente lidhur me vlerësimin e likuidimit të ndërmarrjes shoqërore, “Trepça”.

Opinion i kualifikuar i auditimit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit është se: “Pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të mosprezantimit të pagesave për realizimin e shpenzimeve profesionale të likuidimit në vlerë 1 228 009€ lidhur me marrëveshjen kontraktuale me një kompani të jashtme”.

Konsideroj se pagesat e tilla pa bazë ligjore lidhur me marrëveshjen kontraktuale me një kompani të jashtme janë shkelje të procedurave ligjore të prokurimit dhe në kundërshtim klasik me përgjegjësitë institucionale dhe ligjore me rastin e shpenzimit të parasë publike.

Me gjithë shpenzimin e ulët të buxhetit të ndarë për AKP-në, ajo i ka shpenzuar paratë e Fondit të Mirëbesimit për shërbime konsulente për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Pagesa e shërbimeve të likuidimit nga fondet e NSH-ve në likuidim paraqet rrezikun që fondet në mirëbesim të mos shpërndahen sipas prioriteteve të caktuara me këtë ligj.

Shfrytëzimi i këtyre mjeteve është në kundërshtim me të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Asnjë pagesë që e tejkalon shumën e mjeteve të ndara për AKP-në nuk ka guxuar dhe nuk guxon të bëhet, pa marrë aprovim nga Kuvendi i Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

AKP-ja për vitin 2012 kishte planifikuar 51 kontrata të prokurimit në vlerë 2 874 064€, ndërsa kishte realizuar 50 kontrata në vlerë 2 232 292€.

Gjatë vitit 2012 është nënshkruar një kontratë nga AKP-ja, që nuk ishte e paraparë në planin e prokurimit.

Prokurimi, që Auditori i Përgjithshëm e kishte identifikuar si fushën në të cilën AKP-ja kishte bërë shkeljen më të rënd, hapur dhe në dritë të diellit ishte kontrata e lidhur ndërmjet AKP-së dhe ‘Deloitte&Touche’.

Kjo kontratë ka të bëjë me “angazhimin e shërbimeve profesionale për procedimin, gjykimin dhe përfaqësimin ligjor për ankesa për tërë portfolion e NSH-ve në Republikën e Kosovës”, e cila ishte në vlerë prej 19 920 304€.

Kontrata për “Ofrimi i shërbimeve profesionale për likuidimin e portfolios së ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës” nuk ka qenë e paraparë me planin e prokurimit të AKP-së

Kjo procedurë e prokurimit nga AKP-ja ishte në shpërprurje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi.

AKP-ja ka nënshkruar kontratë, duke mos poseduar fonde adekuate për shërbimet e likuidimit dhe duke bërë zotimin për këto mjete nga NSH-të në likuidim.

Në rast të mungesës së fondeve nga likuidimi i NSH-ve, pagesa do të duhej të financohet nga fondi rezervë, apo tarifa administrative e agjencisë.

Vlera e kësaj kontrate ishte 19 920 304€, apo 2,47% më e lartë se totali i buxhetit të AKP-së për vitin 2012.

Kontrata është e paraparë të realizohet brenda katër vjetëve, ndërsa gjatë vitit 2012 ishin bërë pagesa në emër të kësaj kontrate në vlerë prej 1 228 009€.

AKP-ja për kontratën e lartcekur kishte vendosur në cilësinë e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e ofertave drejtorë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Sipas raportit të ZAP-it, Komisioni i vlerësimit të tenderëve është takuar gjashtë herë për shqyrtimin e ofertave të këtij tenderi.

Nga procesverbalet e këtij komisioni, ZAP-i ka vërejtur se në takimin e parë të Komisionit për vlerësimin e tenderëve, kryesues ka qenë zyrtarja e prokurimit të AKP-së, ndërsa pjesëmarrës në cilësinë e vëzhguesit ka qenë zëvendësmentaxheri i AKP-së.

Inkuadrimi i Bordit të Drejtorëve, përpos në vendosjen e politikave operative, edhe në procese ekzekutive të kompanisë e rrit rrezikun e humbjes së zinxhirit drejtues dhe mbikëqyrës të proceseve.

Ndërsa ndërhyrja e menaxhmentit të AKP-së në cilësinë e vëzhguesit ndikon në humbjen e pavarësisë vlerësuese të anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e tenderëve.

Vlen të theksohet se ish-stafi i AKP-së që ka punuar në hartimin e kësaj kontrate dhe kushteve të saj dhe pas lidhjes së kësaj kontrate të dyshimtë nga AKP-ja janë bërë pjesë e stafit të kësaj kompanie që e ka fituar këtë tender prej 20 milionë euro.

Ky ish-staf i AKP-së që tani është bërë pjesë e kompanisë 'Deloitte&Touche' për punën dhe shërbimet që i ofrojnë si konsulent nga kjo kontratë për një ankesë paguhet nga 300 deri në 400 euro.

Shqetësim tjetër për mua është po ashtu mungesa e rregullores për të ardhurat e personelit dhe anëtarëve të Bordit të AKP-së, e cila përbën shkeljen e radhës.

Po ashtu, mungojnë të dhënat sa i përket tatimit të mbajtur në burim për Bordin e Drejtorëve të AKP-së.

Të nderuar kolegë deputetë,
Aktivizimi i fondeve në mirëbesim të AKP-së në depozita afatshkurtra ka filluar të bëhet nga BQK-ja, duke filluar nga data 24 gusht 2010.

Keni parasysh se AKP-ja menaxhon me fondin e privatizimit që në fund të vitit 2012 ka arritur shumën prej 549,4 milionë euro.

Agjencia obligohet me ligj për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e vlerës së fondit të privatizimit.

AKP-ja fsheh jokompetencën për menaxhimin e fondit të privatizimit pas aludimit se fondet janë të sigurta.

Ky mosmenaxhim shihet në konkludimet e ZAP-it se AKP-ja as që e ka idenë për fondet e investuara nga BQK-ja dhe normat e interesit nga investimet e fondit.

Deri më 30 shtator 2012, gjithsej janë ekzekutuar 44 depozitime. Gjatë vitit 2012 janë depozituar 47 452 377€ në letra me vlerë, dhe interesi i fituar nga to ishte 86 106€.

Niveli i aktivizimit të fondeve të mirëbesimit pas muajit mars 2012 ka qenë zero.

Duke konsideruar normën e lartë të inflacionit në Kosovë, mosaktivizimi i fondeve të mirëbesimit shkakton humbje në vlerën për para të këtyre fondeve.

Në bazë të matjeve statistikore nga Agjencia e Statistikës së Kosovës, shkalla mesatare e inflacionit në Kosovë për vitin 2012 ishte 2,5%

Kjo e dhënë thjesht do të thotë që vlera reale e fondit të privatizimit është për 13,7 milionë euro më pak vetëm për shkak të inflacionit.

Përderisa po t'i marrim parasysh të dhënat statistikore, në Kosovë gjatë 2012 norma mesatare e interesit nga bankat komerciale ka qenë 4,4% në vit.

Nëse AKP-ja do t'i kryente si duhet funksionet dhe përgjegjësitë e dhëna me ligj, me një investim prej vetëm 20% të fondit të privatizimit do të fitonte 4,84 milionë euro në vit.

Po ashtu, AKP-ja ka mungesë të kriterëve të shkruara kur kërkohet shtyrja e afatit për pagesë dhe shtyrja e afatit për verifikimin e së kaluarës së blerësve të NSH-ve.

Rregulloret në fuqi të AKP-së nuk e rregullojnë qartë se në cilat situata dhe sipas cilave kriterë ekziston mundësia për shtyrjen e afatit për pagesën e parë nga blerësi i NSH-ve, respektivisht 75% e vlerës së ofertuar.

Rregulloret në fuqi të AKP-së nuk e rregullojnë qartë se në cilat situata dhe sipas cilave kriterë ekziston mundësia për shtyrjen e afatit që blerësi i NSH-ve duhet t'i përmbushë në plotësi obligimet për verifikimin e të kaluarës me kohë.

Mangësitë në rregulloret e AKP-së që t'i rregullojnë qartë situatat se kur ka mundësi dhe cilat situata do të ishin të pranueshme për shtyrjen e afateve për plotësimin e kriterëve, apo situatat kur duhet të bëhet pagesa lënë mundësi që vendimet të jenë subjektive dhe të mos merren vendime të drejta.

Të hartohen rregullore të qarta dhe të vendosen kriterë të shkruara për situatat kur kërkohen shtyrje të afateve të ndryshme nga blerësit e NSH-ve për pagesë dhe AKP-ja ta gjejë mënyrën e bashkëpunimit më ekspeditiv me Shërbimin Policor të Kosovës në drejtim të përmbushjes me kohë të kriterit për verifikimin e blerësve të NSH-ve.

Kur jemi te kjo çështje, dua te theksoj se në Kosovë flitet se janë blerë dhe privatizuar shumë NSH nga pronarë, paratë e të cilëve janë me prejardhje të dyshimta, të cilët kanë bërë pastrimin e tyre, si ato nga prostitucioni, droga, korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që dua të them është që procesi i privatizimit është një proces shumë i rëndësishëm nëpër të cilin kanë kaluar të gjitha shtetet që pretendojnë tregun e lirë.

Sidoqoftë, ai proces ka shkuar jo mirë në të gjitha shtetet post-komuniste por, tek ne është përcjellë me disa probleme, sidomos ai i transformimit nga AKM-ja në AKP, me zhdukje dhe djegje të dokumentacioneve zyrtare të privatizimit.

Deri më sot, AKP-ja nuk e ka formuar asnjë komision për një raportim zyrtar se çka ka ndodhur lidhur me këto dokumentacione dhe të cilës natyrë janë këto dokumentacione të shkatërruara.

Procesi i privatizimit, i mirë apo jo, është në përfundim. Ky proces është bërë mbi bazën e një kornize ligjore dhe institucionale, të krijuar mbi një konsensus shumëpalësh, ndërkombëtar dhe kosovar.

Procesi i privatizimit ka qenë segmenti më i rëndësishëm i kalimit nga ekonomia e planit në ekonominë e tregut, pra nuk ka qenë krejt e thjeshtë.

Ky proces i filluar me ndihmën e çmuar të ndërkombëtarëve dhe më pas i vazhduar nga institucionet e Kosovës, pa dyshim se ka qenë temë debati dhe kritikë gjatë gjithë zhvillimit të tij.

Në këtë kontekst dhe për ta evituar perceptimin negativ të opinionit publik lidhur me dyshime aferash dhe keqpërdorimesh, është i nevojshëm një konsultim paraprak me të gjithë Ju, kolegë deputetë, dhe do të kishte qenë mirë formimi i një komisioni për ta vlerësuar atë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre,

Raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit jep një pasqyrë të transaksioneve dhe aktiviteteve nëpërmjet shumë tabelave dhe shifrave, po nuk analizon dhe ndriçon kontributin e kësaj Agjencie lidhur me adresimin e problemeve të shumta, që po e përcjellin tërë procesin e privatizimit, probleme këto që qartazi janë të lidhura me menaxhimin e kësaj Agjencie të rëndësishme. Pra, janë të lidhura me mënyrën se si funksionon bordi, si funksionon menaxhmenti dhe si funksionon administrata e kësaj agjencie.

Raporti anashkalon shumë probleme e sfida që kanë pasoja shumë të këqija dhe pasoja të palejueshme. I vetmi problem që thekson raporti është moskompletimi i bordit dhe problemet që ka me kadastrën, e këto probleme lidhen me komunën. Ndonëse raporti nuk

analizon dhe prezanton pikëpamjet dhe aktivitetet e menaxhmentit lidhur me problemet e shumta dhe të grumbulluara dhe si i tillë nuk meriton të aprovohet, megjithatë nga shifrat dhe tabelat e shpërndara gjithandej këtij raporti, me një punë të madhe mund të nxirren disa konstatime, që meritojnë vëmendjen tonë sot.

E para, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka mbetur pa bord menaxhues efektiv dhe kjo çështje sot nuk mund të kalohet ashtu si një çështje rutinore dhe e parëndësishme. Për këtë çështje, përgjegjësia duhet të adresohet kryesisht te Qeveria, por edhe te Kuvendi dhe komisionet e tij, sepse ne po tolerojmë me muaj një situatë të tillë.

Kjo agjenci, pra Agjencia Kosovare e Privatizimit funksionon më shumë se pesë vjet, duke e trashëguar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, që kishte funksionuar po ashtu më shumë se pesë vjet.

Pra, në total i kemi 11 vjet, gjatë të cilave ka qenë normale që procesi i privatizimit të ishte përmbyllur me efekte shumë më të mëdha për zhvillimin ekonomik. Tash jemi ende në këtë proces me shumë probleme, me dyshime për transaksione dhe efekte, të cilat e zhvlerësojnë tërësisht këtë proces edhe atje ku këto efekte kanë qenë normale të jenë të pranishme.

Andaj, kjo agjenci, menaxhmenti dhe bordi i saj, dështojnë ta vënë këtë proces në masën më të madhe në funksion të zhvillimit ekonomik dhe demokratik të vendit. Mendoj se sot është rasti dhe rendi të bëjmë një pyetje elementare: Deri kur mund ta tolerojmë një gjendje të tillë? A mund Buxheti i Kosovës dhe paraja tjetër publike ta financojë një administratë dhe një bord që shpenzon 6 deri 9 milionë euro në vit? Ta financojë një bord jofunksional dhe një menaxhment që interferon në procesin e prokurimit? Kështu konstaton auditori.

Kjo administratë, që punëson, sipas informatës sime, 295 veta, me shumë departamente... *(Ju lutem, a po diskuton ti Arben, apo unë po diskutoj?)*.

Pra, kjo administratë që punëson 295 veta me shumë departamente dhe i gjithë ky staf dhe gjithë këto departamente nuk i mjaftojnë që ta administrojë procesin e likuidimit, por lidh një kontratë për shërbime me një autoritet të likuidimit për 20 milionë gjatë katër vjetëve. Pra, ia zgjat vetes jetën edhe për katër vjet.

Inefiçienca e gjithë kësaj administrate dhe autoritetesh ilustruhet me faktin se nga transaksionet e shitjes së likuidimit gjatë vitit 2012 janë arkëtuar 12 milionë euro të freskëta gjatë tri valëve të privatizimit, katër likuidimeve, ndërsa për financimin e administratës edhe autoritetit të likuidimit janë shpenzuar 7,2 milionë.

Pra, kjo administratë, gjithë ky aparat menaxhon tri valë, 4 apo 8 likuidime dhe ka 12 ndërmarrje në mbikëqyrje. Më lejoni të konstatoj se ky është një shembull klasik i papërgjegjësisë së madhe të përdorimit të parasë publike.

E treta, më lejoni të konstatoj se me një dinamikë të tillë të realizimit të privatizimit dhe likuidimit me problemin e fondeve të ngrira, me problemet në funksionimin e bordit, menaxhmentit dhe administratës së kësaj agjencie ka ardhur koha që i tërë ky proces,

menaxhimi dhe administrimi i tij të rishikohet dhe reformohet shpejt dhe në mënyrë efektive, të krijohen trupa efektive dhe që urgjentisht të përcaktohet fundi i procesit të privatizimit në funksion ekonomik.

Me këtë rast, duhet të caktohet një afat prej më së shumti dy vjetësh kur kjo agjenci duhet ta përfundojë punën e vet, sepse kështu ky trup del të jetë i shtrenjtë, ineffiçient. Pra, nuk lejohet që të vazhdojë agonja e pranishme që prodhon dëme serioze për zhvillimin ekonomik dhe demokratik të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje ministre,

Kolegë deputetë dhe deputete,

Ju të pranishëm,

Është shumë e vërtetë, edhe unë do të pajtohem me kolegun deputet se përgjegjësia në lidhje me këtë institucion, i cili i përgjigjet direkt Kuvendit është e të gjithëve, edhe i Qeverisë, edhe Kuvendit, madje edhe e komisionit. Po dua të bëj me gisht pak edhe drejt vetvetes, sepse komisioni asnjëherë nuk e ka parë të arsyeshme të shkojë ta vizitojë direkt funksionimin e kësaj agjencie dhe t'i shohë drejtpërdrejt punët se si janë aty, por kemi pritur vazhdimisht të na vijjnë raporte me shkrim këtu në Kuvend dhe pastaj t'i interpretojmë, varësisht ndoshta prej aq sa kuptojmë, ose prej preferencave.

Do të përpiqem edhe unë t'i them nga 2-3 fjalë, edhe pse shumicën e çështjeve, sfidave dhe parregullsive i përmendën edhe kolegë deputetë nga partitë e ndryshme.

Unë do t'i referohem kryesisht materialit që na ka ardhur me shkrim, domethënë raportit që e ka sjellë Agjencia Kosovare e Privatizimit. Raporti i AKP-së fillon me përshkrimin e strukturës organizative, duke përfshirë këtu mandatin, organizimin dhe menaxhimin. Në këtë kapitull të raportit mungon organogrami i agjencisë, një komponentë jo e detyrueshme për agjencinë, por më se e nevojshme për ne si deputetë.

Përveç kësaj, AKP-ja duhet të raportojë për strukturën menaxhuese të agjencisë dhe për mandatin e tyre. Në dorëheqjen e kryetarit të bordit, Blerim Rexha, ndër të tjera, në raport ceket se drejtori menaxhues dhe zëvendës drejtorëve menaxhues u ka skaduar mandati dhe ia kanë vazhduar mandatet njëri-tjetrit.

Në raport nuk është përmendur se kush e ka bartur përgjegjësinë e zgjedhjes së personave në pozita menaxhuese në mungesë të bordit dhe pse nuk ka pasur konkurs publik për këto pozita. Edhe kjo duhet të na provokojë ne si deputetë dhe vetëm ky fakt është dashur që të na shtyjë ta shohim situatën se si është atje.

Kur jemi te struktura organizative është e sqaruar në formë narrative dhe si e tillë ka mungesë të informatave. Nuk shpjegohet struktura menaxheriale dhe numri i përgjithshëm i punëtorëve. Në këtë seksion është dashur të përfshihet një pasqyrë e numrit të punëtorëve në fillim të vitit raportues, si dhe ndryshimet gjatë vitit. Ky ka qenë edhe njëri prej rekomandimeve që i ka dhënë një mekanizëm, i cili i ndihmon komisionit në lidhje me këto çështje.

Raporti i agjencisë e thekson në shumë raste faktin që bordi i agjencisë e ka përfunduar mandatin dhe ka pasur një vakuum derisa është vendosur bordi i ri. Ky arsyetim përgjatë raportit i shërben agjencisë për mosplotësimin e detyrave, të cilat i kishe planifikuar, është një lloj shfajësimi. Në anën tjetër, duke qenë që vitin paraprak, po e rikujtoj, të nderuar deputetë, Kuvendi i Kosovës nuk ia ka aprovuar AKP-së raportin e vitit 2011.

Ndërsa në raportin e vitit 2012 nuk theksohet apo arsyetohet kjo e dhënë. Raporti është i ndarë në punën e secilit divizion dhe departament veçmas. Raporti duhet ta pasqyrojë punën e tërë agjencisë dhe për këtë do të ishte më mirë të raportohet si tërësi, e jo me departamente në mënyrë që të kuptohet efikasiteti i punës së agjencisë.

Si rezultat që raporti është një përmbledhje i raporteve të departamenteve, njësia e marketingut vini re, ka raport më të gjerë se ajo e shitjes.

Kështu që mendoj që departamentit të shitjes duhet t'i jepet një rëndësi më e madhe në raport, e edhe departamentit të likuidimit sesa të marketingut.

Ndër të tjera, në raport e shoh si tejet të nevojshme që edhe sfidave të parapara për vitin në vijim t'u bashkëngjitet një plan i veprimit për t'i tejkaluar dhe adresuar ato. Ndërsa, gjithashtu, është e nevojshme të raportohet edhe për tejkalimin ose jo të sfidave, të cilat janë konsideruar si të tilla në vitin paraprak për vitin raportues.

Në këtë mënyrë mundësohet një vijueshmëri apo një kontinuitet i raporteve ndër vite.

Kur jemi te raporti që ka të bëjë me aktivitetin e agjencisë, gjithashtu vetëm raportohet për largimin nga administrimi i gjashtë ndërmarrjeve shoqërore, pa dhënë shpjegime më të detajuara. Disa nga këto ndërmarrje me ligjin e ri për ndërmarrjet publike kalojnë nën komuna, ndërsa AKP-ja nuk raporton diçka të tillë.

Përveç kësaj, raportohet që ka pasur ndryshim në strukturë, duke u themeluar autoritetet për likuidim dhe duke u shuar komisionet për likuidim, pa dhënë shpjegim se çfarë do të thotë ky ndryshim dhe cilat janë arsyet dhe implikimet e këtij ndryshimi.

Në vijim, agjencia i ka listuar çështjet e mbetura peng për shkak të mungesës së bordit, mirëpo nuk ka shpjegim të detajuar për këto. Sa do ta pengojë punën e agjencisë ky stagnim për vitin e ardhshëm? Cilat janë problemet që janë shkaktuar nga kjo ngecje dhe çfarë efekti kanë pasur në çështje tjera?

Siç është cekur më lart në raport, kur jemi te Divizioni i Shitjes, agjencia ka raportuar bazuar në divizione dhe departamente, e jo për punën në përgjithësi. Në shitjet nëpërmjet spin off-it dhe shitjet e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim, e shoh të nevojshme të raportohet detajisht për ndërmarrjet, të cilat janë privatizuar dhe të ketë shpjegim për ato që nuk janë privatizuar.

Gjithashtu, mungon një krahasim me vitin paraprak i procesit të privatizimit për këta dy komponentë. Gjithashtu, më poshtë, e kemi shtruar edhe në komision parlamentar, por edhe tash e vlen për opinionin të dihet, pyetjet për të cilat duhet të përgjigjet AKP-ja: Sa është numri total i ndërmarrjeve të privatizuara në Kosovë? Sa ndërmarrje kanë mbetur

pa u privatizuar? Sa parashihen të jenë të ardhmen, specifikisht në këtë vit, se ne po e diskutojmë raportin e vitit 2012, ndërsa jemi në fund të vitit 2013.

Kur parashihet të përfundojë procesi i privatizimit? Sa ndërmarrje kanë dështuar të privatizohen dhe pse kanë dështuar? Cila ka qenë arsyeja e auditimit për 17 ndërmarrje? Sa ndërmarrje janë privatizuar pa tre ofertues dhe pse?

Narrativi shpjegues për shitjen me spin off dhe shitjen e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim nuk është mjaftueshëm i detajuar dhe mungojnë posaçërisht arsyet dhe shpjegimi për ndërmarrjet të cilat nuk janë privatizuar.

Cilat janë planifikimet për ndërmarrjet, të cilat kanë dështuar të privatizohen? Sa ka pasur ndikim mungesa e bordit, e shumë pyetje të tjera.

Ndërsa, në raportin që ka të bëjë me ndërmarrjet e privatizuara me kushte në këtë seksion të këtij raporti nuk tregohet në mënyrë të detajuar procesi i vendimmarrjes për vënien në monitorim të ndërmarrjeve të cekura. Gjithashtu, nuk ekziston një limit kohor për procesin e monitorimit dhe përfundimit të tij. Duket e nevojshme të ceket se si do të bëhet vlerësimi i punës së këtyre ndërmarrjeve dhe marrja e vendimeve të mëtutjeshme.

Në raport, kur ka të bëjë me komisionin për shitjen e banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore, vlerësoj që ky kapitull duhet t'i ketë parasysh edhe çështjet në vijim: Sa është numri i përgjithshëm i banesave në pronësi të AKP-së? Cilat janë kategoritë në bazë të vitit të ndërtimit? Pse janë refuzuar kërkesat për shitje? Kush e mban përgjegjësinë? Sa objekte banesore në pronësi të AKP-së janë listuar si të uzurpuara? Çfarë po bën AKP-ja për t'i rikuperuar ato? Sa objekte të lëshuara me qira i ka AKP-ja? Sa është vlera e qirasë? Kur do të hyjnë në privatizim? Etj.

Besoj që ne po e diskutojmë sot këtë raport, por paramendoni, unë konsideroj që është jashtëzakonisht i vonuar, pavarësisht që kjo seancë ka vendosur të vijë së bashku me raportin e auditimit, por ne edhe tre muaj e presim raportin vjetor të punës për vitin 2013, ndërsa jemi në fund të këtij viti dhe po raportojmë për një raport të një viti të mëhershëm, që e konsideroj që është shumë me vonesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqetësimi im ka të bëjë me tokën bujqësore. Për fat të keq, edhe më tutje një pjesë e madhe e tokës bujqësore ka mbetur e paprivatizuar. Nuk është në funksion të prodhimit dhe ka mbetur djerrë.

Për më keq, një pjesë e tokës së privatizuar, po vazhdon të mbetet djerrë edhe për faktin që atë e kanë marrë pronarët e rinj. Ata kanë titullarë, por ajo nuk është vënë në funksion të prodhimit.

E tillë është toka, ta marrim për shembull në Suharekë, rreth 1 200 hektarë, pjesa më e madhe e së cilës me të vërtetë ka mbetur djerrë. Dëshiroj ta theksoj faktin se një pjesë e

madhe e tokës bujqësore ka filluar të gllabërohet nga ndërtimet, të mbulohet me hekur dhe beton. Ta marrim, për shembull për dy vjet, nga viti 2002 deri në vitin 2012, rreth 8 000 hektarë të kësaj toke, sipas raportit që e ka bërë inventari kombëtar, është mbuluara dhe tashmë është një aset i humbur.

Që të mos e zgjas, kisha pasur dëshirë t'i jap vetëm tri rekomandime, për shkak se u thanë disa gjëra dhe nuk kam dëshirë të përsëriten. Unë kisha dhënë tri propozime: është mirë që në Agjencinë Kosovare të Privatizimit të dërgohen menaxherë profesionale dhe të përkushtuar për zhvillimin e vendit, të cilët nuk do të ndikohen nga politika, por do ta kryejnë punën e tyre në bazë të ligjit.

Nën dy, duhet të caktohen prioritetet e privatizimit të ndërmarrjeve, të cilat nuk duhet të jenë të përrjetshme, por duhet t'u përgjigjen kërkesave të tregut.

Dhe, nën tre, po ritheksoj që toka bujqësore duhet të privatizohet në sipërfaqe më të vogla dhe duhet të jepet mundësia që atë tokë ta marrin njerëzit, të cilët merren me bujqësi dhe ta vënë në funksion të prodhimit për të mirën e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Dëshiroj të ngre disa çështje, të cilat mendoj që janë të rëndësishme para se raporti i punës së kësaj agjencie për vitin 2012 të hidhet në votim.

Dihet se nga funksionimi i agjencisë varen kreditorët, të cilët janë të shumtë, si dhe potenciali i investimeve të huaja në Kosovë.

Agjencia në portofolin e saj ka mbi 550 milionë euro, prej të cilave për vitin raportues i ka transferuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës 30 milionë euro. Sipas Ligjit për AKP-në, të cilin e ka aprovuar ky Kuvend, agjencia publikon dhe i dorëzon Kuvendit raportin vjetor, i cili përfshin edhe pasqyrat financiare të agjencisë dhe informatat tjera.

Ky raport i është paraqitur Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili e ka aprovuar atë më 9 shtator 2013, pasi është vlerësuar se raporti është i përgatitur në mënyrë profesionale dhe e përshkruan në detaje punën e agjencisë për vitin 2012.

Pavarësisht nga vështirësitë sa i përket mungesës së bordit në përbërje të plotë për disa muaj rresht, agjencia ka 64 kontrata të privatizimit, meqë ka inkasuar rreth 21 milionë euro, dhe nga 98 kontrata nga shitja nëpërmjet likuidimit, nga të cilat ka inkasuar afro 20 milionë euro.

Me gjithë zvarritjen e procesit të shpërndarjes përfundimtare të 20-përqindëshit për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, agjencia e ka gjetur një mënyrë që të bëjë shpërndarjen e parakohshme për këta punëtorë dhe vetëm gjatë këtij viti, është fjala për vitin raportues, ka bërë shpërndarjen e të hollave për mbi 15 mijë punëtorë, të cilët kanë përfituar mbi 21 milionë euro.

Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore tashmë janë privatizuar, apo janë në proces të privatizimit, synimi i agjencisë është që të bëhet likuidimi i këtyre ndërmarrjeve dhe shpërndarja e fondeve për kreditorët e njohur.

Për këtë arsye dhe me qëllim që një gjë e tillë të bëhet në afat sa më të shkurtër, agjencia brenda autorizimeve ligjore ka angazhuar ofruesin e shërbimeve profesionale, i cili vetëm gjatë tre muajve të fundit të vitit në raportim ka proceduar mbi 2 mijë kërkesa të kreditorëve dhe ka lëshuar mbi 200 vendime.

Pjesë e raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe pasqyrat financiare të të hyrave dhe fondeve në mirëbesim dhe dispozitave në fuqi. Këto raporte paraqesin tabela me informacione dhe shifra të sakta, të cilat i përmbushin të gjitha standardet e raportimit financiar dhe të auditimit.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka audituar raportin për pasqyrat vjetore financiare të fondit për vitin 2012. Zyra e Auditorit të përgjithshëm ka konfirmuar se AKP-ja i ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm dhe e ka paraqitur raportin brenda periudhës kohore. Sipas të njëjtit raport, pasqyrat rrjedhëse të parasë prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të pagesës për shpenzimet profesionale të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore të privatizimit në vlerë prej 1 223 009 euro, që sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është bërë pa bazë ligjore dhe si rrjedhojë është cilësuar si opinion i kualifikuar.

Duke qenë i interesuar për punën e agjencisë dhe në aspektet tjera që ndërlidhin raportet financiare dhe të auditimit, jam i interesuar që të mbledh më shumë informacione në lidhje me këtë raport.

Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka shpalosur këtë shumë të konsideruar me informatat që ia ka dhënë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm gjatë procesit të auditimit sipas ligjit në fuqi dhe ka fakte për këtë gjë. Për këtë arsye, agjencia i është drejtuar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me një shkresë në të cilën kërkonte t'i dinte arsyet nëse ky ka qenë një lëshim teknik dhe përse kjo çështje nuk është shtjelluar në takimet paraprake të zyrtarëve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me përfaqësuesit e agjencisë.

Agjencia ka kërkuar që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të ndërmarrë hapa të nevojshëm për eliminimin e këtij gabimi teknik, në mungesë të të cilit raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të AKP-së do të duhej të ishte parakualifikuar, që është rangimi më i lartë i një raporti sipas standardeve të auditimit.

Raporti i përgjithshëm i përmbush të gjitha kriteret e një raporti komplet dhe me informacione të drejtuara për secilin aktivitet.

Agjencia i ka plotësuar obligimet e saj sipas autorizimeve dhe përgjegjësi të veta sipas Ligjit të AKP-së dhe ligjeve tjera të zbatueshme të miratuara nga po ky Kuvend i Kosovës.

Prandaj, konsideroj që AKP-ja për organizimin e ndërmarrë ka vepruar mirë pasi që ka marrë për bazë ligjet adekuate për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e

tija, ligji numër 04/L-035 neni 34, ku qartë ceket se shpenzimet paguhen nga fondet e ndërmarrjeve shoqërore ndërsa ajo e likuidimit është e rregulluar qartë me aneksin e Ligjit të AKP-së që ka të bëjë me likuidimi, neni 16, neni 40 pika 1.3.2 dhe pika 1.3.3. neni 41, neni 42 dhe neni 43. Pra, është zbatuar ligji në praktikë më të mira profesionale për likuidimin e ndërmarrjeve dhe detyrimisht shpenzimet e likuidatorit në të vërtetë administratorit të likuidimit mbulohen nga mjetet e ndërmarrjes në likuidim.

Prandaj, Agjencia të gjitha problemet që i ka duhet sa më parë t'i përmbyllë në kuptimin e asaj që të përmbyllë procesin e privatizimit me sukses dhe pa vonesa në mënyrë që të shpërndahen mjetet e grumbulluara për punëtorë dhe kreditorë tjerë të regjistruar dhe të përmbyllet një herë e mirë ky proces që është një ndër proceset më të rëndësishme ekonomike në Kosovë.

Siç e dimë, Kuvendi i Kosovës vitin e kaluar nuk e ka aprovuar raportin e AKP-së për vitin 2011 dhe se ky raport është aprovuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe për më tepër nuk ka dhënë asnjë arsyes për mos aprovimin e tij apo ndonjë rekomandim për përmirësim. Me këtë Kuvendi ka treguar tendencë politizimi për çështjen e një rëndësie më të madhe se politika ditore e cila është zhvillimi ekonomik dhe progresi i Kosovës.

Prandaj, unë mendoj, të nderuar deputetë, që duhet ta inkurajojmë këtë institucion që të vazhdojë në kryerjen e punëve të saja ligjore për të zgjedhur një herë e mirë çështjen e pronësisë së ndërmarrjeve shoqërore, të mundësojë rritjen e investimeve dhe rrjedhimisht rindërtimeve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, që është e rëndësishme jetike për ne në këtë fazë të shtetit në ndërtim e sipër.

Duke i dëgjuar kolegët e mi deputetë, kam vërejtur atë që i ngatërrojnë periudhat, flasin për periudha të ndryshme, nuk flitet për periudhën raportuese, objekt trajtimi i cili është sot në Kuvend. Flitet edhe për 20% për një vendim të cilin është marrë në këtë kohë nga AKP-ja, po të mos merrej ky vendim për shpërndarjen e përkohshme të 20% për punëtorët nga ato ndërmarrje të cilat janë shitur, kompetenca apo ligji të cilin e ka aprovuar ky Parlament, domethënë Ligji për Odën e Veçantë ishte dashur me prit 200 vjet për t'u shpërndarë 20%. Po mos të ishte ndryshuar ligji që duhet të caktojë një likuidator për likuidimin e 650 ndërmarrje, se fjala është për 650 ndërmarrje që duhet të jetë një vlerë diku rreth 1 miliardë, prandaj ky 20 milionësh që e përmendni ju ka të bëjë me një shumë për afërsisht 1 miliard, ka të bëjë me mbi 100 mijë vendime, po kjo mos të ndodhte atëherë procesi i likuidimit do të zgjaste përmbi 260 vjet. Po, po matematikisht i llogaritur me ato ligje.

Prandaj, kjo agjenci, me gjithë problemet që i ka për bordin, për menaxhmentin e krejt, ka bërë edhe punë të mira të cilat i kanë hyrë në shërbim këtij vendi dhe vlerën duhet njohur si vlerë, po kritikën duhet bazuar në kritikë që ka të bëjë brenda raportit për këtë periudhë...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: 10 minuta i ke pasur. A ta ka përmendur emrin? I është referuar fjalës tënde. Mirë, replikë 2 minuta.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, fjalën deputetit Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Naseri iu referua fjalës sime në kohë të ndryshme, unë e kërkoja një diçka që e kërkojnë të gjithë qytetarët, Naseri ka qenë anëtar i bordit dhe akoma nuk ka dhënë një sqarim pse janë djegur nga kalimi nga AKP në AKM, janë djegur dhe zhdukur me qindra- mijëra dokumentacione të shitjes së ndërmarrjeve publike dhe akoma nuk kemi një sqarim pse është djegur gjithë ai dokumentacion. Naseri ka qenë anëtar i bordit, ndoshta sot mund të na thotë diçka.

E dyta, tha se AKP-ja ia ka dërguar një letër auditorit për ta ndryshuar opinionin e auditorit. Si ka për ta ndryshuar opinionin e auditorit kur ligji për prokurim publik nuk lejon që në ofertën që bordi i drejtorëve, drejtorët e bordit të AKP-së të marrin pjesë në vlerësim të një tenderi, prandaj e gjetura është mu aty, sepse ata kanë marrë pjesë dhe e gjetura tjetër është te pagesat që e kanë prekur Fondin e Mirëbesimit dhe nuk ka si të dalë raporti ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Naser Osmani, një minutë.

NASER OSMANI: Nuk i jam referuar fjalës së tij, po ajo që ai e përmend ka ndodhur 4 vjet para se të shkoj unë, në kohën e AKM-s, kur ka qenë Ahmet Shala, jo Naser Osmani. Dhe gjërat për të cilat përfolën unë jam vetëm i obliguar të them ka shumë për folje, është krijuar një mit i keq për atë institucion dhe institucioni ynë Kuvendi duhet me ndërmarrë diçka. Duhet ndërruar atë bord për të dhënë një shembull të mirë të atij institucioni për arsye se është krijuar aty një perde e zezë sa atje edhe po të shkojë peygamer njëri hajn ka me dalë. Ky është perceptim i qytetarëve që e kanë bërë politikanët vetë.

Prandaj, kryetar, ka raport për vitin 2012 dhe deputetët kanë obligim t'i referohen raportit për vitin 2012. Çdo gjë që ka brenda këtij raporti le të thuhet, por jo të flitet për krejt periudhën nga 2002 deri në 2013 për AKP nuk është korrekte dhe nuk mund të zgjidhim problemin.

KRYETARI: Jam dakord, e kemi në diskutim raportin për vitin 2012 dhe vërtet diskutimet duhet të reduktohen në raportin e vitit 2012. Nëse deputetët donë ta zgjerojnë, atëherë mund të merremi me një debat për krejt procesin e privatizimit dhe kjo është diçka tjetër.

Kuvendi ka të drejtë të kërkojë edhe një auditor të kombinuar ndërkombëtar dhe vendor që t' i auditojë të gjitha privatizimet, por kjo është e drejtë e Kuvendit dhe këtë duhet ta kërkon, por sot e kemi raportin për vitin 2012.

Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuara ministër,

Të nderuar kolegë,

Tani veç u thanë shumë dhe unë pajtohem se duhet të kthehemi brenda materies, sepse për kaq minuta sigurisht që nuk mund t'i themi të gjitha.

Pra, unë do të filloj nga një konstatim edhe duke e shqyrtuar raportin e këtij viti me plot bindje them se Kosova e ka pasur modelin më të pasuksesshëm të privatizimit dhe menaxhimit më të keq të privatizimit jo veç në regjion, po kudo që flitet për këtë proces, fatkeqësisht dhe nuk e ka treguar arsyeshmërinë më të vogël për pronën e vet. Njëherë është mjaftuar se ka pak kompetenca e pastaj ka hyrë në një inercion që në njëfarë forme asnjëherë nuk ka diskutuar se cili është interesi i asaj prone dhe si mund të valorizohet ajo pronë. Një proces i cili as nuk ka mbetur si privatizim komercial, do të thotë që të shiten sa më shtrenjtë pronat, sepse na demanton realiteti, as nuk ka qenë privatizim stimulues që jepet prona më lirë, mirëpo përfiton në punësime, investime dhe forma tjera, fatkeqësisht, dhe ky është realiteti.

Dhe duke u bazuar në këtë unë mendoj se të gjeturat e Komisionit duhet të implementohen në tërësi, sepse janë të gjitha të gjetura mirë të analizuara dhe janë në interes të funksionimit të mirë.

Mirë e ka profesor Muhameti, pajtohem me profesor Muhametin. Ndërsa, vazhdojmë. Dhe jo këtë herë, por pat edhe tjerë. Ndërsa, po ta shtrojmë një pyetje shumë të thjeshtë. Ne kemi nevojë për funksionimin e institucioneve të pavarura që është e vërteta ua kemi dhënë emrin, sepse atëherë kur të bëhen të pavarura edhe do të sillemi sikur të jenë të pavarura, se s'janë të pavarura hiq.

Sido që të jetë, në çdo shërbim shteti dhe qytetari ka të drejtë ta shtrojë një pyetje: sa më kushton ky shërbim? Po ta analizojmë, sa i ka kushtuar Kosovës shërbimi i AKM-së dhe tash i AKP-së, seriozisht nuk e di a arsyetohet ajo punë. Prej shpenzimeve që kanë ndodhur deri edhe te konsulencat e ndryshme.

Pastaj, a ka diçka më qesharake se sa një institucion kaq serioz jep paga nga kategoria mallra e shërbime? Nuk po më çudit pse ata kanë dashur, mua po më çudit që kanë mund të realizojnë. Cili ka qenë ai institucion financiar që e ka miratuar që pagat të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime, që është një shkelje eklatante dhe që kudo një institucion më të vogël për ta dëgjuar një diçka të tillë është edhe një herë për me të dhimb. Dhe edhe një herë tregon që në Kosovë më së paku kujdesemi për ta zbatuar ligjin.

Ndërsa, tani kjo pagesa, qoftë e kompanisë për falimentim ose i themi mbështetje, konsulentë si do që ta themi, përafërsisht kap shumën 20% e vlerës e unë po them shpyqyr që s'na i menaxhojnë furrat e bukës, se s'di çka kishim bërë.

20% të vlerës na i dhamë të na ndihmoj dikush t' i falimentojmë ndërmarrjet, ndërsa qe sa vite, qe 10 vjet ne kemi institucione, veç t'i marrim e t'i këqyrim sa trajnimet, aftësimet, udhëtimet jashtë vendi, sa pagat merren aty dhe ne tash në vend që të paguajmë një konsulent për një përvojë të mirë diku, hiq më pak se 17 milionë paguajmë kompani për falimentim. Sado që të jetë kredibile ajo, sado që të jetë e licencuar, unë

mendoj që 20% e shumës së vlerës totale është shumë, edhe nëpër procese prodhuese edhe kjo s'ishte dashur të jetë, sepse nga koncentratit deri në metal të pasur kushton 15% e merre me mend cili është ky çmim.

Ndërsa po aq e çuditshme, aq më e çuditshme është që duke ditur se ne jemi duke e pritur ligjin për "Trepçën", atje dikush ngutet dhe për herë të dytë, edhe pse ka pasur një studim, për herë të dytë paguan 9 milionë ndërmarrje konsulente për ta bërë studimin e "Trepçës", pavarësisht a e quajmë riorganizim apo e quajmë ri sistemim në çfarëdo forme dhe atë ndoshta në prag të një muajve kur na duhet ta aprovojmë ligjin. Pse nuk ia lëmë atë atyre për të cilët ne do ta bëjmë ligjin, pra ne po angazhohemi që të krijojmë një autonomi për "Trepçën".

(Ndërrhyrje)

A bën t'ju kërkoj falje këtyre që po ua prishi qetësinë? Po vazhdojmë, kështu që do të thotë, ky veprim i AKP-së që të paguajë ndërmarrje konsulente për ta analizuar, për të punuar të njëjtën që është paguar, që është e vërteta, në kohën e UNMIK-ut është qesharake dhe kjo vërtet s'ishte dashur të lejohej.

Dhe unë në fund po them që përveç se e kemi pasur një model aspak efikas, një menaxhim më të keqin, një kosto tepër të madhe për këto shërbime, unë mendoj se po vazhdon avazi: shpenzo sa të duash se s'ka kush të merret me neve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

U thanë shumë çështje dhe unë do të provoj të jem shumë i shkurtër, vetëm do të ngre një tri shqetësime që kanë të bëjnë me raportin e AKP-së dhe me funksionimin e deritanishëm të AKP-së.

Çështja e parë është inicimi i procedurës për riorganizimin e "Trepçës". E tha edhe deputeti më herët Ferati, mirëpo të gjithë deputetët këtu jemi pajtuar që të kemi një ligj të veçantë për "Trepçën", prandaj kërkesa e AKP-së për të filluar a jo me një pagesë të planifikuar të shumës për riorganizimin e "Trepçës" prej 9 milionë do të ishte mirë që atë 9 milionëshin AKP-ja ta ruante për të investuar në "Trepçë" dhe mos ta përdorte për riorganizimin e saj për arsye se ne vetëm kemi bërë më herët një ligj për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara që në fakt ka qenë Ligji për "Trepçën" dhe përkundër kësaj prapë kemi vendosur që të bëjmë një ligj të veçantë për "Trepçën" dhe unë mendoj që me anë të atij ligji ne do të zgjedhim në aspektin juridik çështjen e "Trepçës" dhe kjo kërkesë e AKP-së duket tepër e pa vend.

Çështja tjetër ka të bëjë me AKP-në kur ajo ka filluar të prekë prapë apo të futë duart në fondin e mirëbesimit, të parën punë që është dashur ta bëjë AKP-ja në këtë rast atëherë nëse ka pasur guximin t'i futë duart në aspektin juridik në Fondin e mirëbesimit, është dashur të marrë një vendim për shlyerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Ferizajt. Pra një kohë të gjatë punëtorët e Fabrikës së Tubave të Ferizajt kanë

kërkuar edhe këtu në Kuvend edhe para Kuvendit, edhe para Qeverisë, edhe para AKP-së me dhjetëra herë shlyerjen e obligimeve ndaj tyre dhe AKP-ja është arsyetuar çdo herë se nuk ka të drejtë të prekë në Fondin e mirëbesimit për t'i shlyer obligimet dhe nuk ka të planifikuar mjete për shlyerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Ferizajt. Dhe gjithsesi edhe në aspektin juridik këtu bordi i AKP-së ka bërë një shkelje, po edhe në aspektin etik dhe moral ka bërë prapë shkeljen e dytë.

Dhe, çështja e tretë ka të bëjë me bordin e AKP-së. Shihet qartë se kemi probleme me funksionimin e bordit dhe me vendimet që i merr bordi dhe me kompletimin e atij bordi.,

Unë dua vetëm t'iu rikujtoj kur në fillim të mandatit kemi shqyrtuar plotësim-ndryshimin e ligjit për AKP-në, në atë kohë kam propozuar disa amendamente, disa prej tyre kanë ardhur edhe këtu në seancë, disa të tjera janë marrë në konsideratë nga Komisioni, mirëpo disa tjera nuk janë shqyrtuar. Kryesisht ato amendamente në atë periudhë kohore kanë pasur të bëjnë me funksionimin e bordit dhe atëherë kam thënë se në formën se si është propozuar në ligj funksionimi i bordit, parashihet një perandori. Kanë thënë roli i këtij bordi është roli i një perandori dhe tani po shihet që këtë rol vetëm sa e ka fuqizuar bordi i AKP-së dhe si i tillë është sjell deri më tani pa marr në konsideratë edhe Ligjin për AKP-në, por edhe ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

Dhe, gjithsesi në fund dua të kërkoj që një pjesë e këtij raporti, te rekomandimet, të jetë: obligohet bordi i AKP-së që në afat sa më të shkurtër kohor t'i paguajë detyrimet ndaj punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Ferizajt, Kuvendi i Kosovës obligon bordin e AKP-së që këtë detyrim financiar ta kryejë nga Fondi i mirëbesimit të AKP-së, pasi veç ka filluar të prekë në Fondin e mirëbesimit. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. Të pranishëm janë 70 deputetë. Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012, bashkë me rekomandimet e Komisionit Funkcional dhe të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 19 vota për, 38 kundër dhe 5 abstenime, nuk miratohet raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.

(Ndërhyrje)

Nuk është punë imja, por është dashur të përcaktohet me ligj ose diku, ose duhet të jetë në moralin e njerëzve që i udhëheqin bordet e kompanive të ndryshme që nëse nuk shkon, nuk miratohet raporti ata të japin dorëheqje. Por, kjo tek ne nuk po ndodh, kështu që ne si votuam për, si kundër, gjë s'po merret vesh në këtë punë.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E mora fjalën në lidhje me pikën 7 - Shqyrtimin, realisht debatin parlamentar mbi raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013, që jemi iniciues.

Kisha kërkuar mirëkuptim nga kolegët deputetë dhe nga ju për shkak se është mot i ligë dhe është ora 17:00, është vonë dhe ky është një ndër raportet më të rëndësishme që kërkon edhe vëmendje për t'u diskutuar dhe për të nxjerrë rekomandime dhe konkluzione përkatëse. Pra, më qe është edhe vonë dhe shumë deputetë kanë për të udhëtuar, kisha propozuar ta shtyjmë për nesër në orën 10 dhe edhe një herë kisha kërkuar që këtë propozim ta përkrahin edhe kolegët tjerë deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Për çështje procedurale e kërkoja fjalën. Edhe po të mos kërkohej kjo e kisha ndërmend të shtroj këtë çështje, edhe raportet që e shqyrtoam dhe e votuam pak përpara tregojnë që ka një defekt në qasjen tonë ndaj raporteve dhe debateve.

Prandaj, unë e mbështes kërkesën për ta shtyrë këtë, por mendoj që s'mjafton vetëm kaq. S'dua t'u marr kohë se jemi vonë, por nisma që meriton të përshëndetet është mirë, ka defekte edhe procedurale. Është një çështje që i përket gjithë Kuvendit, është Komisioni për Integritet Evropian që e mbulon këtë çështje. I duhet çdo raporti, çdo debati së pari një letër që të shqyrtohet dhe pastaj mbi këtë bazë edhe të bëhet shqyrtimi i mëtejshëm. Duhet të propozohen rekomandimet që shikoheni, ju lutem, nuk u janë rekomandime, kurse në debat nuk mund t'i kthejmë në rekomandime as në rezolutë. Na ndodh kjo që na ndodhi me shqyrtimin e përparshëm. Të gjitha ato vërejtje, të gjithë pajtohen, por raporti miratohet pa i inkorporuar vërejtjet, prandaj raportet tona nuk shpien gjëkund.

Propozoj që të shtyhet, por jo për nesër, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në cilën t'i shpërndahet raporti nga Ministria përkatëse për Integritet Evropian dhe Qeveria, të shqyrtohet në Komision, Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit dhe të krijohet mundësia që të funksionojmë siç funksionon e gjithë bota.

E kemi pasur një moto "Edhe ne si gjithë Evropa", dhe le të funksionojmë siç funksionon Evropa. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar edhe kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se deputetja Donika Kadaj-Bujupi me deputetët kanë kërkuar debat, jam për ta përkrah që debati të vazhdojë nesër, nëse ministrja është e lirë prej orës 10 dhe kisha bërë një apel te ministrja që t'u thotë edhe ministrave tjerë që të jenë në debat se Raporti i Progresit është për gjithë Qeverinë nuk është veç për ministren Vlora Çitaku.

KRYETARI: Edhe deputetja Blerta Deliu-Kodra e ka kërkuar fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë pajtohem meqë Donika Kadaj është edhe iniciuese e debatit për Raportin e Progresit për Kosovën, atëherë le të shtyhet, mirëpo nuk e di për nesër apo për ndonjë afat të pacaktuar, ajo që duhet thënë është se ne si Komision për Integritet e kemi

shqyrtuar këtë raport dhe raporti është në ueb-faqen e Ministrisë për Integritet. Nuk e di nëse e kanë marrë deputetët tjerë, sepse ne të Komisionit veç e kemi raportin. Dhe, kështu po pajtohem me atë që e tha Myzejane Selmani, sepse njëra prej sfidave dhe vërejtjeve kryesore të raportit është mungesa e ministrave gjatë seancave parlamentare. Mendoj se është mirë që gjatë seancave të ardhshme ku diskutohet Raporti i Progresit për Kosovën, të jenë ministrat dhe ekzekutivi në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu i kemi dy kërkesa tash, kërkesën e Donikës për nesër, debatin, po mendoj që duhet ta kemi parasysh edhe kërkesën e deputetit Hydajet Hyseni.

(Ndërhyrje)

Atëherë, ju a jeni që të shkojmë për nesër me debatin? Atëherë, e kemi kërkesën e propozueses dhe me një votim formal, kush është që debati të vazhdojë nesër?

Faleminderit! Kush është kundër? Pra, me shumicë të votave u vendos që seanca të vazhdojë nesër në orën 10:00.

* * *

E premte, 20 dhjetor 2013

Vazhdim i mbledhjes plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
E nderuar ministre e Ministrisë së Integritetit Evropian,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar dje, më 19 dhjetor 2013.

Konstatoj se për ta filluar debatin kemi numër të mjaftueshëm deputetësh dhe po fillojmë menjëherë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Debat parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e vitit 2013

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka kërkuar debat parlamentar lidhur me të gjeturat dhe sfidat në Raportin e Progresit për Kosovën, i miratuar nga Komisioni Evropian, më 16 tetor 2013.

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të përgatitë dhe Kuvendit t'i paraqesë një informatë lidhur me të gjeturat dhe sfidat e Raportit të Progresit për Kosovën.

Qeveria e ka dërguar këtë informatë në Kuvend. Sipas procedurës ftoj deputeten zonjën Donika Kadaj-Bujupi që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në cilësinë e propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

E nderuar ministre,

Kolegë deputetë,

Realisht të gjeturat e këtij raporti implikojnë dikasterë të shumtë të Qeverisë e ndoshta më së paku Ministrinë e cila e koordinon këtë proces, po e cila edhe dje gjatë gjithë ditës dhe sot po shihet që ka mbetur e vetme.

Sidoqoftë kjo tregon që edhe ky raport ka ra në veshë të shurdhër sa i përket Qeverisë.

Gjatë vitit 2013, por edhe më herët Raporti i Progresit për Kosovën shpërfaq dy aspekte të cilat përshkruajnë mënyrën e qeverisjes Thaçi. Aspekti i parë është dëgjueshmëria e pafund dhe lëshimi pe i Qeverisë dhe i kryeministrit Thaçi gjatë të gjitha proceseve politike të cilat gradualisht Kosovën e kanë sjell në pikën kur rrezikohet seriozisht funksionimi i shtetit. Duke instaluar mekanizma shtesë të pushteteve të cilët nuk janë integruar, për më tepër janë paralel. Dhe këto të fundit dua ta përmend asociacionin të cilit kryeministri Thaçi po i referohet si OJQ, por po dua të theksoj se themelimi i OJQ-ve nuk është subjekt i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe nëse është i tillë atëherë do të përbente dhe do të paraqet rrezik dhe ky nuk do të jetë rreziku i vetëm të cilin keq-qeverisja e Qeverisë Thaçi ia ka sjell vendit.

Dhe kjo qasje shpeshherë mundohet të shitet në opinionin publik dhe para qytetarëve të Kosovës si një bashkëpunim i mirë me miqtë tonë ndërkombëtarë, gjë që në aspektin e dytë të mënyrës se si qeveris Qeveria Thaçi dhe kryeministri, nuk tregohen aspak të tillë. Nuk janë aspak bashkëpunues, përkundrazi janë shumë këmbëngulës dhe rezistues dhe vazhdojnë me të vjetrën, sidomos në fushat e përmendura edhe këtë vit si dobësi e qeverisjes Thaçi, pa ndonjë përmirësim, të nderuar kolegë, përkundër kërkesave të shumta dhe rekomandimeve vjetore edhe në këtë raport nuk janë marrë parasysh sundimi i ligjit, krimi i organizuar dhe korrupsioni që po e hanë vendin.

Dhe si pasojë e këtyre dy të parave, niveli i zhvillimit ekonomik është çdo vit më i ulët dhe krejt çka po rritet në këtë vend është varfëria.

Në Raportin e Progresit të vitit 2013, institucioneve të Kosovës i është kërkuar që t'i orientojnë politikat publike në adresimin e sfidave që lidhen me sundimin e ligjit, me funksionimin demokratik të institucioneve dhe zhvillimin tutje të agjendës evropiane, që do të thotë, konstatim i këtij raporti është që Kosova ende po ballafaqohet me pamundësinë dhe paaftësinë e institucioneve të saj për të treguar rezultate edhe në ushtrimin e funksioneve themelore të shtetit.

Në këtë kuptim, raporti e qartëson që janë pikërisht këto probleme që Kosovës i pamundësojnë dhe vazhdojnë të pamundësojnë liberalizimin e vizave dhe do ta shtyjnë ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Përfundimet që i nxjerr ky raport janë shqetësuese dhe kërkojnë nga institucionet e Kosovës që sa më parë t'i adresojnë çështjet në vijim.

Për Kuvendin, Kosova duhet ta finalizojë reformën elektorale duke siguruar që t'i përfshijë praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe reforma elektorale

nuk duhet të jetë çështje formale, përmban një karakter të veçantë në vlerësimin e gatishmërisë së Kosovës për të treguar rezultate konkrete e jo improvizime.

Ajo çka kemi parë deri tash më shumë është marrëveshje politike se në fakt një reformë esenciale e ligjit ekzistues.

Mbikëqyrja e Qeverisë nga Kuvendi duhet të përmirësohet dhe kjo çka po shohim prapa sot është që me të vërtetë nuk ka vullnet politik që Qeveria t'i japë llogari Kuvendit për asnjë pikë ose asnjë veprim të saj.

Institucionet e pavarura të themeluara në këtë Kuvend dhe unë duhet të ritheksoj që jemi Kuvendi që ka më së shumti në Evropë institucione të ashtuquajtura të pavarura, të cilat themelohen nga Kuvendi, përfaqësuesit e tyre zgjidhen në Kuvend, por komplet kontrollohen nga Qeveria dhe përderisa e kemi këtë gjendje është krejt e pamundur të besojmë që do të kemi institucione dhe agjenci të pavarura.

Rasti i fundit do të thotë lidhet me shqetësimin e Raportit të Progresit në mënyrën se si Qeveria e trajton Kuvendin në rastet e veçanta dhe shumë të rëndësishme, siç është rasti i buxhetit, rasti i Postës kur përkundër shkeljeve të shumta të procedurave mundohet me çdo kusht të instalojë forma të presionit ndaj deputetëve me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe përpjekjeve që janë jashtëzakonisht të dëmshme për vendin. Do të thotë vazhdojmë të jemi vendi me mungesë të transparencës duke shtyrë Qeveria përmes presionit agjenda të dyshimta në Kuvend.

Pika e tretë e këtij raporti thotë: Qeveria duhet të tregojë rezultate konkrete në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, të fuqizojë legjislacionin në këtë fushë si dhe të zbatojë atë. Dhe në fakt arsyeja kryesore që Kosova nuk e merr ende liberalizimin e vizave ka të bëjë pikërisht me krimin e organizuar dhe korrupsionin në këtë vend.

Dhe pas këtyre të gjeturave që janë përditshmëri e këtij vendi, nuk mjafton që të themelohen këshilla që takohen një herë në vit dhe konstatojnë të gjeturat e raportit, konstatojnë që korrupsioni po e shkatërron vendin, ndërkohë që rreth tryezës janë përgjegjësit kryesorë për ta luftuar korrupsionin e që fatkeqësisht janë edhe protagonistët në të shumtën e rasteve dhe me disa përjashtime të kësaj dukurie.

Shqetësimi tjetër i theksuar ose e gjetura tjetër në këtë raport është interferimi i politikës në gjyqësor, thotë mbetet një problem serioz. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial duhet t'u përgjigjen akuzave ndaj gjyqtarëve, ndaj prokurorëve dhe institucioneve gjyqësore, të njëjtën gjë duhet ta bëjë edhe Qeveria edhe Kuvendi.

Duhet të ndërmarrë masa shtesë për të ulur numrin e rasteve të papërfunduara në gjykatë. Dhe është tepër e pakuptimtë kur pas këtyre të gjeturave, zyrtarët e lartë të Qeverisë dhe ministrja e Integritetit kërkon që EULEX-i të largohet nga Kosova.

Nganjëherë kjo kërkesë lidhet me njëfarë përpjekje që të tregohemi sa më patriotë, por mendoj që patriotizmi dhe korrupsioni janë dy gjëra që nuk shkojnë bashkë.

Prandaj Kosova duhet të mbështesë EULEX-in në implementimin e mandatit të tyre dhe kërkesat për largimin e tij janë të pavend dhe mund të dëmtojnë Kosovën në këtë aspekt,

për faktin e thjeshtë se kjo Qeveri me prokurorë dhe gjyqësorë të kontrolluar, nuk do të mund të luftojë korrupsionin, sepse kështu i bie ta luftojë vetveten.

Prandaj, thashë edhe një herë, jam shumë e befasuar me deklaratat e zyrtares së lartë të Qeverisë që EULEX-i duhet të shkojë. Dhe edhe një herë po them që patriotizmi në këtë rast nuk shitet për faktin e thjeshtë se atdhedashuria nuk mund të jetë e tillë nëse keqpërdorim, nëse e korruptojnë këtë vend dhe nëse e çojnë drejt shkatërrimit përmes vënies së interesave tona para interesave të shtetit.

Zhvillimi ekonomik është diçka që derivon nga të gjitha këto pika të lartpërmendura si përkeqësim i rritjes ekonomike, thotë raporti. Eksporti i mallrave është përkeqësuar dhe investimet e huaja neto kanë rënë në nivelin më të ulët, po e theksoj që nga viti 2005, që nënkupton që gjatë gjithë këtyre periudhave dhe në gjashtë vjetët e pavarësisë së Republikës së Kosovës, vazhdojnë prej viti në vit të degradojnë sa i përket zhvillimit ekonomik, sa i përket mirëqenies së qytetarëve dhe sa i përket punësimit.

Përtej kësaj Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në vijim përmes deputetëve të vet do të prezantojë edhe të dhënat sektoriale veç e veç, të gjetura në raport dhe do të japim rekomandimet vijuese veç e veç, mirëpo për fat të keq këto rekomandime, po e theksoj edhe një herë, po shihet që nuk ka gatishmëri ose vullnet politik të zbatohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila madje as nuk është e pranishme që t'i dëgjojë deputetët gjatë diskutimeve të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të kalojmë në diskutimet tjera dua t'ju informoj, të nderuar deputetë, që në bazë të vendimit dhe procedurave të ndjekura nga të gjitha institucionet e vendit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kryetari i Parlamentit, presidentja e vendit, në bazë të vendimit të presidentes së Republikës së Kosovës të datës 18 dhjetor 2013, pas dorëheqjes së deputetit Idriz Vehapi, për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga lista e PDK-së, caktohet deputeti Haxhi Shala.

Deputeti i porsazgjedhur është në sallë dhe i dëshirojmë punë të mbarë. Ftoj deputetin që ta nënshkruajë deklaratën e betimit. Faleminderit!

Sipas radhës përfaqësuesja e Qeverisë e ka fjalën, zonja Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush të raportoj rreth të gjeturave të Raportit të Progresit 2013. Raporti i Progresit në fakt është vlerësim i punës së të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës.

Procesi i integritetit evropian është shumë kompleks dhe me shumë sfida. Integriteti drejt strukturave të Bashkimit Evropian nuk matet me vite as me afate kalendarike, por me rezultate dhe nga praktika mund të vërejmë se disa shtete kanë ecur më shpejt e disa të tjera më ngadalë.

Raporti i Progresit 2013 nga Komisioni Evropian e paraqet gjendjen reale dhe faktike të zhvillimeve njëvjeçare në Republikën e Kosovës duke evidentuar të arriturat dhe sfidat e të gjitha institucioneve.

Po e ripërsëris, Raporti i Progresit, nuk është dokument që skenon performansën e Qeverisë, por është dokument që analizon punën, rezultatet dhe sfidat në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës si hisedare e rëndësishme në këtë proces, deri në fund të këtij muaji, do të miratojë planin e rishikuar të veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me qëllim të planifikimit të të gjitha aktiviteteve konkrete dhe afateve kohore për adresimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në përmbushjen e detyrimeve të saj, mirëpo Qeveria është vetëm njëra hallkë në zinxhirë. Ne besojmë që Raporti i Progresit gjatë 12 muajve të ardhshëm do të shërbejë si bazë për vazhdimin e zhvillimit të dialogut racional dhe konstruktiv ndërmjet aktorëve të ndryshëm në shoqëri dhe vazhdimin e konsensusit mbarëshoqëror për ndërmarrjen e reformave të thella politike, ekonomike dhe shoqërore.

Më lejoni tani, të nderuar të pranishëm, t'i adresoj disa nga gjetjet kyçe të Raportit të Progresit.

Funksionimi i Kuvendit dhe Qeverisë është karakterizuar me ngritje graduale të kapaciteteve në adresimin e prioritetëve të procesit të integritetit evropian, kjo është dëshmuar me përmbushjen e kritereve afatshkurtra dhe përgatitjeve që janë bërë për nisjen dhe mbarëvajtjen e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Sa i përket sistemit gjyqësor është miratuar pakoja ligjore, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për avokatinë shtetërore dhe Ligji për procedurën përmbarese.

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë miratuar strukturën e re të gjykatave dhe prokurorive dhe po ashtu është miratuar legjislacioni implementues sekondar.

Sa i përket reduktimit të lëndëve të vjetra në sistemin gjyqësor, është evidentuar progres.

Sa i përket sigurimit të lirisë së shprehjes janë amendamentuar dy nene të Kodit Penal me qëllim të evitimit të përgjegjësisë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimit të informatave të gazetarëve.

Po ashtu janë ngritur aktakuza kundër tre personave të dyshuar lidhur me sulmin në zyrat e revistës “Kosovo 2.0”. Në fushën e administratës publike duhet theksuar se Kosova ka përmbushur kriteret afatshkurtra të studimit të fizibilitetit duke miratuar legjislacionin sekondar dhe ligjet për shërbimin civil dhe pagat e nëpunësve civilë.

Po ashtu ka vazhduar sistematizimi dhe klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil.

Ndërkohë që për fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të flas në detaje, mirëpo tani po flas vetëm për infrastrukturën ligjore. Është bërë plotësim-

ndryshimi i Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, është hartuar Ligji mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë si dhe Ligji mbi parandalimin dhe luftimin me qenie njerëzore.

Janë miratuar katër strategji dhe plane veprimi në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të narkotikëve dhe parandalimit të krimit si dhe është miratuar plani strategjik për bashkëpunim ndërinstytucional për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po ashtu, është miratuar strategjia e re kundër korrupsionit dhe plani i veprimit.

Në fushën financimit të partive politike është evidentuar progres duke adresuar mangësitë e evidentuara me ndryshimet në Ligjin për financimin e partive politike.

Po ashtu, me Kodin e ri Penal, aktet e konfliktit të interesit dhe mosdeklarimit të pasurisë, trajtohen si vepra penale.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, Qeveria ka vazhduar angazhimin për realizimin e prioritetëve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, bazuar në vizionin dhe prioritetet për zhvillimin ekonomik 2011-2014.

Njëkohësisht Qeveria ka ruajtur stabilitetin fiskal dhe financiar të vendit. Në funksion të këtij objekti është implementuar me sukses Marrëveshja ‘stend bay’ me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Po ashtu Republika e Kosovës është bërë anëtare e plotë e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe e ka nënshkruar Marrëveshjen kornizë me Bankën Investive Evropiane.

Bruto-produkti vendor është rritur nga 4 miliardë e 768 milionë euro në vitin 2011, në 4 miliardë e 916 milionë euro, në vitin 2012.

Në pjesën e parë të vitit 2013 eksportet kanë performuar mirë duke u rritur 5,2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nga kjo eksporti për në vendet e Bashkimit Evropian ka shënuar rritje 4%, ndërsa deficiti i llogarisë rrjedhëse është zvogëluar dukshëm nga 13,8%, në vitin 2011, në 7,7% në vitin 2012.

Investimet e huaja kanë shënuar rritje nga 4,4% e bruto-produktit vendor në vitin 2010, në 10% të bruto-produktit vendor në pjesën e parë të vitit 2013.

Sa i përket mbledhjes së të hyrave nga tatimet dhe doganat krahasuar me vitin paraprak, është rritur shkalla e grumbullimit të të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës, 8,9% rritje dhe Doganat, 2% rritje.

Sigurisht që raporti ka evidentuar edhe shumë sfida, siç po i quajmë me eufemizëm. Ne jemi të vetëdijshëm që puna drejt anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, vetëm sa ka filluar, nuk ka përfunduar. Procesi i integritit evropian nuk është proces negociimi,

procesi i integritetit evropian është proces i brendshëm transformimi i cili merr kohë dhe i cili kërkon përkushtim jo vetëm nga Qeveria, por nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Është e qartë që rekomandimet e Komisionit Evropian në këtë pikë janë të qarta. Nga ne kërkohet përmbyllja e reformës zgjedhore, përmbyllja e reformës së administratës publike dhe fuqizimi i institucioneve të pavarura në fushën e rendit dhe ligjit.

Padyshim, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet një ndër sfidat kryesore me të cilën do të ballafaqohet Kosova në vitet në vijim. Është e qartë që kjo është sfidë për të gjitha vendet që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Mu për këtë arsye Komisioni Evropian ka vendosur që kapitulli 23 dhe kapitulli 24 që mbulojnë fushën e rendit dhe ligjit, të jenë kapitujt e parë me të cilët do të hapen negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe kapitujt e fundit që do të mbyllen para anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Unë ju ftoj që sot të kemi një debat konstruktiv, të mos i drejtojmë gishtin njëri-tjetrit, punë ka për të gjithë, edhe për Qeverinë, edhe për Parlamentin, edhe për institucionet e pavarura, edhe për shoqërinë civile, ta lexojmë Raportin e Progresit drejt ashtu siç është i shkruar, Raporti ka evidentuar progres, hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit nuk është dhuratë që i është bërë Kosovës, është rezultat i përmbushjes së kriterëve afatshkurtra dhe afati kalendarik shumë ambicioz.

Ne tashme i kemi përmbyllur dy runde të negociimit dhe rundi i tretë dhe final i negociatave për MSA është në muajt e parë të vitit të ardhshëm, në pranverë siç edhe deklaroi para pak ditësh komisionari Fyly, ne presim që t'i përmbyllem negociatat dhe të nënshkruajmë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila sigurisht para se të nënshkruhet do të vijë për ratifikim këtu në Parlamentin e Kosovës.

Unë e kam edhe një raport të detajuar për rezultatet e institucioneve të rendit dhe ligjit dhe nëse kryesuesi më jep kohë edhe 10 minuta, unë do të kisha raportuar për të gjeturat ose mund ta marr fjalën më vonë, sepse janë të dhëna komplete nga institucionet e prokurorisë dhe gjyqësisë. Kryesues, a mund ta kem?

KRYESUESI: Për 5 minuta!

MINSITRJA VLORA ÇITAKU: Për pesë minuta! OK!

Atëherë më lejon t'ju njoftoj se prokuroritë kompetente për të gjitha grupet e veprave penale gjatë periudhës raportuese kanë adresuar gjithsej 1 233 kallëzime penale, me 3 152 persona të dyshuar. Prej tyre 577 kallëzime penale kundër 1 771 personave kanë qenë të trashëguara nga viti i kaluar, ndërsa vetëm gjatë tri kuartaleve të këtij viti prokuroritë e vendit në punë kanë pranuar 656 kallëzime penale me 1 381 persona të dyshuar.

Gjatë të njëjtës periudhë raportuese prokuroritë kanë zgjidhur 400 kallëzime penale, me 883 persona të përfshirë, ndërsa rastet tjera janë në shqyrtim e sipër.

Për veprat penale që kanë të bëjnë me narkotikë janë hetuar 381 raste me 634 persona, prej të cilave janë zgjidhur 168 raste, me 269 persona.

Gjatë kësaj periudhe Policia e Kosovës ka konfiskuar 495 kilogramë marihuanë, 22 kilogramë heroinë, 3 kilogramë kokainë dhe mijëra fije bimë kanabis.

Sa u përket veprave penale që kanë të bëjnë me kontrabandimin me emigrantë, deri në shtator të këtij viti janë hetuar 54 raste, me 179 persona të përfshirë, prej të cilave janë zgjidhur 22 raste dhe janë arrestuar 59 persona, ndërkohë që 21 janë lënë të lirë dhe 38 janë nëpër procedura në gjykatat e vendit.

Për veprën penale që kanë të bëjnë me trafikim me njerëz janë adresuar gjithsej 59 raste, me 216 persona të përfshirë prej të cilave janë zgjidhur 28 raste me 129 persona dhe në trajtim e sipër janë 31 raste me 82 persona.

Sa i përket veprës penale që ka të bëjë me korrupsion dhe veprat penale kundër shpërdorimit të detyrës zyrtare, gjatë periudhës raportuese janë adresuar 628 raste me 1 676 persona, prej të cilave deri më tani janë zgjidhur plotësisht 151 raste me 301 persona.

Tek veprat penale që kanë të bëjnë me shpëlarjen e parave gjatë periudhës raportuese janë adresuar 53 raste me 206 persona të dyshuar prej të cilave janë zgjidhur plotësisht 28 raste me 98 persona, ndërkohë që janë në procedurë e sipër edhe 36 raste tjera.

Sa i përket kontrollit të kufirit në vendkalime janë regjistruar 10 milionë e 624 persona, 2 milionë e 814 vetura, kemi të dhëna të sakta me të cilat nuk dua t'ju ngarkoj, mirëpo dua t'ju siguroj që Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë çdo gjë që t'i përmbushë kërkesat e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial. Është kërkuar rritje buxheti. Nga ky vit do të kemi 25 prokurorë më shumë me 55 staf mbështetës dhe 30 gjyqtarë më shumë me 122 staf mbështetës. Janë rinovuar plotësisht 9 gjykata dhe është në ndërtim e sipër gjykata e re në komunën e Ferizajt.

Unë do të jem këtu që t'i dëgjojë vërejtjet, rekomandimet dhe sugjerimet në ndërkohë që për dialogun me Serbinë, e nderuara zonja Kadaj-Bujupi, mund ta thërrisni një seancë të veçantë, mund të debatojmë deri në detaje edhe për funksionin e asociacionit edhe për rolin e tij, sigurisht edhe nga zoti Shala që është koordinator i procesit dhe merr pjesë në të gjitha takimet, mund të merrni edhe informata të sakta dhe të drejtpërdrejta.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara ministre,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Raporti i Progresit për Kosovën ofron detaje lidhur me përparimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës si dhe vlerëson reformat që vendi ynë ka ndërmarrë karshi anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ashtu siç e tha edhe ministria Çitaku, në këtë përmbledhje të punës së institucioneve të Kosovës, ky komision ka vlerësuar se gjatë 12 muajve janë bërë përparime të konsiderueshme lidhur me perspektivën evropiane të Kosovës.

Raporti vlerëson angazhimin e Kosovës në dialogun me Serbinë duke theksuar se Kosova ka realizuar reforma të rëndësishme në politikë, sfidë kjo e cila është adresuar në Raportin e fizibilitetit të vitit 2012.

Sa i përket kapitullit mbi punën e Kuvendit thuhet se Kuvendi ka bërë hapa të përmirësimit të mbikëqyrjes së Qeverisë, si dhe ka ofruar më shumë transparencë karshi shoqërisë civile.

Debati parlamentar si dhe interpelancat e ministrave kanë marrë notë pozitive në Raportin e Progresit për Kosovën. Raporti po ashtu vë në pah edhe një mungesë të koordinimit sa i përket ekzekutivit të legjislativit, specifikisht këtu është fjala për rastet e pyetjeve parlamentare në të cilat deputetët e Kuvendit jo gjithherë kanë marrë përgjigjet e tyre nga ministrat, e nga këta të fundit kërkohet që ta respektojnë më shumë institucionin e Kuvendit.

Sa i përket punës së Qeverisë vlerësohet puna që është bërë për të adresuar prioritetet lidhur me procesin e integritetit evropian dhe kërkohet më shumë koordinim Qeveri-Kuvend për të përafruar legjislacionin me ‘*acquis communautaire*’.

Administrata publike është një fushë e cila thuhet se në këtë drejtim Kosova ka përmbushur kriteret afatshkurtra që kanë dalë nga studimi i fizibilitetit, kurse sfiduesë mbetet çështja e reformës administrative, vërejtje kjo e përhershme e Raportit të Progresit për Kosovën.

Lidhur me pagat e zyrtarëve të lartë nga Komisioni kërkohet legjislacion i ri që rregullon këto çështje si dhe kërkohet që të merren parasysh rekomandimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, pasi që ka pasur raste që këto rekomandime nuk janë marrë parasysh edhe për faktin se dihet mirëfilli se vendimet e Këshillit paraqesin edhe vendimin administrativ të formës së prerë.

Raporti vlerëson ndarjen e hapësirës së nevojshme dhe buxhetin shtesë për Ombudspersonin dhe kërkohet bashkëpunim më i madh me shoqërinë civile, si dhe vlerëson strategjinë e Qeverisë lidhur me bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Komisioni Evropian në këtë raport kërkon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit si dhe vlerëson pozitivisht strategjinë antikorruption dhe hetimin e disa rasteve nga Departamenti Antikorruption.

Agjencia kundër Korrupsionit ka vazhduar të punojë në parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka evidentuar mbi 800 raste të zyrtarëve publikë që mbajnë 2 vende pune e disa të tjerë që mbajnë deri në 5 vende të punës, e këtu rekomandohet që këta zyrtarë publikë të ndërpresin njëren kontratë të punës konform ligjit në fuqi.

Dua të përmend këtu së fundi një vendim të Universitetit të Prishtinës sipas të cilit profesorët që ka njëkohësisht dy kontrata të rregullta pune kanë zgjedhur njëren prej tyre meqë Universiteti i Prishtinës ka evidentuar gjithsej 60 profesorë që kanë nga 2 kontrata pune dhe mendoj se këtë praktikë duhet ta zbatojnë edhe institucionet tjera.

Sa i përket lirisë së shprehjes vlerësohet ndryshimi i dy neneve të Kodit Penal, ashtu siç e përmendi edhe ministrja Çitaku, do të thotë mbi përgjegjësinë penale të medieve, si dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Kemi pasur disa raste të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe kjo është adresuar si brengë. Rastet e fundit kanë qenë para disa ditësh kur një ekip i një televizioni është sulmuar për derisa po kryente punën e vet në shërbim të opinionit publik.

Dhe si çështje të fundit do të përmend pavarësinë e Komisionit të Pavarur që Medieve, meqë ne si pikë të rendit të ditës të fundit për sot e kemi shkarkimin e dy anëtarëve të këtij komisioni dhe në raport thuhet se ka qenë e penguar puna e komisionit nga mungesa e burimeve si dhe ndërhyrjeve politike, dhe sigurisht se ky i referohet decidivisht telasheve të shumta që ne si Kuvend kemi pasur lidhur me emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve, me ç'rast një ish-asamblist e ka shkelur ligjin dhe është emëruar kundërligjshëm si kryetar i Komisionit të Pavarur të Medieve.

Këto janë pika të shkurtra do të thotë të përmbledhura të Raportit të Progresit për Kosovën dhe ne presim që të kemi një debat konstruktiv. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ruajtja e kohezionit dhe unitetit politik në agjendën evropiane do të jetë thelbësore dhe parakusht për të arritur suksese në këtë proces të rëndësisë nacionale.

Deri tani përkundër sfidave të mëdha dhe ngecjeve të kohëpaskohshme në plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga ana e Komisionit Evropian, Kosova ka pasur fatin që të flasin pothuaj se të gjithë njëzëri sa i përket perspektivës evropiane të vendit. Por, ky konsensus nacional nuk mjafton. Nga raportet e përvitshme të progresit përkundër asaj që listojnë edhe disa përparime, ato në veçanti listojnë ngecjet, sfidat dhe kërkesat e Komisionit Evropian në raport me Kosovën dhe konfirmojnë siç u tha gjendjen reale në terren që institucionet e Kosovës e veçmas qytetarët e Kosovës e shohin çdo ditë, e ndjejnë çdo ditë dhe e përjetojnë atë.

Prandaj, edhe Raporti i Progresit për vitin 2013 vetëm e konfirmoi një realitet të cilin të gjithë e njohim dhe i cili tregon se Kosova ka edhe shumë punë për të bërë.

Nëse krahasojmë gjetjet e raportit të këtij viti me vitin e kaluar, pra 2012, shihet se një sërë çështjes kanë mbetur të paadresuara dhe këto në veçanti kanë të bëjnë me sundimin e ligjit si shtyllë kryesore në këtë proces e në veçanti me çështje si lufta kundër korrupsionit, trafikimi me qenie njerëzore, ndikimi politik në institucione të pavarura, ndërhyrja politike në gjyqësor, pastaj mungesa e reformës së administratës publike, ekonomia jo konkurruese dhe siç u tha mungesa e respektimit të të drejtave të njeriut, në veçanti mungesa e lirisë së medieve dhe shqetësimet e tjera.

Megjithatë, duhet të përmendet se raporti vlerëson pozitivisht punën e Kuvendit të Kosovës në miratimin e ligjeve dhe bazës juridike për adresimin e çështjeve të ngritura

nga Komisioni Evropian, mirëpo implementimi i kësaj baze juridike në praktikë mbetet sfidë kryesore.

Gjatë këtij mandati të legjislativit në Kosovë janë krijuar një sërë institucioneve me kompetenca në fushën e integritetit evropian. Megjithatë, praktika po e dëshmon se nuk ka nevojë të bëhen shumë struktura e shumë aktorë në njërin anën, ndërkaq pak punë në anën tjetër. Nganjëherë krijohet përshtypja që e vetmja punë që bëhet është hartimi i strategjive dhe formimi i grupeve punuese për derisa kompetencat e tyre përzihen dhe nuk shihen rezultate konkrete.

Ngecjet serioze në koordinimin efikas në mes të këtyre institucioneve, por edhe atyre të pavarura janë përmendur edhe sivjet në gjetjet e Raportit të Progresit.

Sa i përket raportit ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit që vlen të përmendet, sidomos sot që po e diskutojmë këtë raport dhe mungojnë të gjithë ministrat e resorëve të vendeve tjera, përveç ministres së Integritetit, mospërfillja e Qeverisë dhe e ministrave veç e veç për Kuvendin është ritheksuar përsëri sivjet si një çështje brengosëse në agjendën drejt integritetit evropian.

Mbikëqyrja e Kuvendit ndaj Qeverisë vazhdon të mbetet sfidë, përkundër rolit të sforcuar të disa komisioneve parlamentare dhe këtë objektiv e pengon edhe ndërhyrja e Qeverisë në punën e Kuvendit, siç është parë shumë herë.

Në mënyrë që kjo sfidë të mos përsëritet nga viti në vit, Kuvendi duhet të marrë shumë më seriozisht rolin e vet mbikëqyrës dhe të kuptojë që puna e komisioneve dhe e deputetëve nuk përfundon në momentin kur miratohen ligjet. Në fakt atëherë fillon puna kryesore, pra mbikëqyrja efektive dhe e rreptë sa i përket zbatimit të ligjeve dhe sa më shumë që të intensifikohet agjenda evropiane e Kosovës, aq më shumë duhet të sforcohet dhe intensifikohet edhe roli i Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Të nderuar deputetë,

Zgjedhjet e fundit lokale dëshmuar se kur ka vullnet politik të partive të përfshira në një proces zgjedhor, Kosova edhe mund të bëhet shembull i mirë i zhvillimit të demokracisë.

Megjithatë, në mënyrë që këtë test ta kalojmë me sukses edhe në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, është esenciale siç u tha, që ndër të tjera të bëhet edhe pastrimi i listave të votuesve si parakusht që procesi i ardhshëm i zgjedhjeve parlamentare të konsiderohet i lirë dhe demokratik, sepse zgjedhjet e lira janë parakusht për realizimin e çdo kriteri tjetër i cili përmendet në Raportin e Komisionit Evropian.

Një çështje e cila shumë pak është adresuar përkundër faktit që çdo vit përmendet në Raport të Progresit dhe duhet ta trajtojmë ne si Kuvend e jo dikush tjetër, është pavarësia buxhetore e Kuvendit. Ka ardhur koha që ky Kuvend si institucion i cili e miraton buxhetin për tërë Kosovën, të mos ndikohet në buxhetin e vet nga institucionet e tjera, por ta hartojë atë vetë me imputet e veta dhe të vendosë vetë për buxhetin e saj ashtu siç është praktikë e mirë evropiane.

Unë dua ta falënderoj ministren e Integritetit Evropian për bashkëpunimin me Komisionin e Integritetit Evropian, mirëpo fatkeqësisht ministrat e tjerë nuk po e kuptojnë që kriteret kryesore të përmendura në Raportin e Progresit, në fakt janë të tyre. Shumica e skandaleve të cilat përmenden sa i përket korrupsionit dhe krimit të organizuar, në vend që të luftohen nga institucionet siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, në fakt janë shkaktuar nga ana e kësaj Ministrie.

Pra nuk mjafton vetëm koordinimi i proceseve dhe dhënia e imputeve këtu, por duhet punë konkrete nga secili resor qeveritar dhe natyrisht edhe agjencive të pavarura që kanë rol të rëndësishëm.

Procesi i integritetit evropian megjithatë nuk duhet të përfshijë vetëm institucionet publike, duhet të fillojmë të mendojmë seriozisht për ngritjen e kapaciteteve dhe ngritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile, me mediet, me botën akademike, por edhe me vetë qytetarët për shkak se rëndësia e këtij procesi po rritet çdo ditë.

Përfundimisht, institucionet e Kosovës duhet urgjentisht t'i adresojnë mangësitë e identifikuar nga Raporti i Progresit të cilat në fusha të veçanta dhe shumë më të ngushta do të adresohen nga kolegët e mi nga Grupi Parlamentar, sepse mosadresimi i këtyre sfidave do të vështirësojë rrugën e Kosovës drejt integritetit evropian dhe po ashtu procesin e liberalizimit të vizave i cili është jetik për qytetarët e Kosovës.

Dështimi në plotësimin e këtyre kriterëve natyrisht që do të ketë ndikim edhe në procesin e negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Pra, ka ardhur koha që përfundimisht të shkojmë përtej deklaratave dhe të fillojmë me punën e vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Nëpër çdo dokument të Bashkimit Evropian po vazhdon të përdoret Kosova me fusnotë e cila na mbeti nga negociatat e Brukselit.

Ky përdorim me fusnotë është kontestues për shtetësinë tonë jo vetëm nga Serbia, sepse është etabluar si formë e përdorimit standard nëpër çdo dokument ndërkombëtar për Kosovën. Dhe kjo na e kujton atë premtimin spektakular të zëvendëskryeministres Tahiri e cila thoshte se të mos shqetësohemi shumë, sepse fusnota do të shkrihet shumë shpejt sikur fjolla e borës.

Në të vërtetë ajo që u tret si fjollë bore nuk është fusnota, por premtimet e Qeverisë.

Nuk ka dyshim se pika qendrore politike e vlerësimit të progresit në Kosovë, në këtë raport mbeten negociatat me Serbinë.

Rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian po lidhet me atë se çfarë raporti kemi ne me shtetin e Serbisë. Kjo është arsyeja e vetme pse Raporti i këtij viti është më i butë në gjuhën e tij kritike ndaj punës së Qeverisë.

Raportet e progresit të viteve të kaluara janë dukshëm më kritike dhe këtu ekziston një problem i madh, sepse Bashkimit Evropian në të vërtetë po i ngutet me Serbinë dhe jo me integrimin e Kosovës. Kështu që korrupsioni në Kosovë i cili është i hatashëm, kontrolli politik i drejtësisë që është dramatik dhe shkeljet e ligjit që janë përditshmëri në Kosovë, fatkeqësisht kanë mbetur nën hijen e strategjisë së integrimi evropiane.

Dhe, kjo është fare e çuditshme kur kemi parasysh se për hyrje në Bashkimin Evropian mbi të gjitha janë të vlerësuara çështjet e funksionimit të brendshëm të shteteve, qëndrueshmëria e demokracisë, stabiliteti i institucioneve politike, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, e kështu me radhë.

Prandaj, kjo është arsyeja pse unë mendoj që MSA-ja nuk është fituar pse Kosova po e lufton korrupsionin, nuk është fituar se tash po sunduaka ligji në Kosovë, nuk është fituar MSA-ja pse tash nuk kemi krim të organizuar, por duhet ta themi një të vërtetë të madhe, MSA-ja mbi të gjitha është fituar, sepse kjo Qeveri ka pasur fleksibilitet të madh ndaj kërkesave të Serbisë. Kjo duhet të thuhet. Kjo është arsyeja pse e kemi marrë MSA-në.

Mirëpo, unë do të isha shumë më i gëzuar, sikur të ishte e kundërta, sikur ta kishim fituar MSA-në dhe të kishim marrë notë të dobët në marrëdhënie me Serbinë, po të kishim marrë notë shkëlqyese në luftën kundër korrupsionit, demokracisë, sundimit të ligjit e kështu me radhë, po kjo nuk është e vërtetë.

Ajo që më është dukur vërtetë e kritikueshme në Raportin e Progresit është vlerësimi se roli i Beogradit në veri ka qenë konstruktiv. Kështu thotë Raporti i Progresit. Thotë: “roli i Beogradit në veri ka qenë konstruktiv” Thuhet aty se roli i Beogradit në veri e parandaloi eskalimin e situatës atje.

Me thënë të drejtën, kjo është një e pavërtetë e madhe apo më mirë, krijimi i potencialit destabilizues vjen nga Beogradi e pastaj vetë Beogradi del dha paraqitet si garantues i stabilitetit dhe kështu merr lëvdën të paqena nga Bashkimi Evropian, si dhe shpërblehet me datën e fillimit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Pra, Daçiqi i shkatërroi zgjedhjet lokale herën e parë, në pjesën veriore të Mitrovicës, vetëm pse atje u zgjodh një shqiptar. Pastaj, del dhe thotë se nëse zgjidhet një shqiptar: do të ketë dhunë dhe do të ketë eskalim, pastaj i mobilizon strukturat e tij dhe e zgjedh njeriun e tij, atje. Kështu bëhet ai parandalues i shpërthimit dhe BE-ja e duartroket. Ky nuk është konstruktivitet, ky është shantazh i Daçiqit dhe dorëzim i të gjithëve përpara shantazhit të tij dhe kjo është totalisht metodë politike antievropiane.

Por, te Raporti i Progresit mund të gjendet edhe një e vërtetë, të cilën na e ka mbajtur të fshehur Qeveria e Republikës së Kosovës. Kur flitet, për shembull, për Marrëveshjen e energjisë elektrike, që është bërë në veriun e Kosovës, Raporti i Progresit thotë kështu, thotë që Marrëveshja ia mundëson Korporatës Elektroenergjetike të Serbisë të veprojë legalisht në veriun e Kosovës, kurse Qeveria po na thotë që atje po shpërbëhen strukturat paralele dhe shtetërore të Serbisë.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian po na thotë që atje Qeveria ia paska mundësuar institucioneve të Serbisë operimin e tyre legal. Tash, cila është e vërteta, kjo që po e

thotë Qeveria apo kjo që po e thotë Raporti i Progresit? Unë mendoj që kjo që po e thotë Raporti i Progresit është e vërteta.

Natyrisht, Raporti i Progresit, pas lëvdatave që ia jep Qeverisë për negociatat me Serbinë, i rendit edhe disa shqetësime, të cilat me të vërtetë duhet ta bëjnë Qeverinë t'i vijë turp. Për shembull, këtu po e citoj Raportin e Progresit, thuhet: “ndërhyrjet politike në punën e gjyqësorit mbeten shqetësim serioz”.

Pastaj konstatohet se prokurorët dhe gjyqtarët duhet të kenë më shumë siguri. Kjo do të thotë se ata nuk paskan siguri të mjaftueshme, nëse thuhet se duhet të kenë më shumë siguri. Sërisht po citoj, thuhet: “ndërhyrjet politike në rekrutimin dhe emërimin e të punësuarve publikë, duhet të ndalen. Nëpër borde të pavarura duhet të jenë njerëz të pavarur partiakisht dhe njerëz profesionalë”. Kjo është një thirrje për Qeverinë.

Sa i përket raportit të Qeverisë me Kuvendin, konstatohen dy dukuri të këqija. E para se Kuvendi nuk e mbikëqyrë Qeverinë në masën e duhur dhe e dyta se Qeveria neglizhon llogaridhënien përpara Kuvendit. Këtu, Raporti i Progresit ndalet sidomos te pyetjet parlamentare dhe kjo është vërtetë shqetësuese.

Unë nuk kam bërë kurrfarë studimi statistikor, por prej përvojës që e kemi këtu dhe të gjithë ju kolegë deputetë, mund të konstatojmë lirisht se mbi 70% e pyetjeve parlamentare që shtrohen në këtë Kuvend, nuk marrin përgjigje nga ministrat e thirrur përkatës të ministrive ndaj cilave shtrohen këto pyetje parlamentare.

Dhe, çka na tregojnë këto dy aspekte? Mosmbikëqyrja tregon se Kuvendi është kthyer në një shumicë parlamentare, mbi të cilën direktivat partiake ngadhënjëjnë mbi interesat qytetare dhe kompetencat kushtetuese të Kuvendit për garantimin e demokracisë dhe karakterit republikan të shtetit të Kosovës, sepse deputetët partinë po e qesin mbi interesin, mbi demokracinë dhe shpeshherë edhe mbi Kushtetutën, siç ndodhi rasti me Ligjin për amnistinë, kur shumica e deputetëve këtu i ngritën duart, kurse Gjykata Kushtetuese- thanë që i keni ngritur duart për një çështje antikushtetuese. Kurse, fakti që Qeveria e neglizhon Kuvendin do të thotë se në Kosovë nuk po funksionon principi bazë i demokracisë, që është drejtpeshimi mes pushteteve politike.

Ne e kemi një qeveri të plotfuqishme dhe tejet arrogante ndaj Kuvendit, e cila nuk po e ndjen të nevojshme më që të japë shumë llogari, sepse edhe kur nuk po jep llogari nuk po ka kurrfarë sanksione ndaj kësaj mosllogaridhënie.

Sa i përket drejtësisë aty thuhet se në ato vende ku shqyrtohen çështjet më të ndjeshme të korrupsionit të nivelit të lartë, siç është Prokuroria Speciale e Shtetit, ka pengesa politike, mungesë fondesh dhe mungesë mbështetjes profesionale. Kjo tregon se politikanët e profilit të lartë i frikësohen hetimit dhe i frikësohen drejtësisë.

Pastaj konstatohet në Raportin e Progresit se të drejtat elementare të njeriut nuk janë duke u mbrojtur si duhet. Qeveria mbahet përgjegjëse pse nuk është treguar e zonja në trajtimin dhe përkujdesjen ndaj viktimave të dhunës në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar e vetmja ministre e Qeverisë,

Ky debat është thirrur që Qeveria të dëgjojë se çka mendojnë deputetët lidhur me Raportin e Progresit, ndërsa vëmendje e Qeverisë për të parë se çka mendon legjislacioni, po shihet dhe kjo vërtet është treguesi më i mirë se kjo qeveri as nuk di të përmirësohet, as nuk di të marrë mësim nga raportet e progresit të vazhdueshme nëpër vite që kanë ardhur për Kosovën.

Që nga fillimi, në të gjitha raportet e progresit është potencuar se sfida kryesore për Kosovën mbetet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjithashtu, edhe në këtë Raport të Progresit përsëriten sfidat e njëjta, ku Kosova në vazhdimësi ka ngecje. Kosova është fakt se ka ndërtuar një mekanizëm ligjor të mjaftueshëm, por edhe mekanizmat institucionalë janë themeluar që nga fillimi. Atëherë shtrohet pyetja, pse në të gjitha raportet e progresit nuk ka përparim në këto fusha, madje ka degradim?

Gjithnjë përsëritet fakti se nuk ka kapacitete të mjaftueshme, por mund të them se nuk ka kapacitete të mjaftueshme pasi që nuk ka vullnet politik. Nuk është vullneti politik vetëm miratimi i ligjeve, strategjive, planeve të veprimit, krijimi i grupeve punuese, task-forcave, njësiteve dhe drejtorive të specializuara për ndalimin dhe luftimin e këtyre dukurive. Për këtë flet qartë edhe vetë Raporti i Progresit ku thuhet se skema institucionale për luftën kundër korrupsionit mbetet komplekse, sistemi është i copëtuar në role dhe përgjegjësi të paqarta.

Në kapitullin 4.3.4, ku flitet për Policinë e Kosovës, konkretisht në paragrafin 5 thuhet: “lidhjet ndërmjet nivelit politik dhe menaxhmentit të Policisë janë të afërta”. Kjo do të thotë se edhe në këtë raport përsëriten kritikën se politika kontrollon çështjet operacionale si dhe politikën kuadrore në emërimet e menaxhmentit të lartë të policisë, si në raportet e mëhershme, por e thënë pak më ndryshe.

Siç thashë edhe më lartë, në këtë raport identifikohen si të arritura miratimi i ligjeve, strategjive, krijimi i mekanizmave institucional e tjera, por edhe më tej ka ngecje në implementimin e tyre. Për këtë Qeveria duhet të japë llogari para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës, madje nuk ka nevojë shumë të arsyetohet për Raportin e Progresit, sa ka nevojë ta ndryshojë qasjen e vet ndaj qytetarëve të Kosovës, t’u përmirësojë jetën atyre, të luftojë dukuritë të cilat në vazhdimësi janë kritikë në raportet e progresit që i vijnë Kosovës.

Zbatimi i dy strategjive kyçe për parandalimin dhe luftimin e krimit, që janë policimi në komunitet dhe policimi i udhëhequr nga intelijenca, kritikohet ashpër në këtë raport. Për këto dy strategji dhe koncepte janë harxhuar mund, energji, dhe mund të themi edhe mjete të shumta materiale nga Buxheti i Kosovës dhe nga partnerë ndërkombëtarë dhe përsëri, pas shumë vitesh, kemi ngecje dhe stagnim.

Për të gjitha këto dështime në implementim nuk ka pasur asnjë llogaridhënie nga personat përgjegjës. Kosova ka ngecje të mëdha edhe në hetimet e integruara, pra hetimet financiare së bashku me ato penale. Gjithashtu, kjo kërkesë është e përsëritur me vite dhe nuk ka ndryshuar. Nuk luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni i nivelit të lartë vetëm me hetime penale, këtë e dinë të gjithë ata që merren me këtë fushë. Nuk mjafton hetimi penal dhe dënimi eventual, pa hetime financiare dhe konfiskim të pasurisë së krijuar përmes veprës penale. Këtë ende nuk e kemi parë në Kosovë dhe kjo ende po përsëritet në Raportin e Progresit.

Lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin në veçanti, ne çdo ditë shohim rritje të numrave të rasteve, personave të arrestuar, por në fund dënueshmëria krahasuar me rastet dhe numrin e personave të dyshuar dhe të arrestuar paraqet një diskrepancë të madhe. Në tërë botën kjo ndryshon, por jo në këtë nivel që është më shumë se tragjik në Kosovë.

Pra, operacionet, arrestimet dhe vënja nën hetim i individëve apo grupeve, nuk janë masë matëse për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por dënueshmëria është ajo që mund të llogaritet sukses e kjo në Kosovë është pothuajse në minimum, sepse të gjithë ata që i paraqet policia në gjykatat tona, ata lirohen pas një kohe për të vazhduar veprimtarinë e tyre, prandaj ka krim të organizuar, ka korrupsion.

Çështja e statistikave në të gjitha fushat ka kritika të ashpra. Kjo përsëritet gjithashtu në të gjitha raportet e progresit deri më tani. As këtu nuk kemi parë ndonjë përkushtim të Qeverisë për përmirësim. Pas çdo publikimi të Raportit të Progresit, ne e dëgjojmë Qeverinë e Kosovës duke thënë: është një raport real dhe ne jemi duke bërë të gjitha veprimet që sfidat të adresohen.

Unë dëshiroj të them se qytetarët e Kosovës kanë nevojë jo vlerësimin e Qeverisë mbi raportin, sepse raporti është i përgatitur për t'u përmirësuar Qeveria, për të bërë veprimet e duhura dhe po ashtu, ka nevojë që qytetarët e Kosovës duke rregulluar performancën përbrenda, të jenë të integruar në të gjitha sferat në Bashkimin Evropian.

Është një raport vërtet real, por që kërkon një angazhim sistematik të Qeverisë së Kosovës, të institucioneve të Kosovës, në mënyrë që të mundësojnë që t'i ndalojmë klanet e krimit, korrupsioni dhe të gjitha veprimet antiligjore që ndodhin në Kosovë.

Prandaj, duke vlerësuar se çdo raport deri më tani nuk është vlerësuar ashtu si duhet nga Qeveria për të ndryshuar, konsiderojmë se edhe ky raport do të kalojë me një vëzhgim të përciptë të Qeverisë dhe kjo Qeveri do të vazhdojë avazin e vjetër, ashtu qysh ka qenë deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritet për ministren, edhe pse iu bë apel Qeverisë dje që të jetë këtu, do të thotë se femrat janë menaxhere më të mira edhe në politikë, se siç po shihet nuk është çështje e shovinizmit, por është çështje e ardhjes së saj që dy ditë radhazi brenda Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ne sot po diskutojmë në lidhje me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013.

Në rast se marrim hyrjen e këtij raporti, atëherë mund të themi se ky raport paraqet raportimin e rregullt në Këshillin dhe Parlamentin mbi progresin e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor që janë duke u integruar në Evropë dhe përpjekjet e tyre për t'i përmbushur kriteret e Kopenhagës dhe kushtet e procesit të stabilizim-asocimit.

Kjo u tha edhe nga ministrja e Integriteteve në lidhje me sqarimin e këtij raporti. Në këtë raport përshkruhet shkurtimisht marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian, analizon situatën në Kosovë në aspektet e kriterëve politike, analizon situatën në Kosovë në baza të kriterëve ekonomike, rishikon kapacitetet e Kosovës për t'i zbatuar standardet evropiane.

Në rast se e shohim raportin në përgjithësi, mund të themi se raporti paraqet gjendjen faktike në Kosovë, kjo u tha edhe nga ministrja. Ne jemi të gjithë pjesë e Kosovës si qytetarë të Kosovës, se ne vijmë të deleguar nga qytetarët e Kosovës në Kuvendin e Kosovës dhe, çdo sfidë e cila paraqitet për Kosovën dhe për Qeverinë, është sfidë e të gjitha subjekteve politike. Nuk është sfidë vetëm për Qeverinë, por është sfidë edhe për Kuvendin edhe për Shoqërinë Civile edhe për mediet dhe për të gjithë, që t'i plotësojmë kriteret, që të jemi pjesë e BE-së.

Sa më shumë t'i ofrohem BE-së, kriteret do të jenë më të rrepta për Kosovën. Këtë e dimë të gjithë besoj, si deputetë të këtij Kuvendi dhe shoqëria civile edhe mediet. Në rast se e shohim kapitullin 1.3 marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës, mund të themi se Kosova ka ecur në këtë aspekt, duke marrë parasysh se Kosova merr pjesë edhe në procesin e stabilizim-asociimit, ku ministrja dje është dashur të na raportojë me kërkesë të saj, mirëpo kjo u shty, presim që në një seancë të radhës të raportojë.

Normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë nuk do të jetë i lehtë. Ne jemi pjesë e diskutimeve, ku çdoherë kryeministri duhet të raportojë për çështjet si po shkon situata në mes të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe besoj si deputetë, të gjithë jemi të njoftuar me këto çështje.

Kriteret politike, demokracia dhe sundimi i ligjit, ku paraqitet Parlamenti në këtë rast, Kuvendi i Kosovës merr notë më pozitive, mirëpo edhe në një rast merr notë negative jo me dëshirën ndoshta të gjithë deputetëve, por me disa iniciativa, të cilat janë marrë në Kuvend të Kosovës dhe të gjithë deputetët e kanë raportin përpara dhe e dinë pse në dy seanca atakohet Kuvendi për ndërhyrje. Ndërsa, thuhet se ka marrë në shqyrtim shumë debate me tematika të rëndësishme për qytetarin e Kosovës dhe shumë ministra kanë ardhur të raportojnë kur i ka thirrur Kuvendi, mirëpo në x-raste edhe nuk kanë ardhur.

Në rast se e shohim Qeverinë, Qeveria ka kompetencat në bazë të Kushtetutës, të ekzekutimit të ligjeve dhe nxjerrjes së ligjeve dhe besoj që ata i dinë kompetencat e veta më mirë se sa ne dhe besoj që kapacitetet e tyre nuk mungojnë, nuk mungon as vullneti politik i tyre, për arsye se rapë do t'i nënshtrohen votës nga qytetarët.

Çështja e administratës publike, e nderuara ministre, pasi që ju jeni këtu, është zgjidhur ndoshta, Kosova i ka përmbushur prioritetet afatshkurta, mirëpo do të ketë akoma reforma në administratën shtetërore të vendit, kur dihet se Kosova nuk ka vende të lira në zhvillimin ekonomik dhe e gjithë situata e qytetarëve tanë dhe të rinjve tanë mendojnë që të gjejnë një vend pune nëpërmes administratës së shtetit.

Te sistemi gjyqësor ne kemi miratuar një pako të ligjeve të sistemit gjyqësor dhe shpresoj dhe besoj se Kosova ka një zëvendëskryeministër dhe një ministër të Drejtësisë, i cili di dhe do që Kosova të rangohet më mirë në ranglistat e Komisionit Evropian apo më mirë të themi, të raportit të Komisionit Evropian, që të zhvillohen ligjet, kemi një gjyqësor të pavarur dhe shpresoj se duhet të kthejmë besimin e qytetarëve tek gjykatat tona, për arsye se e gjithë etiketa i shkon Kosovës dhe kemi ndihmën e miqve ndërkombëtarë, mirëpo ne esencë e gjithë çështja varet se sa ne do të kemi besueshmërinë e qytetarëve në gjykatat tona.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk do të jetë e lehtë si në çdo vend të botës demokratike. Edhe në Kosovë, duhet që qytetarët të jenë ata të cilët raportojnë direkt në organet e drejtësisë për luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

Çështja e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave, mund të themi se kemi një përparim edhe këtu mjaft të mirë. Ndërsa, tek çështja e zhvillimit ekonomik apo të themi kritereve ekonomike, mund të themi se bazat e politikave ekonomike të Kosovës janë të mira në raport me institucionet financiare ndërkombëtare, për arsye se Kosova ka vazhduar të zbatojë me sukses Marrëveshjen ‘stand-by’ dhe besoj që në të ardhmen Qeveria duhet të drejtohet më shumë nga sundimi i ligjit dhe nga zhvillimi ekonomik i Kosovës.

Stabiliteti makroekonomik këtu është ruajtur. Në bazë të gjithë kësaj krize, të cilën e ka atakuar Evropën, ndërsa Kosova edhe pse e varfër është ruajtur në këtë rast.

Kërkoj edhe njëherë nga ministrja këtu, që në bazë të sfidave të cilat i ka përcaktuar raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2013, në vitin 2014 të angazhohet Kuvendi, Qeveria, Shoqëria Civile, mediet, që një raport i ardhshëm do të jetë ndoshta edhe më strikt për Kosovën, të jemi të sinqertë edhe para qytetarëve edhe para vetvetes, se çdoherë sa më shumë të afrohem afër BE-së ne do të kemi raporte edhe më strikte. Nuk do të kemi raporte për t’i bërë qejf vetes, po do të kemi raporte të cilat ndoshta do të shikohen shumë hollësisht cilat janë mangësitë dhe dobësitë, të cilat duhet t’i plotësojmë si shtet.

Uroj dhe shpresoj shumë, që raporti i ardhshëm ta gjejë Kosovën në një situatë më të mirë dhe qytetarët e Kosovës në një situatë më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar “6+” e kemi shqyrtuar Raportin e Progresit për vitin 2013 dhe pa dashur ta përsëris ato që e thanë kolegët e mi të nderuar, vlen të ceket dhe dua të shtoj se është e qartë dhe evidente se ka përparim të dukshëm, duke filluar nga marrëdhëniet tona me BE-në, ku si sukses vlen të ceket fillimi apo hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit në mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, pastaj në sundimin e ligjit, në administratë publike, ku Kosova i ka përmbushur prioritetet e saja afatshkurta të studimit të fizibilitetit në fushën e administratës publike, si dhe u miratua legjislacioni dytësor i ligjeve për shërbim civil dhe pagat për shërbyesit civilë.

Pastaj, në sistemin gjyqësor në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat e njeriut, kriteret ekonomike, lëvizja e lirë e mallrave, si dhe mbrojtja e pakicave.

Kur jemi te komunitetet pakicë është e rëndësishme të thuhet se tashmë kampet ‘Osterode’ dhe ‘Çesmin Llug’ edhe zyrtarisht janë mbyllur dhe për fëmijët dhe personat madhor, që vuajnë nga kontaminimi me plumb, ata trajtohen me kujdes të veçantë, duke pasur parasysh fatin se brenda lagjes ku jetojnë të kthyerit nga këto kampe, është vendosur ambulanca me qëllim të ofrimeve shëndetësore sa më cilësore.

Mirëpo, gjithashtu në këtë raport janë evidentuar disa mangësi, që për ne janë shqetësuese dhe ka nevojë për përmirësim, siç është zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për komunitetin rom, ashkali e egjiptian, i cili në mungesë të mjeteve financiare mbetet ende i dobët dhe i paqëndrueshëm.

Po ashtu, arsimimi, shërbimi social i komunitetit rom, ashkali e egjiptian ka nevojë për përmirësim. Gjuha rome është duke u ofruar në disa klasë pilote në Prizren, mirëpo ende nuk ka tekste shkollore të nxjerra në këtë gjuhë.

Mirëpo, duke pasur parasysh se ministrja e Integrimeve Evropiane, zonja Vlora Çitaku, mori postin e kryesueses së Komitetit Drejtues Ndërmintor dhe është duke u marrë shumë seriozisht me zbatimin e strategjisë për komunitetin rom, ashkali e egjiptian dhe unë shfrytëzoj rastin ta përgëzoj dhe ta falënderoj për punën të cilën është duke e bërë në këtë drejtim, kur veç tani janë mbajtur disa takime. Tanimë veç shihen frytet e para në këtë proces dhe ne mbesim optimistë se kjo strategji do të gjejë zbatim të plotë dhe do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes aktuale të komunitetit rom, ashkali e egjiptian, e cila njëherësh vlerësohet si sfidë në Raport të Progresit për vitin 2013. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Gospodo ministarka,

Gospodo poslanici,

Parlamentarna Grupa “Zajednička Budućnost” razmotrila je izveštaj i vidimo da je Kosovo imalo vidni napredak. Međutim, kako se dodaje u izveštaju postoje ozbiljni problemi, kada je reč o vladavini zakona, borbi protiv korupcije, organizovanog kriminala i zaštite nevećinskih zajednica.

Kada govorimo o manjinama vidimo da je zabrinutost isto velika iz upravo zbog ... prava. Moram vam reći da je u pomenutom izveštaju i vidna zabrinutost o zapošljavanju u javnim preduzećima iz redova nevećinskih zajednica.

Kada je reč o ispunjavanju političkih kriterijuma komisija je uočila napredak u donošenju neophodnih zakona, ali je istaknuto da treba da se uloži mnogo napora da se oni i sprovedu i da te procene treba pažljivo nadgledati.

Moramo primetiti da u izveštaju piše da i Kosovo mora da pruži i konkretne dokaze da je borba protiv korupcije i organizovanog kriminala prioritetna i u tom smislu treba ojačati zakone kao i njihovu primenu.

Vidimo da postoji i političko mešanje u pravosudni sistem i to izaziva ozbiljnu zabrinutost. Moramo gospodo poslanici, biti veoma operzni. Vidimo da je Kosovo napravila i veliki napredak, ali moramo još puno raditi na ostvarivanju i kako nevećinskih prava zajednica, tako i svih ostalih zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar,

E nderuara zonja ministresh,

Të nderuar kolegë,

Mendoj se para se të diskutojmë duhet pasur parasysh tri segmente të diskutimit të Raportit të Progresit.

E para, Raporti i Progresit duhet gjithmonë të shikohet në kontekstin rajonal, pra duhet të shihet pak në aspektin krahasues me shtetet aspiruese për integrimin evropian. Dhe, në këtë segment ne më së miri mund ta shohim se ku është vendi ynë, në qoftë se lexojmë edhe raportet për vendet fqinje, sepse nganjëherë gjuha e këtyre raporteve të progresit është shumë finoke apo është pothuajse e unifikuar dhe mund të shohim dallimet.

E dyta, e tha ministrja dhe besoj që ne të gjithë e kuptojmë, ky është një Raport i Progresit të Republikës së Kosovës, të shtetit të Kosovës drejt integrimeve evropiane, ku tregohet progresi i të gjitha institucioneve kushtetuese drejt procesit të integrimeve evropiane sa i përket dhe përgjegjësi të veta ligjore dhe kushtetuese për arritjen e standardeve evropiane.

Dhe e treta, duhet kuptuar se ky është një projekt kombëtar, nuk është një projekt politik i asnjë partie politike dhe këtu suksesi apo dështimi është sukses i yni dhe dështim i përbashkët i yni.

Po ta lexojmë me kujdes Raportin e Progresit për vitin 2013 do të vërejmë një shkallë të progresit, megjithëse të kufizuar, por në Raport të Progresit nuk ka progres të madh, po gjithmonë ka hap pas hapi dhe në këtë Raport të Progresit shihet një progres i dukshëm pothuajse në të gjitha institucionet jo vetëm sa i përket adoptimit të kornizës ligjore në pajtim me standardet evropiane, por dhe qëndrueshmërisë institucionale.

Unë do të ndalem kryesisht në segmentet, në kriteret politike të këtij Raporti, sepse si duket kriteret politike po bëhen kritere bazë, ne do ndalemi në tri momente që janë bazë e këtij debati, e para, qëndrueshmëria funksionale e institucioneve tona; e dyta, reforma zgjedhore; e treta, reforma në administratën publike; dhe momenti i katërt, reforma në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket qëndrueshmërisë institucionale, tani këtu shënohet progresi konkret, tregohet progresi i Kuvendit të Kosovës në shumë segmente, tregohet progresi në miratimin e ligjeve, tregohet një progres i kufizuar sa i përket mbikëqyrjes parlamentare të Qeverisë, por tregohen edhe sfidat dhe këtu përmendet si sfida e parë mungesa e një autonomie financiare, një burimi financiar vetjak të financimit dhe sfida e adoptimit të reformës zgjedhore në Kuvendin e Kosovës.

Padyshim, se si ne do ta implementojmë reformën zgjedhore në vitin e ardhshëm do të varet shumë, se si do të shkruhet raporti për 2014-en dhe ka ardhur koha që përgjegjësinë për këtë reformë zgjedhore ta marrë Kuvendi i Kosovës dhe ne të adoptojmë një sistem zgjedhor në pajtim me kriteret evropiane. Ne kemi dhënë dëshminë se këtë mundemi, kemi dhënë dëshminë me zgjedhjet lokale dhe kjo dëshmi do të konfirmohet përfundimisht me aftësinë tonë për të adoptuar kornizën e mirë ligjore për zgjedhje nacionale dhe ne duhet sa më shpejt të hapim debatin për këtë reformë.

Raporti i Progresit kërkon respektimin e kriterëve evropiane, jo edhe daljen jashtë kriterëve evropiane. Kjo lidhet edhe me presionet aktuale që neve na bëhen edhe për aplikimin e standardeve jashtë evropiane, që lidhen kryesisht me përfaqësimin e komuniteteve pakicë, ku padrejtësisht aktualizohet një çështje që është e mbyllur, është e mbyllur në kuadrin e përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe padrejtësisht bëhen presione në një shtet të ri, presione këto që nuk i hasë në praktikën evropiane të asnjë shteti, për dhënien e koncesioneve të reja, sa i përket përfaqësimit politik të pakicave, edhe pse Kosova sa i përket përfaqësimit të pakicave, mund të jetë model për të gjitha shtetet rajonale, sidomos shtetet që kanë problem me trajtimin e pakicave.

Dhe, mendoj se Kuvendi duhet ta ushtrojë autoritetin dhe duhet ta mbyllë këtë çështje, ashtu siç është mbyllur me miratimin e 22 amendamenteve, me të cilat ne kemi implementuar paketën e Ahtisarit dhe ato vende i kemi shndërruar në vende të garantuara, që përsëri është një nga standardet më të larta të përfaqësimit politik të pakicave.

Një çështje shumë e rëndësishme për të cilën kemi diskutuar disa herë, unë kam diskutuar në çdo Raport të Progresit, është çështja e reformës së administratës publike dhe mua më vjen keq që sot s'është ministri, ministrja do ta mbulojë edhe këtë sektor, por ne kemi një Ministri të specializuar, ka qenë një projekt imi, kur kam qenë ministër i Shërbimeve Publike, të krijojmë Ministri të Administratës Publike, në mënyrë që të arrijmë progres si vend, sa i përket administratës publike, sepse kam qenë i vetëdijshëm që progresi në administratën publike është pika kyçe e integritetit evropian.

Dhe, në të ardhmen progresi ynë në sferën e administratës publike do të jetë përcaktues, sa i përket dinamikës së integritetit evropian. Është e vërtetë se reforma tani ka filluar të implementohet. Ne në vitin 2009 kemi bërë reformën e shërbimit civil, reformën e

administratës publike, reformën e sistemit të pagave. Tani konstatohet progres sa i përket adoptimit të legjislacionit sekondar, por ka edhe kërkesa shumë specifike, që administrata të profesionalizohet edhe më tepër, të depolitizohet, të shtohet përgjegjësia ndaj vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe një varg kërkesash tjera, që do të mundësojnë një administratë shtetërore, një administratë publike, që është e devotshme ndaj shtetit dhe e cila nuk lëviz pas cilitdo cikël të zgjedhjeve parlamentare.

Kështu që Administrata Publike është çelës i funksionalitetit të shtetit, tregon se sa një shtet ka arritur të demokratizohet, duke krijuar një administratë lojale ndaj interesave shtetërore.

Momenti i tretë shumë i rëndësishëm, progresi që është shënuar me të drejtë është progresi në sferën e sistemit të drejtësisë, sidomos reformës së sistemit gjyqësor. Të mos harrojmë se ne kemi një koncept shumë të avancuar të pavarësisë së gjyqësorit, me vetë faktin që kemi instaluar mekanizma kushtetues që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, siç është Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, janë progres evident sa i përket legjislacionit, por mbeten edhe shumë kërkesa që nuk janë eksplicite në Raportin e Progresit, por që do të vlerësohen nga Komisioni Evropian.

E unë mendoj, se ato janë kryesisht tani elementet, ato mekanizmat e vetëvlerësimit të kualitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë, meqenëse prokuroria dhe gjyqësia janë të mbrojtura nga debati parlamentar dhe ne kemi bërë gabim, kur kemi hyrë në këtë “zonë të ndaluar”, që është zonë e ndaluar për perspektivën evropiane të Kosovës. Unë mendoj se gjyqësori dhe prokuroria duhet të krijojnë mekanizma të vetëvlerësimit të kualitetit. Ato mekanizma janë të parapara me ligj, por ne nuk po i shohim që janë gjithaq funksional, nuk po shohim që ato funksionojnë dhe nuk po shohim gjyqtarë dhe prokurorë që shpërblehen për punën e mirë apo që ndëshkohen në karrierë për punën e keqe. Kjo nuk është punë e Parlamentit, por është punë e mekanizmave të vetëvlerësimit.

Marrë në përgjithësi, ne kemi të identifikuar shumë qartë sfidat që kemi si shtet dhe ato sfida janë shumë të lexueshme, dhe ato sfida duhet të shndërrohen në një plan strategjik për implementimin e këtyre gjetjeve të raportit jo vetëm nga niveli qeveritar jo vetëm nga ministrja, e cila duhet të komplementohet për punën që ka bërë në sferën e integriteteve evropiane, por mendoj se nga të gjitha institucionet, ne si Kuvend duhet ta lexojmë pjesën e obligimeve tona, pjesën e obligimeve që ka Kuvendi dhe jo njëherë në vit të diskutojmë, por ky debat të jetë më i shpeshtë, secili institucion, sa i përket përgjegjësisë të veta konkrete, të arrijë progresin.

Është e vërtetë, se ky është një raport teknik dhe është e vërtetë që MSA-ja është diçka që është e merituar, por, çfarë kërkohet?

Duke parë tani vendimet e fundit të Bashkimit Evropian, duke parë dhënien e ftesës për statusin e kandidatit për Serbinë dhe pezullimin e dhënies së ftesës për Shqipërinë, ne si vend që do të vijmë në atë fazë, duhet të krijojmë, të kërkojmë nga Bashkimi Evropian, që të ketë kriteret unike të vlerësimit. Dhe, ato kriteret të reflektohen sa i përket tempos dhe dinamikës së integritetit evropian, sepse nganjëherë krijohet përshtypja se edhe kur janë në pyetje kriteret teknike, nganjëherë kemi qasje politike. Për shembull, unë e quaj pak një “ledhatim” të Serbisë, një “ledhatim” me vetë dhënien e statusit apo një mirënjohje për gjoja konstruktivitetin në procesin e negociatave për Kosovën.

OK, është një proces që s'mund të ndalet nga Kosova, por, çfarë ne mund të kërkojmë?

Mund të kërkojmë që një shkallë e tillë e vlerësimit të progresit të jetë unik për tërë rajonin, të jetë unik edhe për Shqipërinë, por të jetë unik edhe kur të vjen Kosova, sepse nganjëherë mendoj se ka një shikim të dyfishtë sa i përket progresit në raportin teknik dhe nganjëherë edhe çështjet teknike mveshen me petkun politik. Dhe, mendoj se te rasti i Serbisë ka qenë një rast i tillë, ku një progres i shënuar, ndoshta formal, në procesin e negociatave dhe në segmentet tjera, menjëherë është shpërblyer me dhënien e statusit të kandidatit.

Ne kërkojmë, që Bashkimi Evropian t'i vlerësojë përpjekjet e shtetit të Kosovës, t'i vlerësojë angazhimet që ne bëjmë dhe Kosovës t'i japë një status të njëjtë dhe të vlerësojë me kriteret e njëjta jo vetëm Kosovën, po të gjitha shtetet e rajonit, në mënyrë që gara drejt integritit evropian të bazohet në parimin kushtetues, parimi i tretmanit dhe gjasave të barabarta, parimi i instrumenteve të vlerësimit të barabartë e jo kriterëve të dyfishta, sepse kam përshtypjen që kur është në pyetje integrimi i shqiptarëve në Evropë, ende kemi një proces të dyshimit se a mund të jenë shqiptarët evropian.

Unë mendoj, se shqiptarët për çdo ditë po e japin dëshminë që ata mund të jenë evropianë dhe mund të jenë evropianë konstruktivë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua të përshëndes emërimin e koleges sime Vjosa Osmani, e cila është njëra nga njohëset më të mira të fushës së integritimeve evropiane si kryetare e komisionit parlamentar me të njëjtin emër, që besoj që do të lançohet pak më vonë.

Drejtimi i komisioneve nga gra deputete vazhdon të jetë në numër të vogël në këtë Kuvend, nga 13 tani bëhen 3, e kjo është një gjë që nuk më pëlqen aspak, duke qenë se janë pikërisht gratë deputete që e kryejnë punën më të madhe në komisione. I ftoj mediet që ta monitorojnë më shumë punën e komisioneve dhe do ta konfirmojnë këtë.

Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Kosovës gjatë këtij viti gjeti sërish shkelje të mëdha gjatë skanimit të gjendjes.

Shumë pak u bë për t'i përmirësuar vërejtjet që u gjetën një vit më parë. Këto vërejtje janë të drejtuara në radhë të parë tek Ekzekutivi, dhe unë do të veçoja edhe gardianin e drejtësisë së një shteti - Gjyqësorin, sepse sundimi i ligjit është Thembra e Akilit për Kosovës për të shkuar në BE.

Në raport thuhet se Qeveria e Kosovës e ka rritur kapacitetin për adresimin e prioritetëve të procesit të integritit evropian. Ka një farë vlerësimi pozitiv për miratimin e legjislacionit. Mirëpo, fill pas kësaj vjen vërejtja që ligjet mbeten subjekt i ndryshimeve të shpeshta, çështje të cilën e kemi ngritur shpesh edhe këtu në Kuvendin e Kosovës,

sepse po miratohen ligje shpejt e shpejt dhe më pas vijnë për plotësim-ndryshim. Kjo është edhe humbje energjie.

Një nga problemet e evidentuara në raport është ajo që lidhet me mungesën e pjesëmarrjes së ministrave për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare. Dhe, këtu vërejtja ime numër një është për kryeministrin, i cili e injoron plotësisht këtë pikë të rendit të ditës. Por, kryeministri nuk përton të vijë në seancë për të bërë humor e për të mbajtur fjalime joserioze.

Dhe, kuptohet ministrat e ndjekin shembullin e tij. Pyetjet parlamentare janë mekanizmi mbikëqyrës i Kuvendit, i cili do të duhej të ishte ai më aktiv, siç e kanë vendet e tjera demokratike.

Problemi tjetër madhor, Administrata Publike. Edhe pse janë përmbushur kriteret afatshkurtra të studimit të fizibilitetit dhe këtu më duhet të bëj një kompliment për ministrin e Integritetit, e cila po i shtyn vazhdimisht, por si duket nuk gjen shumë përkrahje te ministratë të tjera. Kjo administratë mbetet e pareformuar. Performansa e nëpunësve civilë nuk po matet. Administrata është tej mase e fryrë dhe si e sëmurë në bazë të kriterëve. Por, problemi madhor vazhdon të mbetet politizimi i skajshëm i Administratës Publike.

Qeveritë shkojnë e vijnë, por një shtet mbahet në këmbë nga një administratë e pavarur dhe një gjyqësor i pavarur. Edhe në këtë fushë, pra në Gjyqësor, Kosova po çalon dhe rëndë madje.

Sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë, janë raportuar rastet e ndërhyrjeve politike në gjyqësi, thuhet shprehimisht në raport. E këtu ka luajtur një rol negativ edhe Kuvendi i Kosovës, duke diskutuar raste të gjykuara.

Edhe Gjykata Kushtetuese, e cila duhet të jetë gardian i Kushtetutës ka shkelur ligjet e këtij vendi dhe madje jo një herë.

Në anën tjetër, kemi prokurorë të cilët rrinë në gjumë nëpër zyra dhe nuk reagojnë aspak për të hapur raste ex officio ndaj akuzave të korrupsionit që raportohen për çdo ditë nëpër media. E po kështu ndaj individëve dhe grupeve të cilët po e dhunojnë lirinë e shprehjes, po nxitin urrejtje dhe po duan të na e shkatërrojnë fondamentin e këtij shteti. Këta prokurorë rrinë duarkryq, sepse ndoshta presin se çfarë sinjalesh do t'u japë politika.

Me këtë stil pune, ku shteti ecën për inerci dhe jo në sajë të një strategjie apo vizioni, Kosova, jo vetëm që nuk do t'i ofrohet integritetit në Bashkimin Evropian, por do të bëhet një shtet i dështuar me kuptimin e plotë të kësaj fjale, gjë që asnjëri prej nesh nuk besoj se e dëshiron.

Unë e kam edhe një vërejtje për Komisionin Evropian, i cili një vit më parë me të drejtë e kritikoi ashpër Kosovën për shkak të tentativës për të futur në Kodin Penal nenet nguflatëse për lirinë e medieve, 37 dhe 38.

Është pikërisht ky Kuvend që e miratoi këtë vit, më 31 korrik, Ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe ky do të duhej të ishte prezantuar në raport si një hap pozitiv i institucioneve të Kosovës sa i përket garantimit të lirisë së medieve.

Në anën tjetër, Komisioni Evropian dhe vendet e BE-së shpesh nuk po tregohen të singertë me qytetarët e Kosovës. Është për të të ardhur keq që ata i kanë mbyllur dyert vetëm për Kosovën, duke e pamundësuar lëvizjen pa viza për qytetarët tanë. E kjo gjë i është mundësuar madje edhe Serbisë, shtetit që në BE eksporton kriminelë lufte. Kosovës i bëhet për çdo ditë presion të lëshojë pe, e në anën tjetër Serbia shpërblehet për çdo ditë në kurriz të Kosovës.

Përfundimisht dua të theksoj atë që e kam thënë disa herë në këtë Kuvend, që Qeveria e Kosovës e ka një retorikë të fortë proevropiane, e përdor shpesh atë për t'iu larguar përgjegjësisë për mosveprimet ose veprimet e gabuara. Por, nuk ka punë për plotësimin e standardeve evropiane.

Duke e mbështjellë krimin e korrupsionin me fjalë të mëdha e retorikë anti, por njëkohësisht duke e favorizuar atë në praktikë, për çdo ditë e më shumë po zbehet besimi i qytetarëve të Kosovës në institucione dhe në shtetin e tyre dhe anormalja po kthehet e po pranohet si normë. E njëjta gjë ka ndodhur në veri të Kosovës, ku anormalja është pranuar si normë, e këtu përgjegjës janë edhe institucionet e BE-së dhe të bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht ai aktual, EULEX-i.

Kthimi ose pranimi i anormales si normë është një gjë me pasoja afatgjata për këtë vend, e cila nuk mund të rregullohet asnjë për vit, as me ardhjen e një qeverie tjetër, por duhen dekada. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Ndër konstatimet kryesore të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013 është pamundësia e konstatimeve. Në raport, në faqen 22 të tij, thuhet: “Statistikat ekonomike, posaçërisht llogaritjet, shifrat nacionale, mbeten skajshmërisht të dobëta, duke penguar kështu një vlerësim gjithëpërfshirës të situatës ekonomike”. Ky konstatim i kushtëzon konstatimet tjera, ose mungesën e konstatimeve të tjera si asgjë tjetër.

Kohëve të fundit, në mënyrë artificiale e manipulative është zvogëluar papunësia në Kosovë, duke u zvogëluar popullsia ekonomikisht aktive. Pra, bëhet fjalë për ndryshim shifrash që e shtrembërojnë pasqyrimin e realitetit, e jo për ndryshim të gjendjes aktuale. Kësisoj, nëse janë bërë pesë javë që nuk ka aplikuar për punë, i papuni nuk është më i papunë, por ekonomikisht joaktiv: duhet të jesh i papunë aktiv që të konsiderohesh i papunë. Por, kur të kesh mbetur shumë vjet i papunë, me gjithë aplikimet e rregullta e të panumërta, duhet të jesh edhe njëfarë neurotiku obsesiv që të vazhdosësh të aplikosh, apo jo?

Megjithatë, edhe ajo pakicë që përgjithësisht punon përjeton zakonisht shkelje të mëdha të të drejtave dhe rrezik të lartë në punë.

Sipas Raportit të Progresit 2013, në vitin 2012 në Kosovë kishte 62 aksidente në vendin e punës që janë raportuar, prej tyre 17 me fatalitet dhe 45 me lëndime serioze trupore. Inspektorati i Punës i ka vetëm 49 inspektorë. Kjo është e pamjaftueshme, thuhet në faqen 34 të këtij raporti.

Në raport thuhet se bruto-produkti vendor për kokë banori në Kosovë është 1/9 e mesatares së BE-së. Përafërsisht në të njëjtën kohë, pra në tetor të vitit 2013, u publikua edhe raporti i Bankës Botërore në Kosovë, që thotë se mesatarja e të hyrave për kokë banori është rreth 1/10 e niveleve të BE-së. Vendet e pakta të punës në Kosovë kërkojnë edhe shkathtësi të pakta edhe produktivitet të ulët. Sipas po atij raporti, në Kosovë 37,8% e rinisë së punësuar nuk ka kontratë pune.

Në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013 thuhet që deficitin tregtar i Kosovës është 35,1% të bruto-produktit vendor, pra më i lartë se 1/3 e bruto-produktit vendor.

Investimet e huaja direkte kanë rënë në nivelin më të ulët që prej vitit 2005 në 4,3% të bruto-produktit vendor, dhe gjysma e tij shkon në patundshmëri dhe sektorin e ndërtimit, 12% në shkëmbimet financiare dhe vetëm 13% kanalizohet në prodhim.

Asetet e sektorit financiar janë 74% te bankat dhe 19,5% te fondet pensionale. 70% e aseteve lokale menaxhohen nga tri bankat më të mëdha (nga nëntë sosh, gjithsej) dhe 90% nga bankat janë në pronësi të huaj. Në Kosovë i kemi rreth 300 000 të punësuar dhe rreth 450 000 kredi. Një shtet i kapur nga importi i lartë është komplementar me një popullsi të kapur nga kamatat e larta.

Ndërkohë, një buxhet i tërë i Kosovës ndodhet jashtë vendit: 800 milionë euro të Trustit Pensional dhe 600 milionë euro të Fondit të Privatizimit! Në Kosovë janë vetëm 2,5% të Fondit të Kursimeve Pensionale në bankat e Kosovës, që edhe ashtu s'i karakterizon investimi në vend! Në vend se këto të jenë fonde zhvillimore që nxitin prodhimin dhe asisoj hapen vende të reja pune, paratë na mbeten jashtë ekonomisë sonë, importi sa vjen e rritet, kurse nga Buxheti i Kosovës tjetërsohet fondi zhvillimor për veriun në kushtet kur atje standardi i jetës është dy herë e gjysmë më i lartë se në jug të Ibrit në Mitrovicë.

Sipas këtij Raporti të Progresit, gjatë vitit 2012, janë regjistruar 2 262 biznese të reja, një rritje kjo prej 20% krahasuar me vitin e kaluar. Në anën tjetër, 334 biznese janë mbyllur, ose 16,7% më shumë se në vitin 2011. Kjo do të thotë që është bërë më kollaj të regjistrosh biznes në Kosovë, por është bërë më e vështirë të mbijetosh si biznes. Biznesi e konsideron mungesën e qasjes në financa, ndërprerjen e energjisë elektrike, konkurrencën jo fer (midis ndërmarrjeve lokale) dhe korrupsionin si pengesa kryesore në të bërit biznes.

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013, më shumë se 800 zyrtarë publikë në Kosovë kanë më shumë se dy vende pune (e disa prej tyre deri në pesë)! Agjencia Kundër Korrupsionit ka sugjeruar që zyrtarët të mos jenë

lejuar që të kenë më shumë se një vend pune. Jo vetëm që kjo nuk u përfill, por ka aq shumë zyrtarë që vazhdojnë të kenë biznese private, ose nuk bëjnë deklarinimin te Agjencia Kundër Korrupsioni, kur e marrin postin publik.

Buxheti për Gjyqësorin për vitin 2012 në Kosovë ishte 0,475% të bruto-produktit vendor. Përkushtimi qeveritar matet me madhësinë e buxhetit të dedikuar, e jo me frekuencën e fjalëve të përsëritura. Prandaj, nuk është e çuditshme që numri i lëndëve të grumbulluara u rrit, nga 218 740 lëndë në pritje, në vitin 2012, në 235 000 sosh, në vitin 2013.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Dialogu me Serbinë dhe ligjet e mira në letër po bëjnë që Komisioni Evropian i Bashkimit Evropian ta mbyllë së paku njërin sy para krimit e korrupsionit qeveritar, kur e përpilon Raportin e Progresit, duke e përmendur krimin e korrupsionin jo shumë, jo fort konkretisht, dhe jo aq në fillim të raportit.

Nga tetori 2012 në tetorin 2013, kryeministri Thaçi i ka zhvilluar 17 takime me kryeministrin e Serbisë, Daçiq. Pra, më shumë se një takim në muaj, ose dy takime në muaj, po që se e heqim pushimin veror. Kjo është thelbësisht anormale dhe sigurisht që nuk iu shpagua Kosovës.

Në raportin e fundit të zonjës Catherine Ashton për progresin e dialogut Thaçi-Daçiq thuhet që, “Serbia i ka përmbushur kushtet në të gjitha elementet kyçe, posaçërisht duke e pranuar një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë Themelore të Prokurorisë për rajonin e Mitrovicës”. Pra, baronesha Ashton është përqendruar te koncesionet që i bën Serbia në Kosovë dhe duket e magjepsur me këtë. Në Raportin e Progresit 2013 tashmë u etabluar përdorimi i shprehjes “northern Kosovo”, e jo “north of Kosovo”. Pra, Kosova veriore, që ngjall imazhin e Irlandës Veriore, dhe jo veriu i Kosovës, si nocion gjeografik (por, Kosova veriore si një entitet politik).

Tash që besohet se jemi të pavarur, konsiderohet që mungesa kryesore është demokracia (sasia apo cilësia e saj). Por, demokracia e ka bazë shtetin.

Janë legjitime debatet teorike për demokraci përtej shtetit dhe sovranitetit, mirëpo ndërkohë, praktikisht dhe realisht, nuk kemi askund në botë demokraci pa shtet. Dhe, sidomos kemi demokraci brenda shtetit, demokraci në shtet të caktuar.

Sot, demokracia është - përgjithësisht e kryesisht - shteti demokratik! Në anën tjetër, nuk ka demokraci midis e ndërmjet shteteve. Raportet midis shteteve të ndryshme dihet se quhen marrëdhënie ndërkombëtare - aty zhvillohet politika e jashtme dhe diplomacia. Pra, nuk ka demokraci midis shteteve, ka demokraci brenda shteteve.

Ama, Qeveria e Kosovës, në vend se të bëjë politikë të jashtme dhe diplomaci me faktorët ndërkombëtarë dhe të mundësojë e zhvillojë demokraci me qytetarët dhe për ta brenda vendit, ajo bën demokraci me bashkësinë ndërkombëtare, duke iu nënshtruar shumicës jashtë vendit, kurse brenda vendit është autoritare dhe e korruptuar, mohuese e vullnetit të shumicës dhe shpërdoruese e interesave të shumicës.

Për fund dua t'i them edhe dy çështje. E para, Qeveria jonë vazhdimisht lavdërohet me strategjitë, me sasinë e strategjive. Mirëpo, kjo qasje i bën strategjitë të inkorporueshme në imazhin e projektuar të vendit tonë nga Qeveria.

Pra, strategjitë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve shtetërore me këtë qasje më parë i përkasin regjistrit të qenies dhe pranisë sesa regjistrit të veprimit dhe bërjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja edhe një minutë.

ALBIN KURTI: ...Dhe, çështja krejtësisht e fundit: është e gabueshme nëse ne përpiqemi me çdo kusht, çdo herë, çdo kund të dëshmojemi se Kosova dhe shqiptarët janë evropianë, duke kultivuar e konfirmuar kompleksin e inferioritetit.

Për shkak se e besoj dhe e pranoj atë që e ka shkruar Edward Said për orientalizmin, kritikën e tij ndaj orientalizmit, nuk e pranoj ndarjen Lindje-Perëndim, mirëpo edhe nëse kushtimisht për një moment e pranoj ndarjen lindje-perëndim, mund të them se Qeveria e Kosovës me qasjen e saj po e dëshiron Perëndimin dhe Evropën në mënyrën më lindore të mundshme.

Dhe, kjo qasje e këtillë nuk na afron tek integritet evropiane dhe euroatlantike, por, përkundrazi, gjithnjë e më shumë na largon prej tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit, Do të provoj me qenë goxha i saktë dhe i shkurtër për atë çfarë do të them. Një pjesë e madhe e asaj që është dashur të thuhet, u tha.

Sidoqoftë, më duhet të them se në një aspekt, profesor Bajrami pati të drejtë, ai tha ky raport është raport i progresit për gjithë Kosovës, që do të thotë për të gjitha institucionet, për komunat, për gjykatat. Është e vërtetë. Mirëpo, ne e kemi një Qeveri dhe e kemi një Ministri të Integritet Evropian, e cila në njëfarë forme rolin kryesor duhet ta ketë në koordinimin dhe prodhimin e dokumenteve, prodhimin e raporteve, ndoshta edhe të planeve të veprimit për të gjitha institucione tjera. Disa prej tyre nuk mund t'i urdhërojë, ne e dimë atë punë. Nuk janë të gjitha pjesë e Qeverisë.

Mirëpo, arsyeja pse ekziston një ministri e tillë në shumicën e vendeve që aspirojnë dhe që kanë aspiruar në të kaluarën është pikërisht kjo që Qeveria e Kosovës, me insistim të ministres, në këtë rast, ose të ministrit, kushdo qoftë, ua shkruan nga një letër javë për javë komunave, të cilat nuk e kanë përmbushur ndonjë prej kriterëve që është kërkuar, ua shkruan nga një letër gjykatave, ministrive tjera, insiston dhe, në fund të fundit, del me një raport dhe thotë 'ne kemi insistuar te institucioni A ose B, mirëpo ky institucion nuk po e kryen punën', dhe gjen mekanizma t'i thotë ose Kuvendit, ose institucioneve tjera relevante, 'ky institucion nuk po punon mirë dhe ky shef duhet shkarkuar', e tjera, nuk po sqaroj, se po besoj që po e kuptoni çfarë po them. Domethënë, dikush duhet të jetë në krye të detyrës edhe të thotë 'kemi insistuar, kemi kërkuar, kemi provuar, mirëpo ka

individë, ose ka institucione që nuk po e kryejnë punën e vet, në mënyrë që Kosova të ecën më shpejt drejt integritimeve evropiane’.

Me këtë rast më duhet të them se nuk është këtu problemi i mosfunksionimit të një ministrie, se ne ministrinë po e shohim që po provon të funksionojë, por është mosfunksionim i krejt hallkës të qeverisë në Kosovë, që ka të bëjë drejtpërdrejt me integritet evropian dhe më duhet të pajtohem me atë që tha e zoti Kurti, të cilën në njëfarë forme tjetër e kam thënë disa herë në këtë foltore të Kuvendit, që energjia më e madhe në këtë Qeveri të Kosovës shpenzohet për t’u dukur, domethënë për atë që quhet ambalazh, për pamjen e jashtme, E kam thënë dhe po e përsëris, sikur ta kishin shpenzuar gjithë këtë energji për t’u bërë diçka, ndoshta edhe ishin bërë. Mirëpo, kur energjia shpenzohet veç për t’u dukur, me të vërtetë është problem.

Një çështje tjetër që është shumë problematike sa i përket integritit evropian dhe që po ndodh në Kosovë, nuk është veç Kosova, ka ndodhur edhe në disa vende tjera, ka ndodhur në vende të cilat nuk janë integruar ende, e ajo që ndodh është kjo: Integriti në Unionin Evropian prapë paraqitet jo si një proces qysh është dizajnuar fillimisht në Unionin Evropian, sidomos për vendet e Lindjes, i cili nënkupton një punë të vendeve që aspirojnë, një punë të qeverive që aspirojnë, që gjatë rrugës së integritit të përmirësohet jeta e qytetarëve.

Ajo çka kërkohet në kriteret e Kopenhagës, ajo çka del nëpër raporte, ajo çka kërkohet edhe në çdo dokument që vjen prej komisionit, kryesisht prej Komisionit Evropian, ka të bëjë me atë që duhet ta përmirësoni sundimin e ligjit.

Përmirësimi i sundimit të ligjit nuk është kusht për hir të Unionit Evropian. Sundimi i ligjit duhet të jenë kusht për qytetarët tanë. Duhet të zhvillohet ekonomia dhe zhvillimi i ekonomisë nuk bëhet për hir të shteteve anëtare të Unionit Evropian se ata e kanë ekonominë e vet. Bëhet për ta përmirësuar jetën e qytetarëve tanë. Demokracia, domethënë prapë nuk ka të bëjë për hir të dikujt tjetër dhe kur në vendet si Kosova paraqitja e ngecjeve ose paraqitja e problemeve në procesin drejt integritit evropian ndërlidhet me atë se a na do Unioni Evropian apo jo, a po do Unioni Evropian ne apo jo. Është gabimi fundamental që e bëjnë vendet që nuk e kanë kuptuar hiç integritin në Unionin Evropian. Ama, bash zero.

Kjo nuk ka të bëjë me ministren që është këtu tani, se nuk e kam dëgjuar kurrë t’i them një gjë të tillë, por aq shpesh është dëgjuar në këtë Kuvend të Kosovës që ne jemi krejt në rregull, por ata nuk po na duan, ose diçka ngjashëm.

Këto tema i bëjnë vetëm vendet të cilat, edhe një herë po e përsëris, po dua ta përsëris, nuk e kanë kuptuar ama bash hiç se çfarë duan të bëjnë.

E para që nuk është kuptuar është që Unioni Evropian nuk e pranon një vend i cili e ka në Raportin e Progresit pika-pika të shpërndara, për të cilin kemi folur edhe më përpara, edhe unë kam folur, që thonë kështu: ‘papunësia 40%’, po të matet më mirë del edhe më e madhe; ‘universitetet’, një dështim total domethënë nuk prodhohet dije hiç, domethënë nuk prodhohen njerëz të dijsëm, ‘rastet sociale’ ose varfëria ekstreme, domethënë jeni duke e parë që nëse prej kapitullit në kapitull dikush e nënvizon vetëm fjalinë kryesore

dhe i mbledh ato fjali, dhe i lëshohen në dorë si një përmbledhje një ministri të Punëve të Brendshme të cilido vend të Unionit Evropian, ai tmerrohet. Kurrë nuk mund të mendojë që këtij vendi duhet t'i liberalizohen vizat, në këto rrethana sociale, se krejt njerëzit shkojnë atje e nuk rrinë në vend të vetin.

Duhet parë se çka lexojnë të tjerët në këtë raport se nuk shkruhet vetëm për Kosovën. Dhe, këto elemente po përsëriten, janë duke u përsëritur vit pas viti. Domethënë për 5 ose 6 vjet, nëse i merrni edhe i nënvizoni këto vija të cilat do t'i lexonte një kryeministër ose një ministër i Jashtëm i një vendi anëtar i Unionit keni për ta parë që janë të njëjta. Nuk kanë ndryshuar, nuk ka progres.

Unë po e lus secilin deputet, po i lus institucionet e Kosovës, po i lus qytetarët e Kosovës, ta shohin që integrimi në Unionin Evropian nuk ka të bëjë me kushtet që na kanë vënë ata për të mos na lënë të shkojmë. Por, nuk po shkojmë hiç nëse doni, po bëhemi hipotetiksht, e di çfarë banalizmi po flas, po bëhemi si Zvicra. Nuk po do të hyjë në Unionin Evropian. Sikur të aplikojë, nesër në mëngjes ia kryejnë punën. Ose, si Norvegjia. Po nëse mbërrimë të vijmë në atë ditë që të vendosim vetë a duam të hyjmë apo jo, ne jemi integruar, i kemi kryer të gjitha punët tona.

Po ju lus edhe një herë ta kuptojmë që nuk janë ato kushte që i janë vendosur Kosovës për t'i bërë ne për hir të Unionit Evropian. Jo, janë për ne. Dhe, kjo çfarë fola deri më tani ka të bëjë vetëm me aspektin praktik, që është shumë politik, në fund të fundit, të kushteve drejt Unionit Evropian.

Për raportet me fqinjët, që është një prej pesë kritereve të Kopenhagës, mos harroni, është temë tjetër dhe unë mendoj se për këtë duhet të ketë debat krejt të veçantë.

Ajo çka ne si grup parlamentar kemi insistuar që të ketë në këtë debat sot, ka të bëjë puro me punë praktike, të cilat duhet t'i kryejë Qeveria e Kosovës drejt integritit në Unionin Evropian, ose drejt rregullimit të vendit asisoj që Unioni Evropian t'ia bëjë pyetjen vetes pse mos ta pranojmë Kosovën, e jo pse ta pranojmë Kosovën.

Në fund, dua ta bëj një 'xhep' në bisedë, jo për diçka tjetër po, por më duket që po na tingëllon shumë keq në Kosovë - vazhdimisht flitet për femra dhe për meshkuj. Po ju lus, në femra dhe meshkuj ndahen të gjitha gjallesat. Ka femra edhe meshkuj peshq, kuaj, gjirafa, arusha. Te qeniet njerëzore thuhet burrat edhe gratë, domethënë për qeniet njerëzore kur flasim për gjinitë ka fjalë specifike - thuhet burra ose gra, ose vajza ose djem. Meshkuj dhe femra, krejt llojet e gjallesave janë.

Edhe dua të fundit, meqë fola dy herë prej vendit edhe nuk po dua të keqkuptohem, fjala shovinizëm vjen prej një farë shovenit, ia kam harruar emrin e parë në kohën e Napolonit. Dhe në çfarëdo fjalori definohet si bindje joracionale se gjinia jote, ose etnia jote, ose raca jote është superiore ndaj racës ose gjinisë, ose edhe partisë ndonjëherë tjetër.

Jam absolutisht i vetëdijshëm që në botë 99% e atyre që mundë të kualifikohen si shovinistë janë meshkuj që besojnë që janë më të zotë se gratë, e tjera, e tjera.

Por nëse gratë nisin të thonë që ne jemi më të mira se burrat, veç pse jemi gra, edhe ky është një element i shovinizmit. Nuk e kam hallin që po më vjen inat, ose diçka. Por, nëse nisim të themi kështu, t'i transmetojmë në këtë mënyrë mesazhet që janë të vërteta, në fund të fundit, që jemi të barabartë, atëherë njerëzit që na dëgjojnë, fëmijët, të rinjtë, marrin mesazhe krejt të gabueshme se dikush koka më i mirë se dikush tjetër vetëm pse është i tillë.

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,

Më fal që i thashë këto për burrat dhe gratë dhe për shovinizëm, në pjesën e parë e thashë çfarë u desh të thuhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza Balje e ka fjalën. Suzan Novobërdaliu, urdhëro!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

E përshëndes Grupin e Aleancës kërkesën për debat për Raportin e Progresit. Gjithashtu, nuk më pëlqen mosprania e ministrave këtu, sepse jemi duke diskutua për një raport shumë të rëndësishëm, Raporti i Progresit, tetor 2012-tetor 2013, për të arriturat, nuk do të thosha sfidat, por ngecjet e Kosovës.

Për mua është shqetësuese, natyrisht u përmend edhe nga parafolësit ndërhyrja e politikës në punën e Gjyqësorit. Kjo është shkruar këtu në këtë raport, e gjithashtu edhe për mua është shumë shqetësuese, e nuk do të ndalem më shumë.

Në sistemin e burgjeve thuhet se trajtimi mjekësor është i pamjaftueshëm, shqetësime të rëndësishme lidhen me korrupsionin, nepotizmin, kontrabandën dhe diskriminimin në sistemin e burgjeve.

Disa të burgosur gëzojnë privilegje të zgjeruara dhe abuzojnë me sistemin. A thua cilët janë këta të burgosur që gëzojnë privilegje?

Për korrupsionin u fol mjaft dhe të thuhet që nuk ka, nuk mund ta gënjejmë vetveten. Në të gjitha hulumtimet kemi dalë se ka korrupsion, ka krim të organizuar. Në çdo shtet ku ka korrupsion, ka varfëri, ka papunësi.

Në këtë Parlament shumë është përfolur për azilkërkuesit tanë. Askush nuk do ta lërë vendin e vet, shtëpinë e vet, familjen e vet dhe të kërkojë azil në shtete tjera sikur t'i kishte kushtet në Kosovë. Edhe unë jam kundër kërimit të azilit, por jam që të rinjve tanë t'u krijohen kushtet të punësohen, që të mos kërkojnë azil në shtetet tjera.

U përmend Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale. Mua nuk më kujtohet, kërkoj falje nëse nuk më kujtohet, a kemi pasur rast që është konfiskuar pasuria e ndonjë personi, i cili ka fituar pasuri me vepër penale, e besoj që ka shumë që janë shumë të pasur dhe besoj që nuk e kanë fituar pasuri bash në mënyrë të ligjshme.

Unë do të ndalem pak në të drejtat e njeriut, në të drejtat e grave dhe në barazinë gjinore.

Këtu përmendet Ligji kundër dhunës në familje. Kemi infrastrukturë ligjore të mirë, jo vetëm Ligjin kundër dhunës në familje. E kemi Ligjin për barazinë gjinore, e kemi Ligjin kundër diskriminimit që deri më tani asnjëherë nuk është zbatuar, edhe pse tani e tetë vjet ka hyrë në fuqi. Mirëpo, për shkak të disa neneve aty ka qenë i pamundur implementimi i tij. Të njëjtin e kemi monitoruar, ndaj shumë mirë e di atë ligj.

E kemi Ligjin për familjen, Ligjin për trashëgiminë, por puna është sa zbatohen këto ligje? Do të thotë, është me rëndësi që ligjet të zbatohen, jo vetëm të miratohen në Kuvend dhe të ngelen të pazbatuara.

Përmendet këtu se qëllimi është të forcohet pozita e grave në procese vendimmarrëse dhe në strukturat e sigurisë. Qëllimi është ai. Por, ky qëllim nuk po realizohet, nuk kemi gra në vendimmarrje.

Përmendet se ende nuk është miratuar nga Kuvendi legjislativi për njohjen si viktime civile të luftës të të mbijetuarave dhe të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin.

I njëjti ka kaluar në leximin e parë, tani është në Komisionin për Komunitete dhe Kthim.

Mirëpo, sipas nenit 57, aty është bllokuar për shkak të disa fjalëve, të cilat nuk u kanë pëlqye në këtë propozim.

Mirëpo, sipas nenit 57, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, komisionet janë të obliguara të paraqesin amendamente. Në këtë rast flas për komisionet e përhershme dhe t'i procedojnë më tutje. Nëse kalon afati 10 ditësh, atëherë Komisioni Funkcional duhet të procedojë me ligjin. Do të thotë, në këtë rast këtë ligj nuk duhet ta lëmë të bllokuar në Komisionin për Komunitete dhe Kthim.

Sa u përket të drejtave të fëmijëve, a gëzojnë fëmijët të drejta të barabarta në Kosovë? Nuk gëzojnë.

Ushqyeshmëria, më së pari, a mund të themi se është e njëjtë për të gjithë fëmijët? Shëndetësia, trajtimi mjekësor? Nuk është. Arsimiti? Nuk është.

Arsimimi publik, ta ndajmë, edhe privat? Prapë, mund të themi se në shkollat publike arsimimi është më i dobët dhe në shkollat private ku zakonisht janë fëmijët e familjeve të pasura, kualiteti është ndryshe, arsimi është më kualitativ.

Pastaj mund ta ndajmë në arsimimin e personave me aftësi të kufizuara dhe arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, dhe këtu nuk kemi barazi.

Sa u përket rasteve sociale dhe personave me aftësi të kufizuara, unë i falënderohem Komisionit Evropian, po na lavdëron këtu, por nuk jemi për t'u lavdëruar, sepse e përmend që ka një strategji 2013-2023, e përmend një plan të veprimit 2013-2015. Kam kontakte të vazhdueshme me persona me aftësi të kufizuara, por as plani, as strategjia, nuk zbatohen.

Kemi tri ligje sa u përket personave me aftësi të kufizuara. Përkrahja materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, të cilat i marrin 100 euro dhe pastaj pas mbushjes së moshës 18-vjeçare e kemi ligjin tjetër, i cili thotë për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, ku vetë termi pensionet është diskriminues për një 18-vjeçar dhe kjo shumë nga 100 zbritet në 60, derisa aftësia është e kufizuar e përhershme.

E kemi Ligjin tjetër për aftësim dhe riaftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara, i cili parasheh që çdo i 50-ti person të jetë i punësuar, por ai nuk implementohet.

Gjithashtu, i kemi udhëzimet administrative, të cilat e rregullojnë qasjen në objekte për persona me aftësi të kufizuara. E dimë të gjithë se nuk zbatohet.

Më shumë fola për të drejtat e njeriut, sepse nga 35 kapituj për hyrje në Bashkimin Evropian, 18 u përkasin të drejtave të njeriut.

Dhe, kërkoj nga Qeveria që ligjet, të cilat ne i miratojmë në Kuvend, t'i implementojë. Gjithashtu, edhe në aspektin e të drejtave të njeriut të bëjë më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Skender Hyseni, nuk është këtu. Vjollca Krasniqi, sipas radhës.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

E nderuara ministre,

Unë do të doja të theksoja apo t'i nënvizoja disa nga vlerësimet e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit në disa fusha. Por, do të ndalesha më tepër në fushën e sigurisë.

Por, fillimisht do të them që edhe nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare ende po cilësohemi si vend i korrupsioni dhe krimit të organizuar. U cilësuam kështu para pak kohësh.

Gjithashtu, edhe në bazë të Raportit të Progresit theksohet se krimi i organizuar mbetet shqetësim serioz.

Nuk ka bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të Kosovës, në mënyrë që të jenë më efikase dhe efektive në hetime.

Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë demonstruar një hezitim për t'i nisur hetimet financiare. Si rezultat, numri i konfiskimeve dhe sekuestrimeve të urdhëruara nga Gjyqësori dhe të ekzekutuara nga Policia mbetet shumë i ulët.

Ashtu si raporti i vitit të kaluar, edhe këtë herë, ai thekson se Kosova ende mbetet vend origjine dhe transiti për viktimat e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit seksual për viktimat e trafikimit, që e ka në rritje numrin e viktimave të mitur.

Trafikimi i fëmijëve dhe shfrytëzimi i tyre me qëllim të lypjes së lëmoshës mbetet ende shumë i lartë. Shkalla e dënimeve për këto vepra dhe për këto krime mbetet e ulët.

Gjithashtu, në këtë raport sugjerohet, e që është thelbësore, financimi i qëndrueshëm për strehimore dhe riintegrimin e viktimave.

Një rritje e burimeve për Departamentin për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore nuk ka dhënë rezultate të pritshme.

Gjithashtu, theksoj prapë se ashtu sikur raporti i vitit të kaluar, edhe në këtë raport vendi ynë vazhdon të mbetet rajon transiti dhe kryesisht për ruajtjen e heroinës, që përfshin grupe lokale të krimit të organizuar.

Në përgjithësi, rritja e burimeve të Policisë që merren me luftimin kundër drogës ka pasur disa rezultate pozitive në sekuestrimin e drogës, mirëpo mbetet edhe shumë punë për të bërë.

Në këtë raport i është dhënë hapësirë edhe një çështjeje shumë të rëndësishme, siç është pastrimi i parave.

Theksohet që është miratuar një strategji për parandalimin e pastrimit të parave. Por, njëkohësisht, thuhet që nuk është miratuar ende plani i veprimit për strategjinë, që i bie se më tepër se një vit ky dokument mbetet vetëm në letër, ashtu siç kanë mbetur edhe shumë të tilla.

Institucionet për zbatim të ligjit dhe ato gjyqësore, si eksperiencia e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit që punojnë në rastet e tilla duhet të përmirësohet, duhet përmirësuar njohuritë e tyre për të trajtuar këto lloje të krimeve të ndërlikuara.

Kosova ka me bollëk mekanizma për të luftuar korrupsionin, ka strategji e plane veprimi, por nuk ka dhënë rezultate në këtë drejtim. Këshilli kombëtar, taks-forca kundër korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit, departamente të veçanta në kuadër të Policisë, por edhe mekanizma të tjerë përcjellës, këta mekanizma kanë qenë të pafuqishëm për të dhënë rezultate. Dhe udhëheqësit e këtyre mekanizmave vetëm e konstatojnë një gjë të tillë dhe flasin bile-bile na drejtohen edhe neve edhe qytetarëve se kemi korrupsion.

Një fakt që na përcjell në mënyrë të vazhdueshme dhe u potencua edhe nga kolegët tanë, mirëpo edhe mund të pasqyrohet edhe me këtë seancë të sotme që na përcjell në mënyrë të vazhdueshme, është çështje shqetësuese se si e vlerëson ky raport mungesën e anëtarëve të Qeverisë në këtë Kuvend, ata mungojnë në interpelanca, mungojnë në debate apo mbledhje të rëndësishme të komisioneve parlamentare.

Kjo parandalon Kuvendit për të kryer funksionin e tij mbikëqyrës.

Gjithashtu, ministritë kanë nevojë të përmirësojnë përcjelljet nga kërkesat e komisioneve parlamentare. Më duhet të theksoj edhe një çështje tjetër të cilën e ka konstatuar edhe ky raport, papunësia është shumë e lartë.

Shumica e të papunësuarve janë të pakualifikuara dhe numri i të papunësuarve me arsim universitar është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Ka pak mundësi punësimi, sidomos për rinjtë, kjo është një fjali taksative që gjendet në këtë Raport. Sfidat e vendit tonë janë përtej vlerësimeve të këtij raporti, kemi varfëri, papunësi, zhvillim të dobët ekonomik, shëndetësi të dobët, arsim jo cilësor, sport jo cilësor, kulturë gjithashtu, por shpresoj që do të duhej të vetëdijesohemi si institucione, si Kuvend, në përgjithësi si shoqëri që të punohet më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zonja ministre,

Kolegë deputetë,

Është për t'u përshëndetur sa herë që ka nisma në Kuvend të Kosovës dhe institucione tjera për të debatuar për një dokument kaq të rëndësishëm që është njëkohësisht edhe një udhërrëfyes për rrugën tonë drejt integriteteve evropiane.

Është mirë që ne që jemi përgjegjës jo vetëm për fjalën tonë, por për punën e institucionit të Kuvendit dhe institucioneve tjera, që jemi përgjegjës para qytetarëve, të mos lejojmë që në debate të tilla kaq të rëndësishme të marrim gati rolin e atyre që shpeshherë të njerëzve që i shohim në media e që nuk kanë përgjegjësi e që japin vlerësime sipas ideve të tyre ose sipas qejfeve të tyre.

Raporti i Progresit është kaq eksplisit, është kaq i saktë, kaq i drejtpërdrejtë sikur raporti për të gjitha vendet jo vetë të regjionit, por të gjitha vendeve që kanë aspiruar në Bashkimin Evropian.

Këtu pati komente edhe rreth gjuhës së raportit. Asgjë nuk ka ndryshuar as nga raportet tjera, as nga raportet e progresit për vendet që tashmë janë pjesë e BE-së, pra po përdoren principe të njëjta sikur ato që janë përdorur ose janë vendosur në vitin '97 nga BE edhe janë përsëritur ose po vazhdojnë të përsëriten vazhdimisht. Këto raporte bëhen nga një numër i madh i ekspertëve dhe mund të themi që shpeshherë ne nuk na konvenon gjuha e tyre, ka prej atyre nga ana jonë që do të dëshironim që të kishte një gjuhë më të mirë, një vlerësim më pozitiv sikur që ka edhe tillë që do të dëshironin të kishte vlerësime edhe më negative.

Pajtohem me profesorin Bajrami që tha që është mirë që të bëhet një krahasim edhe me raportet e regjionit. Unë do të dëshiroja të bënim një krahasim edhe me raportet e progresit të mëparshme për Kosovën dhe do të shohim dhe do të inkurajohemi sa shpejtë në Kosovë është hequr nga këto raporte se gjuha e vlerësimeve që ka pasur në raportet në fillim ose disa viteve të mëparshme ku është folur për lirinë e lëvizjes, për incidentet e ndryshme, eksese, sundimi i ligjit që ka qenë nga rastet më banale të përmendura në këto raporte të progresit.

Pra, kemi në këtë drejtim një përparim të dukshëm dhe është për t'u theksuar. Nuk na konvenon askujt nga ne ta ilustrojmë pozitivisht ose negativisht sipas principeve politike, përkatësive politike. Nuk i bëjmë shërbim askujt, qytetarëve, dhe institucioneve ne u

bëjmë shërbim nëse bëjmë vlerësimin real ose komentojmë realisht krejt ato që janë thënë në këtë raport.

Pse ky raport tashmë është më i veçantë ose komentohet pak më ndryshe? Jo për diçka tjetër, por Kosova vetë ka hyrë në një fazë tjetër, në një fazë goxha të rëndësishme. Kapitujt e këtij raporti janë po të njëjtit, në pjesën e parë ku flitet për marrëdhëniet me BE-në, përmendet në veçanti MSA-ja dhe normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Pse të mos theksohet pak më shumë pjesa e procesit të asociim-stabilizimit, ku Kosova tashmë në këtë periudhë për çka është ky Raport i Progresit, theksohet në veçanti?

Ju e dini që ka pasur komente të ndryshme edhe skeptike edhe shumë optimiste për këtë proces, por duhet të theksohet që është hera e parë që Kosova ka vendosur marrëdhënie zyrtare, kontraktuale me BE-në me këtë hap dhe pse mos të thuhet kjo, edhe pse ka pasur komente se nuk është rruga siç kanë qenë vendet tjera etj., por ajo që është e vërtetë është që Kosova ka filluar në këtë proces dhe institucionet e saja tashmë janë në punë e sipër në dialogun për këto marrëdhënie.

Dhe, po ashtu nuk duhet të harrohet përkundër vlerësimeve që u bënë këto ditë në Kosovë, zonja Eshton përveç asaj që ishte publike si vlerësim për Serbinë, shprehimisht kërkon ose thotë që duhet të përmbyllet ky dialog në kontestin shumë pozitiv. Pra, përmendet ky proces dhe inkurajohet Kosova që ta mbyllë sa më shpejt dhe po ashtu procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.

Shikoni nuk mund të flasim, kemi pasur këtu vlerësime të ndryshme sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, unë pajtohem me ministren që kërkoi që një debat tjetër të jetë nga ata që dëshirojnë, por pati edhe akuza nga këtu se ne dikush deputetët që i kanë dhënë sinjalin e gjelbër këtij procesi, kanë përgjegjësinë për krejt ato që po ndodhin në Kosovë. Por nuk është mirë kur flasim për Raportin e Progresit, të mos e shohim vlerësimin pozitiv në këtë drejtim që decidivisht të përmenden normalizimi në aspektin pozitiv i këtyre raporteve edhe u jepet rrugë krejt vendeve të ecin drejt BE-së dhe të theksohen vetëm ato që kanë të bëjnë me krimin, që kanë të bëjnë me korrupsionin në përgjithësi, me sundimin e ligjit dhe për çështje që duhet të përmirësohen edhe më tej.

Vlerësimi për Serbinë nuk është sipas asaj çka dëshirojmë ne, Be-ja dhe besoj që askush nuk e ka pasur këtë pritje, BE-ja e sheh nga një prizëm krejt tjetër Serbinë dhe sikur i sheh krejt vendet e regjionit dëshiron t'i përfshijë dhe t'i inkurajojë në rrugën drejt integriteteve evropiane.

Nuk dëshiroj të thellohem në secilin prej kapitujve, por më lejoni të citoj diçka që është thënë për Kuvendin edhe që këtu pati edhe vlerësime të ndryshme. Thotë: “Kuvendi është treguar i aftë të demonstrojë unitet politik dhe institucional në çështje kyçe” dhe ky është një vlerësim jashtëzakonisht domethënës për ne në Kuvend, pavarësisht që përmenden edhe çështjet tjera që duhet të tejkalohen, siç është puna e buxhetit, mbikëqyrja edhe më e madhe, por sa i përket mbikëqyrjes së institucioneve të ekzekutivit po ashtu përmendet se ka progres.

Te sundimi i ligjit, te korrupsioni, te krimi i organizuar, janë çështje të cilat po përcillen, janë në Raportin e Progresit për Kosovën vazhdimisht edhe në raportin e progresit të

vendeve të tjera. Mendoj që kur është fjala te korrupsioni përmenden çështjet e prokurimit. Ne vetëm javën që shkoi në Kuvend nuk arritëm ta miratojmë për një institucion të lartë të prokurimit edhe kjo mbetet dobësi jona, hajde të jemi më kreativ ne në Kuvend. Të bëjmë edhe tryeza bashkë me Qeverinë edhe me institucionet që të mos lejojmë që institucionet tilla të mos funksionojnë në kohën kur janë në thumb ose në fokus të korrupsionit.

Pra, duhet ta shohim përgjegjësinë tonë veç e veç edhe ne si Kuvend.

Është për t'u mirëpritur zonja ministre edhe komplimente për ato që thuhet në angazhimin tuaj personal në Raport të Progresit edhe për ndonjë ministri tjetër siç është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Por, gjithmonë këto komplimente, ky vlerësim pozitiv do të mbetet nën hijen e vlerësimit të përgjithshëm të procesit të integritetit në Kosovë përderisa ne të bëhemi pjesë e BE-së.

Pra, angazhimi juaj duhet t'i kalojë kufijtë e Ministrisë suaj dhe duhet të gjeni fuqinë t'i inkurajoni edhe më shumë njerëzit, institucionet përkatëse të jenë më të kyçur, më të fokusuar në këtë proces.

Nuk do të ishte mirë që një person i caktuar, qoftë shërbyes civil, departament, njësi e caktuar, ministri të mbetet nën hijen e një autoriteti të madh, qoftë patriotik a diçka tjetër të njeriut të caktuar nga e kaluara, e të mos i përmendet puna e mirë shumë patriotike cilido prej tyre që e bën në realizimin e agjendës evropiane. Duhet të theksohen meritat e secilit, sepse shoqëria jonë tanimë di t'i vlerësojë meritat nga e kaluara të secilit prej nesh, por pret më shumë nga ne për punën e sotme të secilit prej nesh. Në të njëjtën kohë duhet të fokusoni secilën herë e më shumë cilët janë shkaktarët e asaj që quhet stagnim në këtë proces?

Pse ne ta paguajmë taksën e një njeriu të papërgjegjshëm, qoftë shërbyes civil, qoftë pjesë e politikës që nuk e ka përmbushur detyrën e vet në agjendën evropiane, në ndërkohë ku krejt shoqëria jonë presim shumë më shumë që të kyçemi edhe të arrijmë atje ku duhet, në ndërkohë që kemi shumë për të bërë para nesh.

Unë këtë javë, zonja ministre, isha për një angazhim tjetër në Parlamentin evropian dhe takova disa grupe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza Balje e ka fjalën.

HAMZA BALJE: Hvala gospodine predsjedavajući!

Pozdravljam gospođu ministarku Čitaku.

Ja ću u kratkim crtama sasvim osvrnuti znači o izveštaju Evropske Komisije o napretku Kosova.

Ovaj Izveštaj koji pokriva period od oktobra 2012 do septembra 2013. godine usvojene od strane Evropske komisije i po meni dosta je objektivan. Napredak je pred određen na osnovu donetih odluka usvojenih zakona i njihove primljene. Informacije za ovaj Izveštaj

su dobijene od strane Vlade Kosova državne članice Evropske unije, evropske misije za vladavinu Zakona na Kosovu EULEX i informacije od strane raznih međunarodnih vladinih i nevladenih organizacija.

U ovom izveštaju stoji, danas je priznala od 104 zemalja članica Ujedinjenih Nacija među njima su i 23 članice Evropske unije. Da nastavljamo sa saradnjom međunarodnih zajednicom, naročitu reformama javne uprava vladine prava borbe protiv korupcije i tako dalje. Kosovo je na putu ka vizne liberalizaciji i postalalo je član Evropske Banke za obnovu i razvoj EBRD i da sa evropskom institucionom Bankom je potpisano okvirni sporazum sa našom državom.

U Briselu je takođe održano 17 sastanaka dva premijera o normalizaciju odnosa dveju država gde su postignuti određeni rezultati. Segmenata na kojoj bi se posebno osvrnuo jeste nedostatak da u ovom izveštaju stoji da osim ostalim ne većinskim zajednicama osim srpske kao što su podsećam znači Bošnjaci, Goranci, Turci Haškalije Egipćani koji se u ovom izveštaju vrlo malo ovaj spominju ili po nimalo i koji su tako mnogo doprineli u razvoju demokratskog društva Kosova tako da se njihova uloga ne sme i ne može marginalizovati u ovim izveštajima. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja, meqenëse e kom kaluar më parë radhën, e ka fjalën zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Sikurse edhe raportet tjera edhe me këtë raport Kosova u shpall vend me zhvillim të stagnuar, me gjyqësor të dështuar e me krim dhe korrupsion brenda shumicës prej segmenteve shtetërore.

Edhe pse me një gjuhë paksa diplomatike të përzgjedhur, ky raport e thotë po të njëjtën gjë që e thanë edhe raportet e kaluara të Komisionit Evropian. Pra, Kosova po degradon, në rastin më të mirë po stagnon. Fjalët “progres” dhe “përparim” kanë mbetur vetëm në titull të raportit, por nuk zënë vend në asnjë pjesë të dokumentit.

Ndër sfidat kryesore që përmenden në këtë raport janë mos finalizimi i reformës zgjedhore. Por, ne duhet ta themi një të vërtetë të madhe se kush është përgjegjës për mos finalizimin e reformës zgjedhore që dy vjet e tetë muaj prej kur është formuar kjo reformë. Pra, reforma zgjedhore nisi mbrapsht dhe kështu do ta ketë përfundimin.

Në anën tjetër, ne si subjekt politik përgjatë gjithë këtyre dy vjetëve e tetë muaj kemi bërë thirrje dhe kemi pasur qasje serioze karshi këtij procesi dhe kemi dhënë qëndrime me kohë për secilën prej çështjeve që është diskutuar në këtë komision, mirëpo nuk ka pasur vullnet për ta qar reformën përpara nga subjektet që nënshkruan marrëveshjen antikushtetuese dhe jashtinstitucionale, pra reforma zgjedhore mbeti peng i interesave partiake.

Sa i përket sundimit të ligjit, është theksuar se me sukses janë emëruar gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, por nuk theksohet fakti se edhe stafi i ri në gjyqësor është ndikuar dukshëm nga politika, duke i inkuadruar personat që kanë qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë aktiv në politikë ose kanë qenë të njohur si njerëz të para politikës.

Është theksuar në raport se i vetmi kanal i kontaktit të Republikës së Kosovës me Interpolin është administrata e mbetur e UNMIK-ut, ndoshta për këtë problem dhe neglizhencë do të duhej të na jepte përgjigje edhe ministri i Punëve të Brendshme, i cili duket se më shumë e ka qarë kokën për pasaporta e letërnjoftime biometrike se sa për një çështje që ndërlidhet me substancën e ushtrimit të sovranitetit shtetëror.

Raporti po ashtu thekson nevojën për ngritjen e kapacitetit financiar ku aktualisht sistemit gjyqësor i janë ndarë nga buxheti i Kosovës vetëm 0,47% të bruto produktit vendor. Këtë e ka theksuar edhe Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” për gjatë gjithë viteve kur është shqyrtuar buxheti i Republikës së Kosovës, mirëpo nuk kemi asnjë rritje të buxhetit sa i përket sistemit të drejtësisë.

Çështja tjetër e rëndësishme është trajtimi i kontrollit disiplinor në sistemin gjyqësor, ku në raport është theksuar se KGJK-ja ka shqiptuar brenda vitit vetëm 14 masa disiplinore, ndërsa Këshilli Prokurorial vetëm 11 sosh.

Raporti vëren se asnjëra nga këto procedura nuk kanë rezultuar me përjashtim të ndonjë gjyqtari apo prokurori. Kjo më së miri e tregon kontrollin e brendshëm të sistemit gjyqësor që pastaj materializohet me skandalet e shumta që vijnë nga ky sistem.

Sa i përket luftës kundër korrupsionit edhe pse në raport përmendet rrjeti i prokurorëve të cilët kanë qenë të angazhuar në mënyrë të veçantë që të merren me rastet, pra nga fusha e korrupsionit, si duket Komisioni Evropian nuk e ka vërejtur se ky rrejt është në shuarje e sipër. Është mirë për tu pyetur edhe Prokuroria e shtetit se pse nuk po funksionon ky rrjet, për shkak se ne do të duhej ta kishim një strukturë të specializuar brenda Prokurorisë Publike e cila do të duhej të merrej në mënyrë ekskluzive vetëm me rastet e luftimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Në raport përmendet bashkëpunimi i brishtë apo fare ekzistent ndërmjet agjencive të specializuara lidhur me luftimin e korrupsionit. Raporti gjithashtu përmend një sistem të gjerë zyrtarësh të gjitha niveleve që sipas të dhënave të Agjencisë Kundër Korrupsionit, janë më se 800 sosh që mbajnë më shumë e dy vende të punës, e ku disa i mbajnë edhe kah 5 vende të punës.

Duhet të ketë parasysh se përkundër rekomandimeve të dhëna Agjencia Kundër Korrupsionit, për rastet e konfliktit të interesit këto rekomandime nuk janë respektuar fare nga institucionet publike e kjo është për tu ardhur keq.

Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit është cilësuar me të drejtë si jo funksional. Në raport thuhet se takimet janë të rralla, si dhe asnjë rezultat konkret nuk është arritur nga ky trup institucional ashtu siç ka thënë përgjatë gjithë kësaj kohe lëvizja “Vetëvendosje” prej kur që është formuar ky Këshill Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Në përgjithësi raporti konsideron se nuk mjafton vetëm mbulimi i kornizës ligjore dhe strategjive për luftimin e korrupsionit, por për këtë nevojiten rezultate konkrete, gjë që në këtë rast mungojnë.

Sfidë tjetër në këtë raport mbetet edhe pamundësia e Kuvendit që ta kryej detyrën ashtu siç e përcakton Kushtetuta dhe Rregullorja e Punës e kjo vjen krejt si pasojë e Qeverisë së papërgjegjshme.

Në këtë raport përmendet pamundësia e Kuvendit për ta mbikëqyrur Qeverinë, kjo sidomos në kohën e pyetjeve parlamentare dhe jemi dëshmitarë të asaj që shumë prej pyetjeve që parashtrihen në seancat plenare ndaj ministrave apo kryeministrit, nuk marrim përgjigje.

Gjithashtu, mungesa e Qeverisë në interpelanca dhe presioni i Qeverisë që po ia bën Kuvendit duke kërkuar miratimin e projektligjeve me procedura të përshpejtuara vlen të përmendet këtu Ligji për amnistinë, i cili për një ditë u miratua edhe në shqyrtimin e parë e edhe në shqyrtimin e dytë pa pasur asnjë mundësi që të ndërhyjmë në të duke i ditur efektet negative të tij. Për atë arsye edhe shkoi procedura në Gjykatën Kushtetuese që Gjykata Kushtetuese nenet të caktuara i hodhi poshtë.

Problem tjetër që përmendet në këtë raport është edhe përfshirja e shoqërisë civile në grupet punuese të Qeverisë sa për sy e faqe. Shoqëria civile ende përballet me problemet e njëjta me të gjitha vërejtjet përmbajtjesore nëpër ligjet e sponsorizuara nga ministratë përkatëse, ato nuk po merren parasysh nga të njëjtat.

Kjo vlen edhe për institucionet që preken direkt apo indirekt nga ligjet, pra edhe pse ftohen në grupet punuese vërejtjet e tyre nuk po merren parasysh. Rastin e fundit e kemi me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhjetë vërejtje shumë përmbajtjesore të Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Drejtësisë.

Sa i përket ligjvënies apo nevojës të miratimit të ligjeve në këtë raport përmendet rregullimi i statusit të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, por Lëvizja “Vetëvendosje” ka ndërmarrë një nismë legjislative për futjen e personave të dhunuar në Projektligjin për vlerat luftës. Tashmë i njëjti me gjithë kundërshtitë që u bënë nga partia në pushtet, por edhe nga koalicioni qeverisës, i njëjti u miratua në parim, por edhe pse ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit ende nuk është sjell në seancë plenare për të votuar në shqyrtimin e dytë.

Pra, ai projektligj fillimisht u bllokua nga kryetarja e Komisionit për Komunitete dhe Kthim, Jasmina Zhivković dhe tani ka tendenca që të hiqen nenet të caktuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Mirëpo, ne i bëjmë thirrje Komisionit për Buxhet që të mos prek asnjë nen nga Projektligji që ka të bëjë pra, me personat e dhunuar gjatë luftës, sepse ne do ta kundërshtojmë fuqishëm këtë tendencë.

Raporti i Progresit do të jetë njëmend i tillë siç edhe e ka emrin, ku të gjithë bashkë të vendosim që rruga e Kosovës nuk është ajo nga po e dërgon Hashim Thaçi dhe mbështetësit e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuar ministre Çitaku,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Raporti i Progresit paraqet gjendjen reale të zhvillimeve njëvjeçare, të arriturat dhe sfidat. Bashkimi Evropian i ka vlerësuar këto përpjekje përmes pajtimit për të filluar negociatat për një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me Kosovën dhe ka përcaktuar kriteret politike.

Më tej thuhet se Kosova ka arritur kapacitetin e saj për ta adresuar prioritetet e procesit të integritetit evropian përmes ndjekjes së prioritetëve afatshkurtër të identifikuar në studimin e fizibilitetit, siç janë: sundimi i ligjit, administrata publike, mbrojtja e minoriteteve dhe tregtia dhe përmes përgatitjes për negociatat të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Raporti i Progresit ka cekur disa përparime të bëra në punën e Kuvendit dhe të Qeverisë, por ka rekomanduar që të bëhet më shumë, ndërsa, janë kërkuar rezultate konkrete në fushën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky raport ka shqyrtuar dhe vlerësuar shumë aspekte të qeverisjes dhe organizimit shoqëror në Kosovë.

Nga komisionet parlamentare është kërkuar për të siguruara kontrollin e buxhetit, sidomos në fushat e tilla si: shëndetësia, bujqësia, asistenca sociale, kultura dhe arsimi. Shtrohet pyetja: pse bash në këto ministri të kontrollohet buxhet dhe jo të mos kontrollohet buxheti në tërësi? A është në pyetje keq menaxhimi dhe keq përdorimi i buxhetit në ministritë e caktuara apo çka?

Shëndetësia nuk ka qenë asnjëherë prioritet i Qeverisë edhe pse është një sektor shumë i rëndësishëm. Skandalet në sektorin farmaceutik dhe në Qendrën Klinike Universitare tash së fundit e bën që ky sistem të mos jetë shumë i dëshiruar dhe shumë i vlerësuar.

Shëndetësia si e arritur është marrë Ligji i amandamentuar i shëndetësisë i cili ka hy në fuqi në maj të vitit 2013 dhe Ligji i duhanit, ndërsa si sfidë ceket shpenzimet publike në shëndetësinë mbeten më të ulëta në regjion dhe alokimet menaxhohen në mënyrë joefektive.

Investimet e mëtutjeshme në trajnime, infrastrukturë, shëndet mendor të komunitetit dhe bashkëpunim ndërministror janë të nevojshme. Kërkohen përpjekje të mëtutjeshme, përfshirë fondet për programin e kontrollit të kancerit para se të fillojnë programet e kontrollit.

Mungesa e të dhënave statistikore në shëndetësi, veçanërisht në shëndetin e nënës dhe fëmijëve mbeten brengë edhe më tutje.

Duhet të përmirësohet kapaciteti i sistemit informativ shëndetësor, për të siguruar statistika të besueshme shëndetësore në nivel qendror dhe komunal. Mbulimi i gjithë territorit mbetet sfidë.

Shpenzimet personale janë më të larta 40-60% dhe vazhdojnë të pengojnë përmbushjen e nevojave bazike për shëndetin e foshnjave dhe nënave, ushqyeshmërinë dhe shëndetin publik.

Në shumë investime në shëndetësi janë të nevojshme për të siguruar qasjen në shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët. Duhet të zbatohen principet e përgjegjësisë dhe ndarjes së detyrave, si dhe procesi i draftimit, rishikimit dhe implementimit të legjislacionit dhe alokimet e buxhetit.

Reformat e planifikuara duhet të aprovohen dhe implementohen. Fokusi duhet të jetë në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit dhe përdorim më efikas, më të tragetuar të resurseve të limituara financiare.

Komisioni Evropian në këtë raport vlerëson se Kuvendi i Kosovës ka bërë hapa në përmirësimin e mbikëqyrjes së Qeverisë dhe transparencës ndaj shoqërisë civile. Po ashtu, është vlerësuar se rritja e numrit të debateve parlamentare dhe interpelancave në ministri është një hap shumë pozitiv, ndërsa, kritikohet mungesa e Qeverisë në debatet parlamentare dhe në seancat parlamentare gjë që vlerësohet shumë shqetësuese.

Përmes këtij raporti Komisioni evropian ka bërë thirrje që të finalizohet procesi i reformës elektorale, si dhe të përmirësohet më tutje mbikëqyrja e Qeverisë. Raporti i bën vërejtje Kuvendit që të kuptojë më mirë rolin e vetë në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative.

Është kritikuar koordinimi i dobët i Kuvendit me Qeverinë në zgjedhjen e anëtarëve të bordeve, organizatave publike dhe dështimin në përcaktimin e mekanizmave për llogaridhënie nga këto borde.

Parandalimi i konfliktit të interesit, raporti i ka konstatuar se 800 zyrtarë publikë kanë nga 2 e më shumë vende pune. Agjencia ka rekomanduar që zyrtarëve të mos u lihet më shumë se një vend pune, por ky rekomandim nuk është përfillur. Shtrohet pyetja në këtë periudhë kohore ku përqindja e papunësisë është gati 40%, sa ka logjikë që dikush të mbajë 2 e më shumë vende pune, ndërsa dikush tjetër të jetojë me asistencë sociale.

Në raport po ashtu janë përfshirë edhe personat shoqërisht të rrezikuar dhe personave me aftësi të kufizuara thuhet se është përmirësuar korniza ligjore, prandaj miratimi i Ligjit për të verbrit, ligj i cili s'po implementohet edhe pse kësaj kategorie u është dashur që tu paguhet pagesa sipas ligjit prej janarit të këtij viti.

Po Qeveria në bashkëpunim me Kuvendit duhet të përmirësojë kapacitetet për të verifikuar dhe konfirmuar përshtatshmërinë ligjore kosovare me tërësinë ligjore evropiane.

Fakti se anëtarët e Qeverisë ende dështojnë të marrin pjesë në interpelancat e Kuvendit, apo në takimet relevante të komisioneve parlamentare, vazhdon të jetë një breng e madhe. Por, raporti nuk harron të cek se megjithatë me shumë përpjekje nevojiten për implementimin e legjislacionit, llogaridhënies dhe transparencës nga Qeveria qendrore dhe nga ajo lokale.

Raporti rekomandon përpilimin e një ligji të ri për t'i rregulluar pagat e zyrtarëve të lartë dhe për ta reformuar sistemin e pagave në sektorët e rëndësishëm, siç janë arsimi dhe shëndetësia. Kërkohen rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Te trajtimi i luftës antikorrupsion, Raporti i Progresit vlerëson miratimin e strategjisë antikorrupsion dhe hetimin e gjashtë rasteve nga Departamenti anti korrupsion i Policisë së Kosovës në bashkëpunim me EULEX-in.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka vazhduar të koordinojë zbatimin e strategjisë dhe ligjeve për deklarimin e pasurisë nga zyrtarë publik dhe për parandalimin e konfliktit të interesit.

Komisioni Evropian ka vë në dukje se megjithatë Agjencia Kundër Korrupsionit ka rekomanduar që zyrtarëve nuk ju lejohet që të mbajnë dy puna në të njëjtën kohë. Kosova për t'i përmbushur obligimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit duhet të implementojë kornizën legislative të politikave anti korrupsion dhe të jap prova konkrete në arritjen e rezultateve në luftimin e korrupsionit.

Kosova ka nevojë që t'i japë prioritet të lartë luftimit të korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë, sidomos në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës dhe trafikimit të armëve.

Në bazë të këtij raporti Kosova ende ka sfida të mëdha në përmbushjen e obligimeve të caktuara nga Komisioni Evropian. Andej dikasteret e ndryshëm kanë punë të madhe për të bërë deri në vitin e ardhshëm kur do të sillet raporti tjetër i Komisionit Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Raportin e Progresit do ta filloj me një koment që është i njohur dhe që lidhet me qëndrimin politik të BE-së dhe ky është shumë inspirues për qytetarët e Kosovës dhe ai tashmë është i akceptuar. “Kosova dhe Serbia së bashku në BE” është një kapitull i definuar për BE-në politikisht dhe është në implementim, por para se Kosova dhe Serbia të anëtarësohen ndaras në BE, ato duhet të shkojnë pa problemet që i kanë aktualisht dhe që i kanë pasur në të kaluarën.

Për këtë është bërë edhe hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës me kriteret dhe kushte, të cilat e çojnë edhe njërin, edhe shtetin tjetër në BE.

Hapja e negociatave erdhi pasi që Komisioni dhe përfaqësuesja e lartë e vlerësuan se janë të përmbushura të gjitha prioritetet afatshkurtra të kërkuara nga studimi i fizibilitetit. Pas shumë marrëveshjeve të arritura deri tani Kosova dhe qytetarët presin edhe përfundimin e dialogut të shumëpritur dhe të dëshirueshëm për liberalizimin e vizave.

Mbështetja financiare e deritashme nga BE-ja është e mirëseardhur dhe e vlerësuar nga të gjithë ne. Besojmë se mbështetja financiare për institucionet e Kosovës do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë ka qenë një nga kriteret dhe kushtet që i ka dhënë BE-ja për Kosovën. Është një kusht pothuajse i përmbyshur dhe i vlerësuar nga institucionet vendimmarrëse dhe ky kapitull ka zgjuar debat të ashpër mes nesh, por ka qenë një kusht i domosdoshëm dhe kriter i pakapërcyeshëm që na është vënë neve dhe natyrisht që me përgjegjësi të madhe ka pasur një qasje të theksuar nga Qeveria dhe Kuvendi, pavarësisht prej debateve që kemi pasur dhe pavarësisht prej mospajtimeve që kemi pasur për këtë kapitull.

Një nga kapitujt është edhe demokracia dhe sundimi i ligjit. Këtu në raport e kemi një vlerësim natyrisht më të avancuar se në raportet e mëparshme dhe kjo nuk duhet të na inkurajojë, por të na motivojë që në këtë kapitull, sidomos në demokraci dhe sundim i ligjit të gjithë të kontribuojmë dhe të perfeksionojmë ashtu siç kërkohet edhe me kriteret dhe standardet evropiane.

Në kapitullin e Parlamentit, natyrisht se aty i gjejmë ato zhvillime që ne i kemi përjetuar dhe që i njohim të gjithë. Ato i njeh edhe opinioni me vërejtjet që na janë adresuar, natyrisht se edhe jemi të kënaqur me këtë përshkrim që është bërë. Te kapitulli i Qeverisë, natyrisht se edhe këtu ka pasur vlerësime të njëpasnjëshme për veprimet që i ka bërë Qeveria dhe për politikën që ajo i ka zhvilluar aktualisht gjatë këtyre dy vlerësimeve që i ka bërë BE-ja.

Administrata Publike është njëri nga kapitujt që lënë për të dëshiruar dhe natyrisht që të gjitha vërejtjet do t'i kemi parasysh. Institucioni përkatës dhe do të ngrejë performancën e Qeverisë në Administratën Publike. Kapitulli i Avokatit të Popullit gjithashtu ka qenë një kapitull në të cilin është fokusuar BE-ja dhe funksionimi i këtij institucioni vlerësohet me thjerrëza të veçanta për arsye se këtu edhe është kërkuar që të jetë më aktiv dhe kërkohet edhe në të ardhmen që të jetë më i përkushtuar.

Është edhe një vlerësim, i cili natyrisht se është inkurajues - mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë. Këtu e kemi një kapitull mjaft të vlerësuar, por që për ne në filltet e implementimit të kësaj praktike ka qenë diçka që e kemi pasur të panjohur dhe të paakceptueshme, derisa na është imponuar që ta sendërtojmë këtë koncept dhe ta bëjmë tani të implementueshëm dhe funksional.

Kapitulli i shoqërisë civile është vlerësuar se është bërë një përparim i dukshëm, megjithatë është një performancë që autoritetet qendrore dhe lokale duhet ta përmirësojnë në bashkëpunim me shoqërinë civile, ashtu siç vërtet kërkohet dhe ashtu siç vërtet është e domosdoshme.

Një nga kapitujt që është trajtuar me shumë vëmendje është edhe sistemi gjyqësor. Është vlerësuar Kodi i ri Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, të cilët e kanë krijuar një fizionomi me cilësime, dhe aprovimin e një varg ligjesh në përputhje me legjislacionin evropian gjithashtu është vlerësuar si arritje e sistemit gjyqësor. Ndërhyrja politike në Gjyqësor është kritikuar duke apostrofuar rastet dhe kjo vërejtje është leksion që në të ardhmen është lehtë të përmirësohet dhe besoj shumë se nuk do të përsëriten në të ardhmen.

Edhe unë vetë personalisht, bashkë me ju këtu në këtë sallë, ndoshta pa dashur kemi bërë ndërhyrje në sistemin gjyqësor, e kemi bërë këtë dhe kjo nuk ka mbetur pa u hetuar, por është shumë me rëndësishme që të mos përsëritet në të ardhmen dhe është leksion që duhet ta kemi parasysh patjetër.

Përgjegjshmëria dhe efikasiteti janë dy sugjerime që do të ndryshojnë jo vetëm performansën e sistemit gjyqësor, por do të forcojnë integritetin dhe identitetin tonë shtetëror. Lufta kundër korrupsionit ka zgjuar debat të ashpër në shoqërinë tonë, por edhe këtu në Kuvend. Gjithashtu, edhe në Raportin e Progresit ka gjetur një vend të dukshëm dhe ka pasur një qasje jashtëzakonisht të vlerësuar nga BE-ja. Megjithatë, kjo duhet t'i inkurajojë institucionet e Kosovës dhe neve gjithsecilin veç e veç, që lufta kundër korrupsionit të vazhdojë, sepse është një domosdoshmëri, jo për t'i plotësuar kriteret për BE-në, por për ta përmirësuar jetën tonë.

Lufta kundër krimit të organizuar gjithashtu ka gjetur një fokus dhe ka pasur një trajtim në Raportin e Progresit, por kjo duhet të jetë detyrë e përhershme, permanente e institucioneve të Kosovës, dhe natyrisht që të gjithë nuk guxojmë të jemi indiferentë me këtë çështje për të cilën kërkohet qasje konstruktive dhe përkushtim i vazhdueshëm.

Sa janë evropianë qytetarët e Kosovës, u dëgjua edhe kjo pyetje dhe shtrohet vazhdimisht në debatet tona dhe këtu natyrisht se nuk kemi nevojë të deklarohe mi, por mjafton të meditojnë të gjitha autoritetet e BE-së dhe do të gjejnë mjaft fakte, sepse predispozicioni i qytetarëve të Kosovës për BE-në është jashtëzakonisht i theksuar dhe për faktin se ¼ e qytetarëve të Kosovës jetojnë në Evropë. Është po thuaj mbi 3 dekada e sipër, sidomos në këto tri dekadat e fundit e kemi ¼ e qytetarëve të Kosovës në Evropë dhe natyrisht që shkëmbimi i kulturave është bërë jashtëzakonisht i madh, por edhe nevojat e qytetarëve të Kosovës për të lëvizur, për të kontaktuar me familjarët e tyre të punësuar në Evropë i bën jashtëzakonisht të domosdoshme edhe integrimet tona.

Ndërsa institucionet e Kosovës, në këtë çështje duhet t'i ndihmojnë qytetarët që ta realizojnë ëndrrën e tyre evropiane. Koncepti evropian i Qeverisë është dëshmuar shumë herë, por sidomos me krijimin e Ministrisë së Integritetit Evropian është bërë mjaft transparente se kjo Qeveri në programin e saj e ka prioritet integrimin evropian. Edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Nga të gjitha institucionet e Kosovës kërkohet përkushtimi më i madh dhe një ngritje e shkallës së përgjegjësisë sonë në kryerjen e detyrave tona dhe kjo të mos bëhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Qysh në fillim duhet pranuar se është pikërisht raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, dokumenti që e pasqyron punën e Qeverisë së Kosovës brenda dy afateve raportuese. Nuk mendoj se këtu më së miri pasqyrohen të gjitha problemet, meqenëse për shumë gjëra ne këtu flasim vazhdimisht, por duket se Qeveria të gjeturat e

raportit i merr shumë më seriozisht sesa vërejtjet dhe sugjerimet që vijnë nga Kuvendi i Kosovës.

Kur kemi parasysh përmbajtjet dhe sugjerimet e këtij raporti, na duket sikur po i përsëritim gjërat për të cilat kemi folur gjatë vitit. E para, sa e sa herë kemi konstatuar se Qeveria e Kosovës nuk i jep llogari Kuvendit të Kosovës, përkatësisht ajo është e pakontrolluar nga Legjislativi. Kjo është një e gjetur e raportit të Komisionit Evropian, mirëpo duhet të rikujtoj se për këto të gjetura nuk ka ndonjë ndryshim të madh në raportin Kuvend-Qeveri. Për ilustrim, po përmend kërkesat e vazhdueshme që kryeministri të raportojë për dialogun nëpërmjet Kosovës dhe Serbisë, por kjo kërkesë është respektuar pjesërisht.

Në fillim dukej se punët do të shkonin mirë, ndërsa më vonë Qeveria sikur harroi se këtë e ka obligim kushtetues, si edhe obligim që del nga Rezoluta për dialogun. E tash nuk kemi informacione të plota se çfarë ka ndodhur vërtet në Bruksel, pse Serbia është shpërblyer me datën për fillimin e negociatave për anëtarësim, kurse Kosova vetëm se ka hyrë në procesin e negocimit dhe asociimit, apo deri në cilën masë po zbatohet marrëveshja e nënshkruar dhe sa po ndikohen ajo në forcimin e shtetësisë së Kosovës, si dhe në normalizimin e raporteve me Serbinë, apo çfarë po ndodh në sektorin e telekomunikacionit, të energjetikës, hekurudhave dhe tjera.

Prandaj, në këtë çështje gjërat ende janë shumë larg nga ajo që insiston raporti i Komisionit Evropian më tutje. ku edhe janë vërejtje më serioze e sektorit të gjyqësisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme në vend, përderisa ky sektor është joefikas dhe nën ndikimin e politikës, atëherë nuk mund të presim zhvillime të mira në sektorët e tjerë, meqenëse këtu merr epilogun lufta kundër paligjshmërisë - ajo kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, apo ajo për respektimin e kontratave, mbrojtjen e lirisë në punë, jetë apo biznes. Ka përplot raporte tjera që vetëm sa e forcojnë bindjen për këtë situatë. Vetëm t'ju përkujtoj se në raportin për perceptimin e korrupsionit, Kosova ka rënë nga vendi 105, në vendin 111.

Te sektori i ekonomisë, ndonëse në raport përmenden ecuritë pozitive rreth buxhetit dhe raporteve në Fondin Monetar Ndërkombëtar, megjithatë edhe këtu ngecë llogaridhënia e Qeverisë. Sado që plotësohet një formalitet procedural, duke e miratuar projeksionin e buxhetit apo bilancin përfundimtar të tij, mungojnë raportet më të detajuara për disa projekte kapitale, siç janë: rrugët, autostradat, e në vazhdë të kësaj në të shumtën e rasteve nuk përfillen vërejtjet për strukturën e zhvillimeve, përkatësisht Qeveria me kokëfortësi i ka mbrojtur përcaktimet e saj, të cilat kryesisht ishin të lidhura me premtimet elektorale.

Pastaj shqetësuese ende gjendet gjendja në sferën e prokurimit, meqenëse këtu ende ka parregullsi, duke filluar nga dyshimet për keqpërdorim dhe mungesë të transparencës.

Nga hulumtimet e ndryshme janë nxjerrë këto të dhëna për kontraktimin e operatorëve ekonomikë me çmime më të larta, janë nxjerrë raporte të vlerësimit pas dhënies së kontratës, ka neglizhencë apo edhe mungesë të mbikëqyrjes së zbatimit të punëve e tjera. Kjo gjendje mund të gjendet edhe te raporti i Auditorit të Përgjithshëm, ndonëse kjo

situatë është përsëritur disa herë. Për shqetësim është fakti se këto gjëra po ndryshojnë shumë ngadalë.

Kaptinë tjetër është hyrja dhe dalja nga tregu, ndonëse këtu përmendet shifra për numrin e bizneseve të regjistruara dhe atyre të shuara. Vlerësoj se këtu ende ka se çfarë të punohet. E kam fjalën për regjistrin e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, të cilat janë fiktive, apo nuk e paraqesin gjendjen reale në këtë sektor. Kur e them këtë, e kam parasysh se as 50% e bizneseve të regjistruara nuk paguajnë tatime, apo ato janë jofunksionale, ndonëse në regjistra figurojnë si biznese aktive.

Dhe, krejt në fund, është një kaptinë ku ecjet janë shumë të padukshme. E kam fjalën për përmasat e informalitetit, si dhe për përpjekjet për uljen e tij. Është shqetësuese sepse sipas të dhënave të institucionit mjaft të besueshëm, informaliteti merr diku rreth 40% të prodhimit të përgjithshëm vendor, ose në sektorin e punësimit diku 36% e punëtorëve nuk kanë kontrata pune, që do të thotë se ata nuk kanë asnjë mbrojtje, pra edhe nuk i nënshtrohen asnjë detyrimi ligjor.

Për fat të keq, nuk ka ndonjë përmirësim në këtë fushë, sado që Dogana apo ATK-ja e thonë të kundërtën, mirëpo lufta kundër informalitetit nuk mund të matet vetëm me shumën e parasë që këto dy agjenci kanë sjellë në buxhetin e Kosovës, por nëpërmjet zbatimit të ligjit në krejt sektorët.

Duke e pasur parasysh këtë situatë, Qeverisë së Kosovës do t'i sugjeroja që të mos kënaqet vetëm me fjalët e mira që mund t'i gjejë në raportet e Komisionit Evropian, por t'i lexojë me vëmendje gjetjet dhe vërejtjet. Aty duhet të fokusohet, meqenëse ende nuk ka bërë shumë punë sot, kur është në pyetje ekonomik, ngritja e mirëqenies sociale, apo për funksionimi i shtetit ligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Së pari duhet ta bëj një vërejtje për Raportin e Progresit, veçanërisht për përkthimin e raportit të progresit, sepse nëse ai lexohet në gjuhën shqipe është vështirë të kuptohet. Ka aq shumë keqpërkthime dhe keqinterpretime të termave që përdoren në Raportin e Progresit, e këtu e kam fjalën veçanërisht për pjesën e ekonomisë, që e bënë atë në gjuhën shqipe të pakuptimtë.

Pra, nëse BE-ja do të komunikojë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, me Qeverinë e Republikës së Kosovës, me qytetarët e Republikës së Kosovës, atëherë duhet të kujdeset më shumë për gjuhën me të cilën po komunikon. Po them BE-ja, nëse e ka përgjegjësinë, pra institucionet e saj e kanë përgjegjësinë për përkthim. Nëse përgjegjësia për përkthim i bie pastaj Qeverisë të Republikës së Kosovës, e nuk po di kujt bie, atëherë vërtet duhet të kemi më shumë kujdes, sepse, jo vetëm që është keq i përkthyer, por në shumë raste i është ndryshuar plotësisht kuptimi asaj që thuhet në Raportin e Progresit dhe nëse dikush e lexon vetëm në gjuhën shqipe, e që do të duhej të ishte norma, e jo përjashtimi në Kosovë, atëherë do ta keqkuptojë plotësisht atë se çfarë është thënë në të.

Çështja e dytë, po ndalem pak te ajo që e tha ministrja, pra në një debat që u zgjerua pak mendoj pa nevojën Kuvend për atë se çfarë është Raporti i Progresit. Pra, a është analizë, mbikëqyrje e punës vetëm e Qeverisë, institucioneve në përgjithësi, e kështu me radhë? Natyrisht që Raporti i Progresit e analizon në njëfarë mënyre krejt punën e institucioneve, por çështjet e rëndësishme jetike që ngrihen në Raportin e Progresit janë kryesisht të ndikuara nga puna e Ekzekutivit. Pra, edhe këtë të mos e mohojmë.

Natyrisht që edhe Kuvendi këtu e ka punën e vet, e ka edhe Gjyqësori, e kanë edhe të gjitha të tjerat, por janë shumë çështje që ngrihen në Raportin e Progresit, ku është evidentuar ose stagnim ose regres e kështu me radhë, të cilat kanë të bëjnë kryekëput me punën apo mospunën e Ekzekutivit dhe këtë nuk mund ta mohojmë. Pra, në njëfarë mënyre një pjesë e konsiderueshme e Raportit të Progresit merret drejtpërdrejt me punën apo mospunën e Qeverisë, apo me ngecjet e saj, e kështu me radhë. Dhe, mendoj që është e pasinqertë që në ato aspekte ku Raporti i Progresit tregon një progres, të merren meritat nga Qeveria, e pastaj te ato ku e tregon stagnim thuhet se ky është faji i të gjithëve. Pra, nëse meritat janë të Qeverisë, atëherë le të mbetet edhe faji i Qeverisë, dhe për shumë gjëra këtu është ose meritat ose faji i Qeverisë.

Çështja tjetër është që shpeshherë e dëgjuam edhe këtu në seancë, edhe në përgjithësi, ky lloj diskutimi që bëhet këtu në Kosovë nëse Raporti i Progresit është vërtet reflektim real i gjendjes në terren, apo nëse në lexime që po ia bëjmë ne deputetët e subjekteve të ndryshme po e shtrembërojmë realitetin, sepse po e shtrembërojmë reflektimin e realitetit që paraqitet në Raportin e Progresit. Mendoj që në shumë raste Raporti i Progresit është më i mirë se sa është gjendja në terren. Ky është problemi.

Pra, atë që ne e shohim në Raportin e Progresit, ose disa përmirësime e progrese të vogla që evidentohen këtu, janë në fakt ato që nuk shihen në terren. Nuk po them që nuk ekzistojnë si progres, por janë ato të cilat pak ose fare pak po e ndryshojnë gjendjen për të mirë në terren, me gjithë faktin që në pasqyrën në të shkruar, të them ashtu, po reflektohen sikur gjëra pozitive, të cilat ka dhe po ka shumë dëshirë dhe interes Qeveria t'i shtyjë përpara.

Dhe, mendoj se kur flitet për moskeqinterpretimin e Raportit të Progresit, pra kur flitet dhe deputetët ftohen që t'i bëhet një lexim real i kësaj pasqyre reale, siç po quhet, i gjendjes në terren, atëherë mendoj se e njëjta do të vlejë edhe për Qeverinë.

Për shembull, në fjalën e ministres, unë vërejta sa u përket disa aspekteve ekonomike që bëhet një gjysmëlexim i asaj që thuhet në Raportin e Progresit dhe ky gjysmëlexim është keqlexim. Dhe, mendoj që gjëra minimale që ne e presim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, jo vetëm nga kjo Qeveri, por nga secila qeveri, është që të dijë të lexojë, pra që të lexojë mirë, të lexojë atë që është shkruar në Raportin e Progresit.

E tash i kam dy shembuj për ta argumentuar këtë që e thashë. Kur fliste për të hyrat, edhe vendore, edhe nga Doganat, pra që u referohej paragrafëve të veçantë të Raportit të Progresit, ministrja e lexonte vetëm gjysmën e saj. Pra, për shembull, te të hyrat nga Dogana tha se ka pasur rritje në vlerë rreth 844 milionë euro, siç thuhet në Raportin e Progresit, kjo është 2,2% më shumë se në vitin 2011, dhe këtu e përfundoi fjalinë ministrja. E fjalja vazhdon, është presje, dhe pas presjes thuhet: por 32 milionë më pak se

të hyrat e planifikuara, pjesërisht për shkak të një reduktimi në importe, pra për shkak të reduktimit të zvogëlimit të importeve, dhe kjo mendoj që për ta paraqitur saktë se çfarë thotë Raporti i Progresit, pra një e dhënë që e dimë të gjithë, sepse është e dhënë kokëfortë në këtë tast, duhet ta themi fjalinë e plotë që ka pasur rritje në krahasim me vitin 2011, por ka pasur rënie në krahasim me planifikimin që tregon që ose ka pasur rënie të aktivitetit ekonomik krahasuar me planifikimin që ia ka bërë Qeveria, ose Qeveria nuk di të planifikojë, ose qëllimisht planifikon më shumë, vetëm e vetëm sa për ta kaluar buxhetin dhe pastaj e marrim vesh në fund të vitit që planifikimet kanë qenë joreale, siç ka ndodhur shpesh për shembull gjatë këtyre viteve të fundit.

E njëjta gjë pastaj është edhe për zbërthimin në përqindje të të hyrave, edhe të hyrave vendore. Pra, që e ka rritjen rreth 2% më shumë krahasuar me vitin 2011, por ka 7% më pak sesa ishte planifikuar dhe këto mendoj që e tregojnë aktivitetin ekonomik të vendit, i cili, siç është vlerësuar në Raportin e Progresit, pra në fillimin e kapitullit për situatën makroekonomike është në stagnim. Pra, ka stagnim dhe dëmtim, madje dobësim të rritjes dhe të zhvillimit.

Po ashtu, këtu është përmendur, në të njëjtën faqe, pra në faqe 32, në versionin shqip që të ardhurat e mbledhura nga Administrata Tatimore, me gjithë faktin që shënojnë një rritje prej 9%, krahasuar me vitin 2011, përfaqësojnë një përqindje më të vogël të bruto-prodhimit vendor sesa në vitin 2011. Pra, shumë interesante kjo e dhënë, dhe mendoj se është një e dhënë që duhet të interpretohej. Do të kishte qenë mirë prandaj që të kishin qenë këtu edhe ministrat e sektorit, pra ata që e mbulojnë, sidomos ministri i Financave, pse jo edhe ministri i Ekonomisë për ta interpretuar bashkërisht këtë të dhënë, sepse kjo është diçka absurde.

Pra, në kohën kur po thuhet se ka rritje të ekonomisë, ka rritje të bruto-prodhimit vendor, pa ndryshuar asgjë, ose pa pasur ndonjë ndryshim substancial në paketën fiskale, në sistemin tatimor të Kosovës, ne kemi rënie të përqindjes që e nxjerrim nga ky prodhim, ose rritje të prodhimit vendor në formë tatimesh. Po çfarë është duke ndodhur këtu? Ose nuk po mblidhen tatimet, pra po rritet evazioni fiskal, ose, në anën tjetër, nuk ka përputhje ndërmjet bruto-prodhimit vendor të rritur, ose përqindjes së rritjes së bruto-prodhimit vendor që po na paraqitet, e në anën tjetër reflektimit real të kësaj rritjeje pra në të hyrat tatimore që ne i mbledhim. Sepse, nëse rritja e prodhimit vendor në përgjithësi është për 5%, ta zëmë brenda vitit, atëherë me sistemin e njëjtë tatimor edhe të hyrat do të duhej të ishin të rritura për të njëjtën përqindje, po që se mbetet ekonomia në gjendjen e njëjtë, mirëpo meqenëse këtu kemi rritje ekonomike, atëherë kjo tregon se është dashur të rriten edhe tatimet që mblidhen nga kjo ekonomi.

Përgjithësisht, për sa u përket kritereve ekonomike të stabilitetit makroekonomik, në Raportin e Progresit është vërejtur që situata e përgjithshme ekonomike pra mbetet sfiduese për shkak të shkallës së lartë të papunësisë dhe për shkak të mungesës së zhvillimit. Pra, kjo pastaj në njëfarë mënyre argumentohet me dy gjëra kryesore, me dy çështje kryesore, pra në njërën anë e kemi rënie të investimeve të huaja, për të cilat ministrja po ashtu na tha që kanë shënuar ngritje, por në Raportin e Progresit thuhet që janë të nivelit të njëjtë që kanë qenë në vitin 2005.

Pra, kjo është rënie, sepse pre vitit 2005 për çdo vit ka pasur një ngritje të lehtë të investimeve të huaja direke dhe në vitin 2012 pastaj kanë rënë këto investime në atë nivel dhe kryesisht kanë shkuar në sektorin e patundshmërive dhe të ndërtimeve dhe 12% prej tyre në shërbime financiar. Pra, vetëm 13% janë të kanalizuar në prodhim, që nënkupton që edhe ata sektorë të ekonomisë të cilët po rriten janë në njëfarë mënyre sektor, t'i quaj ashtu, të vdekur ekonomikë, sepse nuk është se e kanë prodhimin e vazhdueshëm dhe rritjen e mirëqenies vazhdimisht për qytetarët e Kosovës.

Dhe, çështja e fundit për cilin dua të flas, meqenëse më ka mbetur edhe pak kohë, është çështja e sistemit financiar. Pra, sikur Qeveria, edhe Raporti i Progresit në njëfarë mënyre e paraqesin sistemin financiar si të suksesshëm, por duke u nisur nga fakti që ai nuk është pranë kolapsit. Pra, mbijetesa është njëfarë mënyre sukses tash në Kosovë, në ndërkohë që të dhënat që paraqiten këtu pastaj tregojnë që sistemi financiar në asnjë mënyrë nuk po i shërben kreditimit të ekonomisë së vendit.

Pra, këtu thuhet që kanë rënë shumë investimet me 29%, kanë rënë investimet ose kreditë për investime në ato korporatat jofinanciare pra, ndërkohë që kreditë konsumatore dhe hipotekare janë rritur fuqishëm me 45%, respektivisht 17%, krahasuar me vitin e kaluar, që nënkupton që paratë e qytetarëve të Kosovës të deponuara...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kymete Bajraktari e ka fjalën

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të drejtat e njeriut dhe respektimi i tyre nga e tërë shoqërisë në Republikën e Kosovës lë shumë për të dëshiruar. Në Raportin e Progresit janë adresuar problemet e shumta dhe të natyrave të ndryshme, si në nivelin lokal, ashtu edhe atë qendror.

Moszbatimi i ligjeve është një ndër problemet kyçe, probleme të cilat funksionimin e shtetit e vënë në pikëpyetje. Skandalet e ditëve të fundit në arsim, shëndetësi, në respektimin e të drejtave elementare të njeriut, lirinë e lëvizjes, lirinë e shprehjes së lirë, të drejtën për jetë në vitin 2013 tregojnë se trafikoni përmbushjes së standardeve evropiane po bie, ose për një moment krijohet perceptimi se ka filluar luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar, por të gjitha këto zhvillime assesi nuk po ma mbushin mendjen se është kjo e dyta.

Se Qeveria është jofunksionale dhe nuk është e përkushtuar për t'i kryer detyrat tregon mungesa e vullnetit për t'i përmbushet obligimet ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës. Plotësim-ndryshimet e ligjeve, të cilat ishin në plan të dërgoheshin në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, e të cilat janë 6, siç është plotësim-ndryshimi i Ligjit kundër diskriminimit, Ligji për barazi gjinore, Ligji për paraplegjikë dhe tetraplegjikë, plotësim-ndryshimi i Ligjit për liritë fetare, Ligji për të drejtat e fëmijëve, Ligji për Avokatin e Popullit, asnjëri tyre deri më tani nuk ka ardhur në komision.

Zbatimi i ligjeve në Raportin e Progresit është sfidë për Qeverinë. Rast skandaloz e kemi Ligjin për personat e verbër, ligj i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, ndërsa me rishikim të buxhetit janë ndarë 1,4 milion euro për zbatimin e tij. Gjatë procesit të monitorimit të ligjit nuk kemi marrë përgjigje se pse nuk bëhet kompensimi i personave të verbër sipas ligjit në fuqi. E papranueshme dhe e mjerë ishte situata kur ministri nuk mund të gjente arsye se pse nuk po implementohet ligji.

Grupet e marginalizuara në shoqërinë tonë ende nuk janë prioritet i Qeverisë dhe i shoqërisë sonë. Në Raportin e Progresit janë identifikuar disa aktivitete të Ministrisë së Punëve të Brendshme kundër krimit të organizuar dhe trafikimit me qenie njerëzore. Kosova ende është vend origjine dhe transit për viktimat e trafikimit për qëllim të shfrytëzimit seksual me një rritje të numrit të viktimave të mitur. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të fokusohet në luftën kundër trafikimit të fëmijëve.

Instituti për Krimet e Luftës si duket vetes i ka dhënë pushim. Edhe pse ka dy vjet që është krijuar, asnjëherë nuk kemi pasur raporte për aktivitetet apo punët e kryera nga ky institut, derisa në raport përmendet formimi i grupit ndërministror që merret me të kaluarën dhe me procesin e pajtimit. Për mua është absurdi i kohës që të kërkohet pajtimi i viktimës dhe kriminelit pa u dënuar krimi i bërë. Atëherë, kë do ta pajtojë ky grup ndërministror? Derisa jemi te krimet e bëra gjatë luftës në Kosovës, çështja e personave të zhdukur ende është çështje e dhimbshme për Kosovën. E bëhet edhe më e dhimbshme kur ministrat e kësaj Qeverie premtojnë se do të angazhohen për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Në raport thuhet shumë qartë se Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Kryeministrit duhet të investojnë më shumë në këtë çështje. Se çështja e personave të zhdukur është problem politik, kjo dihet botërisht, e që vërtetohet edhe në raport, ku thuhet se gjetja e mbetjeve mortore varet nga vullneti politik. Çështje në vete është raporti i EULEX-it për statistikën e mbetjeve mortore, si dhe rezultatet e bëra publike në raportin e vitit 2012.

Në raportin e vitit 2012, në krahasim me vitin 2011, mungonin mbi 250 mbetje mortore të djegura, të cilat ishin bërë publike në raportin e vitit 2011. Në pyetjen se pse në raportin e vitit 2012 nuk ishte ky numër, zoti Allan Robinson u përgjigjës se ai kishte vendosur kështu, e kjo i bie kur të më teket mua i vendos në raport, e kur të më teket i largoj. E fatin tonë dhe të fëmijëve tanë e kemi lënë në teket e të tjerëve. Sipas të gjitha gjasave, ministri i Punëve të Jashtme ende nuk ka bërë kërkesë që të bëhen hulumtime në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë për mbetjet mortore të personave të zhdukur, për t'i hequr dyshimet se a ka mbetje mortore atje. E si pasojë e kësaj, nuk kemi një marrëveshje formale për hulumtimin e personave të zhdukur në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë.

Duke mos hyrë në analizë në zhvillimin ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, shihet se na presin sfida të shumta që qytetarët e Kosovës të sigurojnë mirëqenie. Nëse vazhdojmë kështu, do të shkojmë në mes të hiç-gjësë, ndërmjet jetës pa dinjitet, pa krenari dhe pa ardhmëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi edhe 13 diskutues. Mendoj se duhet të bëjmë pauzë deri në orën 15:00, kur do të vazhdojmë me diskutimet. Faleminderit!

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Vazhdojmë me debatin, i cili ka marrë shumë kohë. Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të fokusohem në fjalën time për pjesën e Raportit të Progresit që flet lidhur me debatin për rastin “Kiçina” dhe po e filloj me fjalimin tim me pjesën hyrëse të sqarimit tim të plotë për debatin parlamentar lidhur me rastin “Kiçina”, të botuar në gazetën “Koha Ditore”, më 30 tetor 2013.

Raporti i Progresit për Kosovën, “Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për vitin 2013-14”, përveç tjerash, në vete ngërtheu edhe vërejtjen sa i përket debatit për rastin “Kiçina”, në të cilin ky rast është cilësuar si ndërhyrje në Gjyqsor dhe si një rast shqetësues.

Në Raportin e Progresit thuhet: “Vendimi i Kuvendit për të debatuar për rastin ‘Kiçina’ (ku ish-anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë gjetur fajtorë për vrasje) dhe tentativa për ta adoptuar vendimin, i cili ndërhyr në procesin gjyqsor, shënon një hap prapa për përpjekjet e Kosovës në ndërtimin e institucioneve të pavarura dhe qeverisjes demokratike. Kjo është një çështje e shqetësimit serioz”, marrë nga varianti në anglisht i Raportit të Progresit.

Me debatin e zhvilluar të rastit “Kiçina” në Kuvend, në asnjë mënyrë nuk ka qenë tendencë që të influencohet vendimi gjyqsor.

Qëllimi ka qenë të vërtetohen lëshimet procedurale gjatë procesit të ngritjes së aktakuzës pa prova relevante, gjë e cila edhe ka ndodhur.

Dënimi i personave pa fakte, të cilat thuhet edhe nga gjykata, se janë zhdukur, është padrejtësi e madhe dhe cenim i të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky ishte edhe qëllimi i atij debati.

Sipas juristëve me përvojë, zhdukja e provave dhe procedimi i rasteve pa prova është krim në vete.

Pra, çuditërisht edhe Komisioni Evropian për dy raste të ngjashme të debatuar në Kuvendin e Maqedonisë, i njohur si rasti i ‘Sopotit’, nuk është kualifikuar si ndërhyrje në drejtësi nga Komisioni Evropian.

Pas punës së Komisionit Hetimor Parlamentar janë gjetur prova për lëshimet procedurale dhe si rezultat i rekomandimeve nga ai komisioni hetimor ka rezultuar me organizimin e procesit të mëparshëm dëgjimor, me çka ka fituar drejtësia, duke e zbardhur të vërtetën.

Motivin për atë debat e kemi marrë nga shembuj si ai i Maqedonisë, debateve në Parlamentin e Britanisë së Madhe, si dhe debateve të Parlamentit Evropian, veç e veç për raste të ngjashme.

(Pjesë e diskutimit e dorëzuar me shkrim.)

Të nderuar deputetë,

Pas këtij raporti, unë si përfaqësues i qytetarëve të Kosovës ndihem i obliguar moralisht që për hir të opinionit dhe, mbi të gjitha, për hir të së vërtetës, i vetëdijshëm për peshën dhe rëndësinë që ka, për drejtësinë tonë, të sqaroj edhe një herë qëndrimin tim lidhur me rastin “Kiçina”, që ishte iniciativë imja, e mbështetur edhe nga 84 kolegë të tjerë - deputetë shqiptarë dhe të të gjitha nacionaliteteve të tjera.

Ashtu siç e kam përmendur edhe më herët, kam shpresuar se iniciativa për të debatuar në Kuvend për rastin “Kiçina” nuk do të ndikojë në përmbajtjen e Raportit të Progresit për Kosovën, por edhe nëse do të ndikonte do të duhej përfshirë si element pozitiv për ta vënë në vend drejtësinë dhe të vërtetën.

Por, ndodhi e kundërta. Trajtimi i rastit “Kiçina” nga Legjislativi u keqkuptua nga Komisioni Evropian.

Kur them u keqkuptua, kam parasysh dy objektiva që kanë qenë bazikë në këtë nismë:

- a) Qëllimi i Legjislativit assesi nuk ka qenë ndërhyrja në Gjyqësor, dhe
- b) Kërkesa e shprehur nëpërmjet peticionit nga 52 000 qytetarë të Republikës së Kosovës për ta zbardhur të vërtetën në këtë rast, si dhe faktet e ndriçuara në rastin “Kiçina”, mua dhe deputetet tjerë na kanë shtyrë dhe bërë të besojmë, si atëherë, por edhe sot, se kemi të bëjmë me një rast skandaloz të shkeljes së të drejtave të njeriut nëpërmjet një gjykimi të padrejtë, duke shpallur fajtorë qytetarë të pafajshëm. Rasti Kiçina nuk është i pari dhe i vetmi ku organet e drejtësisë, mbi bazën e akteve të sajura, kanë marrë vendime të gabueshme. Në dijeninë time, ky gjykim, por edhe raste të tjera, ka ndeshur në shqetësimin jo vetëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por edhe me gjerë se kaq.

Në vijim do t’i numëroj faktet kryesore se pse trajtimi i rastit “Kiçina” nga Legjislativi nuk mund të përkufizohet si ndërhyrje në drejtësi:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 70, pika 1, thotë: “Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues”.

Gjithashtu, neni 77, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë: “Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore”.

Ndërsa, iniciativa ime është përkrahur nga mbi 2/3 e deputetëve për formimin e një komisioni ad hoc për verifikimin e shkeljeve procedurale dhe të drejtave dhe lirive të njeriut në rastin “Kiçina”.

Andaj, veprimet e Legjislativit kanë qenë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

- Të gjithë jemi të vetëdijsëm se puna e Gjyqësorit është e ndarë nga puna e ligjbërësit.

Ne, me nismën tonë nuk kemi synuar që të ndërhyjmë në punët e drejtësisë, e këtë më së miri e bën të ditur fakti se kjo nismë ka filluar, pasi janë mbyllur të gjitha procedurat dhe është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Nëse do të ndodhte e kundërta, atëherë me të vërtetë do të mund të konsiderohej si ndërhyrje në drejtësi;

- Angazhimi im dhe i 84 deputetëve tjerë është përpjekje për t'i zbardhur shkeljet procedurale dhe shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, për të cilat ekzistojnë dyshime të bazuara;
- Është e patolerueshme dhe në kundërshtim me të gjitha dispozitat ligjore që në një shtet demokratik, një proces gjyqësor të mbyllet pa i konsultuar të gjitha provat dhe faktet që saktësisht dëshmojnë pafajësinë e të akuzuarve, sikurse ndodhi në rastin “Kiçina”.

Asnjëra prej provave nuk u mor për bazë, nuk u tha në gjykatore, e as në opinion, sepse e dëshmonin pafajësinë e plotë të të akuzuarve.

Vetë humbja e fakteve, provave dhe gjurmëve nga vetë hetuesia shërben të dyshojmë shumë që dikush është interesuar që të mos zbardhet e vërteta.

- Ka shumë shembuj në botë, kur njerëzit e kanë pësuar fatalisht, janë dënuar dhe ekzekutuar, kurse më vonë procedurat tjera e kanë vërtetuar pafajësinë e tyre, mbi bazë faktesh dhe të vërtetimit nëpërmjet ADN-së.

Në rastin “Kiçina”, këto prova janë humbur qëllimisht, e në vendet demokratike, kudo në botë - ligji dhe drejtësia janë të paprekshme.

Dhe, ky shembull është udhërrëfyes për iniciativën time dhe do të jetë udhërrëfyes për punën time të mëtejme në Parlamentin e Kosovës dhe kudo në jetën time.

Të dashur qytetarë dhe opinion i gjerë,

A nuk ju duket e çuditshme sjellja dhe veprimi i një personi me ndikim në rastin “Kiçina”, siç ishte ish-oficeri i SHPK-së, tani oficer i lartë i PK, nëse mund ta quaj oficer, për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara se kishte shpikur rrëfimin e Blerim Kiçinës dhe i kishte vënë në lajthitje edhe hetuesit ndërkombëtarë, duke i bindur ata se kishin zbuluar autorët e vrasjes.

Po i njëjti, më 29.8.2013 është suspenduar nga Agjencia e Kosovare të Inteligjencës.

Ky akt e rikonfirmon fuqishëm gjithë qëndrimin dhe deklaratimet e mia të vazhdueshme si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për figurën e dyshimtë dhe të rrezikshme për vendin dhe proceset tona të Fadil Syleviqit.

Përndryshe, unë si deputet i Kosovës jam ithtar i flaktë i agjendës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për ruajtjen e kohezionit, dinamikës dhe unitetit politik në agjendën evropiane, duke e konsideruar atë të rëndësisë prioritare për Kosovën.

Këtë e kam dëshmuar tashmë dhe do të vazhdoj që të punoj bashkë me kolegët e mi deputetë, ashtu që Kosova në një të ardhme të jetë shtet anëtar i Unionit Evropian.

Për më tepër, vlerat evropiane janë modeli ynë në shtetndërtimin e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Kryesues!

Propozimi ynë është që të shkurtohen fjalimet në 5 minuta, por nuk ke nevojë ta hedhësh në votim, se të gjithë që jemi duke pritur për fjalë, pajtohem.

KRYESUESI: Regjia, fjalën zotit Sadri Feratit fjalën për procedurë.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Unë pajtohem me propozimin e zonjës Bajrami që diskutimet të kufizohen në 5 minuta, ndërsa unë personalisht edhe 2 minuta ua fal ministrave, deputetëve që nuk janë këtu, dhe vetëm një minutë për hir të këtyre që janë këtu do ta mbaj fjalën. Vetëm 1 minutë, sepse nuk meritojnë ndryshe. Faleminderit!

KRYESUESI: Regjia, edhe një herë fjalën zonjës Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, ky debat parlamentar më shumë i ngjan një monologu sesa një dialogu, qëllimi i të cilit është që të dialogohet ndërmjet deputetëve, kryesisht atyre të opozitës dhe të Qeverisë. Është shumë keq dhe kjo u theksua nga të gjithë parafolësit që ministrat nuk janë këtu.

Unë do të flas sot këtu për kriteret ekonomike dhe ngecjet në përmbushjen e kriterëve ekonomike dhe është shumë keq që asnjëri nga ministrat e shumtë që merren me fushat e ndryshme të ekonomisë sot nuk janë prezentë. Unë nuk e di se cilat janë ato aktivitete më të rëndësishme se këto kur Parlamenti u drejtohet atyre.

Poenta e këtij debati nuk është që ne t'i lexojmë statistika dhe të gjeturat e raportit, sepse të gjithë kemi qasje në të, është në ueb-faqen e Ministrisë së Integritetit Evropian. Poenta është që ne t'i pyesim ministrat se pse janë këto ngecje, pse janë këto ndryshime, ku ka progres, ku ka regres dhe të na tregojnë se cila është rruga dhe si mendojnë ata që t'i zgjidhin këto probleme. Do të thotë, qysh do të ecim ne së bashku në rrugën e integritetit evropian.

Tani, meqenëse nuk kemi me kë të dialogojmë, unë po i përsëris ato të gjetura të raportit. Raporti thotë se situata e përgjithshme ekonomike mbetet sfiduese, papunësia është e lartë, rritja e bruto-produktit vendor ka zbritur nga 4,4%, sa ishte në vitin 2011, në 2,5% në vitin 2012, dhe vazhdon të mbetet e ulët edhe në gjysmën e parë të vitit 2013.

Sfidë është edhe prodhimi i statistikave, që ne e kemi cekur vazhdimisht, sepse kjo paraqet një pengesë për vlerësimin gjithëpërfshirës të situatës ekonomike. Bruto-produkti vendor apo GDP ka arritur në 4,7 miliardë dhe kështu mbetet vetëm 11% e mesatares së 27 vendeve të Bashkimit Evropian, pothuajse në nivelin e njëjtë në krahasim me vitin 2011.

Është përkeqësuar ecuria e eksporteve të mallrave, duke rënë në vetëm 1% të bruto-produktit vendor. Deficiti tregtar mbetet tepër i lartë në 35,1% të bruto-produktit vendor, që tregon se prodhimi vendës ende është tejte i ulët dhe me kapacitet të munguar. Ndërkohë që sipas raportit e kemi nivelin më të ulët të investimeve të huaja direkte që nga viti 2005, që është 4,3% të bruto-produktit vendor.

Papunësia mbetet e lartë, me shifra zyrtare prej 35,1%, kurse metodologjia ka ndryshuar dhe thuhet se nuk lejon krahasim me vitet paraprake. Raporti gjithashtu thekson se ka rënë numri i të regjistruarve si të papunë për 22%, por edhe këtu e thekson se ka rënë si shkak i ndryshimit të metodologjisë, e jo si rezultat i ndryshimit të gjendjes në terren, e kjo mbetet shumë sfiduese. 60% e të papunësuarve janë të pakualifikuar.

Inflacioni gjatë vitit 2012 ka qenë 2,5%, që do të thotë është zhvlerësuar fuqia blerëse e parasë. Deficiti buxhetor në vitin 2012 është moderuar në 2,6% të bruto-produktit vendor dhe totali i të ardhurave është rritur me vetëm 1,8%, por duke u ulur përqindja si pjesëmarrje në bruto-produktin vendor.

Të nderuar deputetë,

Raporti gjithashtu tregon se ka pasur rënie të aktivitetit ekonomik dhe ka pasur ngecje në mbledhjen e taksave në krahasim me planin që Qeveria ia ka vënë vetes. Mirëpo, kjo gjatë rrugës është kompensua më nënshpenzim të organizatave buxhetore, si në nivelin qendrorë, ashtu edhe në nivelin lokal.

Procesi i privatizimit, sidomos ai i likuidimit, ka ngecur. Gjatë vitit 2012 janë mbyllur vetëm dy likuidime, nga 179, sa kanë qenë në proces. Edhe kjo është paraqitur si sfidë në Raportin e Progresit.

Janë regjistruar 2261 biznese të reja, që janë 20% më shumë se vitin paraprak dhe në të njëjtën kohë kemi pasur likuidim dhe falimentim të shumë bizneseve të tjera.

Barrierat kryesore në ambientin e biznesit kanë qenë konkurrenca jo fer, e cila duhet të theksohet që vjen drejtpërdrejt nga mosefikasiteti i Ministrisë së Financave dhe Administratës Tatimore, sepse kanë filluar para dy vjetëve fiskalizimin dhe vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse shumëçka u tha këtu, unë në diskutimin tim do të flas shkurt dhe do të fokusohem në këtë Raport të Progresit për Kosovë për vitin 2013, vetëm në pjesën që raporton për politikën e shëndetit publik.

Në këtë sferë, sipas këtij raporti, janë shënuar disa avancime, siç është Ligji i ri për shëndetësinë, pastaj zvogëlimi i mortalitetit të nënave dhe foshnjave, dhënia e shërbimeve shëndetësore komuniteteve RAE, si dhe si hap shumë pozitiv merret në kuptim të afrimit të standardeve evropiane Ligji i ri për kontrollin e duhanit. Prandaj, edhe e inkurajoj Ministrinë e Shëndetësisë që të përkujdeset për implementimin e plotë të këtij ligji.

Mungesa e një sistemi informativ shëndetësor të kompletuar dhe gjithëpërfshirës është një ndër kritikën që jepen në këtë raport. Në mungesë të sistemit informativ shëndetësor, jo vetëm që nuk mund të kemi të dhëna të besueshme statistikore për shëndetin e popullatës, siç është cekur edhe në raport, por edhe vetë ligji i shumëpritur për sigurimet shëndetësore nuk do të mund të funksionojë.

Për shëndetin mental dhe skenimin e sëmundjeve kanceroze kërkohen përpjekje më të mëdha për t'u arritur niveli i dëshirueshëm. Raporti e cek atë që ne si Lëvizje për Bashkim e kemi cekur dhe e kemi ritheksuar secilën herë gjatë shqyrtimit të buxhetit qeveritar se Buxheti i Republikës së Kosovës në përqindje e ndan nivelin më të ulët në rajon për shëndetësinë, si dhe ato mjete të cilat ndahen në raport thuhet se nuk menaxhohen si duhet.

Paratë të cilat shpenzohen nga xhepi i pacientit mbeten ende shumë të larta dhe përbëjnë 40% deri 60% të të gjitha shpenzimeve për shëndetësi. Në raport kërkohen investime shtesë në sektorin e shëndetësisë.

Në përgjithësi, Raporti i Progresit nxjerr si përfundim se Kosova ballafaqohet me sfida të mëdha në sektorin e shëndetësisë. Megjithatë, analiza sa i përket sektorit të shëndetësisë është sipërfaqësore. Sikur të bëhej një analizë më e hollësishme, besoj që do të ishte edhe më e disfavorshme se kjo që kemi përpara.

Prandaj, duke u bazuar në të dhënat e Raportit të Progresit për shëndetësinë në Kosovë, por edhe duke qenë dëshmitarë të gjendjes së mjerueshme në të cilën gjendet aktualisht sektori publik i shëndetësisë në Kosovë, konsideroj se Qeveria duhet futur në prioritetet e veta shëndetësinë, dhe atë jo vetëm deklarativisht, por vërtet ta trajtojë si prioritet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Amir Ahmeti e ka fjalën. Nuk është. Burim Ramadani, nuk është. Teuta Haxhiu, urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Secili ministër do të duhej të ishte i pranishëm, të na njoftojë së paku që i ka lexuar këto të gjetura në Raportin e Progresit, apo thënë më mirë të paktën të reflektojë se njëri prej tyre ka bërë një hap para për t'i shqyrtuar më seriozisht këto të gjetura.

Pajtohem me disa deputetë që thanë pak më herët se gjendja në Kosovë është shumë më e rëndë se sa paraqitet në Raportin e Progresit. E kemi rastin e asociacionit të komunave serbe, konkretisht të kryetarëve të komunave në Mitrovicën e veriut, të cilët marrin

vendime dhe vepron krye në vete, meqë Ministria e Pushtetit Lokal bën një njoftim dhe nuk vepron konform ligjit, ose ligjeve në fuqi.

Çështjet të cilat u adresuan nga deputetët janë të shumta. Unë po mundohem që mos t'i përsëris, të ndalem pra vetëm në fushën e arsimit. Disa nga çështjet që janë adresuar në fushën e arsimit janë që shpenzimet e Qeverisë janë shumë të ulëta për kokë të nxënësve.

Të gjithë neve dhe qytetarëve të Kosovës patjetër se na kujtohen premtimet megalomane të ish-ministrit Hoxhaj në mandatin e kaluar kur thoshte që do të ketë hapësirë të mjaftueshme për të gjithë nxënësit në Kosovë, njëkohësisht kur fliste për digjitalizimin e shkollave. Unë dhe qytetarët edhe sot e kësaj dite nuk e dimë kah shkuan 12 milionë euro, që u shpenzuan dhe asnjëherë një llogaridhënie nuk ekzistoi nga Qeveria.

Qasje jo të barabartë në arsimin cilësor janë paraqitur në raport për nxënësit nga komuniteti rom, ashkali, egjiptian, pra norma shumë të ulëta të regjistrimit, norma të larta të braktisjes së shkollës, si dhe nivele të dobëta të performancës akademike. E njëjta gjë vlen edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Çështje tjetër e adresuar në Raportin e Progresit është edhe arsimi parashkollor, që nuk është mbështetur në mënyrë adekuate. Pra, në shumë shkolla në Kosovë nuk ka të hapura paralele parashkollore. E dimë që me Ligjin për arsimin parauniversitar, arsimi parashkollor është i obliguar dhe Ministria nuk po e respekton, pra thjesht nuk po e zbaton as ligjin që e kemi miratuar në Kuvend.

Gjysma e shkollave të regjistruara punojnë në dy ndërrime, e shumë të tjera me tri ndërrime. Edhe nëpërmjet medieve kemi parë, edhe sot e kësaj dite, shkolla që janë me kushte shumë të vështira, pra thënë thjesht, jo vetëm që nuk kanë hapësirë, por as kushte elementare.

Nëpër shumë shkolla mungojnë laboratorët shkencorë, objektet sportive dhe mirëmbajtja adekuate e ndërtesave shkollore.

Tek arsimi dhe aftësimi profesional, Ministria ndan buxhet më të madh për qendrat e kompetencës së arsimit dhe të aftësimin profesional sesa për shkollat e tjera të arsimit dhe aftësimin profesional, të cilat marrin burime të pamjaftueshme.

Në arsimin e lartë kërkohen përpjekje më të mëdha për rritjen e cilësisë së programeve universitare dhe pasuniversitare dhe për të siguruar që ato programe të jenë të përshtatshme për nevojat e tregut.

Në një konferencë, të cilën e ka organizuar në fillim të dhjetorit Qendra për kurajo politike, disa profesorë në atë konferencë kanë cituar se gjatë procedurave, pra kur bëhet përzgjedhja e stafit akademik, bëhet anashkalim total i procedurave, anashkalohen pra procedurat ligjore në fushën e gradimit të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës dhe në shumtën e rasteve këto procedura shkelen.

Gjithashtu, gradimi apo edhe zgjedhja e stafit akademik bëhet në mënyrë kolektive nëpërmjet pakove, ku një numër i madh i stafit gradohet ose zgjidhet në Senat nëpërmjet

pakove. Ka raste ku gradohet ose zgjidhet dikush madje që ka edhe diplomë të falsifikuar.

Kjo me të vërtetë nuk do koment, kjo është një dukuri shumë e keqe, për të thënë kriminale që ndodh sot në Universitetin e Kosovës. Jemi dëshmitarë edhe të shumë gjërave të tjera që i kemi pa edhe në media.

Pra, me një fjalë, sikur të gjithë ministrat ta kryenin punën e vet, Kosova do të kishte ecur ndryshe, mirëpo e kemi thënë vazhdimisht dhe po e themi edhe sot, këta ministra nuk janë kompetentë, këta ministra janë të papërgjegjshëm dhe e kanë humbur rrugën e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuar ministre,

Pak më herët më pëlqeu diskutimi i kolegut Pajaziti, kur tha se për t'i tejkaluar sfidat duhet të kemi bashkëpunim dhe koordinim me Qeverinë, mirëpo mungesa e Kabinetit qeveritar sot këtu, kur po diskutohet për një temë kaq të rëndësishme, tregon se sa ata janë të interesuar për t'i tejkaluar sfidat.

Unë do të përpiqem që t'i prek disa pika nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian që i takojnë sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, e që mos t'i përsëris lëmit tjera, për të cilat u fol shumë këtu sot.

Edhe pse shumë ligje të Ministrisë së Shëndetësisë janë miratuar në Kuvend, implementimi i tyre në praktikë po shkon ngadalë. Sidomos një mangësi të madhe e ka që edhe pse Ligji i amendamentuar i shëndetësisë ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2013, reformat në këtë ligj po shkojnë ngadalë për shkak se së bashku me këtë ligj në Kuvend është dashur të vijë edhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, pa të cilin reformat në shëndetësi as që mund të mendohen.

Në raport janë parë disa mangësi të cilat do t'i përmend: shpenzimet publike në shëndetësi mbeten më të ulëtat në regjion dhe duhet të bëhen investimet në infrastrukturë, në trajnime, investimet në shëndetin mendor në komunitet, si dhe krijimi i fondeve për programet e skenikut për disa lloje të kancerit, zbulimi i hershëm i të cilëve mund të shpëtojë jetë.

Sistemi i formimit shëndetësor jo i zhvilluar si duhet shkakton mungesën e të dhënave statistikore në shëndetësi, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror.

Mospërfshirja, mund të them këtu edhe e institucioneve private nën ombrellën e Ministrisë së Shëndetësisë, ku me raportimet e rregullta do të na jepnin një pasqyrë pak më reale sa i përket patologjisë dhe dukurive, të cilat paraqiten në shëndetësinë e popullatës sonë, është një mangësi e madhe.

Shpenzimet personale në shëndetësi janë të larta dhe vazhdojnë ta pengojnë përmbushje e nevojave bazike për shëndetin e foshnjave dhe nënave, ushqyeshmërinë dhe shëndetin

publik. Për shkak të resurseve financiare të limituara nuk mund të bëhen reformat e duhura në shëndetësi, si dhe nuk mund të sigurohet qasja në shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Këtu gjithsesi do të kisha përmendur se qasja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shërbimet shëndetësore ende nuk është e kënaqshme, si dhe qasja e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet për t'i marrë shërbime të duhura shëndetësore.

Gjithashtu, resurset ekzistuese, të cilat janë në Ministrinë e Shëndetësisë, pra që janë për shëndetësi, duhet të përdoren në mënyrë më efikase. Një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të vazhdueshëm të legjislacionit, i cili ka mjaft vakuum dhe mangësi, si dhe implementimi i atij ekzistues.

Një sfidë tjetër shumë e rëndësishme është punësimi, sidomos i të rinjve. Kemi një papunësi shumë të madhe, mbi 40%, prej të cilëve mbi 70% janë të rinj. Edhe pse sistemi informativ i menaxhimit të punësimit është i modernizuar, ai akoma nuk është operacional.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike, burimeve njerëzore dhe infrastrukturës fizike nuk mund të bëhet një analizë e hollësishme në sferën e punësimit dhe nuk mund të hartohen politika dhe programe adekuate.

Edhe pse disa ligje të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë miratuar në Kuvend, ato ende nuk implementohen sa duhet, si dhe monitorimi i implementimit të tyre nuk mund të bëhet si duhet për shkak të numrit të vogël të inspektorëve të punës.

Gjithashtu, sfidë paraqet edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të punës. Edhe pse shërbimet sociale janë të decentralizuara, ende nuk është bërë decentralizimi i buxhetit konform formulës së buxhetit për decentralizim, që është zhvilluar në vitin 2012.

Marrëveshjet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me shtetet rajonale dhe të Evropës për realizimin e të drejtës për pension për personat që kanë punuar në këto shtete dhe vazhdojnë të jetojnë në Kosovë, ende nuk po realizohet.

Të mos i përsëris edhe disa pika tjera që u përmendën prej kolegëve, por unë kisha dashur të them se shumë nga këto vërejtje janë dhënë nga ne deputetët këtu, në këtë Kuvend, qoftë në formë të deklarimeve jashtë rendit të ditës, pyetjeve parlamentare apo diskutimeve të shumta, kështu që këto nuk ishin edhe shumë të reja që u panë në këtë raport, mirëpo sa kanë lënë mbresë dhe sa kanë qenë këto iniciativa që të bëhen ndryshimet, është një pikëpyetje e madhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas leximit të raportit të Komisionit Evropian për progresin e Kosovës mund të theksohen disa vlerësime të përgjithshme, si dhe shqetësime serioze për disa procese dhe dukuri të ndryshme negative.

Kështu, një vlerësim i përgjithshëm, i cili haset në shumë pjesë të raportit është ky: Kosova ka vazhduar ta përmirësojë legjislacionin në këtë fushë.

Formulim pak a shumë të ngjashëm hasim gjatë trajtimit të shumë fushave në këtë raport, si për shembull te shpëlarja e parave, pastaj te luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, si dhe te fushat e tjera.

Kjo do të thotë që sipas këtij raporti, Kosova deri diku e ka krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore për të trajtuar dhe për t'u ballafaquar me shumë probleme dhe dukuri negative, që e sfidojnë seriozisht rrugën e Kosovës në drejtim të integriteteve evropiane.

Madje, për legjislacionin kosovar për mbrojtjen e pakicave në raport thuhet: Legjislacioni është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Por, është mjaft shqetësuese moszbatimi apo zbatimi jo i mjaftueshëm i ligjeve në përgjithësi në Kosovë, për çka në shumë pjesë të këtij raporti haset vlerësimi: Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e ligjit; ose shprehja: zbatimi i legjislacionit mbetet sfidë e rëndësishme; ose vlerësimi tjetër: zbatimi i kornizës ligjore është i kufizuar.

Vlerësimet e këtilla që tregojnë për zbatimin jo të mjaftueshëm të legjislacionit kosovar në shumë sfera të rëndësishme të jetës së qytetarit tonë janë një prej dobësive serioze që e përcjellin fushën e sundimit të ligjit në Kosovë.

Në raport, përveç moszbatimit të ligjit, janë ngrehur edhe shqetësime të tjera shumë serioze për fushën e sundimit të ligjit, që shprehen, ndër të tjera, edhe me vlerësime të këtilla: Janë raportuar raste të ndërhyrjes politike në gjyqësi, ku përfshihen pikat e ngrehura nga Qeveria dhe Kuvendi, i cili ka pasur edhe një përpjekje për ta hetuar një rast, që kishte kaluar nëpër të gjitha hapat e procedurës gjyqësore.

Sipas raportit, si shkak i paraqitjes së dobësive të theksuara në rrafshin e sundimit të ligjit është edhe mosplotësimi i vendeve të lira për gjyqtarë dhe prokurorë, sepse nga 404 pozicione të gjyqtarëve janë plotësuar 334, respektivisht janë të zbrazëta afro 18% sosh.

Kurse, në Këshillin Prokurorial, nga 146 pozita për prokurorë, janë të plotësuar 125 sosh, respektivisht janë të zbrazëta afro 15% e pozitave.

Një vërejtje tjetër që i bëhet në raport Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial është se gjatë periudhës raportuese ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, që kanë bërë shkelje të ndryshme në punën e tyre janë shqiptuar vetëm sanksione disiplinore, dhe atë në 25 raste. Kurse, asnjë prej tyre nuk ka rezultuar me shkarkime nga detyra, edhe pse sipas raporteve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare mbi korrupsionin, njëri prej sistemeve më të korruptuara në Kosovë, përveç politikës, është sistemi gjyqësor.

Si pasojë e të gjitha këtyre lëshimeve të Gjyqësorit tonë, sipas raportit, në vitin 2013, numri i rasteve në pritje të zgjidhjeve nga gjykatat tona është rritur në 235 mijë sosh.

Përveç shqetësimeve lidhur me punën e Gjyqësorit dhe fushën e sundimit të ligjit, në raport hasen edhe vlerësime të tjera shqetësuese, që kanë të bëjnë me sfera dhe dukuri të tjera. Kështu, shqetësuese është se në fushën e luftës kundër korrupsionit gjatë periudhës raportuese kanë nisur hetimet vetëm në gjashtë raste nga njësia antikorrupsion e Policisë së Kosovës, në bashkëpunim me EULEX-in. Kurse, numri i rasteve të ndjekura nga Prokuroria mbi bazën e informatave nga Agjencia Kundër Korrupsionit mbetet vetëm nën 10%, apo më pak se 10%, dhe vetëm një numër i vogël i tyre rezulton me ngritje të aktakuzës.

Lidhur me këtë çështje kaq serioze për një shtet që e zë vendin e 111-të në listën e shteteve të korruptuara, në raport thuhet decidivisht: “Kjo mospërputhje duhet të trajtohet si çështje prioritare, sepse Kosova për t’i përmbushur obligimet e veta sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit duhet të ofrojë dëshmi konkrete të rezultateve në luftën kundër korrupsionit”.

Andaj, parandalimit efektiv të korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë ka nevojë t’i jepet prioritet më i lartë. Se korrupsioni dhe format tjera të krimit të organizuar janë brengë shqetësuese e shoqërisë kosovare, tregon fakti se dukuria e shpëlarjes së parave në Kosovë, sipas raportit ka treguar një rritje të theksuar, sepse gjatë vitit 2012 janë paraqitur 200 raste të tilla, apo për 35% më shumë se në vitin paraprak, do të thotë në vitin 2011, që është pasojë e veprimeve të dyshimta të të korruptuarve dhe përfituesve të tjerë nga aktivitetet kriminale, që paratë e tyre të fituara me krim orvaten t’i spastrojnë në forma të ndryshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë,

Faleminderit për durimin tuaj!

Ajo çka unë mendoj se të gjithë po pajtohemi, se të gjeturat në Raportin e Progresit janë reale dhe ne të gjithë po pajtohemi se ato janë konform gjendjes ekzistuese.

Mbetet të shpresojmë se progresin që e ka arritur deri më tani Kosova do të jetë i mjaftueshëm që vitin e ardhshëm të nënshkruhet marrëveshja dhe të ecet më tutje.

Por, megjithëkëtë, ka vend për brengosje në shumë fusha, të cilat i paraqet Raporti i Progresit. Unë do të kisha veçuar, se cilat, sipas meje, do të jenë disa prej sfidave kryesore. Do të jetë integrimi i veriut, sundimi i ligjit, zbatimi i ligjit, qeverisja e mirë në të gjitha nivelet qendrore, institucionet e pavarura, ato lokale, pastaj depolitizimi i administratës, ndërtimi i një administrate racionale, të përgjegjshme dhe efikase. Dhe, krejt kjo do ta krijojë një ambient, që ne pastaj të bëjmë hapa të dukshëm në zhvillimin ekonomik, në të gjithë komponentët e saj.

Mirëpo, për gjithë këtë gjendje brengosëse, të cilën e kemi, unë shpresoj se të gjithë përgjegjës do ta krijojnë një përkushtim, që ata t’i adresojnë shpejt të gjitha këto çështje dhe ta krijojnë një plan të veprimit, të cilin nuk duhet ta presim që ta diskutojmë vetëm kur ta kemi raportin e vitit të ardhshëm, por të bëhet debati dhe diskutimet periodike,

tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, në mënyrë që të gjithë të mund edhe ta stimulojmë atë proces, pastaj t'i nxisim ata që po punojnë, por edhe njëkohësisht t'i kritikojmë ata të cilët nuk janë në nivelin e detyrës.

Dhe, unë mendoj se ky është roli kryesor i këtij bashkëpunimi që ne sot e kemi edhe këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, ajo që nganjëherë pengon, duhet të mos harrojmë, është që gjithë ky shënim i progresit dhe regresit, i gjendjes së mirë dhe jo të mirë, i dedikohet jetës së qytetarëve këtu. Ne këtë nuk po e bëjmë vetëm për të nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe për të bërë përparim në integrimin e Kosovës, në mekanizmat dhe në Bashkimin Evropian, por kjo pikërisht i dedikohet jetës së qytetarëve tanë. Prandaj, kjo është ajo që nuk duhet të na lërë askënd indiferent dhe unë meqenëse kam premtuar që shkurtimi do të jetë në pesë minuta, tre minuta dua t'u fal për respekt atyre që nuk janë këtu, do t'i shfrytëzoj vetëm këta dy minuta: një për mua, një për respekt për kolegët, ta përfundoj këtë këtu dhe me këtë:

Shumë më me padurim po e pres një adresim të institucioneve, në rend të parë të Qeverisë në adresimin e të gjeturave dhe gjithë planeve të avancimit, se sa konstatimin bosh se kjo është një gjendje jo e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dëshiroj që t'i referohem fjalës sime për politikat bujqësore dhe zhvillimin rural.

Është fakt që ka përparime. Kosova ka miratuar ligje, e ka rritur simbolikisht buxhetin, e ka vazhduar mbështetjen e fermerëve me pagesa, është vlerësuar po ashtu pozitivisht themelimi i fondit për garancitë e riskut për kreditë e fermerëve. Por, ky sektor meriton shumë më shumë dhe duhet të ketë një përkujdesje shumë më të madhe.

Raporti i Progresit evidenton humbjen e tokës bujqësore. Rezultatet e inventarizimit kombëtar të pyjeve të vitit 2012, i cili merret edhe me këtë çështje, thonë se toka e bujqësore e Kosovës po zvogëlohet në mënyrë alarmante.

Derisa në vitin 2002 ne i kemi pasur 342 400 hektarë tokë, 10 vjet më vonë në inventarin e tashëm kombëtar, që është bërë në vitin 2010 dhe raporti që është bërë këtë vit, neve na rezulton se i kemi vetëm 309 000 hektarë. Domethënë, 33 400 hektarë janë zvogëluar për 10 vjet. Ne kemi më pak tokë bujqësore, që është një e dhënë alarmante. Nëse është e saktë, vërtet ne duhet ta kapim kokën me duar.

Kjo është një humbje, që i bie afërsisht nga 1% e tokës bujqësore, që është humbur për çdo vit që për 10 vjet është humbur 10% e tokës.

Shqetësim tjetër paraqet koordinimi i dobët ndërmjet organeve përgjegjëse për luftimin e zjarreve në pyje, të cilat kanë përfshirë sipërfaqe prej 12 200 hektarësh, të cilat janë dëmtuar jashtëzakonisht rëndë.

Nëse këto sipërfaqe i nxjerrim te pyjet e reja, kjo shkon në 25% të atyre të cilat janë dëmtuar, jo vetëm nga zjarret, por edhe nga dëmtuesit, që është një dëm kolosal.

Për prerjet ilegale të pyjeve ne folëm mbrëmë, që në çdo vit, për shkak të mosfunksionimit të ligjit, rreth 1 500 000 m³ priten në mënyrë ilegale, ose thënë ndryshe 93% e pyjeve priten ilegalisht, kurse vetëm 7% e tyre priten legalisht.

Sa u përket ligjeve që i kemi miratuar në këtë Kuvend, ka qenë një lojë pingpongu ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për disa ligje, të cilat disa herë është dashur të kthehen. I tillë është Ligji i pyjeve dhe Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikë, nga i cili ky i fundit si ligj nuk i plotëson standardet, madje edhe dijet minimale mungojnë për ta kaluar këtë ligj edhe si komision, por edhe si Kuvend.

Edhe kontrolli veterinar dhe ushqimor është i mbuluar me ligje dhe udhëzime administrative, por këto me vështirësi zbatohen. Për planet operacionale dhe afatgjata të kontrollit, të sëmundjeve të kafshëve, raporti thotë se janë të mangëta dhe janë shumë të vjetra.

Shqetësim të madh paraqet kontrolli i kontrabandës dhe therja e paligjshme e kafshëve, të cilat bartin rreziqe për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve. Edhe më tutje po zvarritet akreditimi i laboratorit të ushqimit dhe veterinarisë dhe funksionalizimi i plotë i tij. Për këtë, edhe janë investuar disa miliona euro, është trajnuar stafi për një kohë shumë të gjatë dhe ky laborator për 4-5 vjet me radhë nuk po arrin të akreditohet.

Në raport konstatohet se Ministria e Bujqësisë nuk ka kapacitete administrative në Agjencinë e Pagesave për t'i administruar dhe kontrolluar pagesat për skemat e granteve, gjë që vërtet është e vërtetë.

Zgjerimi i mbështetjes në sektorët tjerë të bujqësisë duhet të vlerësohet mirë për t'i mos i lejuar mbështetjen për disa produkte për të cilat ka pasiguri në prodhimin e tyre. Edhe ky është një fakt i vërtetë për shkak se në këtë vit ne e kemi mbështetur prodhimin e misrit. Në fakt, prodhimi i misrit nuk është një kulturë që mund të japë rendimente të garantuara, sepse një pjesë të Kosovës nuk e kemi të futur në sistem të ujitjes dhe kjo krijon pasiguri në prodhimin e ushqimit për çdo vit.

Prandaj, edhe këto skema duhet të kemi kujdes që të mos i mbështetim. Shumë skema janë duke u mbështetur me disa masa. Në fakt, këto paraqesin rrezik për shkak se ka mundësi që fermerët të ikin nga prodhimtaria tradicionale e tyre dhe të dalin e të joshen nga këto prodhime dhe të kalojnë në prodhimtari, të cilat nuk i njohin mirë dhe për të cilat nuk mund të garantohet ndonjë rezultat.

Edhe për shërbimet këshillimore ka vërejtje për fermerët të cilët nuk organizohen sipas politikave mbështetëse me pagesa, nuk bëhen sistematikisht në vendin ku duhet, në ferma.

Kosova ka marrë përsipër po ashtu edhe mbrojtjen e natyrës, me miratimin e ligjeve për Bjeshkët e Nemuna, për Malin e Sharrit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministrja e Integrimeve Evropiane, zonja Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për këtë debat shumë konstruktiv. Dua të ju siguroj që çdo vërejtje dhe rekomandim juaji do të shndërrohet në pjesë të planit të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për adresimin e sfidave që derivojnë nga Raporti i Progresit.

Unë ju siguroj që herën e ardhshme, kur të diskutojmë për këtë çështje, do t'i kemi të gjithë anëtarët e Qeverisë këtu. Do të ishte mirë që një mbledhje të radhës ta caktojmë menjëherë në fillim të muajit janar, kur do të diskutojmë Planin e Veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe bashkërisht do t'i ndanim sfidat dhe objektivat që kemi përcaktuar për agjendën evropiane.

Është evidente që argumentet për integrimin e Kosovës në BE nuk prodhohen as në Bruksel, as në Paris, as në Berlin. Argumentet për integrimin e Kosovës në BE prodhohen në Prishtinë, prodhohen në Kosovë dhe prodhohen duke bërë implementimin e ligjeve, të cilat tashmë i kemi miratuar. Është një pajtueshmëri që infrastruktura ligjore është e kënaqshme, por duhet shumë më shumë punë në implementimin e ligjeve që kemi hartuar dhe miratuar bashkërisht.

Nuk pati pyetje të drejtpërdrejta për mua, është e vërtetë. Shumica prej tyre adresonin resor të veçantë. Mirëpo, unë ju siguroj që në një mbledhje të radhës bashkërisht të debatojmë me Qeverinë për Planin e Veprimit. Zoti Ymeri e pati një pyetje të drejtpërdrejtë për përkthimin. Përkthimin e bëjmë ne, fatkeqësisht. Nuk dallon kualiteti i këtij përkthimi nga kualiteti i përkthimeve që i kemi nëpër institucione dhe kjo është një çështje, të cilën duhet ta trajtojmë shumë seriozisht. Por, fatkeqësisht e bëjmë ne. Edhe unë ndonjëherë nuk e kuptoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në fund, sipas Rregullores, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, pas përfundimit të diskutimeve për paraqitjen dhe arsyetimin e rekomandimeve, e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë!

Duke ju falënderuar për durimin dhe debatin shumë konstruktiv, më lejoni që para jush të prezantoj rekomandimet e nxjerra nga ky debat.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i propozon Kuvendit që t'i miratojë këto rekomandime:

1. Qeveria e Kosovës urgjentisht t'i adresojë të gjeturat e Raportit të Progresit të vitit 2013,

2. Qeveria e Kosovës ta procedojë Planin e Veprimit në Kuvend për zbatimin e secilit rekomandim për të gjeturat në Raportin e Progresit brenda një muaji,
3. Qeveria e Kosovës të raportojë në Kuvend për përmbushjen e këtyre kritereve në mënyrë periodike në çdo tre muaj, duke filluar nga tash,
4. Qeveria e Kosovës deri në mars të vitit 2014 të publikojë dhe raportojë në Kuvend që të gjitha kërkesat i ka përmbushur sa i përket liberalizimit të vizave.

Ndërkaq për Kuvendin e Kosovës:

1. Pavarësimi buxhetor i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
2. Pavarësimi i Drejtorisë së Teknologjisë Informative,
3. Ta miratojë Ligjin për Kuvendin brenda periudhës sa më të shkurtër të mundshme,
4. Kuvendi t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për ta detyruar Qeverinë e Kosovës që të jetë e pranishme gjatë mbajtjes së seancave plenare, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe
5. Ta miratojë Rregulloren e Kuvendit.

Duke ju falënderuar, ju ftoj t'i votoni këto rekomandime.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne nuk kemi kuorum, nën një, kurse nën dy numri i rekomandimeve është shtuar. Nuk janë rekomandimet që janë dorëzuar me materialin, prandaj rekomandimet kanë nevojë të harmonizohen ndërmjet kryetarëve të grupeve parlamentare.

Propozoj që pas harmonizimit për mbledhjen e ardhshme, të miratohen rekomandimet e raportit. Ndërsa, besoj do të ishte mirë që të martën ta mbajmë vazhdimin e kësaj seance për ta kryer, për t'i përfunduar këto dy pika që na kanë mbetur.

A jeni dakord? Sabri? Nëse doni e lëmë për mbledhje të Kryesisë, por parimisht unë kisha thënë që para se të hyjmë në buxhet, të jetë e kryer kjo pikë e rendit të ditës.

Në rregull, atëherë e lëmë për të hënë, vendosim në mbledhjen e Kryesisë, pastaj ju njoftojmë.

* * *

E enjte, 26 dhjetor 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013.

Para se të fillojmë me pikat e mbetura, e kam një njoftim: Ju njoftoj për vendimin e Presidentes lidhur me zëvendësimin e deputetëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe atë:

1. Hatim Baxhaku, në vend të deputetit Lutfi Haziri,
2. Xhavit Uka, në vend të deputetit Imri Ahmeti, dhe
3. Xhafer Tahiri, në vend të deputetit Sali Asllanaj.

Me këtë rast, i falënderoj për punë deputetët e deritashëm, ndërsa deputetëve të rinj u dëshiroj punë të mbarë.

I ftoj deputetët e rinj që ta nënshkruajnë deklaratën e betimit.

Konstatoj se në sallë tani janë 96 deputetë, edhe dy të tjerë, gjithsej 98.

Fillojmë me pikën e shtatë, të mbetur:

7. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar me mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2013. Mirëpo, në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2013, i ka paraqitur rekomandimet.

Deputetja nuk është këtu për t'i lexuar ato. Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetja Kadaj-Bujupi, për arsye objektive nuk është sot këtu. Nëse më lejohet, unë do t'i kisha lexuar rekomandimet të cilat janë shpërndarë besoj nëpërmjet Administratës edhe te grupet tjera parlamentare, dhe ato janë si në vijim:

Grupi Parlamentar i Aleancës i propozon Kuvendit që t'i miratoi këto rekomandime në mënyrë që,

1. Qeveria e Kosovës urgjentisht t'i adresojë të gjeturat e Raportit të Progresit të vitit 2013,
2. Qeveria e Kosovës ta procedojë Planin e Veprimit në Kuvend për zbatimin e secilit rekomandim për të gjeturat në Raportin e Progresit brenda një muaji,
3. Qeveria e Kosovës të raportojë në Kuvend për përmbushjen e këtyre kriterëve në mënyrë periodike në çdo tre muaj, duke filluar nga tash,
4. Qeveria e Kosovës deri në mars të vitit 2014 të publikojë dhe raportojë në Kuvend që të gjitha kërkesat i ka përmbushur sa i përket liberalizimit të vizave.

Ndërkaq për Kuvendin e Kosovës:

1. Pavarësimi buxhetor i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
2. Pavarësimi i Drejtorisë së Teknologjisë Informative,

3. Ta miratojë Ligjin për Kuvendin brenda periudhës sa më të shkurtër të mundshme,
4. Kuvendi t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për ta detyruar Qeverinë e Kosovës që të jetë e pranishme gjatë mbajtjes së seancave plenare, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe
5. Ta miratojë Rregulloren e Kuvendit.

Këto janë rekomandimet të cilat janë shpërndarë edhe grupeve tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I dëgjuat rekomandimet. Atëherë shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 95 vota për, një kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi i miratoi rekomandimet e paraqitura nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi lidhur me të gjeturat dhe sfidat e Raportit të Progresit për Kosovën, miratuar nga Komisioni Evropian, më 16 tetor 2013.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen plenare të 19 dhjetor të vitit 2013 t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

I ftoj kryetarët, përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kryetari Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon Xhevahire Izmakun për kryetare të këtij komisioni, ndërsa Ramë Vatën, anëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Po e shfrytëzoj rastin t'i bashkëngjitem mirëseardhjes së kolegëve deputetë të grupit tonë.

Grupi ynë parlamentar e propozon për këtë komision deputetin Salih Morina dhe deputeten Alma Lama. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, zëvendëskryetar është Salih Morina. Kryetari i Grupit "Vetëvendosje", Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Nga “Vetëvendosja”, në Komision do të marrë pjesë deputeti Afrim Kasolli.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Teuta Haxhiun për Komisionin ad hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përsëritje për Qeverinë dhe deputetët,

Koalicioni për Kosovë të Re e propozon për këtë komision zonjën Suzan Novobërdaliu.

KRYETARI: Kryetari i Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče, predlažemo Milivoje Stojanović.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, kryetarja Mufera Shinik.

MUFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim sayın başkan,

“6+” Parlamenter Grubundan komisyon üyeliğine milletvekili Sayın Albert Kinoli’yi öneriyoruz.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit SLS, Sasha Milosavljević.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!,

Ja sam hteo da kažem samo da je u ovoj komisiji trebalo da bude naš predlog, ako idemo onim redom da jednom mi dajemo predlog za Komisiju, drugi put “Zajednička Budućnost”.

KRYETARI: Sipas Administratës, kësaj radhe rendi është për Grupin Parlamentar “Zajednička Budućnost”. Faleminderit!

Na duhet një votim formal. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 112 deputetë.

Konstatohet se me 89 vota për, 2 kundër, 1 abstenim, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr. 04/1-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën 9 dhe të fundit të mbetur nga seanca e kaluar.

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje lokale dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka diskutuar lidhur me shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka rekomanduar shkarkimin e tyre.

Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit do të flas nënkryetari Enis Kervan, ndërsa unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Enis Kervan në emër të Komisionit.

ENIS KERVAN: Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, dhe nenit 12 dhe nenit 14 të Ligjit nr. 04/44 për Komisionin e Pavarur për Media, në mbledhjet e mbajtura më 23 dhe 30 tetor 2013, diskutoi lidhur me shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta bëjë shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, si në vijim:

1. Shefki Ukaj, kryetar dhe
2. Vesna Jovanović, anëtare.

Komisioni, në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, e ka iniciuar procedurën për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së. Shkarkimi i anëtarëve të KPM-së bëhet kur vërtetohet se anëtari i KPM-së mban post publik të zgjedhur dhe të emëruar, është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike dhe merr pjesë aktive në aktivitetet politike.

Komisioni në disa mbledhje ka diskutuar lidhur me shkeljet e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, neni 12, paragrafi 1.3 dhe neni 1.4, nga anëtari i KPM-së Shefki Ukaj, kur gjatë procedurës së përzgjedhjes anëtari i KPM-së ka ushtruar post publik sipas vendimit të KQZ-së, nr. 978/2011 të datës 7 shtator 2011, përkatësisht këshilltar i subjektit politik të LDK-së në Asamblenë Komunale të Prishtinës, post të cilin nuk e ka deklaruar, përkatësisht e ka fshehur.

Anëtarja e KPM-së, Vesna Jovanović, konstatohet se ka bërë shkelje të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, respektivisht në nenin 14, paragrafi 3.7, duke marrë pjesë aktive në aktivitetet politike në emër të Iniciativës Qytetare Serbe për Partesh, pasi është emëruar nga Kuvendi anëtare e KPM-së, që drejtpërdrejt bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2013, me 6 vota për, dy kundër dhe 1 abstenim, vendosi t'i rekomandojë Kuvendit shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, pasi të njëjtit me aktivitetet e tyre e kanë shkelur nenin 12, paragrafi 1.3 dhe nenin 14 paragrafi 3.7 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Në bazë të nenit 14, paragrafi 2, pika 2 e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarëve të KPM-së. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarët e grupeve parlamentare, e doni fjalën? Në emër të Komisionit për Rregullore, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kjo çështje është trajtuar edhe në seancën plenare dhe është kërkuar që të bartet në Komisionin për Legjislacion, i cili është komision kompetent për trajtimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë dhe të vendimeve. Ne e kemi marrë rekomandimin, tash siç duket edhe nga vetë ky kryetar i këtij komisioni, që e paraqiti në emër të tij, kemi edhe dualizëm të vendimit, sepse bëhet fjalë për tre persona, kurse tash aktualisht i përmendi vetëm dy që duhet t'i nënshtrohen shkarkimit të Kuvendit.

Parimisht, ne e kemi theksuar se duhet të respektohet ligjshmëria në tërësi. Komisioni ad hoc nuk e ka kryer punën e vet qysh në start, nëse është dashur për të ardhur deri te ky konkluzion, kështu që ne kërkojmë që të respektohen rregullat e Kuvendit, e jo teket e individëve apo të grupacioneve politike apo të interesave të atyre që kanë mbi Komisionin e Pavarur për Media, sepse është e hapur dhe e ditur lufta që është zhvilluar, sidomos që nga kompletimi dhe moskompletimi i këtij komisioni, kështu që ne kërkojmë dhe është e rrugës që kjo qasje të bartet në Komisionin për Legjislacion, të trajtohet ligjshmërisht dhe atëherë t'i nënshtrohet votimit në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë se rekomandimi është për tre anëtarë, por ne e dimë se njëri anëtar ka ndërruar jetë dhe tani është krijuar një situatë tjetër dhe është njoftuar edhe nga KPM-ja edhe Kryesia dhe në këtë rast, për shkak të çështjes morale, unë mendoj se nuk është në rregull këtu të përmendet edhe disa herë, edhe në seancën e kaluar e kemi përmendur emrin e ish-anëtarit, i cili ka ndërruar jetë, për atë arsye nuk e kemi përmendur.

Kemi diskutuar, i kemi kontaktuar edhe anëtarët e Komisionit dhe në pajtim me ta, nuk e kam përmendur emrin e ish-anëtarit, i cili tash veç më ka ndërruar jetë. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Komisioni e tha fjalën e vet. Mirë, urdhëro! E ka fjalën Arben Gashi, kryetar i Komisionit për Legjislacion.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm ta sqarojmë pak se Kuvendi po hidhet në lajthitje. Vendimin që e lexoj nënkryetari i Komisionit FunkSIONAL, ishte vendim me dy emra, ndërkohë që letrat që i kemi si deputetë është vendim me tre emra. Tash, cili vendim po hidhet në votim e para,

e dyta proceduralisht Kuvendi, apo një anëtar i Komisionit nuk mund ta lexojë një vendim, i cili nuk është i shkruar ashtu. Tashmë, duhet të kthehet në Komision, të plotësohet vendimi, të rregullohet si duhet, të vijë prapë në seancë, e votojmë, i heqim çka do që të vendosim, mirëpo ta rregullojmë çështjen proceduralisht.

Të mos gabojmë, të mos e vëmë në lajthitje edhe Kuvendin, edhe opinionin, sepse është e paarsyeshme që ta marrim një vendim, i cili nuk është në rregull proceduralisht. Të kthehet në Komision, të rregullohet dhe pastaj e votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, me vdekjen e çdo anëtarit të cilitdo institucion që përfaqëson, pushon mandati dhe nuk kemi tash këtu çka nxjerrim kurrgjë në këtë drejtim. Pra, duhet ta kemi një nivel të kulturës.

Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar vendimin e Komisionit FunkSIONAL për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, pas vendimit të që ka ardhur edhe nga Kryesia e Kuvendit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar disa herë situatën e krijuar kohëve të fundit në Komisionin e Pavarur për Media, posaçërisht pas vendimit të Komisionit FunkSIONAL për shkarkimin e anëtarëve, të cilët kanë rënë ndesh me ligjin. Unë do t'i theksoj vetëm nenet në të cilat dy anëtarët bien ndesh dhe ne sot si Kuvend kemi mundësi që të marrim vendim për shkarkimin e tyre.

Pra, shkarkimi nga KPM-ja dhe zgjedhja e anëtarëve: Shkarkimi i anëtarit të KPM-së bëhet kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për largim që parashihet me nënparagrafin, që në këtë rast e kemi 3.7 “ka marrë pjesë aktive në aktivitetet politike, pasi është emëruar si anëtar i KPM-së”, që lidhet me anëtarin Vesna Jovanović, ndërsa e kemi te neni 12 për anëtarin apo edhe për kryetarin e tanishëm, zotin Ukaj, pika 1.3, te neni 12 thekson “personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar, siç janë funksionarët publikë, apo personat të cilët kanë qenë në këto dy pozita gjatë dy vjetëve të fundit”.

Komisioni FunkSIONAL ka marrë vendim në bazë të fakteve dhe mendojmë që sot nuk ka asnjë arsye ta shtyjë këtë vendim. Po ashtu, unë do t'i theksoj edhe shkeljet tjera të vazhdueshme, të cilat kanë ardhur si pasojë e punës jo të përgjegjshme të zotit Ukaj, por po ashtu edhe anëtarëve të tjerë, të cilët sigurisht që do të vijnë në shkarkim për joprofesionalitet...

KRYETARI: Ju lutem, përqendrohuni vetëm në ligj! Konstatimet tjera nuk na duhen sot.

XHEVAHIRE IZMAKU: Grupi Parlamentar voton për rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Se ky Kuvend, përkatësisht ky koalicion qeveritar është shndërruar në instrument partiak për t'i zgjedhur njerëzit e vet nëpër borde, guvernatorë bankash etj., këtë e di i gjithë opinioni, njerëzit nga këshilli drejtues, njerëzit udhëheqës. Ndërkaq, për njeriun që është profesionalisht i përgatitur për këtë punë, pas dy vjetësh u ka rënë në mend tash, edhe në Komision, për ta larguar zotin Ukaj, të cilin duhet diferencuar.

Mos e manipuloni opinionin! Zoti Ukaj prej kur është zgjedhur, asnjë shkelje nuk e ka bërë dhe nuk është rasti i njëjtë si rasti i dytë. Prandaj, nuk mund t'i futni në një thes të dyja rastet. Për këtë, si zakonisht, me një përpjekje maksimale të krijimit të numrave sa për të eliminuar njerëz që e bëjnë punën ashtu siç do të duhej bërë.

Prandaj, ne e kemi kërkuar për shumë arsye, mbi të gjitha, meqë edhe nuk janë rastet e njëjta t'i kthehet Komisionit për Legjislacion, meqë e ka propozuar, por kjo nuk ndodhi as herën e kaluar dhe, edhe sot, unë deklaroj që Grupi im Parlamentar do të votojë kundër këtij rekomandimi.

KRYETARI: Nga "Vetëvendosja", fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është e ditur se edhe në seancën e kaluar ne e patëm përkrahur iniciativën për rikthimin e kësaj çështjeje në komisionet përkatëse, mirëpo Kuvendi atëherë votoi kundër këtij propozimi dhe u ndodhëm para faktit të kryer, sepse nuk kemi çka të bëjmë nëse Kuvendi voton kundër.

Kërkesa jonë ka qenë që kjo listë të ndahet, për shkak se shkeljet kanë qenë të natyrave të ndryshme, mirëpo një fakt nuk duhet ta harrojmë, sepse shkeljet e ligjit janë evidente për të dy personat për të cilët bëhet fjalë në këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Arsyeja pse dola para jush, të mos e jap një prononcim prej vendit, është kjo: jemi duke klithur për sundim të ligjit në Kosovë, secili prej nesh.

Shikoni, para Kuvendit është një vendim shumë i qartë: dy persona e kanë shkelur ligjin. Kurrkush nuk ka dilemë që është shkelur dhe tani e dredhim, e përdredhim që të dalim prej kësaj. Nuk i bën mirë kurrkujt hiç. Është turp t'i kërkojmë dikujt sundim të ligjit nëse e keni tepër të qartë që kemi shkelje të ligjit. Nëse ligji është tepër i kulluar, Ismet, edhe tash duhet ta gjejmë një variant 'jo kanë ardhur dy, jo kanë ardhur tre', nuk dërgohen mesazhet e sundimit të ligjit kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Kush dëshiron replikë prej jush? Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Nuk e dija a po ma di emrin a jo, por ai ma përmendi emrin. Unë jam edhe Ismet Beqiri, edhe shëf i Grupit. Faleminderit! Ajo që po thotë zoti Gjini, mendoj që ne jemi Grup Parlamentar shumë serioz, të cilit, e them pa keqkuptim, nuk ka nevojë të na tregojë nëse është shkelur ligji, apo jo.

Nuk ka absolutisht nevojë të merret me moralizime të tilla. Unë e thashë qartë pse ne jemi kundër diçkaje që nuk qëndron dhe ka shumë arsye t'u kthehet komisioneve. Asgjë s'thamë më tepër, përpos asaj që edhe nuk janë rastet e njëjta dhe nuk mund me një vendim të njëjtë ose me rekomandim të trajtohen dy raste që janë të ndryshme në të njëjtën mënyrë. Nuk mund kjo kështu, duhen ndarë gjërat.

Le t'i ndajë Komisioni, le të konstatohet nëse ka pasur shkelje edhe për njërin edhe për tjetrin, por jo me një vendim, jo me një rekomandim.

KRYETARI: Ardian Gjini, një minutë kundër-replikë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit!

I nderuar deputet, kurrkush nuk foli për joseriozitet të grupeve parlamentare, mirëpo unë po ju them edhe një herë: dy kandidatë që janë në këtë listë, dy anëtarë që janë në këtë listë, e kanë shkelur ligjin dhe këta dy duhet të shkarkohen. Dhe, shtyrja kësaj e Kuvendit për t'i shkarkuar këta dy njerëz vetëm dërgon mesazh se kur janë anëtarët tanë, nuk dëshirojmë t'i shkarkojmë, duam edhe ta shkelim ligjin e të mos i shkarkojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Siç u tha edhe këtu në komisionin përkatës, ne e kemi shqyrtuar këtë çështje dhe janë gjetur se të dy anëtarët kanë bërë shkelje të ligjit, andaj Koalicioni për Kosovë të Re mendon se këto fakte janë reale, të vërteta dhe i përkrah rekomandimet e Komisionit Funkcional që të shkarkohen të dy anëtarët përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nënkryetari Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Mislim da je ova situacija čista i jasna, i da poslanička grupa SLS podržava predlog Funkcionalne komisije da se ova dva člana Saveta nezavisne Komisije za medije razreše jer je nedvosmisleno utvrđeno da se u oba člana kršila zakon, politički nije aktivno u vreme kada su bili članovi ovog nezavisnog tela. Dakle nisu shvatili uopšte svoju ulogu, tako da mi podržavamo predlog da se oni razreše.

KRYETARI: Në emër të Grupit "Zajednička Budućnost", Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsjedniče!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” razmatrala izveštaj Komisije, mi smo se usaglasili da nećemo podržati preporuku komisije, a sa druge strane isto želim da ponovim da i na komisiji dok smo raspravljali nije bilo jednoglasno odluke o ovom pitanju. Naše mišljenje je da nije bilo dovoljno čvrst i dokazaj pouzdanih da bi doneli ovakvu odluku. Znači ponavljam još jednom, mi ćemo biti protiv ove preporuke

KRYETARI: Janë lajmëruar katër deputetë për diskutim. Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më duhet t’i tregoj edhe një herë Kuvendit që Aleanca që në ditët e para të emërimit të kryetarit zotit Shefki Ukaj ka treguar që ka bërë shkelje të ligjit. Në atë kohë asnjë anëtar i asnjë partie politike nuk më ka përkrahur.

Ju kam treguar që nga fillimi se menjëherë kemi parë që ai njeri ka bërë shkelje, ne jemi prononcuar për të dhënë dorëheqje zotëria në fjalë. Dhe, tani të mendohet edhe për zonjën në fjalë, kur ne e dimë se ka shkelje të ligjit, e të diskutojmë këtu e të flasim për rekomandimet dhe anasjelltas kthehemi në komisione të ndryshme, kjo është e pakuptimtë.

Kryetar, njëherë e përgjithmonë, të gjitha partitë politike duhet të jenë serioze, cilido anëtar qoftë, i cilido subjekt qoftë, që bën shkelje të ligjit të mos ndalemi të diskutojmë nëse ka shkelje, apo s’ka.

Fuqishëm e kam thënë, po e them edhe sot: ka pasur shkelje të ligjit në momentin që njihet si anëtar i Komisionit, jemi mashtruar nga zotëria në fjalë. Thjesht, nuk ka sjellë dokumente se ka qenë anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës dhe ne kur e kemi ditur që ai ka qenë anëtar, unë personalisht kam reaguar dhe shkeljet kanë qysh atëherë. Është shkelje edhe sot e kësaj dite dhe nuk duhet të diskutohet shkarkimi i tyre.

KRYETARI: Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë

Unë për sqarim do të precizoj se përveçse kjo materie, e cila u prezantua dhe ky epilog i votimit në Komision nuk është diskutuar për performansën, prandaj nuk pati të drejtë deputetja, kolegja Izmaqi që të fillojë të diskutojë për performansën e individëve.

Nuk është e vërtetë që ka qenë temë, nuk është epilog performansa, dhe kjo edhe një herë e dëshmon se kemi nganjëherë edhe diçka personale.

Unë tani po e informoj edhe Kuvendin se me muaj të tërë e kam lutur Komisionin që t’i marrin dhe t’i analizojmë të gjitha institucionet e pavarura që i kemi e të shohim se cila është gjendja dhe në mënyrë selektive gjithmonë është thënë se ne do të diskutojmë vetëm për Komision. Të gjeturat e Komisionit dhe votimi është ky me epilogun që e keni përpara dhe le të jetë ky shembull i mirë se si fillohet, por unë po çuditem sesi ndërpritet

aty dhe nuk lejohet të diskutohet për asnjë institucion tjetër. Do të thotë, aty ku është imi 'mos prek', aty ku është i yti 'ka shkelje ligjore'.

Edhe është e vërtetë se janë evidentuar shkelje ligjore, por jam i befasuar në mungesën e vullnetit që të shkohet deri në fund me drejtësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Unë ia kujtoj kolegut tim Ferati që pikërisht unë në Komision kam kërkuar që të vijmë në shkarkim të gjithë anëtarët e Komisionit për arsye të performansës shumë të dobët. Mirëpo, në këtë rast kemi shkelje ligjore dhe këtë nuk mund ta përjashtojmë. Pra, edhe një herë nuk besoj që nuk e vëreni dhe nuk e dini që shkeljet vijnë konkretisht te neni 12.

Ndërsa, te performansa për anëtarët e tjerë po ashtu po them edhe një herë: unë kam kërkuar që të vijmë në përjashtim të gjithë. Të vijmë në shkarkim të gjithë për arsye të performansës së dobët. Kaq!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po më vjen shumë mirë që kaq zëshëm dhe kaq të vendosur jemi në mbrojtjen e ligjit. Do të doja që kështu ta shoh Kuvendin gjithëherë. Por, e vërteta është kështu apo nën këtë ka një hipokrizi, këtë e dinë të gjithë.

Kolegu Sadriu më parë foli edhe për komisionet, edhe për bordet tjera. Jo që nuk është ditur në fillim. Është ditur jo vetëm për këtë rast, por për të gjitha komisionet, që ka shkelje apo nuk ka shkelje. Po thirrmi formalisht në shkelje të ligjit dhe mirë që thirrmi edhe formalisht. Unë them për një rast, por di shumë raste, dhe do të doja që ky Kuvend ta formojë një komision dhe t'i hulumtojë të gjitha bordet dhe ta bëjë një raport për funksionalitetin e bordeve dhe mënyrën e zgjedhjes tyre.

Ta zëmë, po e ngre me emër: a nuk ishte po e njëjta shkelje, ndoshta edhe më e rëndë, kur e emëruat kryetar të Bordit për të dhënat e qytetarëve zotin Ruzhdi Jasharin? Po jua përkujtoj, ka qenë edhe anëtar i Asamblesë, shef i Grupit. Atëherë keni heshtur! Sa e sa njerëz i keni që janë në pension? Në pension janë dhe janë anëtarë të bordit! Nuk është shkelje kjo?!

Këtu i mbyllni sytë! Më vjen shumë keq kur me kaq vrull paraqiten këta të Aleancës, i dinë vetë, i kanë disa që i kanë në pension. Nëse dëshirojnë edhe me emra ua them. Por, edhe Partia Demokratike.

(Ndërhyrje: Thuaji, thuaji!)

Po, i di ti! Pikërisht në atë Komision të Ruzhdiut, shikoni, i keni!

Armendi po më thotë Drita Begolli, unë nuk e njoh Drita Begollin, por i njoh disa tjerë. Prandaj, kërkoj të formohet një komision dhe t'i hulumtojë kush janë ata dhe të vendosim vërtet në baza, të vendosim vërtet me parime, e jo në emër të parimeve me hipokrizi.

Ky është një revansh ndaj tij. Mund të ju them edhe diçka tjetër: raporti i Auditorit flet për shumë shkelje, për të cilat duhet të përgjigjet edhe stafi në atë bord. Janë të gjetura shumë serioze. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Si duket, edhe një herë me duhet t'i shpjegoj sendet krejt të qarta, krejt të pastra.

Këtë procedurë të shkarkimit nuk e ka nisur Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Kjo është nisur se dy njerëz e kanë shkelur ligjin. Nëse ju e nisni ndonjë procedurë për dikë që e ka shkelur ligjin dhe supozoni që është anëtar i Aleancës, po ju garantoj që do të votojmë, se është brutalisht e qartë. Por, edhe një send tjetër po ju tregoj: nuk është nisur procedura për shkarkim të këtij personi, edhe pse dihet që moti ka qenë i shkelur ligji, që kur është emëruar, për shkak se ju jeni marrë vesh me PDK-në, edhe i keni emëruar njerëzit e juaj në bord, edhe atëherë kurrkush s'ka dashur ta nisë këtë procedurë. Por, kur ka shkuar njëri, tash dikush e ka nisur procedurën ta shkarkojë edhe tjetrin.

Krejt në rregull, nëse ju mendoni që nuk është bash fer, por ligji është shkelur, letrat i keni përpara dhe nuk kemi nevojë ta shtyjmë më tepër. I keni shtyrë, krejt në rregull! Por, letra ka ardhur në Kuvend, qysh mund ta zgjatim më tepër kur e kemi letrën bardh e zi, që thotë është shkelur ligji. Veç kaq po them unë. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Në të vërtetë, nuk mund të mos e ruaj respektin për deputetin Gjini, por nuk është mirë të bëjë insinuata, sepse kush me kë është marrë vesh, është zgjedhja e guvernatorit, është zgjedhja pastaj e zëvendësguvernatorit etj., dhe kryetari i Bordit të AKP-së, qëndrimi në seancë... Mosni, unë ju lus, ne kemi folur për çështje procedurale dhe nuk është mirë për ta luajtur rolin e konspiracionit këtu kush me kë është marrë vesh, sepse ky është vendi i vogël dhe i dimë gjërat.

Ajo që ne e thamë, zoti kryetar, është që kemi kërkuar të respektohen procedurat për këtë rast. Nuk dëshiroj për ta ulur nivelin e diskutimit në këtë mënyrë, sepse edhe një herë po e them, në x-raste i dimë ne të kujt janë, si janë marrë vesh dhe nuk po e themi jeni marrë vesh me PDK-në, sepse qëndrimi në sallë në shumë raste flet vetë. Kur e kemi pasur mundësinë për t'ia humbur kuorumin dhe të mos dërgoni militantë partiakë guvernator, kryesuesin e Kuvendit të Shtimjes, Ruzhdi Jasharin sot e kemi drejtor për mbrojtjen e të dhënave personale, e shumë emra tjerë.

E dini se me përkrahjen e kujt është zgjedhur zoti Blerim Rexha kryetar i Bordit. Pra, ne po kërkojmë vetëm që procedurat të respektohen dhe nuk po themi asgjë më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë besoj se është e qartë për të gjithë. Nuk është propozim, as këto rekomandime nuk janë të asnjë grupi parlamentar, por janë rekomandime të një komisioni të këtij Kuvendi, që është i përbërë nga të gjitha partitë politike. Ky komision e ka kryer punën e vet në mënyrë të mrekullueshme, edhe pse edhe në Kryesi, edhe me seancë, është konstatuar se ka vepruar me vonesë. Megjithatë, më mirë vonë se sa kurrë.

Unë u bëj thirrje të gjitha komisioneve të tjera, le ta ndjekin shembullin e këtij komisioni dhe aty ku shohim dhe konstatojmë shkelje, le të veprojmë ashtu siç ka vepruar ky komision. Ju garantoj se Grupi Parlamentar i PDK-së do t'i përkrahë të gjithë dhe do t'i luftojë të gjitha dukuritë negative.

Këtu po shihet qartë se kur i dhemb dikujt, atëherë reagon, prandaj kjo është e papranueshme dhe ligjshmëria nuk mbrohet në këtë mënyrë. Parlamenti i Kosovës po vihet në lojë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dëshiroj pak qetësi në rast se ka mundësi. Duke marrë parasysh se ne po zgjedhim komisione ad hoc për përzgjedhjen e këtyre bordeve, unë mund të them e gjithë esenca qëndron te këto komisione që po i zgjedhin këta njerëz dhe e shkelin direkt ligjin. Të gjithë e dimë se së pari Komisioni ad hoc e ka shkelur ligjin dhe nuk e di pse po diskutojmë sot.

Keni kujdes nëpër komisione ad hoc a po zbatoni ligjin pikë për pikë, e të mos e vëmë Kuvendin në lajthitje dhe të thuhet se Kuvendi e ka shkelur ligjin. Ju lutem kujdes me njerëzit që i përzgjedhim nëpër komisione ad hoc. Sot nuk e di çka do të duhej të diskutohet më tepër, kur të gjithë e dimë se kjo është shkelje ligjore.

KRYETARI: Ardian Gjini, çfarë ke kërkuar? Replikë? E ke pasur fjalën për replikë! Me Rregullore, është kryer e drejta për replikë. Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kjo që po thuhet këtu, kjo hipokrizi i shkon për fytyrë vetëm PDK-së. Po të ndalej e t'i lexojë, t'i shohë punët e veta pak më ndryshe, nuk do t'i kishte humbur kohë kot edhe vetes, edhe deputetëve, edhe qytetarëve.

Me të vërtetë, kjo nuk është luftë për ligjshmëri në asnjë mënyrë, është luftë për një partizan në një aradhe të caktuar qysh janë mësuar të gjitha bordet t'i shndërrojnë në atë mënyrë, dhe po të ishte luftë për ligjshmëri, LDK-ja sigurisht se të gjitha angazhimet e veta, si më herët, por edhe tani, do t'i orientonte në këtë drejtim.

Lënda për këta tre emra as që ka qenë në komision. Ka qenë për zotin Hydaverd dhe për zonjën Vesna, por në mënyrë si di ta bëjë PDK-ja e ka futur edhe emrin tjetër.

Ne do ta përkrahim çdo ligjshmëri, por jo me hipokrizi, të cilën e di vetëm PDK-ja ta ngrejë në këtë formë.

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën. Më fal! Mocion procedural ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht për procedurë, atëherë edhe replika më duhet. Nuk kam kërkuar kundër-replikë për shkak se deputetit të fundit, i cili më përmendi nuk i pata replikuar. Do të jem i qartë, unë i replikova dikujt tjetër përpara, atëherë deputeti tjetër e përmendi emrin tënd dhe, sipas Rregullores, unë kam të drejtë përsëri të replikoj kur dikush ma përmend emrin. Ky është i treti që ma përmend emrin.

Dhe, pas këtij mocioni, kërkoj replikë. Faleminderit!

KRYETARI: Gabim e ke, prandaj vazhdojmë. Arben, shkurt, 2 minuta! Ti s'e ke marrë fjalën. Fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë veç e kam një pyetje sqaruese, këtë çështje nuk e kam shumë problematike, personalisht. Vendimin që e kam përpara thotë: të shkarkohen Shefki Ukaj, Nevzat Hydaverdi dhe Vesna Jovanoviq. Kuvendi po vihet në lajthitje: a po i shkarkojmë këta tre persona, apo është nxjerrë një vendim tjetër në komision? Kryesuesi i Komisionit nuk mund të nxjerrë vendim tjetër.

(Ndërhyrje)

Unë kërkoj që të jemi të qartë çka po votojmë. Me vendimin që e kemi përpara, ne po shkojmë në absurd. Kuvendi po e shkarkon një person të vdekur. Është absurd. Prandaj, kthehuni në komision, rregullojeni, e votojmë, i shkarkojmë. Pikë! Faleminderit!

KRYETARI: I ngarkuari nga komisioni për të raportuar e ka thënë për 2 kandidatë, këtij tjetrit i ka pushuar mandati dhe s'kemi nevojë të flasim për ta. Fjalën e ka, e fundit, deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Kryetar, në fakt kaloi debati dhe unë pajtohem plotësisht me atë që e tha zoti Gjini, le të hidhet në votim dhe ne të votojmë, sepse Kuvendi veç është vënë në lajthitje dhe këto justifikime të LDK-së nuk kanë kuptim më. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kam një vërejtje për komisionin dhe nuk është vetëm për këtë rast. Ky komision ka pasur mundësi t'ia sjellë Kuvendit kandidatët për të dyja bordet, edhe për Bordin e Komisionit të Pavarur për Media, edhe për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe kandidatët që vërtet kanë merituar të jenë nëpër ato borde janë eliminuar, qoftë pa ardhur në Kuvend, qoftë edhe kur kanë ardhur në Kuvend. Edhe ky Kuvend ka eliminuar njerëz që kanë merituar të jenë drejtues të atyre bordeve. Të njëjtën gjë, i njëjti komision e ka bërë edhe me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Realisht, unë kërkoj nga komisionet që nëse kërkojnë ligjshmëri, atë ligjshmëri dhe atë drejtësi në ligjshmëri ta zbatojnë vetë në vendimet që i marrin dhe i sjellin në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Të pranishëm janë 108 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votimin e rekomandimit të komisionit. Votojmë tash! Vetëm me elektronikë!

(Ndërhyrje)

Konstatohet se me 59 vota për, 34 kundër, 6 abstenime, Kuvendi i shkarkoi dy kandidatët e mbetur për shkarkim.

Pra, Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e Shefki Ukajt dhe Vesna Jovanoviqit, anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Këtu e mbyllem seancën. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*